# HISTORIJA

PËR KLASËN E VIII TË SHKOLLËS TETËVJEÇARE
DHE PËR KLASËN E IV GJIMNAZ

„MUSTAFA BAKIJA"
PRISHTINË 1953

SHTYPET SI DORËSHKRIM

# HISTORIJA

## PËR KLASËN E VIII TË SHKOLLËS TETËVJEÇARE DHE PËR KLASËN E IV GJIMNAZ

"MUSTAFA BAKIJA"
SHTËPIJA BOTUESE KRAHINORE
PRISHTINË 1953

Hartoi:
Gojko M. Solariq

Përkëtheu nga serbishtja:
Jani Gjino

Redaktoi:
Mehmet Gjevori

# ZHVILLIMI I EKONOMIS KAPITALISTE TE POPUJT E JUGOSLLAVIS

## ZHVILLIMI I MARRËDHANJEVET KAPITALISTE DHE NDËRTIMI I ORGANIZATËS BORGJEZE SHTETNORE NË SËRBÍ

### Despotizmi i Milloshit dhe monopolizimi i tregtis

Princ Milloshi e muer mirë sundimin në duert e veta, dhe si nëpunës mâ i naltë turk në Pashallëk, rrëmbeu për vehte shum t'ardhuna. Ai, me ndihmën e Turqëve, u shlirue prej shum bashkëpunëtorëve të vet prej kryengritjes së parë, e sidomos prej atyne që e pengojshin për të vendosë despotizmin e tij. Për nji politikë të tillë Milloshin e ndihmuen njerëzit që dëshirojshin me u pasunue si njerëz t'oborrit të tij. Kur princi kryesuer muer në duert e veta mbledhjen e taksave për Sulltanin dhe dhanjen e të hollave spahijve, me rastin e mbledhjes së taksave ai mbante gjithëmonë nji pjesë të mirë për vehte, kurse dorëzonte mâ pak se sa mblidhte. Për mbledhjen dhe dhanjen e të hollave Turqëve Milloshi kishte nji numër të caktuem njerëzish. Ata i shërbejshin verbënisht dhe kryejshin gjithëshka që i urdhënonte ai. Despotizmi dukej në të gjitha drejtimet e politikës së Milloshit, e veçanisht në monopolizimin e tregëtis.

Mbassi në Sërbi nuk kishte ligjë të shkruem, por gadi të gjitha punët kryheshin simbas dëshirës së disa njerëzve, pra, as jeta dhe pasunija e njerëzve nuk ishte e sigurtë. Në nji situatë të këtillë Milloshi nuk çante kryet aq shum pse në vjetin 1830 dhe 1833 ishte garantue me hatisherifin e Sulltanit

për çdo njeri tregëtíja e lirë; por ai me njerëzit e tij mbante gjithënji monopolin e tregtís së jashtëme. Ortakët e tij blejshin kafshë t'imta dhe të trasha, e çojshin mb'at' anë Savës dhe Danubit n'Austrí dhe prej tyne kishin fitime të mëdha. Në qoftë se dikush tjetër guxonte me veprue ashtu, atëhere ai vente kryet në rrezik, sepse Milloshi me njerëzit e tij do t'a likuidonte si konkurent. Mbassi në duert e princ Milloshit gjindej mbarë politika e mbrendshëme, e njikohësisht edhe ajo juridike dhe financjare, mundësija e vetme për me e kufizue sundimin despotik të princit dhe me ndalue monopolizimin e tregtís ishte vetëm përpilimi i ligjit themeltar të shkruem — kushtetutës. Në këtë regjim despotik nuk zgjidheshin mjetet për të largue kundërshtarët politikë. Milloshi mund të vriste lirisht gjithëkend dhe të përvehtësonte pasunín e tij. Por mun për këtë u shtue pasigurimi edhe për ata njerëz që kryejshin urdhënat e tij dhe që njikohësisht pasunoheshin. Ata gjindeshin në rrezik se mos princit i mbetet syni edhe në pasunín e tyne ose të dyshonte në besnikín e tyne. Prandej shum bashkëpunëtorë t'afërm të tij ishin për ndryshimin e gjendjes në Sërbi dhe për kufizimin e sundimit të princit.

### Çashtja agrare, turbullimet popullore dhe kushtetuta e parë

Merita mâ e madhe e princ Milloshit ka qenë ajo se ai ishte vendosshmënisht kundër asaj që në Sërbi të ruhen marrëdhanjet feudale, dhe se punoi për zgjidhjen e çashtjes agrare. Ndonse këjo çashtje nuk u zgjidh në pikëpamje të drejtë demokratike, d. m. th. që toka e marrun prej Turqve t'u ndahej atyne që e punojnë, me gjithë atê u vendos se ata që punojnë tokën si blemës trashëgimtarë të mbeten pronarë të tokës. Toka, e cila mâ përpara i takonte klerit'musliman (Toka e xhamive), tash u takonte manastirëve dhe kishave. Kullosat dhe pyjet, të cilët i shfrytëzonte i gjithë katundi, u banë pasuni e Komunes dhe secili katundar kishte të drejtë që tue hapë nji pjesë të pyllit, atê pjesë ta këthejë në pronë të tij.

Shlirimi i katundarëve sërbë prej datyrimeve të mâparshëme feudale filloi në vjetin 1818 dhe përfundoi plotësisht

në Fruer të vjetit 1833. Në kuvend u vendos që të gjithë Sërbët të bâhen pronarë t'asaj toke ku gjindeshin n'atë vjet, dhe ishin të barazuem me ata që kishin të drejta qysh mâ përpara në tokat e tyne. »Spahillyku në Sërbi u asgjâsue për gjithëmonë«. Prej asaj kohe katundari u bâ pronar i tokës që punonte dhe mundte me marrë hua për të, me e ble dhe shitë.

Këto marrëdhanje të reja krijuen në Sërbi kushte të reja për prodhim mâ të madh dhe për zhvillim mâ të shpejtë të forcave në katund dhe qytet. Tash filloi koha e çeljes së rrahëve mâ të mëdhej nëpër pyje që këtheheshin në toka buke. Numri i dhenve dhe i dhive filloi me u pakësue, kurse nga ana tjetër u shtue numri i derrave; numri i kafshëve të trasha rritej ngadalë. Për të gjitha këto punë ishte i nevojshëm nji numër i madh duersh të forta, prandej filluen me u zhvillue mâ shpejt familjet që jetojshin në bashkësi mâ të mëdha se sa ato që kishin mâ pak fuqí punëtore.

Mbassi ruhej gjithënji »angarija për parín« deri në vjetin 1835), prijsat e nahijeve, bujqë — robët katundarë, priftënit dhe murgjët shfrytëzojshin gjithënji forcën punëtore pa pagesë të masave të gjana popullore. Ata duhej t'i punojshin angarije arat e tyne, të cilat jepshin prodhime mâ të mëdha. Për këtê shkak gjendja e katundarëve të vorfën keqësohej gjithënji, ndërsa pasanikët katundarë — me gjithë se nuk mujshin me u pasunue prej tregtís për arsye të monopolizimit të princ Milloshit dhe ortakëve të tij — pasunoheshin në llogari të katundarís së vorfën, tue shfrytëzue të drejtën »angari për parín«.

N'atë mënyrë me nji shpejtësi të madhe u krijue ndamja e popullsís së Sërbis në klasa, e njikohësisht edhe mosbarazimi ndërmjet njerëzve të klasës së pasun. Mâ në fund këjo gjendje shkaktoi mosmarrëveshtje.

Milloshi, për oborret e shumtë me derra dhe kafshë, kishte nevojë për nji sasi të madhe landë druni prej pylli. Poashtu tokat e tij të gjana dhe tregtija e monopolizueme kërkojshin shum duer punëtore. Pjesën mâ të madhe t'atyne punëve e kryejshin njerëzit »angari për parín«. Përveç atij shfrytëzimi kryheshin edhe shum veprime tjera simbas qejfit të tyne. Kundër këtij regjimi shtohej gjithënji pakënaqësija e katun-

darëve, e borgjezís nëpër qytete, e paris popullore dhe e nëpunësave të naltë.

U përgatitën tradhëti për me e rrëzue Milloshin, por ato u zbuluen dhe disa prej njerëzve u vranë. Poashtu u banë edhe përgatitje për turbullime, disa prej të cilave edhe u kryen. Nji prej këtyne ka qenë turbullimi i Gjakut (1825). Turbulluesat kërkojshin të pakësoheshin taksat dhe angarija, që tregëtija të jetë e lirë për të gjithë njerëzit, që kështu të përmirësohet gjendja e katundarís së vorfën. Në vendin Azanji (në nahijen e Smederevës) filloi turbullimin Milivoje Popoviçi - Gjak, tregtar, me të cilin u bashkue populli i atyne viseve. Turbullimi drejtohej kundër egërsís së teprueme të princit të nahijes Petër, i cili ishte nji prej njerëzve të besueshëm të princ Milloshit. Populli u çue kundër taksave të mëdha, e poashtu edhe kundër punës së disa organeve sunduesë, të cilët mbrojshin sundimin despotik të princ Milloshit. Ka pasë raste që me turbulluesat bashkoheshin edhe persona prej aradhëve që Milloshi çonte për të shue turbullimin.

Turbullimi i Gjakut nuk ishte i përgatitun mirë ideologjikisht, e as i organizuem mirë, prandej nuk u përhap, por u kufizue vetëm në nji hrahinë të vogël. Topolla ishte parapa si vend për t'u mbledhë kryengritësat, por mun aty turbullimi u mposht. Njisít e armatosuna të Milloshit u mbytën në gjak.

Mbas turbullimit të Gjakut pakënaqësija kundër despotizmit të Milloshit shtohej gjithënji e mâ tepër. Hatisherifi i sulltanit, në vjetin 1833, kufizoi mjaft sundimin e princit, por Milloshi vazhdonte me sundue me zotësi simbas dëshirës së vet. Prandej u krijue pakënaqësi gjithnji mâ e madhe ndërmjet nëpunësave mâ të naltë, të cilët në Sërbi përfaqësojshin byrokracín e parë. Interesat e tyne, të drejtueme kundër mënyrës së ndjekjes së politikës prej princit, n'atê çast u përputhën me kërkesat e masave popullore.

Në vjetin 1835 filloi turbullimi i ri, të cilin e drejtoi serdari i Resavës, Mileta Radojkoviqi. Simbas emnit të tij edhe turbullimi u quejt turbullimi i Miletës. Ajo u çue kundër tiranís së princit kryesuer; kryengritësat paraqitën kërkesën që sundimi i tyne të kufizohet me kushtetutën dhe masat tjera ligjore.

Kur gadi 5000 burra mbërrijtën në Kragujevc me kërkue kushtetutën, princ Milloshi nuk gjindej aty, ndërsa Tomo Vuçiq - Perishiq dhe Dimitër Davidoviqi u premtuen se do të përpilojnë kushtetutën, e kështu në këtë mënyrë e larguen popullin, i cili u shpërnda.

Ky turbullim e frigësoi princ Milloshin dhe prandej pranoi që të përpilohet kushtetuta. Projektin e kushtetutës e dha Dimitër Davidoviqi, ministër dhe këshilltar i princit. Në Fruer të vjetit 1835 u thirr kuvendi populluer në Kragujevc dhe në Sretenjë u hap me fjalimin e princit. Kushtetuta e parë serbe u shpall në nji mënyrë shum madhështore, dhe u quejt Kushtetuta e Sretenjës.

Këjo kushtetutë ishte përpilue me frymë demokratike mbassi parashifte ndamjen e sundimit ndërmjet princit dhe Këshillit. Kuvendi populluer përbâhej prej njiqind deputetësh, të cilët i zgjidhte populli. Simbas kushtetutës, asnji ligj mbi taksat nuk mund të jepej pa pëlqimin e kuvendit populluer. Kushtetuta parashifte pamvarësín e gjyqeve dhe u garantonte të gjithë njerëzve barazi përpara gjyqit.

Kushtetutën e Sretenjës duhej t'a aprovonte Porta, si pushtet suprem mbi Sërbín. Ndërkaq, qeverija turke dhe sulltani, tue u marrë vesht me përfaqësuesin rus dhe austrijak në Stamboll, nuk e pranuen për shkak të demokratizimit të saj, kështu që nuk mujti me u zbatue.

Pjesa dërmuese e popullit sërb nuk mundëte e as që donte që Sërbija të qeverisej pa ligj kushtetute, prandej vazhdoi luftën e vet për kushtetutë. Në këtë mënyrë sùlltani dhe Porta u detyruen që në vjetin 1838 t'i japin nji Hatisherif, i cili në Sërbi u quejt Kushtetutë turke. Me këtë kushtetutë u kufizue sundimi i princit suprem dhe iu dhanë shum të drejta këshillit, anëtarët e të cilit ishin të përherëshëm. Kështu në Sërbi u kufizue sundimi i princit suprem.

Me këtë gjendje të re nuk u pajtue princ Milloshi, mbassi nuk mund të largonte anëtarët e Këshillit prej vendeve të tyne, madjé edhe kur ata ishin kundërshtarë të politikës së tij. Prandej, në vjetin 1839 ai e lëshoi fronin si princ dhe shkoi në Rumani ku kishte nji pasuni të madhe toke.

Mbassi i biri i Milloshit Mihajli ishte ende i mitun dhe nuk mundëte me marrë sundimin, në Sërbi, u krijue regjenca, në të cilën hynë Jevrem Obrenoviqi, Avram Petroviqi dhe Tomo Vuçiq - Perishiq, që të tre prîjsa të Kryengritjes së dytë. Në vjetin 1840 e muer sundimin Mihajli, i cili u përpoq me futë politikën e sunduesit të pakufijshëm, ashtu sikurse i ati i tij. Mirëpo anëtarët e Këshillit, në saje t'urdhënave të Kushtetutës turke i ruejtën pozitat e tyne. Ata nuk e lëshuen sundimin prej duerve të veta, mbassi ai nuk mvarej as prej princit as prej popullit. Kundërshtimet ndërmjet princit dhe anëtarëve të Këshillit u ashpërsuen gjithënji e mâ shum, dhe në vjetin 1842 filloi konflikti. Tomo Vuçiqi filloi turbullimin kundër princit. Mihajli u nis me ushtri drejt Kragujevcit, por Vuçiqi i qëndroi me armë. Princi e humbi luftën dhe nëpër Beligrad kaloi n'Austrí. Ky qëndrim me armë kundër princit tregoi se Këshilli u bâ trup oligarhik, i cili shfrytëzon Kushtetutën turke, dhe se anëtarët e tij, me ndihmën e pjesëmarrjes së vet të përhershëme në Këshill e pa lejen e popullit u banë zotnuesit e kushtetutës politike në vend. Pse këthyen Statutin turk anëtarët e Këshillit u quejtën »mbrojtës të Kushtetutës«.

### Zyrat e para shtetnore; zanafilla e klasës qytetare dhe formimi i byrokracis

Kur Mihajli u largue prej Sërbije, për princ u proklamue Aleksandër Karagjorgjeviqi. N'ato ndryshime dinastike, mbrojtësat e kushtetutës i ndihmoi Turqija, prandej Rusija nuk ishte e kënaqun me politikën e tyne. Kuvendi i ri populluer në vjetin 1843 zgjodhi përsëri Karagjorgjeviqin, kështu që në regjimin e ri, mbrojtësat e kushtetutës e përforcuen plotësisht pozitën e tyne në pushtet.

Gjatë kohës së regjimit të mbrojtësave të kushtetutës, dalëngadalë u zhvilluen zyrat shtetnore, të cilat filluen të mbijnë qysh në Kryengritjen e dytë. Zyra e parë, zyra popullore, u këthye gjatë kohës së Milloshit në Zyrë princore. Në të të gjithë nëpunësat konsideroheshin si shërbëtorë të princit, por edhe vetë ata e ndjishin vehten si të tillë. Gjatë kohës së qeverís së parë të Milloshit dhe Mihajlit, Ministrit ishin plotësisht nën

sundimin e princit, ndërsa gjatë kohës së regjimit të kushtetutëmbrojtësave ministrat u banë faktorë politikë, dhe princi Aleksandër nuk mund të vepronte simbas dëshirës.

Kështilli i shtetit qysh prej themelimit të vet e deri te nxjerrja e kushtetutës turke nuk ka pasë luejtë ndonji rrol të posaçëm, por prej vjetit 1838 u bâ enti mâ i fuqishën shtetnuer në Sërbi. Kuvendi populluer në Sërbi nuk kishte kurrfarë fuqije deri sa klasa borgjeze nuk ishte forcue dhe bâ e pamvarun.

Gjyqet e parë u krijuen në Sërbi në vjetin 1820 dhe më 1821. Ata gjykojshin për vepra kriminaliteti dhe fajtorët i dënojshin mâ tepër me rrahje, mbassi burgjet, për shkak t'ushqimit, kushtojshin shtrejt.

Në vjetin 1823 u krijue Gjyqi i mbarë popullit sërb. Ai kryente gjykime vetëm në pashallëkun e Beligradit.

Regjimi i kushtetutëmbrojtësave ka pasë sukses n'organizimin e zyrave shtetnore. Ai vû themelet e organizatës borgjeze shtetnore. Këto zyra shërbejshin si mbështetje të politikës së Sërbís së pamvarun. N'atê kohë u krijue nji numër mâ i madh nëpunësash, të cilët ishin në shërbim të regjimit. Shërbëtorët e deriatëhershëm të princit u shndërruen në nëpunësa shtetnorë, dhe në këtê mënyrë ndërtojshin organizatën shtetnore bashkëkohore.

### Ngritja e borgjezis, zhvillimi i zejeve dhe i ekonomís monetare — ndamja e katundit në klasa shoqnore

Në periudhën e qeverimit të kushtetutëmbrojtësave, borgjezija sërbe mbërrijti me fitue autoritet të madh politik. Mbassi ajo klasë, në stadiumin fillestar të zhvillimit të vet ishte flamurtare e përparimit, këtheu të gjitha ngjarjet në Sërbi dhe shpejtësoi zhvillimin e tyne.

Në kohën e regjimit statutmbrojtës ekonomija në Sërbi fitoi pikëpamje të reja. Mënyra e vjetër patriarkale e prodhimit u orientue kah e reja, kah ajo kapitaliste. Ai kalim në mënyrën e prodhimit nuk u zhvillue shpejt, por mjaft ngadalë, e me gjith'atê ndihej përparim i vazhdueshëm. Mbassi n'Austrín fqîj mënyra e prodhimit tashmâ kishte kalue prej asaj mani-

fakture kah ajo kapitaliste, influenca e asaj toke fqîj në procesin e prodhimit në Sërbi ishte mjaft e fortë.

Kur borgjezija sërbe muer plotsisht pushtetin në duert e veta, filloi me shfrytëzue të gjithë mjetet për të shtue pasunít e veta. Në radhë të parë ajo e shtoi pasunin e vet nëpërmjet të tregëtís, dhe prandej muer karakter tregtar. Tregtija eksportuese u shtue mjaft, dhe në kohën prej vjetit 1843 deri në vjetin 1855 eksportimi prej Sërbís u dyfishue. Mâ shum eksportoheshin derra n'Austri. Numri i tregtarëve të mëdhej u rrit, dhe ky mâ shum në Beligrad, i cili filloi me u bâ qytet ku shpreheshin mâ fort dëshirat e borgjezís.

Mbassi tregtija ishte dega ekonomike që sillte mâ shum fryte, me atê merreshin jo vetëm tregtarët katundarë, por edhe zejtarët dhe nëpunësat e çdo lloji. Me ndihmën e tregtís u forcue ekonomija mall-të holla nëpërmjet t'eksportimit të landëve të përpunueme dhe importimit të mallit të gatshëm. Zejet e vjetra prej kohës turke filluen me ra, e në vend të tyne u dukën të rejat. Përpunoheshin sende simbas porosís, për shpenzuesat, me të cilët zejtarët kishin lidhje të drejtpërdrejtë; por zejtarët punojshin edhe për tregtoret që shitshin prodhime të zejtarëve — opinga, sheshe,[1]) litarë, spangë dhe të tjera.

Tregtarët pajisëshin tregtoret e tyne gjithënji e mâ shum me mall industrial të jashtëm prej të cilit kishin fitime të mëdha. Sërbís i mungojshin shum prodhimet teknike, kështu që malli i jashtëm shitej mjaft, kurse tregtarët kishin nji përqindje të madhe fitimi dhe krijojshin kapitalin spekulativ. Poashtu sikurse merreshin me tregti të gjithë njerëzit e çdo profesjoni, edhe me spekulim merreshin prej të parit e deri te i mbrami tue fillue prej tregtarëve të pasun dhe nëpunësave të naltë — byrokratëve, katundarëve dhe zejtarëve e deri te cikrrimtarët në qytete dhe katunde.

Kur u krijue borgjezija tregtare, ajo i kushtoi kujdes të madh xehtarís. U shtue eksploatimi në Majdan-Pek dhe në Kuçajë, u hap topshkrisja në Kragujevc. Kërkesa për pëlhura ndikoi për hapjen e endëses në Uzhicë, e cila për nji kohë mjaft të gjatë plotësonte vetëm nevojat lokale.

[1]) Sheshe = pantofla, heqe.

Me futjen e ekonomís mall-të holla dhe me paguemjen e taksave në të holla u ndryshuen marrëdhanjet jo vetëm në qytet por edhe në katund. Mbassi nuk kishte mjaft të holla në qarkullim, dhe mënyra e vjetër e ndërrimit të mallit tue u bâ tramp (me shkëmbim) po zhdukej me shpejtësi, veçanisht në katunde, gjendja ishte mjaft e vështirë për njerëzit e vorfën. Ata nuk mund të mbërrijshin aq lehtë me fitue aq sa të mundeshin me mbajtë gjallë familjet e tyne, prandej shpeshherë ishin të detyruem me marrë të holla hua. Merrshin hua prej nëpunësash, ose tregtarësh të cilët merrshin hua prej shtetit, pa kamatë ose me kamatë të vogël (4—6%). Ata nëpunësa po ato të holla i jepshin me shkue mâ tutje, u jepshin hua katundarëve dhe zejtarëve me nji interes prej 20%, 30% e deri në 50%, kurse shpeshherë me përqindje edhe mâ të madhe, dhe tue veprue kështu pasunoheshin në mënyrë spekulative.

Me sjelljet e këtilla të nëpunësave dhe tregtarëve të pasun u krijuen kushtet për ndamjen e shpejtë të katundit në klasa shoqnore, d. m. th. ndamja e qartë e shoqnís sërbe në tregtarë të pasun, byrokraci e naltë dhe turma të vorfuna të popullit, n'ata që mundën prej t'ardhunave të tyne vjetore t'i paguejnë shtetit detyrimet e veta dhe të mbajnë anëtarët e familjes së tyne, dhe n'ata, të cilët me punën e tyne në copën e vogël të tokës nuk mundën me i pague taksat e as me mbajtë familjen. Rrjedhimi i ndamjes në klasa shoqnore ka qenë ramja shkallë-shkallë e bashkësive (kooperativave) të vjetra dhe proletarizimi i nji sasije të madhe banorësh të katundit, të cilët filluen me ardhë gjithënji e mâ shum në qytet për të kërkue punë, për të fitue kafshoren e bukës dhe për të mbajtë familjet e veta.

### Qëndrimi i Sërbís në vjetin 1848 dhe në kohën e luftës së Krimés

Gjatë kohës së regjimit ligjmbrojtës sundimtari mâ i madh në Sërbi ka qenë Ilija Garashanini. Ai me nji grup njerëzish u përpoq me çue autoritetin e Sërbís ndërmjet Sllovenëve të Jugut dhe prej tyne me krijue qendrën për shlirimin e tyne.

Garashanini nën ndikimin e emigrantit polak Franjo Zakës (i cili ishte në shërbim të Francës) në vjetin 1844 shkroi arti-

kullin e vet »Nacertanije« (Drejtimi), në të cilin shfaqi mendimin e vet mbi atê se ç'drejtim duhet të ndjekë qeverija sërbe në politikën e vet të mbrendshëme dhe të jashtëme. Garashanini dëshironte që principata sërbe të fitojë për aleatë popujt që e rrethojshin. Ai donte »bashkim të popujve«, pa dallim feje, dhe kërkonte që të punojnë të gjithë për idén jugosllave.

Garashanini, mandej, kërkonte që Sllavët e Jugut të shlirohen prej ndikimit politik austriak dhe rus, si dhe prej mbisundimit ekonomik t'Austrís. «Drejtimi» ishte shkrimi i parë politik ndërmjet Sllavëve të Jugut, ku problemi i bashkimit të tyne u parashtrue si ideologji. Ai n'atê kohë i përgjigjej dëshirave të borgjezís së re sërbe.

Borgjezija e re erdhi në kohën e regjimit ligjmbrojtës nëpërmjet të Garashaninit caktoi qëndrimin e vet në çeshtjet që i takojshin ndodhinave përjashta kufijve të shtetit. Ajo poashtu tha fjalën e vet gjatë kohës së revolucjonit të vjetit 1848. Qysh mâ përpara kishin ndodhë mosmarrëveshje të vogla ndërmjet princit Aleksandër Karagjorgjeviq dhe prîjsave ligjmbrojtësa. Këjo mosmarrëveshtje veçanisht u dallue në nji çashtje të politikës së jashtëme, d. m. th. në çashtjen e revolucjonit në Hungari, në vjetin 1848. Princi, për interesa personale, dëshironte që Sërbija të mbetej plotësisht neutrale në përpjekjen ndërmjet Sërbëve të Vojvodinës, prîjsat e të cilëve ishin n'anën e Habzburgëve dhe të reaksjonit austriak, dhe Hungarezëve, të cilët luftojshin kundër hegjemonís s'Austrís dhe oborrit të Habzburgëve, për lirín dhe pamvarësín e vet. Populli sërb në principatë dëshironte me ndihmue Sërbët në Vojvodinë. Parija e ligjmbrojtësave shfrytëzoi për qëllimet e veta këtê mosmarrëveshtje ndërmjet princit dhe popullit dhe, si faktor vendimtar në politikë, u bashkuen me dëshirat e popullit. Prandej Sërbija ndihmoi luftën e Sërbëve në Vojvodinë kundër Hungarís tue dhanë të holla, armë dhe municjon, si dhe me aradhën e vullnetarëve nën komandën e Stefan Kniqaninit.

Përçamja ndërmjet princit dhe ligjmbrojtësave u bâ mâ e madhe në vjetin 1853, për arsye se princi dëshironte me

shpëtue prej mbisundimit të Këshillit të shtetit dhe kërkonte me i vû vetë ministrat dhe këshilltarët. Atê vjet filloi Lufta e Krimés, populli sërb ishte me Rusët dhe kërkoi që Sërbija të marrë pjesë n'anën e saj kundër Turqëve. Princi ishte i mendimit për neutralitet të plotë, për shkak të rrezikut prej Austrije. Këtê mosmarrëveshtje ndërmjet princit dhe popullit e shfrytëzuen ligjëmbrojtësat për me agjitue kundër princit. Me gjithë se Ilija Garashanini ishte nën ndikimin e politikës franceze, prap se prap foli kundër qëndrimit neutral të princit në lidhje me Luftën e Krimés, me qëllim për të dobësue ndikimin e princit në popull.

Rrjedhimi i grindjes ndërmjet princit dhe ligjmbrojtësave i shtyni këta të krijojnë nji trup, i cili të rregullonte marrëdhanjet ndërmjet princit dhe ministrave. Prandej Ilija Garashanini me nji dredhi dinake mujti me ia mbërrijtë qëllimit që t'aprovohej ligji që Kuvendi populluer të mblidhej më 28 Tetuer të vjetit 1858. Ky ligj ka nji randësi të madhe, mbassi âsht ligji i parë i këtij lloji në Sërbi. Në bazë të këtij, kah fundi i Nandorit të vjetit 1858 u zgjodh kuvendi i quejtun Kuvendi i Shën Andrés. Ai e rrëxoi prej fronit princuer Aleksandër Karagjorgjeviqin dhe luejti nji rrol me randësi në luftën e popullit sërb për liri qytetare dhe kushtetutë.

Kuvendi i Shën Andrés ka randësi, pse âsht i pari kuvend populluer në Sërbi, zgjedhë prej popullit në mënyrë moderne. Ai muer pushtetin mâ të naltë të shtetit në duert e veta. Në tê sundonte mendimi që Kuvendi populluer duhet të sjelli të gjithë ligjët e jo vetëm buxhetin si ka qenë mâ përpara. Ky kuvend ua muer Këshillit e princit disa të drejta të mâparëshme dhe solli »Ligjin e ri mbi Kuvendin populluer«, në të cilin ndodhej nji kapitull për shtypin e lirë. Ky ishte përparim i madh për Sërbín e vogël, e cila ishte ende nën suverenitetin e sulltanit turk. Puna e Kuvendit të shën Andrés ka forcue bukur shum aspiratat e popullit sërb, të cilat qysh mâ parë çfaqeshin në tê.

## Regjimi absolutist i Mihail Obrenoviqit, puna në propagandën nacjonale dhe fitimi i qyteteve

Kuvendi i Shën Andreut vendosi që në fronin princuer të këthehet Milloshi plak. Ai nuk mund të pajtohej me Kushtetutën dhe me gjendjen e ré në vend, por nuk mujti me i asgjásue ligjët që ishin në fuqi. Ai nuk pajtohej as me idét politike, të cilat kishin zanë rrâjë në Sërbi gjatë mungesës së tij, kështu që ai ishte i pakënaqun. Por mbassi ishte plak, mbas nji kohe të shkurtë vdiq (në vjetin 1860).

Po n'atê vjet sundimin princuer e muer për të dytën herë Mihajli. Ai kaloi shum vjetë jashtë shtetit, kryesisht në Vjenë, dhe u pajis me idén e absolutizmit modern të shekullit të XVIII. Në fillim të sundimit të tij të dytë Mihajli bani mjaft ligjë themeltarë e për aprovimin e tyne nuk kërkoi leje prej Portës, me gjithë se Sërbija gjindej gjithënji nën suverenitetin e saj, kurse anëtarët e këshillit Mihajli i këtheu në nëpunës të vet. Ministrat u banë të mvarun te princi dhe konsideroheshin si sekretarë të tij. Kuvendi populluer muer karakter kryesisht këshillonjës dhe mblidhej për çdo tre vjetë, u vû cenzura, kështu që nuk kish mâ liri shtypi, ndërsa fletoret (gazetat) e opozitës nuk delshin mâ. Kështu Mihajli vendosi regjimin e vet personal që kishte të gjitha cilësít e absolutizmit.

Gjatë kohës së sundimit të vet, Mihajli kujtonte se misjoni i tij si princ sërb ishte me shlirue mbarë populin sërb prej suverenitetit turk dhe në këtê mënyrë të bashkojë nën mbrojtjen e vet të gjithë popujt e Ballkanit. Partizanë të politikës së tij ishin byrokracija e naltë dhe grupi politik liberal, i cili mbështetej në borgjezín dhe në nëpunësat.

Në vjetët e parë politika e Mihajlit pati sukses jo vetëm në Sërbi por edhe te Sërbët, të cilët ishin nën sundimin turk dhe të perandorís austrijake, e poashtu edhe te Jugosllavët tjerë. Besohej se Sërbija me format ligjore të princit, e veçanisht me formimin e «ushtrís popullore» në vjetin 1861 (50 000 ushtarë), do të kryente nji vepër të madhe për unjisimin e popujve jugosllavë. Ndikimi i propagandës së Sërbís ndihej edhe në Mal të Zi dhe në Bullgarí, veçanisht në vjetin 1862, kur diplomacija e Mihajlit mujti me bâ për vedi Rusín dhe Francën që

në konferencën në Stamboll të detyrojnë Turqín për të lëshue të gjithë qytetet e Sërbís.

Me gjithë se Rusija dhe Franca në vjetin 1862, në Konferencën e Stambollit kërkuen që ushtrija turke të tërhiqet prej qyteteve të Sërbís mbrenda katër muejve nuk mujtën me ia mbërrijtë qëllimit, mbassi për këtê kundërshtuen Anglija dhe Austrija. Anglija frigohej se mos po fiton Rusija influencë të madhe në shtetet ballkanikë, kurse Austrija poashtu kishte frigë së Sërbija plotësisht e pamvarun do të ndikojë edhe mâ fort të Jugosllavët, të cilët ishin në suazën e shtetit të vet. Ajo gjendje u ndryshue në fitim të Sërbís atëhere, kur Austrija e humbi luftën kundër Prusís në vjetin 1866, te Sadova. Anglija e ndryshoi qëndrimin e vet përsa i përket çashtjes Lindore, dhe në Prill të vjetit 1867 Sërbija fitoi qytetet: Uzhicë, Soko, Beligrad, Shabac, Smederevë dhe Kladovë. N'atê mënyrë politika e jashtëme e Mihajlit, tue u mbështetë në Rusín, pati suksesin e vet mâ të madh. Sërbija u bâ e pamvarun, por jo edhe shtet me suverenitet të plotë. Ajo, përkah pikëpamja ushtarake, ishte shteti mâ i fortë n'Europën juglindore: kishte nji ushtri prej 150 000 ushtarësh.

Përparimi i Sërbís së vjetit 1860 nuk u pëlqente Turqvet. Prandej, ata provokojshin Serbët, sidomos ushtarët e tyne në Beligrad, Soko e Uzhicë, ku kanë ra viktima të reja.

Ngjarja në Çukur çesme me 3 qershuer 1862 ka tronditë veçanisht marëdhanjet ndërmjet Sërbëvet e Turqvet. Atë ditë kah mbramja, si përherë, Beligradasit shkojshin me marrë ujë të fresktë, për të pasë natën. Në Çukur-çesmë (sod rruga e Dobraqinit) erdh edhe shërbëtori i ri Sava dhe vuni shtamën e vet me e mbushë. N'atê moment e ndeshën disa ushtarë turq, e tue mos pritë që ta mbushte Sava shtamën, nji Turk desht me përdhunë ta merrte ujin për vedi. Sava kundërshtoi, praudej Turku i mshoi në krye aq fort saqë djali ra vdekun. Për këtê vrapuen njerëzit që ndodheshin afër kësaj ngjarje. Grumbulli i njerëzve rritej dhe te Sërbët filloi protestimi kundër Turqvet. Simbas këshillës së përkthyesit sërb Turqit u ndanë prej grumbullit që të evitohej përleshja.

Afër Çukur-çesmës ndodhej kazerma turke. Kur Turqit të përcjellun prej Sërbve kaluen pranë saj, ushtarët shprazën pushkët dhe vranë ndërmjetësin sërb te qeveritarët turk dhe plaguen shum Serbë.

Të dy ngjarjet ıxitën Sërbët e ata u kundërshtuen Turqve. Shumkund hynë në përleshje. Gjendja u vështirësue. Turqit kanë pasë në qytetin e Kalemegdanit nji numër të madh ushtarësh t'armatosun mirë, ndërsa Sërbët kishin afsh për luftë, por nuk kishin mjaft armë. Dy politikâj kryesorë sërbë t'asaj kohe, Garashanini dhe Ristiqi ndërmjetësuen që të përfundojë çashtja në mënyrë paqësore. Mirëpo, sa ishin tue u krye bashkëfjalimet, Sërbët vranë nji oficer turk ndërsa ushtarët turk vranë nji oficer sërb e shum qytetarë. Kështu plasi lufta ndërmjet Sërbëve e Turqve në shum vende të Beligradit.

Në këtê ngjarje u përzinë edhe diplomatët e huej, të cilët e kishin pa ngjarjen. Me ndërmjetësimin e tyne dhe Garashaninit komandanti turk Atir Pasha pranoi që ushtrija të tërhiqet në fortesë. Dita e nesërme kaloi në qetësi, mirëpo me 5 qershuer filloi përsëri krisma e pushkëve.

Atë ditë Turqıt bombarduen Beligradin. Ky bombardim zgjatı katër orë e gjymës. Sërbët mâ luftarë rrokën armët dhe me to i kundërshtuen bombardimit turk. Këjo ngjarje ishte kulmi i përdhunimeve turke, prandej shkaktoi pezmatim të madh në tanë popullin e gjithashtu edhe te përfaqësuesit e shtetevet të huej.

Princ Mihajli muer pushtetin absolut në duert e veta me 6 qërshuer. Sërbët protestuen në Stamboll dhe treguen situatën në Beligrad. Ajo mund të zgjidhej vetën po të tërhiqeshin Turqit prej qyteteve, përndryshe, do të plasë lufta. Qëndrimi i tillë energjik i Sërbëve ndihmoj mâ së shumti që qysh në korrik të vjetit 1862 të thirrej konferenca e diplomatëve të huej në vendin e vogël Kanlixhi në Stamboll, me detyrë që ta zgjidhi mosmarrëveshjen sërbo-turke. Këjo mbledhje e diplomatëvet u thirr Konferenca e Stambollit.

Mbas këtyne ndodhinave, kur Mihajli ishte në kulmin e fuqís së vet dhe kur pritej që nacjonalizmi i tij revolucjonar do të realizojë premtimet e veta (luftën e popujve të Ballkanit

kundër Turqís dhe për krijimin e nji shteti të përbashktë prej Sërbís, Malit të Zi dhe Bullgarís), u pá se ajo dëshirë mbeti vetëm premtim. Borgjezija sunduese në Sërbi dhe regjimi absolut i princ Mihajlit nuk ishin në gjendje me realizue nji vepër kaq të madhe. As borgjezija e as princi nuk mujtën me shfrytëzue gjendjen revolucjonale nacjonale të shtresave të gjana të popujvet jugosllavë, mbassi këta nuk besojshin për nji jetë mâ të mirë në regjimin e Mihajlit. N'atê kohë në Sërbi nuk kishte liri fjale e poashtu nuk kishte as lirí shtypi mâ shum se n'Austrín reakcjonare. Fletoret sërbe në Vojvodinë shkruejshin dhe propagandojshin mâ lehtë idét revolucjonaro-nacjonale të Sllovenëve të Jugut se sa mujshin me e bâ këtê fletoret në Sërbí. Mihajli nuk deshti me e ndërrue këtê regjim absolutist me atê demokrat, i cili kishte me iu përshtatë gjendjes së lëvizjes përparimtare popullore. Prandej filloi ndamja ndërmjet Rinís së bashkueme sërbe, liberalëve dhe lëvizjes së Miletiqit në Vojvodinë. Grupimet politike të pakëna-quna punojshin kundër Mihajlit për shkak të punës së tij të ngadalshëme për unjisimin e Sllavëve në Ballkan. Rrjedhimi i fundit i këtyne kundërshtimeve ka qenë vrasja e prijsit Mihajl në Koshutnjak, në vjetin 1868.

Me gjithë frigsimet e mëdha të vetë princ Mihajlit, politika e tij ka nji randësi të madhe për popullin sërb. Ai bani shum vepra pozitive. Siguroi pamvarësín e shtetit dhe me shlirimin e qyteteve këputi kontrollin turk. Mandej, nguli themelet e organizimit ushtarak modern, ushtri e cila mund të mbronte vendin prej anmiqve të jashtëm dhe që shteteve të mëdha t'u garantonte se në Sërbi kishte me pasë paqë dhe rregull. Merita e tij mâ e madhe âsht se politika e tij ngriti ndërgjegjen nacjonale në shkallën e kuptimeve borgjeze t'asaj kohe dhe Sërbët i shpëtoi prej letargjís, në të cilën i kishin futë ligjëmbrojtësat. Ajo ndërdijë e re nacjonale hodhi rrezet e veta edhe jashtë kufinit të principatës së Sërbís, tue përfshi edhe krejt Jugosllavët tjerë.

**Rilindja kulturore e Sërbís dhe puna e Vuk Karaxhiqit**

Prej Kryengritjes së parë dhe dytë, në Sërbi, krahas me naltësimin e ndërdijës nacjonale, filloi me u shtue edhe numri

i njerëzve që dijshin lexim-shkrim. Shumica e tyne prej teritorit t'Austrís u hodh në Sërbi. Ata filluen me zanë pozitat me përgjegjësi n'administratë, e shpeshherë edhe pozitat me përgjegjësi politike. Ata njerëz prunë në Sërbi mënyrën e jetesës së shoqnís s'atjeshëme, që dallohej mjaft prej mënyrës së jetesës së katundarëve në Sërbi. Ata t'ardhun, prej Sërbëve në principatë quheshin «gjermanoshakë» për shkak se në të folun përdorshin shum fjalë gjermanishte dhe përpiqeshin që shum sende, madjé edhe mënyrën e mendimit, ta mbartëshin prej Austrije në Sërbi.

Qysh prej kohës së ligjmbrojtësave ajo gjendje u ndryshue mjaft mbassi n'atê kohë në Sërbi u çel nji numër mjaft i madh shkollash fillore dhe disa gjimnaze. Përveç kësaj u hapën edhe shkolla për amvise, shkolla bujqësore dhe akademija ushtarake. Për shkollat fillore, për ato të mesmet dhe shkollat e nalta u bâ edhe ligji për rregullimin dhe punën e tyne. Prej enteve kulturore u formuen Biblioteka popullore dhe Muzeumi.

Në gjysmën e parë të shekullit XIX, kur borgjezija filloi me u zhvillue si klasë, ndërmjet gjithë Sllovenëve filloi naltësimi i shpejtë i ndërdijës nacjonale. Ajo ndërdijë nacjonale kallxoi se Sllovenët e Jugut ishin mjaft të mbrapambetun në krahasim me popujt tjerë në pikëpamje kulturore. Ajo ishte rrjedhimi i pozitës së tyne të nënshtruem gjatë sundimit turk. Prandej të gjithë Sllavët e Jugut u përpoqën me krye sa mâ shpejtë rilindjen e tyne kulturore.

Me zhvillimin historik, klasa borgjeze erdhi në pushtet dhe krijoi bazën materjale për rilindjen kulturore; borgjezija u përpoq që rilindjen ta kryej me anën e letërsís, mbassi n'atê kohë nuk kishte kushte për hulumtime mâ të mëdha shkencore. Te Sërbët ky proces ishte i ngjajshëm me procesin e Jugosllovenëvet tjerë.

Borgjezís së re sërbe nuk i përshtatej gjuha ruso-sllave, e cila përdorej në kishë dhe në librat e shekullit të XVIII, mbassi tregtarët nuk e kuptojshin, e aq mâ pak me atê mundeshin me krye punët e veta. Prandej, gjuha letrare filloi me u bâ ajo e popullit.

Rilindja kulturore te Sërbët u zhvillue shpejt dhe vendosshmënisht në saje të punës së Vuk Stefan Karaxhiqit

(1787—1864). Mbassi Vuku ishte autodidakt dhe nuk vuente prej iluzjonesh të ndryshme, mujti me krye veprën revolucjonare në reformën e gjuhës dhe t'i vejë themelet kulturës kombtare sërbe.

Begatija e madhe që mëshihej në kangët popullore, në kallximet dhe në proverbat, Vuku i mblodhi dhe i përpunoi ashtu që ato u banë pronë e të gjitha klasave dhe profesjoneve.

Deri në kohën e Vukut shkrimtarët sërbë shkruejshin me nji gjuhë të përzieme sërbo-sllovene, të cilën populli nuk e kuptonte. Vuku, për bazë të gjuhës sërbe, muer gjuhën e thjeshtë popullore dhe vû parimin: »Shkruej ashtu si flet«. I udhëhequn prej atij parimi, nxuerr gramatikën e parë (në vjetin 1814) dhe fjalorin (në vjetin 1818). Këto dy vepra, bashkë me kangët popullore, me kallximet dhe proverbat, kryen revolucjonin në gjuhën sërbishte dhe krijuen kushtet për përhapjen e arsimit në turmat popullore.

Me gjithë se klasa qytetare sërbe në Vojvodinë ishte në shkallën mâ të naltë të zhvillimit, prap se prap aty nuk mujti me u krye ky shndërrim revolucjonar në gjuhë. Ai u krye në Sërbi, ku qysh prej kryengritjes së parë po shkëlqente shkëndija e përparimit. Edhe Vuku duel në votrën e kryengritjes së parë dhe mujti me u bâ flamurtar' i rilindjes kulturore në Sërbi.

Rruga e Vukut dhe mënyra e reformës së gjuhës dhe e drejtshkrimit nuk u pëlque qarqeve të vjetra kishëtare dhe politike të Sërbëve të Vojvodinës. Ata u çuen egërsisht kundër reformës gjuhësore. Mbas tyne shkoi edhe pushteti qeveritar në Sërbi në vjetin 1832, tue ndalue shtypjen e librave dhe fletoreve me drejtshkrimin e ri. Por ky qëndrim reakcjonar i jerarkís kishëtare dhe i Sërbís zyrëtare dështoi, mbassi zhvillimi historik kërkonte dishka të re dhe mâ të mirë. Mâ në fund e reja fitoi, Vuku u bâ ati i kulturës së re sërbe.

## MALI I ZI NË LUFTË PËR PAMVARËSI

### Luftat kundër Turqëve dhe Francezëve; lidhjet me Rusín

Në kuartalin e katërtë të shekullit të XVIII Mali i Zi luftoi kundër Turqëve nën udhëheqjen e despotit të vet Petër

Petroviqit të I (1784—1830). Pasha i Shkodrës, Mahmut Bushati filloi me bâ përgatitjet për luftë kundër Malit të Zi qysh në vjetin 1784. Në qytetet kufitarë të përforcuem Zhablak dhe Podgoricë dërgoi ushqim dhe veshje për ushtrín. Në Shkodër mblodhi ushtrín prej Shqipnís së Veriut dhe u mundue me bâ për vehte edhe disa fise hercegovase veçanisht Drobnjakët që të sulmojnë Malin e Zi. Mahmut Bushatit i shkoi për dore me bâ për vehte edhe disa prej parís së Malit të Zi që, bashkë me fiset e tyne, të jenë n'anën e tij, e jo me Malazezët tjerë.

Kur Malazezët mësuen për përgatitjet luftarake të pashës së Shkodrës, filluen edhe ata me u përgatitë për luftë. Guverneri i Malit të Zi, Radonjiqi, mendoi se do t'i shkonte për dore me e ndalue luftën në qoftë se i jep pashës dhurata, por u gabue. Me qenë se pasha vuni kushte që Malazezët nuk mujshin, ose nuk deshtën me i pranue, mbassi ishin fye, u thirr mbledhja e të gjitha nahijevet më 1875 në Cetinë, në të cilën u hodhën poshtë kërkesat e pashës.

Pasha i Shkodrës sulmoi me ushtrín e tij në Qershuer të vjetit 1785, hyni deri në Cetinë dhe dogji e shkatërroi edhe manastirin e Cetinës. Këjo luftë dështoi kryesisht prej mospajtimit që kishin ndërmjet tyne kryetarët e Malit të Zi dhe nga shkaku se disa sish luftuen n'anë t'anmikut.

Vjetin e ardhëshëm u këthye ipeshkvi Petri i I prej Rusís në Mal të Zi dhe filloi me pajtue fiset e ngatërrueme midis njeni tjetrit, me qëllim që të krijonte fuqín e qëndresës kundër Turqëve dhe kundër dhunimeve të tyne. Kur Rusija dhe Austrija banë përgatitjet për luftë kundër Turqís më 1787—1791, erdhën në Mal të Zi njerëzit e tyne dhe i shtynë Malazezët për t'u hudhë në luftë. Mbassi disa sish u munduen me fjalë e zotime të bukura për të bâ për vehte Malazezët që të mbajnë anën e Austrís, ndërsa të tjerët për Rusín, kryetarët malazezë u danë me shoshoqin, sepse ipeshkvi Petri i I ishte me Rusët, kurse guvernatori Radonjiq ishte me Austrín. Me gjithë atë Malazezët hynë në luftë n'anë t'aleatëve dhe luftuen kundër Turqëve me 1788 dhe më 1789. Luftimet mâ të mëdha u banë në Shpuzë dhe në Podgoricë; më 1790, kur Turqët sulmuen nga të dyja anët, Malazezët mujtën me u bâ ballë si duhet.

Kur këjo luftë e madhe kundër Turqís u krye me paqën e Svishtovit më 1791, dhe në Jashë më 1792, Mali i Zi nuk pati kurrfarë fitimi prej saj. Me paqën e Svishtovit u parapá vetëm amnestija për të gjithë ata Malazezë që muerën pjesë në luftën kundër Turqís. Në traktatin e paqës të lidhun në Jashë, Mali i Zi madjé nuk përmendet aspak.

Paqa e lidhun midis pashës së Shkodrës dhe Malazezëve nuk zgjati për shum kohë. Qysh në pranverën e vjetit 1792 Turqit filluen të sulmojnë Malin e Zi, por lufta të përgjakshëme dhe serioze u banë vetëm në vjetin 1796. Nën komandën e ipeshkvit Petër të I Malazezët ngadhnjyen në luftimet që banë në Martiniqe dhe në Kruse afër Podgoricës. Mahmud pasha u vra në Kruse. Kah ana e Turqëve ishin dhe Francezët, prandej Malalezët u damtuen shum prej kësaj lufte të re.

Me t'ardhun në fuqi ipeshkvi Petër i I u përpoq që të lidhë me Rusín marrëdhanje të ngushta e të marrë prej saj të holla dhe armë për luftën kundër Turqëve. Mirëpo kur mbërrijti në Rusi u prit anmiqsisht dhe u shtrëngue, me urdhën të princit Potemkin, të largohet prej vendit. Këjo pritje e panjerzishëme ia theu zemrën dhe e frigoi Petrin e I, por ai punoi edhe mâ tutje për të plotësue dëshirën e popullit të vet. Prandej përdori çdo rast tue i shpjegue Rusís se Malazezët janë me të e jo me Austrín, dhe se kanë për të bâ shkamos tue flijue çdo gjâ për luftën kundër Turqëve, n'anën e Rusís.

Qëndrimi i Rusís ndaj Malit të Zi u ndërrue në vjetin 1800. Prej asaj kohe Mali i Zi bâhet aleat i Rusís, jo vetëm në luftë kundër Turqëve, por edhe kundër Francës nën Napolonin e I. Këjo këthesë u bâ në vjetin 1800, kur anija ruse erdhi prej Korfuzi në Budvë ku shgarkoi nji sasi të madhe armësh dhe municjoni për Mal të Zi. Prej kësaj kohe Austrija humbi besimin në Mal të Zi, sepse me këtê u pá mâ se ky âsht me Rusín.

Perandoresha ruse Katarina e II dyshoi në Malin e Zi se mos bashkëpunonte me Austrín, por mbas vdekjes së saj marrëdhanjet u ndryshuen në të mirën e Malit të Zi, dhe Rusija caktoi për popullin malazez nga nji ndihmë vjetore prej 1000 dukatësh.

Kur Francezët nënshkruen paqën me Austrín më 1805, fituen Dalmacín. Ipeshkvi Petër i I muer me luftarët e vet Bokën e Kotorit, kurse kah deti e pat ndihmue flota ruse, e cila luftonte aso kohe kundër Napolonit. Prej anijave ruse u shgarkuen dhe aradha ushtarake, të cilat u erdhën në ndihmë Malazezëve. Kështu pra Petri i I luftoi kundër Francezëve dhe Turqëve tue marrë ndihmë prej Rusëve. Gjendja u ndryshue më 1807 n'atê kohë kur cari i Rusís Aleksandri i 8 lidhi me Napolonin e I paqën në Tilzit. Me urdhën të perandorit rus ipeshkvi u shtrëngue të dorëzojë Bokën për ta sundue Francezët. Këjo gjâ për Malazezët ishte nji grusht i randë dhe i papritun, të cilin e pritën me keqardhje.

### Puna e Petrit të I dhe e Petrit të II për mbarështrimin e mbrendëshëm të vendit dhe rrethanat ekonomiko-kulturore

Kah fundi i shekullit të XVIII dhe në gjysmën e parë të shekullit të XIX sundimi në Mal të Zi ishte theokratik, mbassi pushtetin epruer të vendit e mbante në duer të veta ipeshkvi i Cetinës. Këjo periudhë âsht e mbushun me lufta shlirimtare kundër Turqëve, por po në të njajtën kohë kryhet edhe procesi i kalimit prej organizatës fisnore n'atê shtetnore. N'atê proces ndikoi para së gjithash lufta shlirimtare, në të cilën disa prej fiseve malazeze bashkohen në nji bashkësi të vetëme, por n'atê kohë bâhen gjithashtu edhe disa ndryshime ekonomike. Këta dy faktorë rrisin ndryshimet në gjendjen ekonomike të disave, nga të cilat shpejtohet zhvillimi shoqnuer në Mal të Zi. Disa nga Malazezët mbajnë lidhje tregtare me qytetet nëpër teritorët turke, por edhe me vendet tregtare të Bokës së Kotorit, të cilët janë nën drejtimin e Austrís. Ky âsht nji prej shkaqeve që fiset malazeze, nën ndikimin e këtyne njerëzve autoritativë dhe të pasun, nuk ishin gjithmonë të bashkuem dhe që disa sish, nën ndikimin, e qyteteve tregtarë të teritorit turk, ishin me Turqit.

Për këtê gjendje Petri i I dhe Petri i II u detyruen me e drejtue punën e tyne politike për të çrranjosë sa mâ shpejt mbetuninat e organizatës së vjetër fisnore. Prej këtyne mbetuninave damin mâ të madh e ka pasë sjellë hakmarrja e gjakut,

e cila në të shumtën e rasave ka pasë qenë shkaku i luftave midis fiseve t'atyshëm. Këjo luftë ka pasë shpartallue fuqít e bashkimit të fiseve malazezë për shlirim prej pushtuesit turk. Prandej u pá e domosdoshëme që të bashkoheshin të gjithë fuqit fisnore dhe të krijohej organizata shtetnore, e cila ka për të pasë në duert e veta pushtetin e përgjithshëm dhe ka me qenë përmbi kryetarët e fiseve. Ky pushtet u detyrue të zhdukë vetqeverisjet e vjetra fisnore, në dobi t'interesava të përbashkëta dhe të përgjithshëme të popullit, sepse këta kanë pasë pengue nevojat e bashkësís.

Peshkopët e Cetinës kanë pasë mbi vehte detyra të randa: duhej me krijue pushtetin shtetnuer që bazohej në fise, por që në nji kohë me qenë mbi ta dhe t'i qeverisë këta fise. Petri i I me këtë rast themeloi gjyqe, të cilët qëndrojshin përmbi institucjonet e vjetra fisnore. Gjyqi si ent duhej t'ishte i detyrshëm për të gjithë Malazezët, pa marrë parasysh se në çfarë shkalle patën sundue institucjonet e ndryshme nëpër disa prej fiseve të vendit. Këjo tentativë e peshkopit Petri i I për të vendosë ligjët për të gjithë fiset në Mal të Zi hasi aso kohe në nji qëndresë të madhe. Me gjithë se kanuni u pranue në nji mbledhje, ku patën qenë thirrë të tanë fiset, nuk pat mundësi me u zbatue në praktikë. Por ipeshkvi ka tregue vullnet të fortë dhe nguli kambë sa mâ në fund ia duel në krye dhe fitoi përfundimisht, dhe aty kah fillimi i shekullit të XIX mujti me vû në fuqi gjyqin e përgjithëshëm fisnuer. Këjo punë pat nji randësi shum të madhe, mbassi atëhere duel në pah dëshira e njimendtë e bashkimit të fiseve malazezë. Me anë të këtij gjyqi u desht të çrranjoset hakmarrja e gjakut, e cila ka pasë shti përçamje midis fiseve të ndryshëm. Në këtë mënyrë u krijuen kushtet për organizimin e shtetit të përbashkët.

Kryetari fisnuer i Bjeliçëve, si edhe disa tjerë, të ndihmuem mâ tepër prej njerëzish të fiseve të tyne, nuk u pajtuen me entin gjyqsuer prandej ai nuk mujti me u zbatue në praktikë në kohën e Petrit të I, me gjithë se edhe përpjekjet e bame për t'u vendosë ishin nji hap përpara.

Se këjo gjâ âsht e saktë, shihet mâ mirë edhe me faktin se mbasardhësi i Pjetrit të I, Petri i II Njegoshi (1830—1851) mujti që gjatë kohës së sundimit të vet me krijue në Mal të Zi organe të rij sundimi, të cilët ishin në kundërshtim me organizatën e vjetër fisnore dhe përfaqësojshin bazat e para t'organizatës së shtetit borgjez. Në vjetin 1832 Petri i II thirri kuvendin, ku u vendos me krijue organe të rij sundimi, kurse mbas kësaj u krijue enti i senatit. Senati malazez përbâhej prej 12 deri 14 anëtarësh, prej fisesh të ndryshëm të Malit të Zi. Senati kryente punët e qeverís qendrore të Malit të Zi dhe ishte mbi të gjithë fiset. Përposë Senatit u krijue edhe »gvardija« (gjyqi i ulët), e poashtu u dukën edhe »perjanicët« (gjindarmërija). Të dy këta ente ishin nën urdhën të Senatit dhe kishin për detyrë me zbatue vendimet e tij, si dhe me përforcue sundimin e ri qendruer. Gjindarmët luejshin rrolin mâ me randësi për thyemjen e qëndresës së kryetarëve të fiseve kundër sundimit të ri. Këjo luftë ishte e ashpër dhe e rreptë; shpeshherë ajo ka pasë qenë ndjekë prej shum dhunimeve dhe vrasjeve të shumta politike.

Formimi i shtetit borgjez në Mal të Zi u krye nëpërmjet të dhunës, poashtu si edhe në vendet tjerë, mbassi partizanët e rendit të vjetër nuk deshtën me hy nën rendin e ri me të mirë.

Këto ndeshje t'ashpra në Mal të Zi u banë mâ të qarta kur erdhi Petri i II Njegoshi, i cili e hoqi titullin e guvernatorit që kishte zanafillë të vjetër, e edhe mâ shum atëhere kur u vendosën taksat. Nji numër i madh Malazezësh kundërshtoi me pague, por dalëngadalë detyrimet depërtuen në ndërdijen e popullit.

Ipeshkvi Petër i II u përpoq të përforcojë kufijt ndërmjet Malit të Zi dhe Turqís, por rreth çashtjes së Grahovës lindën shum vështirësina, mbassi Turqët nuk ndëgjojshin n'asnji mënyrë me ia lëshue até Malit të Zi.

Sundimi i Petrit të II ka randësi të madhe për Malin e Zi edhe në pikëpamje kulturore. N'até kohë pjesa mâ e madhe e popullit ishte analfabete dhe të pashkollë. Mbassi Njegoshi ishte vetë njeri i shkolluem dhe poet e shkrimtar i talentuem, u përpoq që në vendin e vet të vjetë themelet e parë të kulturës

shpirtnore. Në vjetin 1834 u themelue shkolla e parë në Mal të Zi e pak kohë mbas saj u ndërtue edhe shtypshkroja në Cetinë.

Petri i II e pasunoi letërsín jugosllave me disa vepra. Me veprën e tij mâ të ndëgjueme »Kunora e Maleve«, popullin sërb e bani të pavdekshëm ndërmjet popujve të kulturuem. Për motiv kryesuer muer ndodhit politike, zhdukjen e turkoshakëve në Mal të Zi. Si artist i madh në kangët e veta përshkroi shum momente prej jetës popullore të Malazezëve e kështu krijoi veprën e madhe të randësishme kulturore. Me veprën e tij Njegoshi paraqiti Malazezin në botën e jashtëme, mbassi »Kunora e maleve« âsht përkëthye në të gjitha gjuhët europjane.

### Princi Danillo dhe vendosja e sundimit të shejtë

Zhvillimi i Malit të Zi gjatë kohës së Petrit të I dhe Petrit të II mbërrijti deri n'atê shkallë sa që princi Danillo (1851—1860) nuk u fut mbrenda. Kështu u zhduk theokratija në Mal të Zi dhe u vendos sundimi i shejtë. Danillo, qysh prej fillimit të sundimit të vet dëshironte me e bâ Malin e Zi të pamvarun, të naltësojë autoritetin e tij dhe prej tij të krijojë shtet të pamvarun. Për me i mbërrijtë këto, atij iu desht me bâ nji luftë të vështirë në politikën e jashtëme dhe të mbrendshëme. Në fillim përsa i përket politikës së jashtëme — u mbështet në Rusín.

Për të krijue për shtetin e vet kufij sa mâ natyralë, ai filloi luftën kundër Turqëve. Malazezët pushtuen kështjellën turke Zhabljak në breg të Liqenit të Shkodrës. Mbassi princi Danillo ndihmoi përgatitjen e kryengritjes në Hercegovinë, Porta caktoi Ymer-Pashë Llatashin për të sulmue me armë Malin e Zi. U zhvillue nji luftë e ashpër dhe e përgjakshëme, ushtrija turke ishte mâ e madhe në numër dhe mâ e armatosun, prandej e shkeli Malin e Zi dhe dogji shum vende. Austrija dhe Rusija nuk mund të lejojshin që Mali i Zi të shkelet, prandej ndërhynë energjikisht, kështu që Porta urdhënoi që ushtrija e Omer pashës të tërhiqet, dhe në vjetin 1853, në Podgoricë nënshkroi paqë me Malin e Zi.

Rrjedhimet e kësaj lufte ishin të vështira për Malin e Zi të vogël, kurse organizimi i mbrendëshëm i vendit u kallxue si i vjetëruem. U pa qartë se ishte nevoja me u marrë sundimin prîjsave, me i nënshtrue dhe me vû në bazë të shëndoshë mbledhjen e taksave. Mali i Zi nuk ishte në gjendje me përforcue sundimin shtetnuer me ndihmat vjetore nga ana e Rusís dhe Austrís. Princi Danillo veproi pa kurrfarë taktike për kryemjen e këtyne detyrave. I dëboi kryetarët e fiseve, e në vend të tyne vuni nëpunës që mvareshin prej princit. Tash ushtrija filloi me u rregullue nën kontrollin e princit dhe me u mësue me qenë mâ e disiplinueme për të qenë sa mâ e fortë në rast lufte.

Kur përballoi rezistencën e mbrendshëme të disa fiseve, princi Danillo e përmblodhi krejt sundimin në duert e veta dhe vendosi absolutizmin, i cili u përshtatej krenëve të klasës sunduese në Mal të Zi. Për shkak t'absolutizmit të tij Danillo kishte shum anmiq personalë, e këjo paraqitte rrezik të madh për vendin, ku nuk ishte zhdukë ende zakoni i vjetër i hakmarrjes, e poashtu jetonte ende kulti i trimnís personale.

Gjatë luftës së Krimés Mali i Zi qëndroi neutral, por në Kongresin e Parizit në vjetin 1856, shtetet e mëdhej shtrinë protektoratin e tyne dhe mbi Malin e Zi, por Turqija nuk desht me bâ kurrfarë lëshimesh dhe konsideronte se Mali i Zi ásht gjithënji pjesë e shtetit të vet. Prandej princi Danillo iu lut Napolonit të III me shpallë njoftjen e pamvarësís së Malit të Zi. Princi shfrytëzoi situatën, mbassi dalloi njifarë mosmarrëveshtjesh ndërmjet shteteve të mëdha.

Kur në vjetin 1857 shpërtheu kryengritja në Hercegovinë nën prîjsin Llukë Vukanoviqin, Danilo e ndihmoi haptazi, prandej filloi lufta e re kundër Turqëve. Lufta e madhe u zhvillue më 1 Maj të vjetit 1858 në Grahovë. Aty Turqit u mujtën keq. Mbas kësaj fitorje, me ndërhymjen e Napolonit të III, u furmue komisjoni ndërkombëtar, i cili kishte për detyrë me caktue kufijt ndërmjet Malit të Zi dhe Turqís. Komisjoni vendosi që Malit të Zi t'i takojë Grahova, krahina e Nikshiqit, Lipova, Reçina dhe pjesa e Drobnjakut, Vasojeviqit dhe Kuçit, të cilët mâ përpara u takojshin Turqís. Me këtë zgjidhje Mali i Zi

fitoi kufîj mâ të mirë dhe njikohësisht u njoft si teritor i pamvarun nën suverenitetin e Sulltanit.

Këto suksese të mëdha të princ Danillos në politikën e jashtëme dhe në të mbrendshëmen nuk i asgjâsuen zakonet e vjetra të hakmarrjes, dhe në vjetin 1860, në Kotor, nji emigrant e vrau Danillon, por me këtê ai nuk mujti edhe me ndryshue gjendjen e krijueme. Sundimi i shêjtë dhe sundimi i centralizuem shtetnuer në Mal të Zi kishin ngulë thellë rrajët e veta dhe nuk mund t'asgjâsohej mâ vetëm me nji atentat.

# LËVIZJET NACJONALE TE POPUJT JUGOSLLAVË

## RILINDJA POPULLORE TE KROATËT

### Lufta kundër dëshirave centraliste të Vjenës dhe Peshtës

Perandorija Austriake futi centralizmin në mbarë teritorin e shtetit në shekullin e XVIII, në kohën e sundimit të Marija Terezës dhe të birit, Josifit të II. Njikohësisht u fut edhe gjermanizimi: gjermanishtja mbisundoi n'ushtri dhe në zyrat shtetnore. N'atê mënyrë Gjermanët u përpoqën për të mbisundue mbi gjithë jetën politike dhe t'asgjâsojnë privilegjet materjale të klasës sunduese feudale të bazuem në marrëveshtjet e Shekullit të mesëm. Centralizmi vjenez u mundue me e pengue kundërshtarin e vet mâ të rrezikshëm — Hungarín, e cila ishte toka mâ e pasun në krejt perandorín. Hungarezët u provokuen prej kësaj dhe dëshirojshin që me ndihmën e kushtetutës së klasës së vet të vjetër dhe tue ruejtë gjuhën hungarishte, jo vetëm me i qëndrue Austís, por edhe të shtrijnë sundimin e vet n'ato krahina, të cilat në bazë të marrëveshtjeve të ndryshme u takojshin mâ parë atyne se Austrís. Austrija dhe Hungarija kryesisht luftojshin rreth çashtjes se kujt do t'i mbetej mbisundimi për bregdetin kroat t'Adriatikut.

Kësaj lufte ndërmjet Austrís dhe Hungarís për të siguruedaljen në det i kundërshtoi Kroacija me qëndrimin e vet ndaj Hungarís. Politika vjeneze shfrytëzoi mosmarrëveshtjet ndërmjet klasave sunduese të fisnís kroate e hungareze, por Vojna Krajinën nuk desht me e bashkue me banën e Kroacís, mbassi

n'atê mënyrë humbte ndikimin e drejtpërdrejt nën nji pjesë mjaft të madhe të vendeve kroate. Po i njajti rast ishte edhe me Dalmacín, e cila në Kongresin e Vjenës, në vjetin 1814—1815, i takonte Austrís.

Oborri vjenez u përpoq vendosmënisht me mbrojtë interesat e dinastís austriake dhe t'ekonomís, prandej e kundërshtoi futjen e hungarizimit në Kroaci; ai u përpoq që me anën e gjermanishtes të përhapë influencën e vet dhe lejoi që deri në njifarë shkalle të kufizueme të zhvillohen aspiratat e rilindjes se borgjezís së re kroate. Për shkak të politikës taktike të tillë nga ana e Vjenës në decentet e para të shekullit të XIX, te nji pjesë e fisnikëve[1]) kroatë dhe te borgjezija e re u krijue besimi se obori i Vjenës âsht me Hungarezët. Por në vjetin 1826 ata e panë se Vjena as që mendonte me ia bashkue Vojna Krajinën banës së Kroacís, tue pasë frigë se n'atê mënyrë do të përforcohej Hungarija.

Në luftë ndërmjet Vjenës dhe Peshtës perandorit austriak iu desht që dalëngadalë të tërhiqej dhe t'u bâjë lëshime Hungarezëve. Këtê situatë e shfrytëzoi fisnikija hungareze dhe kërkoi që Kroacín ta këthejë në pjesë të shtetit të vet. Edhe fisnikija kroate, për shkak t'interesave të klasës së vet, dalëngadalë iu afrue botëkuptimeve hungareze, mbassi në luftën e përbashkët kundër absolutizmit vjenez mujshin me i ruejtë mâ mirë privilegjet e klasës.

Ajo lidhje e fisnikís kroate e hungareze si klasë sunduese në Kroaci mundësoi që në vjetin 1827 të marrë vendimin për futjen e gjuhës hungareze në shkollat kroate. Atëhere fisnikët kroatë nuk mendojshin ende për t'u kundërshtue qëllimeve hungareze, tue shfaqë aspiratë tjetër — që gjuha e vjetër të zëvendësohet me atë të nanës, me gjuhën kroatishtę. N'atê kohë ndihej endé mbisundimi i plotë politik i fisnikëve kroatë, të cilëve u përshtatej përdorimi i gjuhës latinë në Kuvend dhe politikë. Fisnikët e mësojshin mâ lehtë gjuhën gjermanishte dhe hungarishten se sa atê të popullit.

[1]) Fisnikë = bujarë, aristokratë.

## Lëvizja Ilire

Mbas vjetit 1830 nën ndikimin e Revolucjonit borgjez në Francë filloi pjekja e kushteve për idét e rilindjes në Kroaci, e cila mori idét demokratike prej Perëndimit. Në saje të mjeteve të veta materjale, ajo mujti me shkollue bijt e vet në shkollat e mesme dhe të nalta. Kështu shkallë-shkallë u rrit inteligjenca kroate, e cila zente pozitë n'entet shtetnore dhe private, kurse në jetën publike filloi me ndikue në fisnikët kroatë.

Në zhvillimin e tregtís dhe zejeve filloi me u bâ edhe ndamja në klasa shoqnore në Kroaci. Si përgjegje në shtypjen hungareze, së cilës fisnikët për shkak t'interesave të shtresës nuk i kundërshtuen, punët në politikë, filloi me i marrë në duert e veta borgjezija e re kroate. Mbassi borgjezija kroate dhe turmat e gjana popullore nuk kishin të drejta politike, së pari në vjetin 1832 filloi me punue për rilindjen kulturo-arsimore. E gjithë verprimtarija n'atê pikëpamje quhet l ë v i z j a i l i r e.

Titulli Ilir âsht përdorë si emën për kroatët dhe për Sllavët tjerë të Jugut, në kohën kur ndërdija nacjonale filloi me u formue, por nuk kishte marrë ende formën e plotë. Ai emën duhej të përfshinte të gjithë Sllavët e Jugut neutralë, dhe nuk ngjalli kurrfarë dyshimesh në Vjenë dhe në Peshtë mbi zgjimin e ndërdijes nacjonale te Kroatët. Këtê titull e ngjiti Ludevit Gaji, frymëzuesi kryesuer i rilindjes.

Ludevit Gaji lindi në Krapinë në vjetin 1809. U shkollue në Varazhdin dhe në Karllovc. Filozofín e mësoi në Grac, ku ishte anëtar i shoqatës studenteske «Klubi Ilir». Atje mësoi idiomën shtokavishte. Mâ vonë në Peshtë u muer me shkencat e jurisprudencës. Në vjetin 1830 shkroi libërthin «Udhëzime të shkurta për me shkrue drejt gjuhën kroato-sllovene». Me këtê bani reformën e parë të gjuhës kroatishte dhe në vend të kajkavishtes futi idiomën shtokavishte, që ishte me randësi të madhe për krijimin e kombësís kroate. Kur u këthye në Zagreb filloi me mbledhë rreth vehtes rinín e profesjoneve të ndryshme, e cila përhapi edhe mâ tej idét e rilindjes.

Bashkëpunëtorët e Gajit prej klasës qytetare, për shkak të realizimit të dëshirës së tyne politike, kërkuen mbështetje te

fisnikët, të cilët si klasë sunduese kishin të gjitha të drejtat politike, e nuk e kërkuen te bujqët katundarë pa të drejta, të cilët përbâjshin shumicën dërmuese të popullit kroat. Borgjezija e re kroate filloi me u bâ flamurtare e lëvizjes së re të rilindjes dhe i shkoi përdore me futë n'atê lëvizje edhe nji numër fisnikësh.

Mbassi Hungarezët, në luftën e tyne kundër Vjenës dëshirojshin me bâ për vehte sa mà shum njerëz, u munduen me lehtësue pak gjendjen e katundarís, prandej në vjetin 1836, në Sabor sulmuen të drejtat e vjetra feudale të Kroacís. Këjo manevër e politikës Hungareze ishte shkaku që nji numër i konsiderueshëm i fisnikëve kroatë u bashkue me Lëvijzen ilire dhe punoi aktivisht në rilindje. Ideologu kryesuer politik i Lëvizjes Ilire u bâ konti Janko Drashkoviqi.

Janko Drashkoviqi, në vjetin 1832 botoi shkrimin politik nën titullin «Dizertacjoni», dhe në të dha bazat e para të punës politike në Kroaci. Ai pranoi që në politikë të përdoret gjuha e popullit dhe jo latinishtja, në të cilën mbaheshin deri atëhere të gjitha ligjëratat politike. Në «Dizertacjonin» u kërkue bashkimi i Dalmacís, Rijekës dhe Vojna Krajinës me Kroacín dhe Sllovenín e «me kohë edhe Bosnja do të hyjë në suazën e Kroacis». Mâ tej në programin e Drashkoviqit kërkohet që të ndihmohet zhvillimi i tregtís dhe për até të jepen kredi, si edhe të demokratizohet shkolla për arsimimin e shtresave të gjana. Por, nga ana tjetër, ai program pajtohej për ruejtjen e rendit feudal, mbassi i porositte feudalët se ata duhet të sillen kundrejt bujqëve robë si prindë. Drashkoviqi nuk këshilloi se bujqëve duhej me u dhanë lirín, të cilën ata dëshirojshin me e fitue qoftë edhe tue e ble, por këshillon që fisnikët duhet të ndihmojnë bujqët, mbassi ata mund t'i damtojnë randë kur të vijnë «vjetët e vështirë».

Fisnikíja kroate frigohej prej revolucjonit të katundarís, prandej pjesënisht u bashkue me Lëvizjen ilire, e cila ishte e para që parashtroi çashtjen për zhdukjen e ndryshimeve ndërmjet klasave shoqnore. Pjesa e fisnikëve që bashkëpunonte me borgjezín e re kroate ishte për atê që bujkrobët t'arsimohen në shkollat fillore, por nuk pranojshin që t'u jepen të drejta

politike. Prandej Lëvizja ilire, si rilindje, pati mâ shum randësi kulturo-ekonomike se sa politike.

Gaji, në vjetin 1835, filloi me nxjerrë në Zagreb fletoren «Gazeta kroate», me shtesën letrare «Afërdita kroate, sllovene dhe dalmatinë«. Fryt i madh kulturuer ishte themelini i shtypshkrojës (1837), e cila u quejt »Shtypshkroja e Gajit«. Ajo shtypte libra dhe gazeta, e në këtë mënyrë mundësoi që qysh prej vjetit 1838 filluen të hapen salla leximi nëpër qytetet dhe vende mâ të mëdhej. Sallat e leximit filluen me u bâ qendra të dëshiravet nacjonale në grupet e mëdhaj të klasës qytetare. U themelue M a t i c a I l i r e për përparimin e gjuhës dhe të shkrimit ilir. Të gjitha ato fitore kulturore, në radhë të parë ndihmuen për naltësimin e ndërdijes së klasës qytetare, kurse katundari kroat mbeti gjithnji bujkrob pa kurrfarë të drejtash.

Mbassi Lëvizja ilire ishte lëvizje e borgjezís kroate, në të mujtën me u shprehë idét e politikës ekonomike. Në vjetin 1841 u formue «Shoqata e zotnijve», ku rriheshin problemat e eksportimit dhe të tregtís. Kroacija eksportonte drû (veçanisht dru lisi prej pyjeve të Sllavonís), venë dhe prodhime blegtorale: lëkura, lesh, brij kafshësh të trasha dhe vo. «Shoqata e zotnijve» punonte për ngritjen e industrís, e n'atë kohë u ndërtuen fabrika për pëlhura, lëkura dhe letër.

### Formimi i partive politike

Për shkak të zgjimit t'inteligjencës kroate dhe krijimit të ndërdijes nacjonale, si edhe për shkak t'asaj se nëpërmjet të rilindjes edhe nji numër i mirë fisnikësh i përfshiu mâ lehtë idét nacjonale — qeverija hungareze filloi me i kushtue kujdes mâ të madh ndodhivet në Kroaci. Shumica e fisnikëve kroatë në Lëvizjen ilire shifte rrezik të madh për klasën e vet dhe frigohej se mos humbëte sundimin dhe privilegjet e veta si klasë. Fisnikët frigoheshin mâ shum për shkak të zgjimit të turmave katundare, të cilat mund të bâjshin revolucjonin dhe t'asgjasojshin me forcë marrëdhanjet feudale. Prandej, fisnikët kroatë, me ndihmën e Hungarezêve, në vjetin 1841, organizuen Partín kroato-hungareze, me qëllim coptimi të për-

tizanëve të rilindjes popullore. Këtê parti Ilirët e quejtën »Hungareshe«, kurse partizanët e saj i thirrshin »hungaroshë«. Në krye të Partís hungareshe ishin kontat Aleksandër Drashkoviqi, Erdedi, Levini dhe Gjuro Rauhu.

Partizanët e Hungaroshëve ishin kundërshtarë të vendosun t' idiomës shtokaishte, e cila quhej «vllah». Poashtu ishin edhe kundërshtarë të emnit ilir, tue kërkue që n' administratë dhe në shkolla të futet gjuha ungarishte. Ata u munduen që të hungarizohet e tanë Kroacija. Hungaroshët për vehte flitshin se janë «të mirë Kroatët dhe Hungarezët» e njikohësisht fajtorët i paditëshin tue thanë se ata e çojnë Kroacín nën sundimin e Vjenës ose në prehën të Rusís, tue thanë se punojnë bashkë me Sërbët dhe Turqët. Këjo parti e parë zyrëtare në Kroaci — hungaroshja — përdorte gjithëfarë lloj mjetesh për të bâ për vehte pjesëtarë që t'i ndihmojshin në drejtimin e vet politik, e për këtê e ndihmonte politika zyrëtare e qeverís së Peshtës.

Në vjetët e parë Vjena e këqyrte me sy të mirë, kurse Ljudovit Gaji vuni marrëdhanje të mira me qarqet politikane austriake. Oborri i Vjenës kujtonte se nëpërmjet të ilirizmit do të forconte influencën e vet në Silovenët e Jugut e n'atê mënyrë të mundëte me marrë mâ lehtë mâ parë Bosnjën dhe Hercegovinën, e mandej edhe Sërbín. Këtê gjendje e preu kancelari austriak Meterniku. Në vjetin 1843, me urdhën të perandorit u ndalue përdorimi i çdo emni ilir. Prandej, partizanët e rilindjes popullore i ndërruen gjithkund emnat ilire në popullore. Mbas kësaj ndodhije gazetat muerën titullin «Gazeta të popullit«, kurse Lëvizja ilire u shndërrue në »Parti popullore«, e cila mori trajtat e veta themelore në vjetin 1841. Kryetar i Partís popullore u bâ Janko Drashkoviqi, i cili dha vijat themelore t'ideologjís së vet politike. Partizanët e Partís popullore thirreshin edhe mâ vonë me emnin e përgjithshëm — ilirë. Ata ishin romantikë të mëdhej, dhe me rastin e agjitacjonit të tyne shfrytëzojshin edhe formën e jashtëme për me u dallue prej të tjerëve, mbajshin «kësula të kuqe», veshje popullore, në brez hanxharë dhe revolverë, ndërsa në krahnuer shpata.

Qysh në kohën e themelimit të këtyne dy partive, në Kroaci filloi me u zhvillue ndërmjet tyne luftë e madhe, ve-

çanisht nëpër qytetet, ku shpeshherë mateshin edhe fizikisht. Nën ndikimin e Vjenës dhe Peshtës — si dhe për shkak të luftës s'ashpër ndërmjet partizanëve politikanë të këtyne dy partive, të cilat mbrojshin ideologji të kundërta — filloi ndamja ndërmjet ilirëve. N'anën popullore mbas nji kohe të shkurtë u formue krahu i djathtë, i cili ishte për bashkëpunim me oborrin perandorak në Vjenë dhe krahu i majtë, të cilin e përbâjshin njerëz të rij, që kërkojshin demokratizimin e jetës politike në Kroaci.

Detyra kryesore e partive politike në Kroaci n'atê kohë ishte — me përvehtësue në mbledhjet pozitat në krahinat. Partizanët e Partís popullore besojshin dhe ishin të bindun se do të kenë shumicën e votave, mbassi kështu dukej situata simbas gjendjes politike në Kroaci. Por, ndodhi e kundërta: Partija popullore humbi në votimet. Shkaku i këtij rezultati ishte pse «katundarët fisnikë», të cilët kishin të drejtë votimi, votuen për hungaroshakët dhe u bashkuen me fisnín feudale dhe jo me inteligjencën përparimtare kroate. Mbassi shumica e votuesave përbâhej prej fisnikësh dhe nëpunësash, partija e hungaroshëve, fitoi lehtë. Për shkak të këtyne rezultateve të votimeve situata politike në Kroaci u ashpërsue dhe filloi përpjekja e quejtun «Viktimat e Korrikut».

Më 29 Korrik të vjetit 1845, në Zagreb, në sheshin e Markut u bâ përpjekje e përgjakshëme. Përpjekja filloi midis poetit Marko Bogoviqit dhe togerit t'ushtrís që ruente oborrin e banit. Bogoviqi e sulmoi oficerin me shpatë, kurse ushtarët filluen, menjiherë me qitë me pushkë. Kur qitjet e pushkëve u ndalën, në shesh kishin mbetë shum qytetarë dhe ushtarë të vdekun dhe të plagosun. Këjo vërteton se edhe qytetarët gjuejtën me pushkët e veta kundër ushtarëve — roje.

Këjo ngjarje solli si rrjedhim dorëheqjen e banit kroat dhe coptimin e plotë të Partís popullore. Në sundim, me ndihmën e Vjenës, erdhi krahu i djathtë i Partís popullore, kurse njerëzit përparimtarë të së majtës u tërhoqën prej politikës aktive dhe iu kushtuen punës kulturo-shkencore. U themelue Muzeumi populluer, dhe në vjetin 1848, banka e parë në Kroaci. Në Kroaci këjo bankë u themelue me kapitalin e borgjezís dhe

qysh prej asaj kohe filloi me luejtë nji randësi të madhe në zhvillimin e ekonomís kapitaliste.

Puna e rilindjes në Kroaci pati sukses, mbassi për qëllimet e veta bani për vehte nji pjesë të madhe të fisnikëve. Ndërsa, ndikimi i saj në turmat katundare, gati nuk u ndi aspak. Lidhja ndërmjet fisnikëve kroatë dhe borgjezís nuk ishte e frytshëme: në vjetin 1847, në Kuvend u vendos që gjuha popullore të konsiderohet si gjuhë zyrëtare n'administratë dhe në politikën e Kuvendit. Këjo ishte nji fitore e madhe, mbassi për propozimin e Ivan Kukuljeviqit votuen edhe fisnikët, të cilët mâ përpara ishin për gjuhën latine.

Këjo fitore në kuvend nuk u ndi në turmat e gjana popullore; ajo do të duket qartë në vjetin tjetër revolucjonar, 1848.

## RILINDJA POPULLORE TE SLLOVENET

### Periudha e okupacjonit francez

Në fund të shekullit të XVIII fisnikët në Slloveni filluen me humbë gjithënji e mâ shum fuqín e vet n'ekonomi si dhe ndikimin e vet politik. Ky dobësim i klasës sunduese t'atëhershëm veçanisht u shpejtue në kohën e Revolucjonit të madh borgjez në Francë dhe në kohën e luftave të Napolonit në këto krahina. Okupacjoni Francez në Slloveni prej vjetit 1809 deri më 1813, në fillim për Sllovenët, don të thoshte ndryshim i madh në gjendjen politike dhe ekonomike, prandej ky ndërrim nuk u bâ pa hasë në kundërshtime. Por, mbassi Francezët futën liri mâ të madhe dhe marrëdhanje të reja, të cilat i ndihmuen borgjezís së re sllovene për të përparue mâ lehtë, Sllovenët e kuptuen se ato ndryshime e çuen kah e mbara — në kalim prej marrëdhanjeve të vjetra, në marrëdhanje të reja feudale, n'ato kapitaliste.

Sundimi ushtarak francez, mbas paqës së Vjenës në Vjetin 1809, organizoi Provincat ilire; këto përbâheshin prej krahinave jugosllovene: Kranjska, Korushka Jugore, Trieshta, Istra, Dalmacija dhe Dubrovniku, dhe nji pjesë e Kroacís tue fillue prej Kupës dhe Savës deri në Detin Adriatik. Qendra

politike dhe drejtonjëse e këtyne vendeve të pushtueme ishte Lubljana, kurse drejtuesi ishte marshali francez Marmoni.

Qeveritarët okupatorë francezë futën gjuhën popullore dhe ndërtuen shkolla ku mësohej gjuha. Në këtë mënyrë përforcohej sundimi populluer dhe ndjenjat nacjonale. Shum sllovenë kaluen n'anën e francezëve dhe muerën pozita të nalta në drejtimin e Provincës ilirjane. Kur qeverija franceze në Provincën ilirjane e zhduki feudalizmin, kur i shliroi katundarët prej detyrimeve feudale, (nji pjesë të prodhimeve bujqësore ishin të detyruem me ua dhanë zotnijve të vet) dhe kur ndaloi punën angari, te Sllovenët filloi shndërrim i madh dhe lindi simpathi ndaj Francezët.

Gjuha sllovenishte u bâ e barabartë me frangjishten, italishten dhe gjermanishten, e këjo ka nji randësi të madhe, mbassi qysh prej asaj kohe mujti me u zhvillue kultura nacjonale sllovene. Në krye të rilindjes popullore te Sllovenët qëndron poeti Valentin Vodniku (1759—1810), i cili u bâ themelues i letërsís nacjonale sllovene.

N'atë kohë shkallë-shkallë filloi me u rritë te Sllovenët ndërdija për kombësín dhe nevojën e bashkimit të popullit.

Ndikimi i sundimit të ri borgjez francez ndryshoi kushtet jo vetëm në fushën e kulturës dhe t'arsimit por edhe n'atë ekonomike dhe të komunikacjonit. Në vjetët e parë të rilindjes filloi të rritet eksploatimi i xeheroreve, tregtija filloi me u bâ mà e gjallë, kurse zejet muerën hov mâ të madh.

### Përforcimi ekonomik dhe zhvillimi i lëvizjes popullore

Gjendjen që krijoi sundimi francez nuk mujti mâ me e ndërrue plotësisht as Austrija, e cila mbas Kongresit të Vjenës në vjetin 1815, pushtoi rishtazi të gjitha krahinat sllovene. Me gjith'atë periudha prej largimit të francezëve deri në revolucjonin e vjetit 1848 ishte mjaft e vështirë për popullin sllovën. Dëshirën centraliste t'Austrís, kryeministri i së cilës ishte princi Meternih, reakcjonari mâ i madh i Europës s'atëhershëme, Sllovenët e ndijshin poashtu si edhe të gjithë popujt që ishin në suazë të perandorís Austriake.

Perandori austriak, në të vërtetë, në vjetin 1816, i shpalli përsëri krahinat e përvehtësueme për Mbretni Ilire, por

regjimi reakcjonar i Meternikut bani shtypje me të gjithë mjetet për të shue ndërdijën nacjonale te Sllovenët. Ajo shtypje u ndie në jetën politike dhe ekonomike. Sundimi austriak nuk la atê drejtësi që vunë Francezët, por as që mujti me u këthye përsëri zotnijve rrolin e dikurshëm në drejtimin e shtetit. Pozitat n'administratën shtetnore tash i merrshin njerëzit prej radhëve të fisnís borgjeze.

Austrija gjatë kohës së luftave me Napolonin e pá se sa të randësishëme janë xeheroret për përpunimin e hekurit dhe prodhimin e materjalit luftarak. Prandej nuk e pengoi aspak ekonomín xehtare, të cilën borgjezija përpiqej me e përparue. Mbassi në Slloveni kushtet për përpunimin e hekurit ishin të mira, në Kranjskë u ndërtuen industri të vogla për përpunimin e hekurit në vendet Sava dhe Javornik (te Jasenica), Bohinjë, kurse në Shtajerskë në Mislinjë. Në secilën prej këtyne sipërmarrjeve punojshin prej 500 deri më 800 punëtorë.

Që këto industri të mujshin me u pajisë me landë të para, e sidomos industrija austriake, në Slloveni filloi shfrytëzimi gjithënji mâ i madh i xeheroreve. Me nxjerrjen e zhivës n'Idri, të plumbit në Plajberk, në Medicë dhe në vendet tjerë, dhe me nxjerrjen e thëngjillgurit në Tërbovlje, Hrasnik, Zagorje, etj. gradualisht filluen me u forcue ekonomikisht edhe pronarët e atyne xeheroreve të shumta.

N'atê kohë u zhvilluen edhe tregtija e manifakturës e ajo e sendeve koloniale: e pëlhurave, qelqit, letrës, vojit dhe sheqerit. Ato filluen me pranue gjithënji numër mâ të madh punëtorësh, të cilët pjesënisht vijshin prej tokave austriake, por në nji sasi mjaft të madhe edhe prej katundeve sllovenë. Numri mâ i madh i atyne manifakturistëve ishin të huej, të cilët kishin futë kapitalet e veta në sipërmarrjet në teritoret e Sllovenís mbassi aty kishin në dispozicjon pasunít natyrore të vendit dhe forca të lira punëtore. Bashkë me kapitalistët e jashtëm, mâ shum me ata prej Vjenës dhe Peshtës, të cilët formuen sipërmarrjet, u pasunue edhe borgjezija vendase — nëpërmjet të tregtís, tue ble doganën dhe taksat e vendit, si edhe tue ble toka prej fisnikëve.

Katundari slloven, mbas Kongresit të Vjenës ra përsëri nën sundimin e fisnikëve të huej. Ai kishte mbërrijtë në nji gjendje me punue për interesat gjermane dhe italjane. Zotnijt e mëdhej të tokave filluen, me plehnue tokën dhe në të të mbjellin misër, patate dhe tërfojë, kështu që prej t'ardhunave të tyne kishin fitime të mëdha. Katundarët e vorfën, për shkak të shtimit të taksave, të punëve dhe detyrimevet tjera të ndryshme, kërkojshin me këputë marrëdhanjet feudale, mbassi ato ishin shum mâ të randa se në kohën e okupacjonit francez, kur paguejshin vetëm taksa dhe shërbejshin n'ushtri. Për shkak t'asaj gjendje të vështirë, katundarët sllovenë në luginën e Vipavës kundërshtuen me u pague tagra feudalëve të vet, por sundimtarët përdorën forcën ushtarake dhe kështu i detyruen për me u bindë. Me anën e ushtris, feudalët mujtën me shfrytëzue të drejtat e veta feudale, kështu që përdorshin edhe dënime fizike kur katundarët nuk plotësojshin detyrimet e veta. Gjendja e tillë solli si rrjedhim arratisjen e njerëzve në mal, gjâ, që n'atê kohë, në Slloveni ndodhte mjaft shpesh. Këta t'arratisun sulmojshin tokat e zotnijve e katundarët e pasun dhe i plaçkitshin, kurse ndihmojshin katundarët e vorfën të patokë.

Zhvillimi i lëvizjes punëtore, që filloi nën okupacjonin francez, u vazhdue edhe nën okupacjonin austriak. Qeverija e Vjenës ishte e detyrueme me ba disa lehtësina për gjuhën popullore sllovene. N'Universitetin e Gracit, disa profesora, me zanafillë sllovene, mbajshin ligjëratat e veta në gjuhën sllovene. Poashtu në Lubljanë kishte edhe Licé. Sllovenët filluen me përdorë gjithënji e mâ shum gjuhën popullore në shkollat fillore, por me gjith'atê gjuha gjermanishte mbisundonte në shkolla dhe n'administratë, mbassi ajo ishte gjuhë zyrëtare. Gjuha sllovene në shkollat e mesme ishte lanë krejtësisht mbas dore, mbassi aty ndihej coptimi i Sllovenëve në Kranjcë, Shtajerë, Korushë dhe Bregdet. Ndërmjet tyne egzistojshin dëshira separatiste.

Njerëzit që punojshin në rilindjen popullore në rasat mâ të shumta veprojshin secili në vendin e vet të ngushtë. Kështu në Kranjskë punoi peshkopi Anton Slomsheku me bashkëpunë-

torët e vet, në Shtajerskë Mikloshiq, Tërstenjak dhe Vraz, kurse në Goricë Velentin Staniqi.

Në këtë kohë dalëngadalë u zhvillue ndërdija për lidhjen e Sllovenëve, por në periudhën e rilindjes nuk dihej ende për bashkimin e popullit; këjo ndodhi mâ vonë.

**Dy rryma në shoqnín sllovene**

Flamurtarët e rilindjes sllovene përkah çashtja e gjuhës u ndanë në dy rryma, e këjo ndamje kaloi edhe në mbarë popullin. Njana rrymë ishte përparimtare, atê e udhëhiqte poeti Franc Presherni me bashkëpunëtorët e vet Çopon dhe Smokoleon. Ky grup mbështetej në traditat gjuhësore-letrare të reformimit slloven të shekullit të XVI, kurse idét e veta i shfaqte në gazetën «Kranjska Pçelica». Partizanët e kësaj rryme luftarake janë të njoftun nën emnin »Qarku i Preshernit« dhe u angazhuen për të fitue të drejta ekonomike dhe nacjonale për Sllovenët. Ata i kuptojshin nevojat e katundarëve dhe ndeshjet e tyne me feudalët, prandej kaluen vendosshmënisht n'anën e katundarís së vorfën dhe ishin për demokratizimin e lëvizjes nacjonale sllovene.

Rrymën tjetër në Rilindjen sllovene e përbâjshin njerëzit e mbledhun rreth dr. Janez Blajvajsit, profesor i shkollës së medicinës në Lubljanë, dhe grupet e ilirëve, të cilët futën prej Kroacís idét e Lëvizjes ilire.

Këjo rrymë bani për vehte jerarkín kishëtare, nëpunësat dhe borgjezín, dhe me kohë bani nji ndikim të fortë edhe te katundarët sllovenë. Partizanët e kësaj rryme këqyrshin me zgjidhë çashtjet politike vetëm tue bashkëpunue me sundimtarët austriakë. Përdorimi i gjuhës sllovene ën shkollat, simbas mendimit të tyne, mund të realizohej vetëm në qoftë se i shërbejshin me besniki sundimit austriak. Në këtë rrymë merrte pjesë edhe Jernej Kopitari, filologu i madh, i cili jetonte në Vjenë.

Qëndrimi i kësaj rryme konzervative ishte që reformat politike të kryhen në mënyrë që katundarët bujq-robë me i ble dalëngadalë prej spahijve të tyne. Kësi qëndrimi për shkëputjen e feudalizmit, ajo rrymë, kishte për arsye se kisha katolike në Slloveni ishte feudal i madh, kurse jerarkija e tyne gjindej

gati e tanë në Lëvizjen e rilindjes. Për katundarín e vorfën, bujkun-rob, këjo rrymë nuk ka aspak kuptim, kështu që e porosit me lexue lutje dhe që të mos kundërshtojë sundimin e ligjëshëm.

Janez Blajvajs, grupit të vet i afroi edhe partizanët e Lëvizjes ilire, kështu që të gjithë së bashku veprojshin në Lëvizjen e rilindjes.

Lëvizja ilire, në Kroaci luejti nji rrol pozitiv gjatë kohës së Rilindjes; porse, ideja e ilirasve që kroatishtja të bâhej gjuha kulturore e Sllovenëve ishte reakcjonare, dhe lufta e Sllovenëve që të shkonte n'atê rrugë ishte e dënueme me u shkatërrue qysh mâ përpara.

Këto dy rryma në Rilindjen sllovene kryen ndikimin e vet mbi popullin. Ana pozitive e kësaj rryme ishte pse ajo ngriti ndërdijen e popullit, si dhe ndërdijen e veçantë që te ai të krijohej ideja mbi Sllovenín dhe të kuptojshin se të gjithë i takojshin nji populli nën emnin e përbashkët Sllovenë.

Kundër kësaj veprimtarije, të huejt përdorën edhe partizanët të tyne në vend si dhe të gjithë mjetet që t'i këthejnë Sllovenët në shërbetorë të bindëshëm. Nji pengesë e madhe për sundimtarët e jashtëm ishte »Qarku i Preshernit«, kështu që ata ishin kundër kësaj rryme në Rilindje dhe përdorën të gjithë mjetet e sundimit të vet. Në kohën e Rilindjes nuk ishte e mjaftueshme ndërdija e njerëzve që të shkojshin mbas Preshernit, dhe prandej me ndihmën e sundimit austriak udhëheqësín politike në popullin slloven e muerën njerëzit e rrymës tjetër. Këjo ishte rryma e Bllajvajsit e cila u bante lëshime sundimtarëve austriakë, dhe me ndihmën e keqpërdorimeve të klerit, ligështuen rezistencën e popullit kundër regjimit të huej.

Me gjithë se gjatë Rilindjes në Sllloveni u banë gabime të mëdha, sidoqoftë ngjarjet në Sllloveni përparuen dhe e banë të vetën. Fitoi gjuha letrare, ajo gjuhë që predikonte Presherni, kurse Ljubljana u zhvillue në qendër të Sllovenís. Në të u zhvilluen shum ngjarje kryesore politike dhe kulturore, të cilat ishin me randësi për të gjithë Sllovenët.

## POPUJT JUGOSLLAVË NË VJETIN 1848

### Rrethanat ekonomike dhe shoqnore te Sërbët në Hungarín Jugore dhe revolucjoni i vjetit 1848. Asambleja e Majit në Karllovcin e Sremit.

Shumica e Sërbëve në Hungarín Jugore nuk ishin bujqrobë të pronarëve hungarezë. Në saje të këtyne privilegjëve ata gëzojshin njifarë autonomije fetare dhe kulturore dhe mund të merreshin me disa degë ekonomike. Pjesa mâ e madhe e popullit Sërb në Banat, Baçkë, Baranje dhe Srem merrej me punimin e tokës, kurse pjesa tjetër me zejtari dhe tregti. Mbassi Hungarija ishte krahina mâ e fortë dhe mâ e pasun në perandorín Austriake, Hungarezët ruejshin me kujdes të drejtat e veta të vjetra të fitueme me marrëveshtjet me perandorët austriakë. Fisnikët e mëdhej hungarezë kishin fjalën e parë në politikë, prandej përpiqeshin me asgjâsue ato privilegje që fituen Sërbët në Hungari, ose me i ulë n'atê shkallë sa që praktikisht mos kishin kurrfarë vlefte. Për shkak të qëndrimit të tillë të fisnikëve hungarezë Sërbët e kishin shum vështirë me u naltësue ekonomikisht.

Këto rrethana u ndryshuen shum kah fundi e shekullit të XVIII dhe në fillim të shekullit të XIX, kur në krejt teritorin e perandorís habzburge mbizotnoi manifaktura dhe depërtoi mjaft mënyra e re kapitaliste e prodhimit. Në Hungarín Jugore ishin pasunue krahinat bujqësore, të cilat jepshin sasi të mëdha prodhimesh bujqësore dhe blegtorale, kështu që u krijue mundësija për nji zhvillim mâ të madh të sipërmarrjeve manifakturiste dhe zejtare që përpunojshin ato prodhime. Në lidhje me përparimin e ri të bujqësís filloi me u ndi nevoja për shtimin e numrit të zejeve, të cilat pajisshin katundarët me prodhime zejtare.

Sërbët merreshin edhe mâ përpara me zeje, si njerëz të lirë, d. m. th. ushtarë, kur nuk ishin në lufta, e po këtê punë e vazhduen edhe kur pushuen luftat ndërmjet Austrís dhe Turqís. Kerrtarët e shumtë, farkatarët, remtarët, opingarët, shesheta rët, vozgatarët etj. dalëngadalë zgjanuen punëtorít e veta dhe filluen me shkue në vende mâ të mëdhej dhe në qytete, ku filluen me ndikue në ngjarjet e politikës lokale.

Nji pjesë mjaft e madhe Serbësh filloi me tregtue me kafshë dhe me prodhime bujqësore. Këta tregtarë, në saje t'aftësís së tyne, mbërrijtën në mjete mâ të mëdha materjale dhe filluen me ndikue në zgjidhjen e atyne çashtjeve që i pengojshin Serbët, të nënshtruem nën sundimtarët hungarezë. Sërbët tregtarë dhe zejtarët kishin mundësi materjale me shkollue bijt e tyne në shkollat e mesme dhe të nalta hungareze, e kështu u formue inteligjenca sërbe, e cila veproi në zhvillimin e mâtejshëm të rrethanave shoqnore politike te Sërbët në Hungarín Jugore.

Sërbët në Hungarín Jugore, prej shekullit të XVII ishin nën ndikim të madh të jerarkëve të kishës së vet, e ky ndikim u ruejtë edhe në gjysmën e parë të shekullit të XIX. Perandorët austriakë kujdesoheshin mâ shum për të mbetë të kënaqun feudalët hungarezë se sa Sërbët, të cilët i çmojshin vetëm si ushtarë të mirë që duhej të vriteshin për Vjenën dhe dinastín. Jerarhija kishëtare, për shkak të tokave të shumta i ruente dhe i mbronte privilegjet fetare të fitueme e njikohësisht mbronte edhe interesat e popullit sërb kundër fisnikëve hungarezë, të cilët dëshirojshin me i këthye të gjithë Sërbët në bujq-robë të vet. Prandej turmat e popullit sërb në Hungarín Jugore qëndrojshin mbas klerit të vet.

Në kushte të tilla u krijue borgjezija tregtare serbe, e cila kërkonte mundësi mâ të mëdha për kryemjen e punëve të veta. Në gjysmën e parë të shekullit të XIX ajo nuk ishte ende e zhvillueme mjaft për të mujtë me i nda dëshirat e veta prej atyne të jerarhis kishëtare, prandej të dy këta grupe shkuen bashkë dhe udhëhoqën popullin sërb në luftë për zgjanimin e autonomís kishëtaro-shkollore në politikë.

Në Fruer të vjetit 1848 kur plasi revolucjoni në Pariz dhe si ndonji tufan përfshiu të gjithë vendet që ishin nën drejtimin reakcjonar të kancelarit austriak Meternikut, në Hungari filluen me u zhvillue ngjarje të mëdha. Mbas kryengritjes se punëtorëve, studentave e qytetarëve në Vjenë e Berlin, shpërtheu me 15 Mars të vjetit 1848, kryengritja në Peshtë, e cila u shndërrue në revolucjon të popullit hungarez për me u shlirue prej Austrís dhe Habzburgëve.

Borgjezija hungareze mujti me futë në revolucion të gjitha klasat: punëtorët, katundarët, borgjezín dhe fisnikët, kështu që lufta nën udhëheqjen e Lojaç Koshutit dhe poetit Shandor Petefit mori nji karakter të përgjithëshëm kombtar, e Perandori austriak Ferdinandi, i friguem prej revolucjonit, u njohu Hungarezëve autonomín, me kusht që Hungarija të qëndrojë në suazë të perandorís, e lidhun me Austrín vetëm përsa i përket personit të perandorit. Qeverija e Vjenës nuk e njohti sinqerisht këtë vendim të perandorit, kështu që revolucjoni hungarez u vazhdue, dhe në Kuvendin në Peshtë u rrëxue dinastija e Habzburgëve.

Kur në sulmin e parë revolucjonar Hungarezët e rrëxuen sundimin austrijak në vendin e vet, udhëheqësat e revolucjonit nuk deshtën me u njohtë popujvet tjerë në teritorët e veta, kurrfarë të drejte për autonomi. Simbas mendimit të tyne, në teritorin e Hungarís kishte vetëm popull hungarez, e gjithë popujt tjerë duhet me iu përshtatë Hungarezëve.

Turmat e gjana të popullit sërb në fillim të revolucjonit e këqyrshin me simpati luftën e popullit kundër Vjenës, por, kur prej gjysmës së Marsit deri në Maj muerën drejtim të nacionalizmit hungaromadh, Sërbët u friguen për autonomín e tyne të parë dhe kaluen në taborrin kundërshtar.

Perandori i ri austriak Franc Jozefi i I dhe qeverija e tij i shfytëzuen këto mosmarrëveshtje ndërmjet Hungarezëve dhe Sërbëve, i banë për vehte krenët Sërbë për drejtimin e vet politik në luftë kundër revolucjonit Hungarez. Nën udhëheqjen e jerarkís kishëtare dhe të borgjezís, në vjetin 1848 u mblodh asambleja e madhe popullore në Karlovacín e Sremit. Këjo asamble vendosi dhe e shpalli Sremin, Banatin, Baçkën dhe Baranjën Vojvodinë të Sërbís. N'atë asamble për patrijark u zgjodh Josif Rajaçiqi, kurse për komandant të rojës së kufinit u zgjodh për vojvodë Stefan Shupljikasi. Këshilli populluer i zgjedhun duhej me u kujdesue për zbatimin e vendimeve të marruna n'Asamblén e Majit.

Për shkak të vendimeve t'Asamblés së Majit, Hungarezët u çuen në luftë kundër coptimit të teritorit të Hungarís dhe dërguen ushtrín e vet kundër Sërbëve. Sërbët në Vojvodinë organizuen qëndresën kundër kësaj ushtrije. Mbassi vdiq Stefan

Shupljikasi, njisít sërbe i komandoi Gjorgje Stratimiroviqi, por i erdhën edhe vullnetarë për ndihmë prej Sërbije, nën komandën e Stefan Kniqaninit. U zhvilluen lufta t'ashpra dhe Sërbët në nji vend te Senatomashi (ma vonë Sërbobrani) i mujtën njisít hungareze, por këto lufta nuk prunë kurrfarë zgjidhje, mbassi ushtrín revolucjonare hungareze nuk ishin t'afta me e asgjâsue as njisít austriake, nën komandën e Vindinshgresit, e as ato të Kroacís nën komandën e Josip Jelaçiqit, — deri sa në Mars të vjetit 1849 sulmuen trupat ruse, të cilat i dërgoi cari Nikolla i I, nën komandën e princit Paskijeviq.

### Asambleja e Marsit në Zagreb: kryengritja katundare — syprimimi i bujqëve-robë

Revolucjoni i vjetit 1848 përfshiu edhe Kroacín, ku u shtue gjithënji e mâ tepër pakënaqësija kundër politikës së Peshtës dhe Vjenës. Në partín popullore njerëzit u ndanë në dy taborre, të cilët përkah botëkuptimet e veta politike përfaqësojshin dy drejtime të kundërt. Nji palë ishin feudalo-ushtarakë dhe qarqe klerikë, të cilët i udhëhiqshin: konti Kulmar, peshkopi Heulik dhe koloneli Jelaçiq; të tjerët ishin flamurtarët e lëvizjes popullore revolucjonare tue pasë për prijsa baronin Kushlan, Vërbançiqin, Oreljin etj. Ky grup mbante drejtimin radikalo-demokrat për kërkimin e ndryshimeve politike dhe padyshim përfaqësonte shumicën e popullit kroat.

Më njizet e pesë Mars të vjetit 1848, u mbajtë në Zagreb Asambleja popullore, e cila në tridhetë pika përpunoi «kërkesat e popullit». Prej këtyne pikave shihet se Kroacija kërkoi rregullimin shtetnuer e shoqnuer. Asambleja e Marsit kërkoi anulimin e krahinave të vjetra, që sundimin në Kroaci ta merrte qeverija, e cila do të jetë përgjegjëse përpara Asambles. Asambleja e Kroacís duhej me qenë e përfaqësueme prej të gjitha shtresave. Asambleja përpiloi edhe ligjin e zgjedhjeve, i cili parashihte votime direkte. Në komunet së pari do të zgjidheshin kandidatët, e këta në qendrat e rrethit të zgjidhnin përfaqësuesat.

Asambleja e Marsit të vjetit 1848 ka nji randësi të madhe në historín e Kroacís, mbassi ajo do të thotë këthesë prej

feudalizmit të vjetër, në rendin e ri borgjez. Borgjezija e re kroate fitoi përkohësisht dhe syprimoi bujqët-robë dhe feudalizmin, e në këtë mënyrë mundësoi nji zhvillim më të shpejtë t'ekonomís dhe kulturës në Kroaci.

Dy muejt — Mars dhe Prill — përbâjnë etapën e parë të ngjarjeve revolucjonare në Kroaci, mbassi gjatë asaj kohe u zgjidhën shum çashtje politike. Propozimi i Gajit që asambleja të zgjedhë banin u pranue, prandej feudalët kroatë u friguen prej këtij vendimi. Për ata ishte e randësishme në se fronin e banit do ta merrte ndonji prej demokratëve prej Partís popullore ose ndonji njeri që do të pajtohej që të mbetën zotnijt e tokave. Prandej konti Kulmer e rregulloi çashtjen në Vjenë që në pozitën e banit të vinte Josip Jelaçiqi. Më 23 Mars perandori nënshkroi vendimin me të cilin Jelaçiqi u emnue për ban, kurse më 25 Mars, në votimet që u mbajtën në Zagreb duhej që populli kroat të kënaqë vetëm formën.

Me gjithë se Jelaçiqi i takonte reakcjonit, në muejt e parë, i detyruem prej krahut të majtë kroat, iu desht që si ban të bashkëpunoi me Asamblén, e cila mori vendime shum të randësishme. Asambleja kërkoi bashkimin e Vojna Krajinës, Dalmacís dhe Rijekës me Kroacín dhe Sllovenín në nji krahinë të përbashkët. Ajo poashtu kërkoi aleancë politike me Vojvodinën Sërbe dhe me trevat «austriake» Shtajerskën, Korushkën, Istrën dhe Goricën.

Në luftë kundër Hungarezëve, Jelaçiqin e ndihmoi edhe krahu i majtë kroat. Kur bani u dërgoi qarkore të gjitha krahinavet në Kroaci dhe Sllavoni, me të cilën ndalonte që të kryejshin urdhënat e Peshtës, ajo praktikisht preu lidhjet e deriatëhershëme ndërmjet Hungarís dhe Kroacís. Këtë akt të ban Jelaçiqit e ndihmoi krahu i majtë Kroat tue lejue se n'atë mënyrë siguron pamvarësín shtetnore dhe nacjonale të Kroacis.

Këjo gjendje mbeti deri në vjeshtë, por, kur Jelaçiqi u nis me ushtrín kufitare kundër Vjenës revolucjonare për të ndihmue me shue Kryengritjen e Tetorit dhe kur bani urdhënoi që në Kroaci të shpallet kushtetuta qendrore, krahu i majtë e pá se ishte mashtrue. Jelaçiqi kallxoi qartë se âsht në shërbim të kundër-revolucjonit austriak, i cili atê vjet filloi luftën kundër Revolucionit hungarez.

Prej Marsit të vjetit 1848 filloi lëvizja revolucjonare ndërmjet katundarís kroate. Katundarët kryengritësa paraqiten kërkesat për të ndalue angarín dhe taksat pyjore dhe për të marrë kullosa dhe prodhime. Lëvizja mâ e randësishme katundare u bá rreth katundit Grobnik, ku katundarët muerën pushtetin në duert e veta. Kryengritje katundare u zhvilluen edhe në viset prej Virovitice deri në Osek, ku ishin tokat mâ të mëdha të feudalëve. Këtu katundarët kryen mâ shum sulme kundër pasunive të fisnikëve dhe muerën ushqim dhe kafshë. Raste kryengritjesh kishte edhe në viset e Krizhevcit, dhe rreth Sisakut e Zagrebit.

Katundarët parashtruen kushtet e veta në formë peticijesh në të cilat kërkojshin këputjen e plotë të marrëdhanjeve feudale. Në Vojna Granicë kishte mâ pak lëvizje katundare; aty krajinasit kërkojshin që në shkollat të ndalet gjuha gjermanishte dhe të futet gjuha e popullit, të hiqet koha e gjatë e shërbimit ushtarak, e para së gjithash toka të kalojë plotësisht në duer të katundarëve.

Mbassi ndërdija nacjonale e klasës qytetare, e cila u lidh me fisnikët, n'atê kohë ishte ende e dobët (e aq mâ e dobët ishte te katundarët). Kryengritjet katundare në disa vise mujtën me u shue mjaft shpejt mbassi nuk ishin të lidhuna ngushtë. Ligji për syprimimin e bujqëvet-robë që u muer në Vjenë, ishte shéj që bujqët të liroheshin edhe në Kroaci. Prandej Jelaçiqi në marrëveshtje me feudalët kroatë dha vendimin për shlirimin e katundarëve; ai atê e bani prej frigës së vrullit revolucjonar gjithnji mâ të fortë e prandej Hungarezët me revolucjonin e vet nuk i tërhoqën edhe katundarët kroatë.

Me syprimimin e bujqëve-robë katundarët u shliruen prej «angarís», por jo edhe prej taksave të pyllit, mbassi simbas kuptimit të shumicës n'Asamble «kërkush nuk mund të kërkonte me të drejtë që zotnijt t'i lejojshin dikujt me shfrytëzue taksat e tij — mbassi Zoti dhe drejtësija kërkojnë që secili të gëzojë të vetën». Këso botëkuptimesh të ban Jelaçiqit i ndihmoi Ivan Kukuljeviqit dhe burrat tjerë të njoftun, kurse radikal demokratët kërkuen n'Asamble dhe nëpërmjet të shtypit të tyne që katundarët të shliroheshin prej të gjitha tagrave. Simbas kërkesës së tyne duhej të shliroheshun jo vetëm

bujqët-robë, por edhe ata katundarë që punojshin tokën e zotnijve tue bâ marrëveshtje. Demokratët radikalë kërkojshin që e tanë toka që punojshin katundarët të bâhej pronë e atyne që e punojshin, ose pronë e komuneve.

Mbassi këjo inteligjencë përparimtare, por e vogël në numër, n'Asamble nuk mujti me bâ për katundarët kurrgjâ të posaçme, ata u çuen në kryengritje dhe kundërshtuen me iu bindë sundimit gjatë vjetit 1848 dhe 1849, deri sa kundërrevolucjoni nuk fitoi dhe asgjâsoi Revolucjonin hungarez.

**Programi i «Bashkimit të Sllovenís»**

Kur mbërrijtën lajmet e para mbi revolucjonin në Vjenë, filluen lëvizjet e turmave në Slloveni. Me gjashtëmbëdhetë Mars, në Lubljanë filluen demostratat kundër regjimit t'atëhershëm të Meternikut dhe për zhdukjen e taksave qytetare, të cilat i pengojshin mâ shum qytetarët në tregtín e tyne. Fisnikët lëshuen tokat e veta dhe shkuen në Lublanë dhe në vende tjerë ku kishte ushtri, për të shpëtue jetën.

Me lëvizjen revolucjonare në Lublanë u bashkuen punëtorët, qytetarët dhe nëpunësat. Por, kur punëtorët kallxuen dëshirë të haptë për aksjone revolucjonare, qytetarët u friguen dhe organizuen rojen nacjonale, e cila duhej të vepronte bashkë me ushtrín kundër demonstruesave. Në vendet tjerë me rojen nacjonale u bashkuen edhe fisnikët për të mbrojtë të drejtat e tyne të vjetra.

Katundarët sllovenë e pritën revolucjonin me enthuziazmë; ata ishin të bindun se kishte ardhë momenti për t'u shlirue prej tagrave feudale, tue u kundërshtue për me iu bindë zotnijve feudalë, e në disa vende kryen edhe sulme kundër fisnikëve. Kështu më 21 Mars sulmuen feudalin e Izhanit, i plaçkitën dhe dogjën mobiljet dhe fletoret ku ishin të shënueme detyrimet e katundarëve për tokën. Ky grup prej 500 katundarësh u shpartallue në përpjekjen që pati me ushtrín, e cila shum syresh i kapi dhe i burgosi. Pasunít e kishave dhe pasunít e feudalëve shejtnorë katundarët i sulmuen dhe i plaçkitën edhe në shum vende të Korushkës dhe Kranjskës.

Katundarët sllovenë kryengritësa u lidhën me punëtorët kryengritësa, veçanisht n'Idri dhe në punishten e hekurudhës

për Trieshtë, dhe së bashku i detyruen fisnikët me lëshue pê. Gabimi mâ i madh te katundarët ishte ai se ata kishin besim te perandori austriak, prandej lëvizja revolucjonare në Sllo-veni nuk u zhvillue deri në shkallën e duhun.

Mbas ngjarjeve të Marsit në Lublanë dhe në vendet tjerë të Sllovenís, filloi nji hov mâ i madh ndërmjet inteligjencës së re sllovene, e cila jetonte në grupe të mëdhej në Vjenë dhe në Grac. Organizata studenteske sllovene në Vjenë, «Sllove-nija», në Prill të vjetit 1848 filloi me përpilue programin slloven.

Programi slloven kërkonte që Kranjska, Shtajerska, Ko-rushka dhe Bregdeti që ishin të coptuem të bashkohen në nji mbretni nën emnin Sllovenija. Ky program i «Sllovenís së bashkueme» kërkonte që gjuha sllovenishte ka po ato të drejta si edhe gjermanishtja; që ajo të futet në përdorim nëpër zyrat dhe shkollat; që Sllovenija t'i ndajmbathet Austrís dhe jo Pe-randorís gjermane.

Grupet politike që veprojshin në Slloveni gjatë kohës së revolucjonit në vjetin 1848 nuk ishin të lidhuna mirë, e âsht nji fatkeqësi e madhe që grupi i demokratëve revolucjonarë nuk pati asnji njeri të fortë që të mundëte me çmue si duhet gjendjen politike. Kur ngjarjet n'Austri shkuen drejt rrugës kundër-revolucjonare, ato shkojshin në llogari të Bllajvasit dhe grupimit të tij politik, i cili kishte lidhë marrëveshtje me apsolutizmin austriak dhe me reakcjonin feudal.

### Dëshirat shlirimtare të turmave të popullit dhe qëndrimi reakcjonar i prijsave serbë e kroatë.

Përpjekjet e atyne turmave të Sllovenëve të Jugut, të cilët në vjetin revolucjonar të 1848 u gjetën bashkë me Mo-narkín Habzburge kërkojshin që: të shlirohen plotësisht nga feudalizmi dhe të fitojnë liri veprimi nacjonal dhe fetar. Turmat popullore u bashkuen me revolucjonin me enthuziazëm dhe ishin të gatshëm me dhanë qoftë edhe flijimet mâ të mëdha për shlirimin e tyne socjal dhe nacjonal, për të drejta të plota politike. Ato besuen se mbërrijti momenti me fitue tokë, të cilën do ta merrshin prej feudalëve të mëdhej dhe që do t'u takonte atyne që e punojshin.

Turmat popullore të Sërbëve në Vojvodinë dhe të Kroatëve prej Kroacís dhe Sllovenís e këqyrshin me simpathi revolucjonin hungarez, por kur prîjsat hungarezë nuk deshtën me bâ kurrfarë lëshime për kombësít tjera, qëndrimi i Sërbëve dhe i Kroatëve u ndryshue.

Në Vojvodinë qysh në fillim të lëvizjes revolucjonare u dalluen luftarët e pafrigshëm Tançiqi dhe Stranimiroviqi, të cilët i prinë lëvizjes për asgjâsimin e marrëdhanjeve të vjetra feudale, dhe për pamvarësi dhe ndamje të plotë prej Hungarezëve. Por, mâ vonë sundimin e prîjsís e muerën njerëzit reakcjonarë tue pasë për prijs patrijarkun Bajaçiq, të cilët shpresojshin në ndihmën e ushtrís habzburge dhe reakcjonit ligjmbrojtës të Sërbís, por në të vërtetë ata e ndihmuen Franc Jozefin, dhe jo ai ata.

Rajaçiqi u lidh me banin kroat Jelaçiqin, dhe që të dy përdorën mjete të ndryshme për të bâ për vehte turmat me qenë n'anë të perandorit dhe me i çue në luftë kundër Revolucjonit hungarez. Rajaçiqi dhe rrethi i tij ruejtën tokat e veta dhe kujtojshin se ajo âsht e vetmja rrugë e drejtë, kurse turmat popullore u flitshin se sërbizmi âsht i kërcnuem.

Në Kroaci, turmat e gjana popullore poashtu ishin të përgatituna shpirtnisht për t'u shlirue prej zotnijve të vet feudalë dhe kryen heroizma revolucjonare në shum vende. Por, klasa qytetare shpenzuen forcat e veta tue bisedue n'Asamblén në Zagreb dhe tue shkrue në fletore për të kallxue se kush ka të drejtë: ata që janë për zgjidhjen e plotë të çashtjes agrare, apo ata që janë vetëm për shlirimin personal të katundarëve, dhe humbën kohë tue mos ardhë në takim me turmat e gjana popullore. Ai grup, i cili qysh në kohën e Ilirve besonte se âsht mâ mirë për Kroacín në qoftë se lidhen me Austrín e fortë, me ndihmën e së cilës u shlirue Hungarija, pruni në sundim Jelaçiqin, kurse ai, si ban që ishte, kishte ndalue me u diskutue mbi çashtjet ekonomike dhe shoqnore dhe këtë e bante për arsye «nacjonale dhe patriotike«. Me gjithë se njerëzit rreth Jelaçiqit flitshin mbi sllovenizmin dhe kroatizmin, bani dëshironte që ata të flitshin se ai vetë âsht «austrijak entuziast». Kështu ai grup politik, i cili në vjetin 1848 erdhi në sundim në Kroaci, i dha randësi mâ të

madhe shpëtimit të Dinastís Habzburge dhe ruejtjes së krejt parandorís austriake. Prandej prijsat politikanë në Kroaci dhe në Sërbi përfaqësojshin drejtimet reakcjonare dhe së bashku me prijsat serbë prej Vojvodine punojshin kundër interesave jetësore të popullit sërb dhe kroat, tue i çue ata në pozitë për të ndihmue që të ruhet Monarkija habzburge.

## RILINDJA POPULLORE TE MAQEDONASIT

**Sistemi i beglerëvet dhe gjendja e popullit maqedonas; zhvillimi i qyteteve dhe dukja e borgjezís maqedonase.**

Gjendja ekonomike dhe politike e rajës maqedonase nën sistemin feudal të spahijve turq ishte mâ e vështirë se për të gjithë popujt jugosllavë. Ajo gjendje u keqësue edhe mâ tepër gjatë shekullit të XVIII, atëhere kur Perandorija turke humbi krahinat në Hungarín Jugore, si dhe Sërbín për njifarë kohe. Dobësija e shtetit turk ndihej në të gjitha drejtimet e ekonomís turke, dhe n'organizatën ushtarake e politike. Organizata e vjetër ushtarake nuk mujti me durue shtypjen me armë nga ana e shteteve fqij, Rusís dhe Austrís. Prandej, sundimi turk duhej të kalonte në reforma. Sistemi i vjetër i zijametëve dhe timareve u zëvendësue prej atij të beglerëve.

Në sistemin e beglerëve nji pjesë e tokave iu dha spahijve për me e shfrytëzue ata vetë. Ajo tokë u quejt begllëk. Tokën e punonte spahija në rezhin e vet, ose ua jepte katundarëve që ta punojshin, me kusht që t'i jepshin atij gjysmën ose nji të pestën e prodhimeve. Përveç këtyne detyrimeve, katundarët u paguejshin spahijve taksa të ndryshme në dobi të perandorit dhe t'arkës së shtetit.

Kur Turqija filloi me u dobësue gjatë luftave, feudalët turq simbas dëshirës së vet zgjanojshin begllëket, tue marrë prej çifllëkeve katundare toka që i bashkojshin me begllëkun e tyne. Këjo sjellje e agallarëve dhe beglerëve keqësoi dhe mâ shum gjendjen në shtetin turk, i cili nuk kishte mâ të holla për të pague ushtrín me pagesë. Udhëheqësat e sundimit shtetnuer turk i merrshin tapijat përdhunisht, tue përvehtësue tokën katundare. Shpeshherë ato rrëmbime përfundonin tue vra ose burgosë katundarët. Pronarët e çifliqeve, çiflik-sahibijt,

eksploatojshin katundarët në nji mënyrë çnjerëzore, të cilët tash muerën emnin çifligarë ose bujq-robë. Ky sistem beglerësh qëndroi zyrëtarisht deri në vjetin 1859, e në formë pak të ndryshueme edhe mâ vonë.

Në kohën e çifligimit veçanisht silleshin keq me popullin jeniçerët. Ata mbas shlirimit të Sërbís humbën nji teritor të madh në Ballkan, prandej u përpoqën për me u përforcue në Maqedoni. Atje rrëmbejshin toka dhe eksploatuen deri në vjetin 1826, kur Sulltan Mamuti i II e pezulloi ushtrín' jeniçere, të cilën e konsideroi si flamurtare të pabindshmënís ndaj ligjëve dhe reakcjon feudal në perandorí.

Sistemi i beglerëve e shtoi shum shfrytëzimin ekonomik të turmave popullore në Maqedoni. Prandej shum njerëz shkuen në vise tjera për të fitue, kurse shum të tjerë shkuen edhe në shtete tjerë. Këjo shpërngulje me qëllim gyrbeti u shtue veçanisht në shekullin e XIX.

Prej çifligimit të katundarëve u shtue edhe numri i katundarëve të vorfën në Maqedoni, të cilët shkojshin nëpër qytete ku merreshin me zeje të vogla; kurse katundarët e pasun u vendosën nëpër qytetet dhe filluen me u marrë me tregti. Poashtu edhe njerëzit që këtheheshin prej gyrbetit mâ shum vendoseshin nëpër qytetet, ku hapshin dyqane tregtije dhe zejesh. Në këtê mënyrë u shtue numri i Maqedonasve nëpër qytete. Mbassi ishin tregtarë dhe zejtarë t'aftë filluen me u pasunue. Në qytetet Kumanovë, Prilep, Shkup, Manastir, Veles në fillim të shekullit të XIX u krijue dhe u forcue çarshija e maqedonasve. Ata u siguruen materijalisht dhe ndikojshin gjithënji e mâ shum në ngjarjet e qytetit të vet.

Prej vjetit 1774, kur Turqija lidhi paqë me Rusín në Kaçuk-Kajnarxhi, u zhvillue gjithënji e mâ tepër tregtija me shtete tjerë europjanë. Këte tregti e kryejshin tregtarët grekë dhe maqedonas, mbassi Turqit nuk kishin kurrfarë prirje për këtê degë t'ekonomís. Prej Maqedonije transportojshin lëkura të papunueme, duhan, hashash, gëzofa etj., e importojshin hekur, mall kolonial dhe hekurishte. Prej kësaj tregtije Maqedonasit u pasunuen. Gjatë udhëtimeve të tyne me qëllim tregtije në Beligrad, Peshtë, Novi-Sad, Stamboll, Lajpsig, Mi-

lano, Odesë dhe në vende tjerë, panë prodhime mâ të mira, e poashtu edhe mënyrë mâ të mirë jetese. Prandej tregtarët si borgjezë filluen me ndryshue qëndrimin dhe mënyrën e marrëdhanjeve kundrejt sundimtarëve.

Lidhjet e gjana të Maqedonasve me botën tjetër mbaheshin nëpërmjet të panaireve në qytetet maqedonase. Në panairet vijshin tregtarë prej së jashtëmi për të ble lirë prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Ndikimi i tregtarëve të jashtëm dhe gyrbetlijve Maqedonas u përhap në mënyra të ndryshme nëpër qytetet maqedonase, kështu që dalëngadalë, borgjezija ndryshoi trajtën e vet, dhe njikohësisht bâhej e ndërdijshëme se jeta e saj nën sundimin turk duhet të ndryshohej.

Borgjezija e re maqedonase filloi pra me u forcue me anë të tregtís. Me të hollat e veta, tue dhanë ryshfet, filloi me ndikue te nëpunësat turq e në këtë mënyrë u bâ faktor me randësi jo vetëm n'ekonomi por edhe në politikën e qyteteve dhe katundeve të mbarë Maqedonís.

**Fillimet e zgjimit nacjonal — rilindja popullore dhe vëllaznit Milladinovë.**

Maqedonija, e cila gjindej mâ afër Stambollit se të gjithë krahinat tjera jugosllave, shfrytëzohej mâ shum materjalisht dhe në pikëpamje kulturore ishte krahina mâ e mbrapambetun. Por sidoqoftë mbi të prap ndikojshin vendet që ishin në nji shkallë zhvillimi mâ të naltë. Me gjithë vështirësít e mëdha, me anën e fanariotëve sundonte krejt jetën kulturore dhe shpirtnore në Maqedoni. Në të gjitha pozitat kishëtare vijshin Grekë, të cilët me anën e sundimtarëve turq i shfrytëzojshin edhe ata vetë Maqedonasit. Për shkak të shtypjes nga ana e fanariotëve kah fundi i shekullit të XVIII dhe në fillim të shekullit të XIX filloi lufta e borgjezís së re maqedonase kundër robnís shpirtnore dhe kulturore të Maqedonasve nga ana e patriarkís greke. Lëvizja filloi në Shkup dhe në Shtip, dhe u përhap edhe në vendet tjerë që ishin qendra kryesore me randësi.

Ajo luftë shprehte dëshirat e Maqedonasve për të pasë për kryetar fêje Maqedonas dhe që ritet fetare të kryhen në

gjuhën maqedone. Mâ e randësishme n'atê luftë ishte kërkesa që mësimi në shkollat të kryhej në gjuhën maqedone dhe jo në gjuhën greqishte. Borgjezija e re maqedone dëshironte me u shlirue prej konkurencës së tregtarëve dhe zejtarëve grekë, të cilët i mbronte kisha fanariote greke. Prandej së pari lufta ishte e drejtueme kundër kishës greke. Në qoftë se Maqedonasit kishin me u shlirue prej fanariotëve, të cilët ishin të lidhun me sundimtarët turq, atëhere ishte lehtë mbassi njikohësisht do të shlirohej edhe nga konkurenca a tregtarëve dhe zejtarëve grekë, e po ashtu do të dobësohej edhe shtypja feudale, mbassi feudalët e klerit turk ishin të lidhun me jerarkin feudale të kishës.

Lufta e Maqedonasve kundër klerit grek zgjati plot 70 vjetët e shekullit të XIX. Ajo luftë u ndal mbas fermanit të sulltanit në vjetin 1870, kur u krijue egzarhija bullgare, prej së cilës mvarej edhe kisha maqedonase.

Lufta për t'u shlirue prej sundimit të kishës njikohësisht ishte puna edhe për shlirimin e gjuhës maqedonishte në shkollat fillore. Në krye të kësaj lëvizje qëndrojshin tregtarët e pasun, të cilët kishin mâ shum interes që gjuha maqedonase të futej në shkollat maqedone dhe fëmijt e tyne të mësojnë në gjuhën amnore. Tregtarët e Shkupit u kallxuen mâ luftarë përsa i përket kërkimit të gjuhës popullore, prandej në vjetin 1837 u themelue shkolla ku nxanësat nxejshin në gjuhën maqedono-sllovene.

Ndërdija nacjonale u përhap edhe prej qytetevet tjerë ndërmjet Maqedonasve. Veçanisht u dallue Velesi, ku kish tregtarë të pasun, të cilët studjojshin jashtë shtetit dhe sillshin idét në qytet të vet. Qendra e luftës për gjuhën maqedono-sllovene ish Prilepi, ku vepronte nji rreth i tanë intelektualësh vendas dhe prej andej përhapej ndërdija e rilindjes nacjonale në të gjitha anët e Maqedonís.

Po nji gjâ e tillë ndodhi dhe n'Ohër, ku mbarë populli veproi për ndërtimin e shkollës maqedono-sllovene — disa tue dhanë ndihma në të holla e të tjerë me punë vullnetare; në

vjetin 1858 ata ndërtuen shkollën fillore. Për të parën herë aty u kallxue kontradiksioni i klasës ndërmjet Maqedonasve, mbassi pasanikët e mëdhaj t'Ohrit mbajshin anën e patriarkis greke, kundër popullit të vet.

Numri i shkollave fillore në gjuhën maqedono-sllovenishte u shtue në qytetet dhe manastiret. N'atê mënyrë ndikimi i rilindjes depërtoi edhe në turmat e gjana popullore. Prej inteligjencës u krijue kuadri mësimuer vendas. Disa shkruejshin në gjuhën kishëtare maqedono-sllovenishte, si J. Kerçevski dhe K. Pejçinovi. Të tjerë si janë P. Zografski, Gj. Pulevski, K. Shapkarovi dhe D. Milladinovi, i shkruejtën tekstet në gjuhën maqedonishte. N'atê kohë u zhvillue puna në letërsín maqedonase dhe në mbledhjen dhe botimin e kangëve popullore maqedone. Në këtê fushë pune u dalluen mâ shum vllaznit Milladinov.

Prej të gjithë punëtorëve në kohën e rilindjes maqedonase mâ e dallueme âsht figura e Kostandin Milladinovit, poet dhe shkrimtar. Ky mbaroi fakultetin e filozofís n'Athinë, e mandej shkoi në Moskë për të përsosë studimet e veta. Kur u këthye në vendin e vet, ai bashkë me të vëllan Dhimitër Milladinovin, mësues në Kukush, punoi palodhmënisht për Rilindjen e Maqedonasve dhe për ngjalljen e ndërdijes së tyne nacjonale. Vëllaznit Milladinov mblodhën kangë popullore maqedonase. Për t'i botue ato kangë Kostandini shkoi në Zagreb, ku prej Shtrosmajerit mori ndihmën për botimin e kangëve. Këjo përmbledhje kangësh popullore ishte e nji randësija të madhe kulturore për Maqedonasit në shekullin e XIX.

Kur luftarët për gjuhën popullore mujtën që libri në gjuhën greqishte nëpër kishat të nxirret jashtë përdorimit, atëherë mitropoliti grek e akuzoi Dhimitër Milladinovin të sunduesat turq se ai âsht agjent i organizatës sllovene dhe se mori urdhën prej qeverís turke për të çue në Maqedoni kryengritjen. Për shkak të kësaj padije të rrejshëme Dhimitrin e burgosën dhe e çuen në Stamboll, në burg. Për shkak të punës së vet me popull në Stamboll zunë dhe burgosën edhe Kostandin Milladinovin, kur shkoi aty për me ndërhy që të

lirojë të vëllan. Të dy vëllaznit Milladinov u helmuen në Stamboll, simbas urdhënit të patrijarkís greke, në vjetin 1861.

E gjithë puna e rilindjes në Maqedoni u kufizue kryesisht në naltësimin kulturo-edukativ të popullit. Por mbassi Maqedonasit ishin të shfrytëzuem keq prej sundimit turk dhe prej klerit grek, të cilët pengojshin zhvillimin e tyne ekonomik dhe politik, lëvizja e rilindjes fitoi nji randësi të domosdoshme politike. Ai karakter politik u duk në ngritjen e ndërdijes nacjonale dhe në forcimin e kushteve ekonomike të tregtarëve maqedonas, të zejtarëve dhe inteligjencës.

# ZHVILLIMI I MÂTEJMË I MARRËDHANJEVE KAPITALISTE NË VENDET JUGOSLLAVE DHE LUFTAT NACJONALE TË POPUJVET TANË NËN KUSHTET E DEPËRTIMIT IMPERIALIST NË BALLKAN. LËVIZJA PUNËTORE TE JUGOSLLAVËT

## KALIMI N'EKONOMIN KAPITALISTE NË SËRBI. LUFTAT PËR TË DREJTAT KUSHTETUESE DHE PËR DEMOKRACI QYTETARE

### Kalimi n'ekonomín kapitaliste, forcimi i borgjezís; shkatërrimi i kooperativizmit dhe vorfnimi i katundarís

Mbas vrasjes së princ Mihajlit në Sërbi u zgjodh këshilli. Këshilli nuk e shpalli Millanin e mitun për princ, nipin e Jevrem Obrenoviqit, por vendosi për të bâ votimet për Asamblén e madhe popullore, e cila duhej ta caktonte princin. Por gjeneral Mihal Petroviqi-Bllaznavac, ministër i ushtrís, sulmoi shtetin dhe shpalli për princ Millan Obrenoviqin. N'atê mënyrë Bllaznavci u bâ zotnues i gjendjes, mbassi atij iu nënshtruen ushtrija, nëpunësat dhe Asambleja popullore.

Asambleja e madhe popullore u zgjodh nën shtypjen e ushtrís dhe filloi të punojë në Topçider me 20 Qershuer të vjetit 1868. Puna e saj zhvillohej simbas »këshillave« të Bllaznavcit dhe të Jovan Ristiqit, e krejt asamblén e rrethonte ushtrija. Këshilltarët dhe qeverija emnuen këshillin legjislativ, e ky përpiloi projektin e kushtetutës. Në vjetin 1868 u aprovue kushtetuta e re, që zêvendësoi kushtetutën e vjetër turke, e

cila mbas shlirimit të qyteteve nga robnija turke u bâ e padurueshme në Sërbín e shlirueme.

Kushtetuta e re ishte reakcjonare mbássi autorizimet e Asamblés popullore i çoi në shkallën mâ t'ultë. Ligjët e aprovueme në bazë të tij kufizojshin të drejtën e mbledhjeve dhe kuvendimeve, të drejtën e gjykimeve dhe lirín e shtypit. Borgjezija sërbe, në të cilën mbështetej sundimi i ri ishte e mbrojtun në nji shkallë të gjanë prej kushtetutës së re reakcjonare. Nën hijen e saj ajo filloi me u përforcue me shpejtësi. Fuqija e tij u përforcue edhe mâ tepër gjatë kohës së qeverimit të këshilltarëve. Atëhere borgjezija, me ndihmën e manipulimeve në të holla dhe të tregtís eksport, u bâ e vetmja klasë sunduese në Sërbi. Sundimi i borgjezís qëndroi edhe mbas vjetit 1872, kur prej këshilltarëve e mori sundimin Millan Obrenoviqi.

Deri në vjetin 1870 u krijuen kushtet për t'u vû themelet për kalimin e Sërbís në mënyrën kapitaliste të prodhimit dhe n'ekonomín kapitaliste. Prej Kryengritjes së dytë popullore, e veçanisht gjatë kohës së regjimit të ligjmbrojtësave, gradualisht pasunít filluen me u përqëndrue në duert e disa njerëzve. Prej radhëve të katundarëve të pasun u ndanë disa dhe u banë tregtarë në katundet dhe qytetet. Ata importojshin mall të ndryshëm prej së jashtëmi, kurse prej Sërbís eksportojshin prodhime bujqësore dhe blegtorale. Tregtarët e pasun kaluen në qytetet dhe krijuen magazinat e veta, në të cilat mbajshin mall të ndryshëm dhe filluen me u marrë me tregti të madhe.

Bashkë me këta tregtarë u shtue edhe numri i byrokratëve. Këta, nën ligjmbrojtësat edhe në kohën e princ Mihajlit, u pasunuen si nëpunësa, dhe kah vjeti shtatëdhetë, nji pjesë e tyne u hodh në tregti, mbassi ajo ishte mâ e dobishme. Prej tregtís së mbrendshëme dhe të jashtëme, u shtue edhe veprimtarija e të hollave dhe u krijuen kushtet për themelimin e bankave.

Mbassi depërtimi gjithënji mâ i fortë i kapitalizmit në Sërbi pati rrjedhime të vështira për turmat e gjana popullore, në vjetin 1862 u krijue Drejtorija e fondeve, instituti i cili

me pak kamatë kishte me u dhanë hua katundarëve të vorfën dhe të mesëm, e kështu me e ruejtë prej shkatërrimit të plotë. Po për të njajtët shkaqe gjatë kohës së qeverís së këshilltarëve në vjetin 1871, u organizuen arkat e kursimit në qarqet. Por të hollat e Drejtorís së fondeve dhe t'arkave qarkore të kursimit, në radhë të parë shfryzojshin nëpunësat, tregtarët dhe katundarët e pasun, ndërsa katundari i vorfën dhe e mesëm nuk kishte kurrfarë fitimi prej atyne enteve.

Kur disa tregtarë u pasunuen, filluen me themelue banka private. Kështu në vjetin 1869, në Sërbi u themelue banka e parë private me nji kapital prej 200 000 dukatësh. Mbas kësaj u hapën edhe banka tjera private në qytetet mâ të mëdhej. Pronarët e tyne ndikuen mjaft në ngjarjet politike dhe ekonomike në Sërbi.

Prej importimit të mallnave u pakësue rroli i mjeshtërive shtëpijake dhe zejeve të vjetra. Mallnat e fabrikave të jashtëme ishin mâ të lira dhe me kualitet mâ të mirë, kështu që zejet e vjetra (shtambtarët, rrobaqepsat, argjentarët, litarpunuesat etj.) filluen me u zhdukë, kurse zejet e reja zhvillo-heshin shum ngadalë. Mjeshtërít shtëpijake (endja e përhurave dhe materjevet tjera, përpunimi i sendeve prej druni, etj.) në fillim u zhduk në qytet, e mandej edhe në katund. Shkaku i kësaj zhdukje ishte pse malli i jashtëm ishte mâ i mirë dhe se në Sërbi, gradualisht po depërtonte shija europjane në veshje, n'ushqim dhe për kah mënyra e rregullimit të banesave. Së pari këjo shije depërtoi në qytetet mâ vonë edhe në katundet.

Në periudhën e kalimit të Sërbís n'ekonomi kapitaliste, kur klasa e borgjezís filloi të marrë hov nëpërmjet të tregtis import e eksport, degës së vetme të prodhimit të krijimit të tepricave për eksport, ishin bujqësija dhe blegtorija. Këtu aktiviteti i tyne ndihej mâ shum, e poashtu ato ishin degët që plotësojshin nevojat e popullsís për sa i përket ushqimit, e nga ana tjetër ato plotësojshin në nji shkallë të madhe edhe nevojat e popullsís në veshmbathje.

Në zhvillimin e shpejtë të tregtís dhe me ramjen e mjeshtrive shtëpijake filloi edhe shkatërrimi i shpejtë i kooperati-

vave katundare dhe ndamja e katundarís në klasa shoqnore. Shkaku i këtij shkatërrimi të kooperativave qëndron në kalimin e Sërbís n'ekonomin monetaro-mallnave dhe në forcimin e borgjezís, e cila gjithënji e mâ tepër merr pozitat n'aparatin shtetnuer. Me futjen e pagimit të taksave në të holla, prej vjetit 1835 filloi kërkimi i shumave mâ të mëdha në të holla, e poashtu këjo përfshinte gjithënji prodhim mâ të madh. Por, nën kushte të tilla pune me vegla primitive ai prodhim nuk mujti me sigurue sasi të mjaftueshme të hollash për taksa gjithënji mâ të mëdha dhe të kënaqë dëshirat për jetë mâ të mirë.

Simbas zakoneve të vjetra, kooperativa katundare nuk mund të ndahej pa pëlqimin e të gjithë anëtarëve, kurse të drejtë në tokën kishte vetëm ai që e punonte. Këta zakone u shkatërruen me zbatimin e ligjëve të reja shtetnore, të cilat borgjezija, si klasë sunduese, i pruni tue pá vetëm nevojat e veta. Por, gjatë kohës s'ekonomís kapitaliste, kur zejtarët e rij filluen me prodhue sende edhe për nevojat e katundit, te kooperativat filloi me u dukë dëshira për ato prodhime, e iu dha mundësija me anë të të hollave të kënaqë dëshirat dhe nevojat e veta. Këjo don të thoshte prishje e marrëdhanjeve të reja dhe shkatërrim i kooperativave.

Për importimin e mallnave nga jashtë jepeshin prodhimet bujqësore dhe blegtorale, kështu që mbas nji kohe shum të shkurtë vlefta e importit kaloi vleftën e eksportimit. Rrjedhimi i këtij mosbalancimi ishte ramja e shpejtë e prodhimeve të vendit dhe kriza për të holla. Prej këtij mosbalancimi u damtuen mâ shum katundarët e vorfën dhe të mesëm. Tash, në krahasim me prodhimet e tyne ra mbi ta pjesa mâ e madhe e taksave, prandej katundarët u banë huamarrës te bankat dhe te individët. Për të pague huat, plotësuen nevojat me mjete pune dhe blenë kafshë, katundarët merrshin hua te tregtarët tue pague nji kamatë të madhe. Në këtë mënyrë i futshin me borxh të korrat e tyne t'ardhshëme për të mbulue shpenzimet e tashme, dhe kështu u mbytën në hua, prej së cilës nuk mundën me dalë mâ kurr.

Gjendja për katundarín u keqësue gjithënji e mâ shum, prandej nuk i shpëtuen as bankat e arkat qarkore të kursimit. Ato arka shtetnore, në të cilat merrshin hua katundarët e vorfën dhe të mesëm, vepruen krejt ndryshe. Katundari i vorfën dhe i mesëm nuk kishte mundësi me shkue deri në Beligrad ose në qytetin e qarkut për të marrë hua, mbassi për shkak të vorfënís nuk mundte me u largue prej shtëpís së vet për nji kohë të gjatë. Prandej kuptohet se ato huana të lira i shfrytëzojshin vetëm tregtarët dhe katundarët e pasun. Ata shkojshin në rrugë për disa ditë, sillshin në pazar ose në panair prodhimet e veta e njikohësisht kryejshin edhe punë në bankë. Poashtu edhe nëpunësat udhëtojshin me shërbim e kështu merrshin hua me kamatë shumë të vogël. Mandej me ato të holla që i kishin marrë me nji interes të vogël bâjshin kontrabandë dhe spekulime të ndryshme. Rruga prej Uzhice në Beligrad dhe këthimi zgjatte 17 ditë, e katundari i vorfën nuk mundte të nisej në këtê rrugë mbassi gjatë asaj kohe duhej të shpenzonte, për vehte, e nga ana tjetër as familja nuk mund të jetonte me atê ushqim që kishte mbetë në shtëpi.

1. Pakënaqësija e katundarëve sërbë kundër byrokracís dhe fajdexhijve duel në shesh mâ së shumti në kohën prej vjetit 1870 deri më 1880.

Për ato dhetë vjetë u zhvillue mâ shpejt proçesi i shndërrimit t'ekonomís neutrale n'atê kapitaliste moderne. E para gati u zhduk plotësisht, kurse e dyta filloi me sundue. Këjo âsht koha kur borgjezija qëndroi fort në kambët e veta dhe kur në zhvillimin e politikës së mbrendshëme dhe të jashtëme interesat e veta u banë mâ të randësishme.

### Svetozar Markoviqi dhe puna e tij për përhapjen e ideve socijaliste; zanafilla e lëvizjeve punëtore

Gjendja politike dhe ekonomike në Sërbi përpara dukjes së Svetozar Markoviqit ishte në shêj të zhvillimit të kapitalizmit që ishte në duer të tregtarëve, byrokratëve dhe kontrabandistave, të cilët e kishin përfshi gjithë sundimin në duert e tyne. N'atê kohë u shkatërruen kooperativat katun-

dare dhe ekonomija e vjetër natyrale. Katundarët e vorfënuem (të patokët) shkuen në qytetet për të fitue. Në vjetin 1870 Svetozar Markoviqi u këthye në Sërbi, mun atëhere kur në të po bâhej kalimi n'ekonomín kapitaliste. Si djalosh njizet e tre vjeçar ai muer pjesë të dukshëme në jetën politike të vendit të vet. Lindi me 8 Shtatuer të vjetit 1846. Shkollën fillore e mbaroi në Rekovc dhe Jagodinë, kurse katër rende të gjimnazit në Kragujevc. Gjimnazin e naltë dhe maturën i mbaroi në Beligrad në vjetin 1863, mandej u regjistrue në fakultetin teknik të Shkollës së naltë. Mbas tre vjetëve shkoi në Petrograd (në Leningradin e sodshëm) me burs shtetnuer për të vazhdue studimet e veta. Aty u njoft me mësimet e revolucjonarëve të demökracís ruse Çernishevski, Dobrolubov dhe Pisarev, dhe qysh atëhere filloi me studjue të gjithë drejtimet socjaliste. Për shkak të shëndetit të dobët dhe klimës s'ashpër kaloi në Cirih, ku studjoi socjalizmin shkencuer të Marksit. Si student jasht shtetit shkoi dhe dërgoi artikuj për gazetat në Sërbi. Për shkak t'artikullit »Sërbija e mashtrueme« ia prenë bursin dhe ai u këthye n'atdhé, dhe nuk vazhdoi mâ studimet në fakultetin teknik, por iu kushtue gazetarís.

Menjiherë mbassi u këthye n'atdhé, në vjetin 1870, tue bâ agjitacjon me gojë dhe tue shkrue artikuj, filloi me punue për shndërrimin e marrëdhanjeve shoqnore në Sërbi në mënyrë revolucjonare. Veçanisht u angazhue për të futë zejtarët në kooperativa (»shoqata«), e kështu me ndryshue dhe përmirësue pozitën e tyne.

Kur në Qershuer të vjetit 1871 filloi me dalë fletorja e parë socjaliste në Sërbi »Radnik«, në të Markoviqi shkroi nji serí artikujsh kushtue Komunës së Parizit dhe Internacionales së parë dhe shfaqi haptas idét e veta socjaliste. Për shkak të këtyne shkrimeve, në vjetin 1872 »Radniku« u ndalue me dalë. Atëhere, grupi i intelektualëve të rij përparimtarë përpiloi programin politik, që në Sërbi u bâ program i grupit socjalist t'atëhershëm.

Kritika e Markoviqit kundër regjimit ishte shum e ashpër dhe dallohej prej objektivitetit; ajo i hapi popullit syt kun-

drejt ngjarjevet që e çojshin në shkatërrim. Për shkak të të kritikuemit të tij të papajtueshëm, regjimi desht me kapë Markoviqin, kështu që atij për njifarë kohe iu desht të mshifet në Novi Sad. Kur në vjetin 1873 u këthye përsëri në Sërbi, ai filloi me redaktue në Kragujevc fletoren »Javnost«. Edhe në »Javnost« kritikon birokracín dhe kërkon vendosjen e vetqeverimit të popullit. Artikujt e tij ishin prej lamís politike, ekonomike, filozofike dhe shkencavet tjera. Me shkrimet e tij Svetozar Markoviqi dëshironte me edukue shoqnín sërbe t'asaj kohe; dëshironte që monarkija të zêvendësohej prej republikës.

Përsa i përket shlirimit të popujvet të Ballkanit prej Turqëve, Markoviqi mendonte se popujt atê munden me e bâ edhe vetë, me forcat e veta. Mbas shlirimit duhet t'organizohet federata e vendevet ballkanikë.

Për të mbërrijtë këtê qëllim kaq me randësi sikurse âsht shlirimi nacjonal, Markoviqi e kritikoi ashpër qëndrimin nacjonalist të sundimtarëve t'atëherëshëm, punën e dinastiís Obrenoviq dhe dëshirat e tyne për krijimin e Sërbís së madhe. Ai kritikoi aspiratat sërbomëdha të lëvizjes së rinís, dhe kërkoi që t'i kushtohet mâ shum kujdes punës socjale se sa asaj nacjonale. Me kritikën e vet ndikoi që rinija e bashkueme sërbe të ndahet dhe pjesa e saj mâ e përparueme, veçanisht nga rinija shkollore në Beligrad, të pranojë idét socjaliste.

Puna e Markoviqit ndërmjet zejtarëve nuk kishte sukses, mbassi ata orientoheshin kah borgjezija, kur e kooperativat e tyne mbas disa vjetësh u banë sipërmarrje kapitaliste, të cilat shfrytëzojshin deri në kulm punëtorët e vet — shegërtat dhe kallfat.

Markoviqi kishte mâ tepër influencë ndër katundarët e vorfën dhe nxanësat, veçanisht n'ata të shkollës pedagogjike në Kragujevc.

Në vjetin 1875 punëtorët e fabrikës s'armëve në Kragujevc, bashkë me intelektualët përparimtarë, mujtën që në votimet komunale të marrin drejtimin e komunës. Po këjo ndodh edhe në Smederevë e Shabac, gjâ që i idhnoi mjaft sundimtarët. Qendra e lëvizjes punëtore në fabrikën e shkrimjes

së topave në Kragujevc, prej kah në Fruer të vjetit 1876 u organizue demonstrata e punëtorëve dhe nxanësave të shkollës pedagogjike. Me 15 Fruer grumbulli i madh i demonstrantëve filloi me qarkullue nëpër rrugët e Kragujevcit. Princi Millan urdhënoi nëpërmjet të Ministrit t'ushtrís, që Komandanti i Kragujevcit të kapë fajtorët, e atê që kundërshton me e coptue. Mbas demonstratës u banë shum burgime dhe u keqpërdorën si punëtorët ashtu edhe intelektualët; shum punëtorë u pushuen nga puna.

Grupi politik socjalist, me plan të përpunuem të kërkesave, u duk në Sërbi qysh në vjetin 1871. Prîjs i saj ka qenë Svetozar Markoviqi. Programi i atij grupi përmbante 21 pikë. Në to ndërmjet tjerave, kërkohej: autonomija komunale e qarkore dhe vetqeverim, pamvarësi të plotë për gjyqet, liri shtypi dhe shoqatash, me krijue ushtrín popullore në vend t'asaj të përhershëme, reformë shteti përkah vetqeverimi, hapje shkollash bujqësore dhe zejtare; bashkimi i kulturës ushtarake me atê qytetare. Socjalistët kërkojshin pezullimin e esnafit dhe hapjen e bankave për tregti dhe t'arkave qarkore të kursimit për bujqët dhe zejtarët. Këtê program e nënshkruen prîjsat socjalistë t'atëhershëm Svetozar Markoviqi, Aqim Çumiqi, Vaso Pellagiqi, etj.

Ndonse Svetozar Markoviqi dhe shokët e tij ishin socjalistë t'enthusiazmuem, përsëri nuk kanë hŷ në shkencën e socjalizmit që e kanë predikue mësuesit e mëdhej të popullit punëtuer Karl Marksi e Fridrih Engelsi.

K a r l M a r k s i (1818—1883) âsht i pari ndër njerëz që ka tregue se klasa punëtore udhëheq gjithë punëtorët e zellshëm dhe nën udhëheqjen e saj mund të sendertohet socjalizmi, të cilit i përket ardhmënija. Ai ka studjue zhvillimin e shoqnís prej njerëzve mâ të vjetër deri në kohën e vet dhe ka mbrrijtë deri në tezën: »klasa punëtore duhet ta rrëmbejë pushtetin nga anmiku i klasës — borgjezija — me anë të revolucjonit«. Gjithashtu Marksi ka vërtetue se e vetmja mënyrë e mundshëme për të mbajtë pushtetin në duert e proletarjatit âsht diktatura e klasës punëtore.

Për të mbrrijtë në këto teza shkencore Marksit iu desht me mësue shum, shka edhe ka bâ gjatë gjithë jetës së vet. Ka lé në krahinën e Rajnit në qytetin Trier. I ati ka qenë avokat me kulturë të naltë. Maksi dallohej në shkollë prej nxanësave tjerë për aftësít e tija të mëdha e zellin në të mësuem. Kështu ka mbetë në gjimnaz dhe n'univerzitet të Bonit e të Berlinit.

Kur Marksi i ri kreu studjimet, shum qytetarë të krahinës së Rajnit nuk pajtoheshin me sundimin reakcjonar prusjan, mbassi ai pengonte përparimin e industrís. Prandej këjo borgjezi e përparueme e Rajnës nxuer »Gazetën e famshëme të Rajnës« në Kolonjë, drejtori i së cilës u bâ Marksi me 1842. Nën udhëheqjen e tij gazeta muer karakter revolucjonar e demokratik. Për këtê shkak qeverija prusjane ndaloi daljen e fletores. Për Marksin ishte vështirë të qëndronte mâ gjatë në Gjermaní, prandej kaloi me jetue në Paris. Aty studjoi socjalistët francezë dhe u muer me gazetarí.

Marksi u detyrue me u largue prej Parizit, sepse qeverija prusjane kërkonte me e gjykue për shkak të shkrimeve të tija t'ashpra. Prandej ai, nëpër Bruksel shkoi, në Londër ku kaloi pjesën mâ të madhe të jetës së vet.

Në Londër Marksi mujti me punue qetësisht në studjimin e socjalizmit shkencuer e t'ekonomís politike. Këtu shtypi veprën e vet të vogël nga vëllimi, por të përmendun: »Manifestin e partís komuniste«. Në fillim të vjetit 1843 Marksi çeku mësimin e vet për zhvillimin e shoqnís dhe ndamjen e saj në klasa — njana klasë janë shfrytzuesat (eksploatuesat) dhe tjetra të shfrytëzuemit (t'eksploatuemit). Gjithashtu çeku mësimin e vet për revolucjonin, për klasën punëtore dhe për diktaturën e proletarjatit. Në këtê vepër u shfaq për të parën herë parulla: »Proletarë të të gjithë vendevet, bashkohuni!«

Posë artikujve të shumtë nga lama e shkencave të ndryshme e në gjuhë të ndryshme, Marksi ka shkrue edhe veprën e vet mâ të madhe nga ekonomija »Kapitalin në tre blêj«. Me ketê vepër fitoi zulmë të madhe ndërmjet njerëzve të dijshëm në mbarë botën.

Bashkëpunëtori mâ i afërmë i Marksit ka qenë F r i d r i h E n g e l s i (1820—1895). Ky ka lé në qytetin industrial Barmen, në krahinën e Rajnës, prej t'et, që ka qenë fabrikant i pasun. Engelsi plak pat dërgue të birin n'Angli si nëpunës fabrike. Mirëpo Fridrih Engelsi nuk shkoi mbas gjurmave të t' et për tu pasunue, por iu kushtue lëvizjes revolucjonare të klasës punëtore.

Në punën e vet njohti jetën e punëtorëvet, prandej shkroi veprën »Pozita e klasës punëtore n'Anglí.« N'atê vepër vuni në pah jetën e ashpër dhe të vështirë të punëtorëve, të cilët i eksploatojshin pashpirt pronarët e fabrikave. Por Engelsi tregon fuqín e madhe të klasës punëtore, e cila âsht e aftë me bâ luftë për shlirimin e vet. Kësaj lufte të klasës punëtore i ka kushtue Engelsi krejt jetën e vet. Ai me shkrime të shumtë çekte mendimin e vet të bazuem në prova shkencore. Punëtorët mund të çlirohen prej kapitalistave të tyne me anën e organizmit në Partin komuniste, e cila do t'i udhëheqë të gjithë punëtorët në revolucjon deri në ngadhënjim. Engelsi ka përvehtësue plotësisht idét e mendimet e Marksit, prandej mbas vdekjes së këtij ka mujtë me udhëheqë proletarjatin në botë e me vazhdue punën shkencore të Marksit.

Të dy këta mësues të mëdhej të proletarjatit u banë t'afërmë për të gjithë njerëzit përparimtarë. Marksi dhe Engelsi gëzojnë nji prestigj të madh te njerëzit punuesa të të gjithë vendevet pa marrë parasysh se cilës kombësi i përkasin.

Në vjetin 1870 socialistëve në Sërbi u ishte mâ e vështirë për me coptue mënyrën esnafe t'organizimit dhe të menduemit te zejtarët dhe punëtorët, por mun për këtê influenca e tyne n'atê kohë ishte mjaft e fortë në katund, ndër katundarët e vorfën. Lëvizja socjaliste ndërmjet zejtarëve u shkatërrue qysh në kohën që jetonte vetë Svetozar Markoviqi, kurse mbas vdekjes së tij (vdiq në vjetin 1875 në Trieshtë) u shkatërrue edhe ndërmjet turmave katundare.

Prej lëvizjes përparimtare politike që ishte nën ndikimin e ideve katundare në Sërbi u nda borgjezija e ultë dhe katundarët. Ata krijuen grupin e radikalëve, i cili me ndihmën e Adam Bogosavljevit, të katundarëve dhe deputetëve, të tri-

bunës popullore; mujtën me tërheqë mbi vehte numrin mâ të madh të katundarëve sërbë.

Me gjithë se lëvizja e Svetozar Markoviqit u shkatërrue, prap se prap mbeti thelbi socjalist ndërmjet proletarjatit të pakët qytetarë dhe në rini. Lëvizjen punëtore e udhëhoqi luftari i regjun. Mito Ceniqi, të cilin e dëbuen prej Sërbije si bashkëpuntuer të Markoviqit në vjetin 1873. Ceniqi shkoi në Pariz, por iu desht patjetër me u largue edhe prej France mbas nji vjeti; u këthye pra në Sërbi dhe u vendos në Shabac. Ka qenë dënue me 8 vjetë burgim, gjâ që përforcoi edhe mâ tepër bindjen e tij socjaliste. Mbas burgut në vjetin 1881, nxori fletoren »Radnik« dhe në të shkroi artikuj kundër radikalëve tue i karakterizue si tradhtarë të lëvizjes socjaliste.

Puna e Ceniqit drejtohej në bashkimin dhe futjen e proletarjatit n'organizata dhe shoqata punëtore. Nën ndikimin e tij u organizue shoqnija e përgjithshëme punëtore në Beligrad, e cila kishte për detyrë me mbledhë të gjitha shoqatat punëtore të vendit në nji bashkësi pune. Prej asaj kohe mbeti edhe Programi dhe Kushtetuta e Partís socjaliste sërbe që e përpiloi Ceniqi. Në program âsht shfaqë qëndrimi i grupit t'atëhershëm të socjalistave për sa i përket organizatës së shtetit. Në të kërkohet që çdo individ të ketë të njajtat të drejta politike e që mjetet e prodhimit të jenë të përbashkëta, pronë e komunes.

N'ideologjín socjaliste të Ceniqit ndihej shum influenca e ideologjís mikroborgjeze, gjâ që mund të kuptohet lehtë mbassi në Sërbi në kohën e tij nuk ka pasë industri, e, pra, as proletariat të shumtë modern. Në Sërbín e atëhershëme shumica e punëtorëve punonte në punëtorít e vogla ose të mëdha. Organizatat punëtore kishin karakter esnafi. Punëtorët ishin t'organizuem simbas llojit të punës dhe shumica kishte për ideal ose të fitonte aq sa të mundej me ble nji copë tokë dhe disa krenë kafshë e me u këthye në katund, ose me hapë ndonji duqan zejtarije dhe të bâhen të pamvarun në punë.

Në Sërbi, mbas Ceniqit luftari kryesuer për çashtjen socjaliste ishte Vaso Pellagiqi. Ai prej Sërbije kaloi në Bosnje, dhe punoi për ngritjen e ndërdijes socjaliste deri në

fund të shekullit të XIX. Plot tridhetë vjetët e fundit të shekullit të XIX nuk kishte kushte për krijimin e lëvizjes punëtore moderne revolucjonare në Sërbi, mbassi politika reakcjonare e sundimtarit prej dinastís së Obrenoviqit ndalonte përparimin e borgjezís sërbe si dhe zhvillimin e industrís, e këtê e bante tue pengue ndërtimin e industrís, e mbassi nuk kish fabrika të mëdha, nuk mund të krijohej proletariati i shumnumërt nëpër qytetet.

### Luftat shlirimtare të Sërbís kundër Turqís (1876—1878) dhe Kongresi i Berlinit. Sërbija si shtet i pamvarun

Kur në vjetin 1875 plasi kryengritja e madhe Boshnjako-hercegovase kundër sundimit turk, dhe kur disa grupe kryengritësash kërkuen që Bosnja t'i ndajmbathet Sërbís, kurse Hercegovina Malit të Zi, filluen pështjellime ndërmjet sundimtarëve në Sërbi. Për shkak të presjonit t'Austro-Hungarís Sërbija nuk mund të ndihmonte legalisht kryengritësat, gjâ që te populli shkaktoi moskënaqësi. Për shkak të kësaj gjendje, qeverít e Sërbís dhe të Malit të Zi, me gjithë atê vendosën me i paraqitë Turqís në vjetin 1876 propozimin që Bosnja të lëshohet nën drejtimin e Sërbís, kurse Hercegovina — Malit të Zi. Porta nuk e pranoi këtê propozim dhe nuk desht me u hy në bisedime, mbassi e konsideronte vehten si fuqi suvrane mbi të gjithë vendet në jug të Savës dhe Danubit.

Nën presjonin e mendimeve publike dhe tue pá se ishte koha e përshtatshëme, Sërbija dhe Mali i Zi i shpallën luftë Turqís në Korrik të vjetit 1876. Sërbija u fut në luftë me 93 000 ushtarë dhe me 5 000 vullnetarë. Kundër Sërbís Turqija dërgoi gjashtë divizjone me 126 000 luftarë dhe 20 000 trupa të parregullta (bashibozukë). Ushtrija sërbe ishte mâ e dobët se ajo turke; ajo nuk ishte e ushtrueme mirë si ushtrija popullore që themeloi princ Mihali, kurse ushtrija turke ishte ushtri me të vërtetë e rregulltë, nën komandën e Abdul-Kerim-pashës me përvojë. Materjalisht ushtrija sërbe qëndronte keq, kurse ajo turke mjaft mirë. Ushtrija sërbe ishte e

re, me nji numër shum të vogël oficerash të naltë Sërbë. Komandant i ushtrís ishte gjenerali rus Çernjajevi.

Betejën e madhe të parë, që u zhvillue me 6 Korrik të vjetit 1876, ushtrija sërbe e humbi dhe u tërhoq n'anën e majtë të lumit Timok, kurse Turqit pushtuen Knjazhevcin. Gjatë gjithë Gushtit dhe Shtatorit u zhvilluen lufta me humbje dhe fitore si prej njanës ashtu dhe prej tjetrës palë, por prap se prap ndifej epërsija e ushtrís turke. Sërbët luftuen trimnisht, veçanisht njisít që ishin nën komandën e kolonel Horvatoviqit; por mbas luftës së suksesshëme në Shumatovë filloi tërheqja.

Më shtatëmbëdhetë Tetuer të vjetit 1876 në mëngjes, filloi beteja e Gjunisit nën zjarmin e artilerís së randë. Artilerija turke, nën komandën e Jahja Pashës, gati i coptoi njisít sërbe. Por kur njisit turke sulmuen në kodrën e Gjunisit, trupat sërbe filluen me u tërheqë në luginën e Moravës. Sërbët e humbën betejën në Gjunis. Kah fundi i Tetorit u ndal lufta dhe filloi armëpushimi. Dy ditë mbas armëpushimit në Paraçin, Gjeneral Çernajevi ia dorëzoi komandën kryesore Horvatoviqit, dhe së bashku me oficerat tjerë rusë dhe me vullnetarët shkoi në Rusi nëpër Beligrad.

Fuqít e mëdha ndërmjetësuen në të dy anët anmike, dhe me 1 Nanduer të vjetit 1876 u nënshkrue paqa, e cila në Fruer të vjetit 1877 u zgjat. Por këjo paqë nuk zgjati shum. Kur në Prill të vjetit 1877 Rusija i shpalli luftë Turqís, dhe kur n'atê luftë kallxoi epërsi dhe pati shum suksese, edhe Sërbija u fut përsëri në luftë kundë Turqëve, si aleate e Rusís.

Ushtrija sërbe në këtê pjesën e dytë të luftës së vet shlirimtare kallxoi mâ shùm entuziazëm dhe pati suksese. Mori Leskovcin, Bella Pallankën dhe vende tjerë, dhe te Qiprovica u takue me ushtrín ruse. Këtu u vendos që të dyja ushtrít së bashku të nisen në drejtim të Sofjes. Kah fundi i Dhetorit kapitulloi Nishi, ku u çarmatos garnizoni i madh turk, dhe n'atê rast u zunë rob 5 000 ushtarë turq dhe ra në dorë nji sasi e madhe materjali ushtarak. Kah fundi i Dhetorit ushtrija sërbe pushtoi Pirotin, kurse Rusët pushtuen këthesën Shipke (në malin Ballkan) dhe Sofjen. Në Kallnuer të vjetit 1878

ushtrija sërbe mori Prokupljen dhe Kurshumlín, dhe u nis drejt Kosovës. Ushtrija ruse, mbassi pushtoi Plevnën, depërtoi me shpejtësi drejt Detit Egje dhe Stambollit. Perandorís turke i kërcnohej rreziku që të humbi tokat e pushtueme në Ballkan.

Këto fitore të mëdha t'ushtrís ruse e çqetsuen Anglín. Ajo frigohej se Turqija do të humbte brigjet e veta n'Europë dhe brigjet në Bosfor dhe Dardanele, prandej e këshilloi me i ofrue Rusís paqë. Përveç kësaj, Anglija me flotën e vet të madhe luftarake iu kërcënue Rusís. Rusija tue qenë e dobët në det, nuk mund të futej në luftë me Anglín, prandej pranoi ofertën për paqë. Me 3 Mars të vjetit 1878, u nënshkrue marrëveshtja për paqë ndërmjet Rusís dhe Turqís në Shën-Stefan, afër Stambollit.

Simbas asaj paqe, kufijt ndërmjet Sërbís dhe Bullgarís duhej të rregulloheshin ndërmjet tyne. Sërbija i dha Bullgarís Bella Pallankën, Vranjën dhe Pirotin, kurse për vehte muer Novi Pazarin dhe Mitrovicën. Mali i zi u shtri aq sa u kufizue me Sërbín. Me këtê marrëveshtje u krijue Bullgarija e Madhe — e cila shtrihej prej Detit të Zi deri të Liqeni i Ohrit dhe në brigjet e Detit Egje, prej grykës së Vardarit dhe Strumës deri te Burugeli, në jug, prej këndej deri mbrapa Jedrenës e prap deri te Deti i Zi.

Sërbija nuk ishte e kënaqun me këta kufíj të caktuem në paqën e Shën-Stefanit, mbassi humbi ata qarqe që pushtoi, tue luftue dhe tue dhanë flíjime të mëdha.

Prej marrëveshtjes së Shën-Stefanit poashtu nuk mbetën të kënaqun as Anglija dhe Austro-Hungarija. Anglís nuk i interesonte me formue Bullgarín e Madhe, e cila mori brigjet në Detin Egje, kështu në këtê mënyrë Rusija kishte mundësi që nëpërmjet Bullgarís të dalë në Detin Egje dhe prej andej të kërcënojë rrugën kryesore t'Anglís për pushtimet koloniale n'Azi, nëpërmjet të Suezit. Austro-Hungarija, poashtu nuk ishte e kënaqun për shkak të prestigjit të madh të Rusís në Ballkan si dhe ndikimit të saj mbi Sllovenët në shtetin austro-hungar. Për shkak të këtyne kontraditave, në Qershuer të vjetit 1878, ndërmjet shteteve të mëdhej u bâ Kongresi i Berlinit, i cili i ndryshoi kufíjt e shteteve të Ballkanit.

Në Kongresin e Berlinit u zvogëluen mjaft teritoret e Bullgarís, dhe të Malit të Zi, kurse ato të Sërbís u zgjanuen. U krijue Principata Bullgare, prej Danubit deri në Ballkan, me viset e Sofjes, kurse në jug të Ballkanit u krijue krahina Rumelija Perëndimore, e cila ishte nën suverenitetin e sulltanit turk. Sërbís iu dhanë katër qarqe (i Nishit, Toplicës, Pirotit dhe Vranjes) dhe pamvarësi e plotë. Mali i Zi u bâ shtet i pamvarun dhe doli në det si dhe disa qytete me rrethet (Nikshiqin, Podgoricën, Kollashinin, Barin dhe Ulqinin). Turqís iu këthyen krejt Maqedonija dhe Sanxhaku i Novi Pazarit. Në këtê mënyrë u prenë përsëri kufijt ndërmjet Sërbís dhe Malit të Zi. Austro-Hungarija fitoi të drejtën që t'okupojë Bosnjen dhe Hercegovinën, tue qitë si arsye se atje duhet të vendosë rregull dhe qetësi.

Luftat shlirimtare të Sërbís kundër Turqís prej vjetit 1876—1878, që kushtuen shum viktima dhe materjal, i prunë popullit sërb pamvarësín e shtetit dhe shtrimjen e kufijve të mâparshëm.

Në Kongresin e Berlinit Sërbija mori disa angazhime në lidhje me ndërtimin e hekurudhës, por poashtu fitoi edhe të drejtën me hy si shtet i pamvarun në marrëdhanje diplomatike ndërkombëtare. Të gjitha këto don të thojshin nji hap përpara për ngritjen e shtetit dhe për zhvillimin e ngjarjeve politike dhe ekonomike në vend.

## Regjimi absolutist dhe politika austrofile e Millan Obrenoviqit; konflikti me borgjezín

Në bazë të kushtetutës së këshilltarëve të vjetit 1869, — e cila nuk kishte cilësi demokrate, por ishte kushtetuta e parë që ishte përpilue në Sërbín e shlirueme plotësisht pa pjesëmarrjen e Turqís — borgjezija sërbe shpresonte se do ta ndante sundimin me princin.

Kur Millan Obrenoviqi, në vjetin 1872 u shpall se âsht në moshë, ai mori detyrën princore dhe filloi me shfrytëzue të metat e kushtetutës për të forcue regjimin e vet apsolut. Sërbija e vogël, ku gjithëshka ishte primitive, nuk mund të kënaqte kërkesat e Millan Obrenoviqit, mbassi ai dëshironte

me jetue si magnatët e mëdhaj gjermanë dhe hungarezë. Muer hua gjithëkund ku mujti, luente kumar dhe humbi shuma mâ të mëdha të hollash se sa përbâjshin t'ardhunat e tij princore. Udhëtimet e shpeshta dhe jeta e natës në Vjenë ishin shkak që ai filloi me i këqyrë me urrejtje njerëzit dhe gjendjen në Sërbi. Ky Obrenoviq nuk kërkoi midis sërbëve njerëz me të cilët të thellohej sinqerisht në çashtjet politike të vendit të vet, por shkonte dhe këshillohej me përfaqësuesat gjermanë dhe austriakë, e këtê e bante gjithënji natën, gjatë kohës që luente letra. Në këtê mënyrë ai ishte gjithënji nën influencën e partizanëve të qeverimit shtetnuer apsolut.

Në kundërshtim me dëshirat e Millanit për të qenë i plotfuqishëm si princ, te shum njerëz politikanë në Sërbi u ndi influenca e pansllavizmit, e cila prej Rusije kaloi në Ballkan. Ata politikanë llogaritshin se shtetet ballkanike me ndihmën e fuqís ushtarake dhe diplomatike ruse do të shlirohen prej sundimit turk. Poashtu besojshin se Sllovenët e Jugut që ishin nën sundimin e Austrís do të shlirohen dhe do të bashkohen në nji shtet të vetëm bashkë me Sërbín. Ajo idé pansllave binte gjithnji në konflikt me politikën austriake dhe turke.

Për shkak të këtyne konflikteve, princ Millani i afrohej gjithënji e mâ tepër politikës s'Austrís. Ai ishte i bindun se me ndihmën e saj do të mundte me shtri teritorin e Sërbís në jug dhe se do të marrë prej Turqís ato krahina të cilat në shekullin e mesëm ishin pjesë të shtetit sërbë. Poashtu ai mendonte se me ndihmën e Austrís do të mundte me smbrapsë dëshirat demokratike të popullit serb, i cili jo vetëm që nuk ishte i kënaqun me gjendjen shtetnore, por kërkonte që edhe Asambleja popullore të marrë rrolin politik. Dëshirat e popullit pajtoheshin me dëshirat e borgjezís serbe. Ajo kërkonte që ministrat t'i emnonte Asambleja popullore, e jo princi simbas dëshirës së vet, pa marrë parasysh në se ata janë zgjedhë mâ përpara për deputet apo jo. Populli serb dhe shumica e borgjezís serbe kërkojshin qeveri parlamentare, prandej zhvilluen luftë të qëndrueshme dhe të gjatë kundër princit, për krijimin e regjimit parlamentar.

Lufta për sundimin parlamentar u shndërrue në konflikt ndërmjet princit Millan dhe borgjezís sërbe. Ajo luftë u shfaq në politikën e mbrendshëme dhe të jashtëme të Sërbís. Ajo u duk edhe mâ fort me rastin e çashtjes së ndihmës që duhej me u dhanë kryengritësave boshnjako-hercegovinas, atëhere kur princ Millani mori qëndrim të kundërt me atê t'interesave të popullit dhe borgjezís. Në fillim populli sërb u ndihmoi haptazi kryengritësave, kurse mâ vonë, kur Austrija u kërcënue se do të ndërhynte, e ndihmoi kryengritjen msheftazi me të holla, me vullnetarë dhe me materjal luftarak.

Mosmarrëveshtjet ndërmjet princit dhe popullit veçanisht u shfaqën mâ të forta në çashtjen e politikës austrofile të Millan Obrenoviqit.

Mbas Kongresit të Berlinit dhe zbatimit të vendimeve të tij në teritorin e Sërbís — e veçanisht përsa i përket ndërtimit të hekurudhës prej Beligradit nëpër Nish deri në Vranjë dhe Caribrod — princi Millan u orientue plotësisht n'Austro-Hungarín dhe filloi me bâ politikë në kundërshtim me interesat e popullit. Ai dëshironte me marrë në duert e veta gjithë sundimin shtetnuer. Llogaritte se do të merrte ndihëm prej Austrís për luftë kundër opozitës në popull dhe Asamblés popullore. Poashtu mendonte se do të kishte ndihmën e shteteve të mëdhej e kështu do të përforconte dinastín e vet në fron, edhe sikur t'ishte kundër dëshirës së shumicës së popullit serb. Për shkak të politikës së tillë Millanit iu desht me i bâ shum lëshime politike dhe ekonomike Austro-Hungarís.

Në Qershuer të vjetit 1881 ndërmjet princ Millan Obrenoviqit dhe Austro-Hungarís u lidh marrëveshtja e fsheftë, e quejtun »konventa e fsheftë«, e me nji afat prej 10 vjetësh. Prej qëverís serbe nuk dinte kërkush për marrëveshtjen përveç ministrit të punëve të jashtëme, Çedo Mijatoviqit. Ai nënshkroi konventën n'enëm të Sërbís. Kryetarit të qeverís, Piroçanit, princi i premtoi qysh mâ përpara se këso marrëveshtje nuk do të lidhte, por e mashtroi dhe e bani atê pa pëlqimin e tij. Me gjithë atê, Piroçani mbeti përsëri në qeveri, e poashtu edhe ministri Çedo Mijatoviqi, i cili kryente punët e fshehta për princin në dam t'interesave të popullit. Kryetari i qëverís,

Piroçani, në të vërtetë për kah botëkuptimet e veta, ishte reakcjonar, por përsa i përket kësaj çashtje deshti me dhanë dorëheqjen. Ndërsa, edhe ai u pajtue me mënyrën apsolute të zhvillimit të politikës së jashtëme e kështu provokoi pakënaqësi edhe mâ t'ashpër ndërmjet turmave dhe qeverís.

Konventa e nënshkrueme përfaqësonte miqsín ndërmjet Sërbís dhe Austro-Hungarís, i ndalonte Sërbís punë politike, fetare etj. ndërmjet Sllovenëve të Jugut, të cilët ishin nën sundimin e Monarkís austro-hungareze. Veçanisht këjo vlente për Bosnjën e Hercegovinën dhe për Sanxhakun e Novi Pazarit. Me këtë konventë Austro-Hungarija pranoi që princ Millani të shpallet për mbret kur këtë ta shohë të nevojshëme, e në qoftë se njani prej shteteve që nënshkruen konventën futet në luftë, tjetri do të mbetet neutral.

Konventa ishte e drejtueme kundër çdo ndikimi të Sërbís ndaj Sllovenët tjerë të Jugut si dhe kundër ndikimit rus ndaj Sërbët. Ajo mbron qeverín dhe dinastín, kurse Sërbija hoqi dorë prej çdo veprimi në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në vendet tjerë ku jetojshin Sërbët. Si shtet Sërbija u fut nën protektoratin e Austro-Hungarís dhe nuk mund ta zhvillonte politikën e vet pamvarësisht.

Mbassi përparimtarët u pajtuen me konventën, në të vërtetë ata u banë shërbëtorë të princit Millan dhe të politikës austrofile.

Mbas Kongresit të Berlinit kushtet në Sërbi ishin shum të vështira. Arkat e shtetit ishin të shprazta mbassi të hollat shpenzoheshin në luftat. Populli u vorfënue shum. Ndërtimi i hekurudhave, krijimi i enteve të rij shtetnorë, shtimi i ushtrís dhe i armatimeve të saj, prunë shtuemjen e taksave dhe të huanave shtetnore. Me nënshkrimin e atyne huanave u pasunuen individët dhe mbas nji kohe të shkurtë u banë kapitalistë. Ata ndikonin në ngjarjet politike në Sërbi.

Për shkak të gjendjes së tillë u rrit pakënaqësija në popull, kurse luftat politike ndërmjet disa partive u ashpërsuen gjithënji mâ tepër. Princat dhe përparimtarët për këtë shkak mbërrijtën në pozitë të vështirë mbassi shumica e popullit u nda prej tyne dhe i urrente. Për ta përmirësue nji politikë të

tillë në fitim të tyne, princi dhe qeverija i propozuen Asamblés popullore që Sërbín ta shpalli për mbretni. Asambleja popullore, në vjetin 1882 shpalli mbretnín, kurse Millanin e shpalli për mbret.

Mbas proklamimit të mbretnís u banë zgjidhjet për Asamblén popullore. N'agitacjonin paraelektoral muer pjesë haptazi edhe mbreti Millan. Ai mori qëndrim të vendosun kundër radikalëve, të cilët kishin shumicën në popull, internoi shum opozitarë dhe familjet e tyne. Qeverimi i tij i plotfuqishëm u shndërrue në tiraní. Për këtê arsye, kundër tij opozita muer qëndrim të tillë si mos me qenë sundimtar, por si me qenë anmiku mâ i madh i vendit dhe i popullit.

Pasoja e kësaj politike ishte atentati në Millanin, në Fruer të vjetit 1882. Atentatin e bani Jelena (Ilka) Markoviqi, vejusha e Jevrem Markoviqit të pushkatuem. Ky atentat nuk pati sukses, por këtê e shfrytëzoi mbreti Millan dhe burgosi shum njerëz prej opozitës, e veçanisht prîjsat e Partís radikale.

Për shkak të politikës austrofile të mbretit si dhe prej qëndrimit të tij kundrejt borgjezís s'imtë, e cila ishte bashkue me Partín radikale, filloi përpjekja e gjatë ndërmjet mbretit Millan dhe borgjezís, e cila me ndihmën e popullit mâ në fund do ta mundë dinastín Obrenoviq.

**Formimi i prartive të para politike qytetare: Kryengritja e Timokut; Lufta sërbo-bullgare dhe kushtetuta e vjetit 1888**

Prej Kryengritjes së parë dhe të dytë në Sërbi filluen me u formue dy lloj grupesh politike; grupi i atyne që ishin mbas prîjsave të kryengritjes, dhe grupi i atyne që nuk pajtoheshin me drejtimin e tyne politik. Dy grupe të tillë ishin partizanë të Karagjorgjeviqit dhe Obrenoviqit. Kur mbas fitores në Kryengritjen e dytë u formue Këshilli, u krijue grupi politik i aristokratëve, i cili u çfaq haptazi gjatë kohës së re të regjimit të ligjmbrojtësave.

Në kohën e Asamblés së Shën Andrés në vjetin 1858, u krijue grupi liberal që e përbâjshin njerëzit e rij përparimtarë, të cilët ishin shkollue jashtë shtetit. Ky grup quhej Parti libe-

rale me gjithë se nuk ka pasë të gjitha veçorít e nji partije politike. Nuk kishte as program e as kushtetutë të shkrueme. Të gjithë këta grupe politike përpiqeshin me marrë sundimin e kur e merrshin mundoheshin me e mbajtë për nji kohë sa mâ të gjatë.

Në vjetin 1871 u duk grupi i parë politik me plan të caktuem politik dhe me program të shkruem. Ky ishte grupi i Svetozar Markoviqit dhe Aqim Çumiqit. Porse, ajo u shkatërrue shum shpejt dhe nuk u shndërrue në parti socjaliste masovike. N'atê kohë nuk kishte kushte të mjaftueshme për jetën e saj si parti politike.

Kah vjeti i tetëdhetë i shekullit të XIX, në Sërbi u dukën kushtet për krijimin e partive të para politike qytetare. Atëherë klasa borgjeze ishte forcue dhe zhvillonte luftë në forma të ndryshme për të marrë sundimin e plotë në shtet. Prandej në vjetin 1881 u formue partija e parë qytetare, Radikalo-popullore. Ajo kishte të gjitha veçorít e nji partije politike moderne, përpiloi programin dhe kushtetutën e vet, krijoi këshillat e vendit, të rrethit dhe qarkut, e mbi të gjithë qëndronte këshilli kryesuer i partís në Beligrad. Fletorja kryesore e partís ishte »Samouprava« (Vetqeverimi), kurse prîjs i partís ishte Nikolla Pashiqi. Agjitatori mâ aktiv i partís ndërmjet katundarëve ishte Ranko Tajsiqi, kurse ndërmjet intelektualëve Pero Todoroviqi dhe Rasha Millosheviqi, nxanësat e Svetozar Markoviqit.

Programi i Partís radikale kërkonte mirëqenje dhe liri në politikën e mbrendshëme, kurse në politikën e jashtëme »pamvarësi shtetnore dhe bashkimin e të gjitha pjesëve të sërbizmit«. Vijat themelore të programit të Partís radikale ishin përparimtare, mbassi në to kërkohej ndryshimi i kushtetutës me qëllim për futjen e së drejtës së votës në të gjithë dhe zgjedhjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesave të popullit. Poashtu, përparimi i asaj partije dukej edhe n'atê se kërkonte shkollim të përgjithëshëm, të detyrueshëm dhe pa pagesë dhe me u dhanë bursa nxanësave të vorfën.

Partija popullore radikale, mbas themelimit të saj, ka pasë shum sukses te turmat e gjana katundare dhe te borgje-

zija e vogël, të cilët n'atê kohë dobësoheshin ekonomikisht. Ajo u kallxue e qëndrueshme në luftë kundër apsolutizmit të Millan Obrenoviqit dhe në përiudhën e parë të punës së vet ishte përparimtare, mbassi futi idét borgjezo-demokrate në Sërbi. Luftoi për lirín e popullit, që ishte në ndikimin e ideve të Svetozar Markoviqit.

Në vjetin 1881 u organizue Partija përparimtare Sërbe, partizanët e së cilës u quejtën përparimtarë. Ideologët e saj kryesorë ishin Millutin Garashanini dhe Millan Piroqanci. Fletorja kryesore e partís ka qanë »Videlo«.

Përparimtarët në programin e vet kërkojshin liri fjale, shtypi dhe shoqatash si dhe përgjegjësín e ministrave për veprat tyne. Ndërsa, gjatë sundimit nuk i përmbaheshin kurr programit të vet, por bâjshin politikë shum reakcjonare. Partizanët e përparimtarëve ishin shtyllat kryesore të sundimit apsolutist të Millan Obrenoviqit dhe u kallxuen si anmiq të turmave popullore.

Grupi i vjetër liberal prej Asamblés së Shën-Andrés me kohë i humbi veçorít e veta përparimtare, dhe njerëzit tjerë në tê gradualisht muerën pozitat dhe mbërrijtën me ndikue edhe politikisht. Ajo parti e vjetër liberale rilindi plotësisht; prandej edhe ishte e shtërngueme që në kushtet e reja të riorganizohet. Së pari, në fillim të vjetit 1881 disa prej partizanëve të tij krijuen Shoqatën për t'i ndihmue letërsís sërbe, kurse në vjetin 1882 këjo Shoqatë u shndërrue në Parti liberale. Prîjs i partís u bâ Jovan Ristiqi, burr shteti i madh sërb. Për atê ishte mâ e randësishme me pasë në duert e veta me marrë sundimin e shtetit, gjâ që edhe i shkoi për dore për nji kohë mjaft të gjatë.

Partija liberale ishte birokrate dhe zotnijsh. Prandej ndërmjet partizanëve të saj sundojshin idé politike mbrapanike. Reakcjonariteti në parti dukej në çdo hap, kurse sundimi i Jovan Ristiqit, ishte mjaft i fuqishëm. Ai nuk lejoi që në Këshillin kryesuer të partís të futeshin liberalët mâ përparimtarë, si Jevrem Grujiqi dhe Jovan Iliqi, të cilët ishin të parët që filluen me predikue në Sërbi për idét liberale të Perëndimit dhe të fusin në politikën sërbe ideologjín e demo-

kracís borgjeze. Këta dy njerëz me merita nuk mujtën me iu përshtatë sundimit të Jovan Ristiqit në Partín liberale.

Përparimtarët dhe liberalët zhvilluen veprimtarín e tyne politike në qytetet, kurse radikalët kujdesin e vet ia kushtuen katundit. Mbas formimit të partive politike qytetare, ndërmjet tyne u zhvillue luftë e ashpër. Lufta mâ e ashpër u zhvillue ndërmjet radikalëve dhe përparimtarve. Mbassi mbreti Millan bashkëpunonte mâ shum me përparimtarët dhe anonte kah ata si sundimtar, radikalët filluen luftë t'ashpër edhe kundër mbretit. Këjo luftë kishte pasoja të mëdha si në politikën e mbrendshëme ashtu edhe në politikën e jashtëme, të cilat u dukën veçanisht në Kryengritjen e Timokut, e cila ishte pasojë e politikës mbas konventës së fshehtë.

## Kryengritja e Timokut

Menjiherë mbas proklamimit të mbretnís populli filloi me u përgatitë për lëvizje. Ato u provokuen prej urdhënit të qeverís së Piroçancevit për vulosjen e shtazëve, — dhe pakënaqësija në popull u ngjall veçanisht prej punës s'Asamblés popullore, në të cilën kishte edhe përfaqësuesa të pazgjedhun. Gjendja e vështirë politike u keqësue kur në vjetin 1883 në burgun e Pozharevcit u mbyt Ilka Markoviq. Këjo ndodhi gjatë kohës së qeverís reakcjonare të Nikolla Hristiqit, gazetat e të cilit njoftuen se Ilka vari vehten.

Mbas kësaj qeverija filloi me mbledhë armët prej ushtrís popullore. Armët në duert e popullit kërcënojshin pushtetin e plotfuqishëm të Millan Obrenoviqit. Ardhja e Hristiqit për kryetar qeverija donte me thanë se ky birokrat do të zbatonte vendimin për mbledhjen e armëve.

Puna për mbledhjen e armëve filloi në mbarë vendin kah fundi i Shtatorit të vjetit 1883. Në Krajinën e Timokut ajo mbledhje u bâ në nji mënyrë shum barbare. Për këtê shkak u bâ ndeshja në katundin Çiflig dhe në vende tjerë.

Porsa shpërtheu kryengritja, qeverija shpalli shtetrrethim në qarkun e Cërna Rekës dhe nxori ligjin mbi gjyqin special. Për kryetar të gjyqit special u emnue Dragomir Rajoviqi, anëtar i kasacjonit (gjyqit të naltë).

Mbas shpalljes së shtetrrethimit dhe ligjit mbi gjyqin specjal kryegritja u përhap dhe mâ shum dhe përfshiu teritor edhe mâ të madh. Në katundin Banjë burrat e armatosun i hoqën prej shërbimit nëpunësat, prenë vijën telegrafike dhe formuen këshillin populluer. Në popull u shtue pakënaqësija për arsye se qeverija e çfuqizoi ligjin mbi lirín e shtypit, dhe gazetat nuk mund të dilshin pa lejen e policís.

Në fillim ushtrija sulmoi Grykën e Sokobanjës, e prej këndej nëpër Bjelovc u doli mbrapa kryengritësave. Ndeshja ndërmjet kryengritësave dhe ushtrís u bâ në Çestobrodicë, në vendin e quejtun Stolicë. Kryengritësat ishin t'armatosun keq, me pushkë të vjetra, prandej u detyruen me u shpërnda prej zjarmit të fortë t'ushtris. Ushtrija e qeverís u nis prj Boljevcit drejt Zajeqarit dhe Vrazhogerncit. Lufta vendimtare u zhvillue në Vratarnicë, te Zajeqari. Mâ në fund ushtrija pushtoi Knjazhevcin, kurse nji pjesë të kryengritësave e zû rob.

Kryengritja shpërtheu edhe në rrethin e Moravës, Aleksincit dhe Krushevcit. Rreth Aleksincit u mblodhën afër 6000 burra, të cilët u nisën drejt qytetit. Ata katundarë kryengritësa pushtuen Aleksincin, por mâ vonë ushtrija fitoi. E gjithë këjo kryengritje u shue për dhetë ditë, e mbassi mâ e ndërdijshëme ndodhi në rrethin e Timokut, u quejtë Kryengritja e Timokut.

Mbas shuemjes së kryengritjes në Zajeqar filloi punën e vet gjyqi specjal, i cili pa pasë fakte të mjaftueshme dhe të veçanta dënoi me vdekje 94 burra, dhe me internim 567. Numri mâ i madh u dënue me burgim, sepse kishte marrë pjesë në kryengritje.

Prej të dënuemve me vdekje njizetë u pushkatuen në Kraljevicë, te Zajeqari. Ata njizetë kishin merita mâ të mëdha në luftë kundër mbretit Millan dhe sundimit të tij apsolutist. Ndërmjet tyne u dalluen mâ shum Marinko Ivkoviqi, prift prej Boljevci, dhe Lubo Didiqi, tregtar dhe deputet populluer radikal prej Soko Banje.

Për shkak të kryengritjes së Timokut u burgosën edhe anëtarët e Këshillit kryesuer të Partís radikale, me Pero Todoroviqin, Rasha Millosheviqin etj. Nikolla Pashiqi mujti

me ikë në Zemun e prej andej kaloi në Bullgari, ku jetoi si emigrant politik. Adam Bogosavleviqin, tribunin e madh populluer, e helmuen në burg me 19. III. 1880.

Kryengritja e Timokut âsht e lidhun ngushtë me Partín radikale; n'atê kryengritje muerën pjesë në shumicë anëtarët e saj, por Këshilli kryesuer i partís gjatë luftës dhetëditëshe nuk ishte aktiv dhe këjo u lehtësoi sunduesave që këtê kryengritje popullore ta shuejnë dhe ta përballojnë shpejt. Paaktiviteti i krenëve në Partín radikale erdhi mbassi disave u ishte mërzitë lufta e vazhdueshme n'opozitë, pse frigoheshin për jetën e vet. Ndërsa, turmat e gjana radikale prej popullit banë atê që konsiderojshin mâ të nevojshëme n'atê moment, kur mbreti desht me u marrë armët, të cilat u nevojiteshin për të mbrojtë lirín e vet.

Kryengritja e Timokut nuk kishte të gjitha veçorít e revolucjonit të vërtetë. Në tê punohej pa plan dhe nuk veprohej aq sa duhej revolucjonarisht kundër anmikut, i cili ishte i organizuem mâ mirë.

## Lufta sërbo-bullgare (1885) dhe Kushtetuta e vjetit 1888

Në Shtatuer të vjetit 1885, princi bullgar Aleksandër Batenbergu proklamoi në Pllovdivë bashkimin e Mbretnís Bullgare dhe të Rumelís Lindore. Mbreti Millan atê bashkim e konsideroi si çrregullim të merandimit në Ballkan. Ai bazohej n'atê se me bashkimin e Bullgarís Jugore dhe asaj Variore âsht cenue Marrëveshtja e Berlinit e vjetit 1878. Si austrofil, besonte se n'akcjonin e vet do ta ndihmonte Austro-Hungarija. Prandej me 12 Tetuer të vjetit 1885 i shpalli luftë Bullgarís.

Beteja kryesore në këtê luftë u zhvillue në Slivnicë; ajo filloi me 15 Nanduer dhe qysh në fillim Bullgarët patën suksese te Ropoti. Lufta vazhdoi deri me 27 Nanduer, kurse Sërbët humbën botejën në Slivnicë. Ushtrija u detyrue me u tërheqë mbas nji lufte triditëshe, dhe mbreti Millan e pá se e humbi luftën.

Përfaqësuesi austro-hungar në Sërbi, konti Kovenhiler, shkoi si ndërmjetës te Bullgarët për të bâ paqë dhe i shkoi

për dore me e përfundue luftën. U krijue komisjoni që do të caktonte vijën kufîtare.

Në Fruer të vjetit 1886, u nënshkrue paqa në Bukuresht. Simbas kësaj paqe u këthye gjendja e paraluftës. Për Sërbín këjo desht me thanë pasukses, kurse për Bullgarín unjisim' i shtetit.

Mbas asaj lufte ndërmjet Sërbís dhe Bullgarís u zhduk krejtësisht prestigji i mbretit Millan kundrejt popullit Sërb. Simbas mendimit të popullit, Slivnica, ku trupat Sërbe pësuen disfatë, ishte turp nacjonal, e për këtê âsht përgjegjës regjimi apsolutist i mbret Millanit. Pasojat e kësaj gjendje prunë ndërrimin e shpeshtë të qeverís. Millani, tue u mundue me shpëtue vehten, pranoi me ua dorëzue sundimin radikalëve, por gjendja nuk ndryshoi, mbassi populli kërkonte ndryshimin e kushtetutës dhe liri. Borgjezija dëshironte me u vendosë mënyra parlamentare e sundimit që kështu të mundte me veprue drejtpërdrejtë në politkën shtetnore dhe të kryejë punët e veta ekonomike.

Në vjetin 1888 Millani pruni si sundimtar përsëri reakcjonarin e madh Millan Hristiqin, tue shpresue se ai me masa t'ashpra do të përmirësojë gjendjen politike në Sërbi. Por, Hristiqi i kishte përgjakë duert në kryengritjen e Timokut, kështu që tash, ardhja e tij provokoi pakënaqësi edhe mâ të madhe në popull dhe në borgjezi. Për këtê shkak Millani u detyrue me thirrë Asamblén e madhe popullore, e cila kishte me përpilue kushtetutë të re.

Në Dhetuer të vjetit 1888 u votue kushtetuta e ré, e cila ishte borgjezo-demokrate. Në këtê kushtetutë për të parën herë në Sërbi u vendos sundimi parlamentar, ku vendos shumica n'Asamblen popullore. Simbas këtij, qeverija duhej të përbâhej prej njerëzish që i kish zgjedhë populli n'Asamblén popullore. Me kushtetutë u garantuen të drejtat e qytetarëve dhe lirija e tyne personale. U ndaluen gjyqet specjale dhe u sigurue lirija e shtypit e poashtu u hoq cenzura për botimin e gazetave dhe vepravet tjera të shkrueme. Me këtê kushtetutë u fut lirija e zgjedhjeve dhe votimi i fshehtë, por jo edhe e drejta e përgjithshëme e votimit.

Kushtetuta parlamentare e vjetit 1888 erdhi si rezultat i luftës njizetëvjeçare të popullit Sërb. Simbas asaj kushtetute, mbreti dhe Asambleja popullore u banë të barabartë në nxjerrjen e ligjëve si dhe për vendosjen e çashtjeve politike. Pa pëlqimin e Asamblés popullore nuk mund të merrej ose të hiqej asnji ligj në shtet.

Kur kushtetuta hyni në fuqi, mbreti Millan abdikoi në favor të të birit të vet, Aleksandër Obrenoviqit. Por mbassi ky ish i mitun drejtimin e vendit e muer këshilli i shtetit i përbamë prej tre vetësh: Jovan Ristiqit, gjeneralit Jovan Velimarkoviqit e Kosta Protiqit. Qeverija e përbame prej radikalësh, mbas nji kohe të shkurtë erdhi në konflikt me këshillin e shtetit. Lufta vazhdoi edhe mâ, për futjen e kushtetutës në jetë.

### Grusht shteti i majit të vjetit 1903

Qeverija e këshilltarëve zgjati prej vjetit 1889 deri në vjetin 1893, dhe u rrëxue prej sulmit mbi shtetin në vjetin 1893, atëherë kur Aleksandër Obrenoviqi u shpall në moshë madhore, me gjithë se nuk ishte ende 17 vjeç. Porsa mori në duert e veta drejtimin e shtetit, ky mbret mujti me vendosë regjimin e vet. Në fillim të sundimit të vet u mbështet n'ushtrín; prandej i ati i tij, Millani, u këthye në Sërbi dhe u bâ komandant i ushtrís.

Gjatë gjithë sundimit t'Aleksandër Obrenoviqit Sërbín e kishin përça konflikte të ndryshme të mbrendshëme dhe influencat e jashtëme. Nën influencën e t'atit të tij Millan, mbreti Aleksandër nuk desht me e formue qeverín prej nëpunësash. Këto qeveri t'ashtuquejtuna »neutrale« përbâheshin prej njerëzish që kryejshin dëshirën e mbretit, e jo atê të popullit. Qeverít neutrale ishin të dobta prandej n'Asamblén popullore rrëxojshin lehtë deputetët, të cilët kërkojshin që qeverín ta përbâjnë njerëz prej asamblés. Ndërrimet e shpeshta të qeverive vijshin edhe prej influencës së dy shteteve të mëdhej — Austro-Hungarís dhe Rusís. Aleksandër Obrenoviqi vazhdoi me ndjekë politikën austrofile, kundër së cilës vepronte Partija radikale me ndihmën e influencës ruse në Sërbi.

Për shkak të këtyne influencave të ndryshme, Aleksandri, gjatë sundimit të tij dhetëvjeçar ndërroi dymbëdhetë qeveri të ndryshme. Me ato ndryshime të shpeshta t'individëve në pozitat e ministrit, atij i shkoi për dore me coptue Partín radikale dhe nji numër të madh të prîjsave të saj t'i këthejë në zbatuesa të bindëshëm të planeve të politikës së tij.

Në Maj të vjetit 1894, Aleksandër Obrenoviqi e pezulloi kushtetutën përparimtare të vjetit 1888 dhe këtheu në fuqi kushtetutën reakcjonare të vjetit 1869. Simbas kësaj kushtetute mbreti ish i plotfuqishëm, mbassi atëhere partít popullore nuk ishin të qëndrueshme. Partija përparimtare dhe ajo liberale kaherë ishin antipopullore dhe prîjsat e tyne këqyrshin vetëm se si me marrë sundimin dhe pozitat, kështu që për gjithëshka ndihmojshin politikën e mbretit; Por, edhe Partija radikale u ndryshue mjaft. Nji pjesë e madhe e prîjsave të saj u largue prej luftës për bamjen e politikës dhe këqyrte vetëm me mbërrijtë në ndonji pozitë të naltë shtetnore. Prej vjetit 1894, prîjsat e Partís radikale trathtuen dhe partija merrte gjithënji karakter borgjez, dhe filloi me humbë karakterin katundar. Në parti sundimin e muerën pasanikët e mëdhej, të cilët për shkak të punëve të veta për import-eksport, u banë besnikë të sundimtarit.

Për shak të dobësís së tillë të Partive politike në vjetin 1898, mbreti mujti me anulue të gjitha partít politike në Sërbi dhe me veprue simbas dëshirës së vet. Në nji gjendje të tillë u kryen zgjedhjet ndërmjet të të besuemve; në 'to u zgjodhën kryesisht liberalët dhe përparimtarët, kurse radikalët muerën gjithësejt vetëm nji vend përfaqësuesi n'Uzhicë dhe e refuzuen.

Katundarët sërbë nuk e këndojshin mâ kangën e vet luftarake: »Ustaj, selo, ustaj rode« (Çohu, katund, çohu klan)... mbassi situata politike për ata u bâ e padurueshme. Ata nuk mujshin me kuptue qëndrimin e njerëzve prej udhëheqësís radikale, shumica e të cilëve u banë servilë të mbretit dhe pranojshin politikën e tij antipopullore. Popullit i ishte veçanisht i pakuptueshëm qëndrimi i Nikolla Pashiqit, i cili si prîjs i partís mâ të madhe dhe mâ revolucjonare në vend vjetë me radhë luftoi kundër tiranís së Millan Obrenoviqit, kurse në

vjetin 1899 në gjyq qëndroi si qyqan, dhe në letrën që i dërgoi mbretit Aleksandër shënoi bashkëpunëtorët e vet Kostë Taushonoviqin, Stojan Protiqin, Ranko Tajsiqin e të tjerët si kundërshtarë të kunorës dhe dinastís.

Gjendja politike në vend filloi të bâhet edhe mâ e vështirë atëhere kur mbreti Aleksandër u martue me vejushën Draga Mashin. Partit politike e lejuen këtê martesë për arsye se mbreti politikën e vet të jashtëme e këtheu prej Austro-Hungarís në Rusín, dhe në vjetin 1901 i dhuroi shtetit kushtetutën. Këtê kushtetutë të re e shfryetëzuen radikalët, të cilët u futën në qeveri bashkë me përparimtarët. Ajo u quejtë »e fuzionueme«. Pjesëmarrjen e tyne në qeveri, radikalët e arsyetojshin përpara turmave popullore tue u bazue në kushtetutën e re, e cila u futë në jetë, me gjithë se këjo nuk ishte përpilue n'Asamblén popullore. Për çashtjen e »fuzionit« Partija radikale u nda, e ky ish sukses i madh i mbretit Aleksandër.

Gjatë kohës së sundimit t'Aleksandër Obrenoviqt ekonomija nuk mujti me u zhvillue n'atê shkallë që dëshirohej. Për kah tregtija eksportuese Sërbija mvarej krejtësisht prej Austro-Hungarís. Ky shtet i madh fqîj përpiloi konventën veterinare dhe me 'tê caktoi që Sërbija t'eksportojë gjâ të gjallë. Tregtarët e mëdhej për eksport prej Sërbije ishin kapitalistët prej Vjene, të cilët blejshin mallin në Sërbi nëpërmjet të kapitalistave vendas. Në saje të tarifava hekurudhore, Austro-Hungarija mujti me bllokue mbarë tregtín import-eksport të Sërbís, jo vetëm me Austro-Hungarín, por edhe atê me shtetet tjerë europjanë. N'atê mënyrë Sërbija u bâ e mvarun prej Austro-Hungarís për kah pikëpamja ekonomike dhe politike. Politika e Austro-Hungarís synonte kah qëllimi që Sërbija të mbetej gjithënji vend bujqësuer, prej së cilës ajo, me çmime t'ulta, të merrte prodhime bujqësore, si dhe pasunít xehtare, për sipërmarrjet e veta industrijale. Këtê politikë t'Austro-Hungarís e ndoqën të dy Obrenoviqët e fundit, pse n'atê mënyrë krijojshin për vehte mbështetje në politikën e tyne gjatë sundimit antipopulluer. Këtê politikë e ndihmuen edhe byrokratët, të cilët në pozitat e veta mund të shfrytë-

zojshin tue marrë ryshfet prej tregtarëve me rastin e dhanjes së vizave për import e eksport.

Në mbështetjen e tillë politike n'Austro-Hungarín nuk pajtohej partija politike, e cila përfaqësonte borgjezín. Tue kërkue tregti mâ të madhe dhe të pamvarun ajo kërkonte që Sërbija të mbështetej plotësisht te Rusija dhe në fuqín e saj politike.

Në kohën e sundimit t'Obrenoviqit të fundit u zhvillue edhe klasa punëtore, e cila jetonte nën kushte shum të vështira. Prej vjetit 1895 ata filluen me përparue gradualisht dhe me u bâ të pamvarun si klasë e proletarjatit dhe prandej preu lidhjen e vet të mâparshëme me zejtarët si punëdhanësa. Klasa punëtore filloi me botue fletoret e veta socjaliste »Socjaldemokrati« në vjetin 1895 dhe »Radničke novine« në vjetin 1897. N'atê kohë u organizue »Shoqnija punëtore Beligradase« si dhe organizata e parë mjështërore »Shoqnija punëtore e opingarëve«, në fillim në Beligrad dhe në Kragujevc.

Në mbledhjet punëtore dhe nëpërmjet shtypit socjalist flitej jo vetëm për çashtjet ekonomike, por edhe për ato politike. N'atê kohë u dukën edhe grevat e para punëtore, ku shfaqeshin kërkesat për sigurimin e punëtorëve dhe për shpalljen e ligjit për punëtorët.

Policija i shpërndante mbledhjet dhe grevat dhe përpiqej me të gjithë mjetet për të pamundësue zhvillimin e lëvizjes punëtore, e cila atëhere kishte partín e vet në Sërbi. Kundër lëvizjes punëtore nuk punonte vetëm qeverija, por edhe të gjitha partít borgjeze. I vetmi mik i lëvizjes punëtore ishin studentët e shumtë në Shkollën e naltë, ku egzistonte klubi socjalist studentesk.

Në vjetin 1903 filluen Demonstratat e Marsit në Beligrad. Me propozim të studentëve socjalistë Dimitër Tucoviqit dhe Trishe Kaçleroviqit dhe nacjonalistit Lubo Jovanoviqit-Çupe, u mbajtë mbledhja e shoqnís studenteske »Pobratimiteti« në ndërtesën e Shkollës së naltë me 23 Mars të vjetit 1903 para dite. Mbas mbledhjes studentët u shpërndanë qetësisht, por mâ vonë u lajmëruen me shkue mbas dite në Kalemegdanin e Vogël, prej kah do të fillojshin demonstratat. Po n'atê ditë

ishte caktue mbledhja protestuese e ndihmës tregtarëve, të cilët duhej të mblidheshin në kafe »Takova«, por mbassi atê mbledhje e ndaloi policija, edhe ata erdhën në Kalemegdan.

Në vendin e caktuem në Kalemegdan u mblodhën mâ se gjashtëqind. Por mbërrijti edhe policija me gjindarmët. Për shkak të tyne demonstrata nuk mujti me fillue në Kalemegdan, por demonstrantët në grupe të vegjël u shpërndanë dhe u mblodhën n'oborr të Shkollës së naltë. Kur policija pushtoi portën kryesore, demonstrantët duelën kah dera tjetër dhe u futën në rrugën e Knez (princ) Mihalit, prej këndej u nisën në drejtim të Terazís dhe Oborrit tue bërtitë: »Rrnoftë lirija!«, »Poshtë despotizmi!« Gjatë rrugës me demonstrantët u bashkue nji numër mjaft i madh njerëzish, kështu që vargu u rrit në dy mijë njerëz. Demonstrantët e shumtë mbushën xhepat dhe muerën në duer gurë tue pritë me u ndeshë me gjindarmët. Në Terazije u duk kordoni i gjindarmëve, dhe atje filloi ndeshja e parë. Gjindarmët goditën shum demonstrantë, por as ata nuk i kursyen gjindarmët tue i qëllue me gurë. Tue pá se policija vendosi me qitë me armë, demonstrantët u tërhoqën, por mâ përpara i shkatërruen të gjitha redaksít e fletoreve qeveritare.

Mbas mbarimit të demonstratave, demonstrantët u shpërndanë dhe shkuen nëpër shtëpijat e veta, e disa grupe shkuen në Kalemegdan, ku filluen me u sqarue me gjindarmët. Nji prej tyne qiti me armë dhe plagosi nji punëtor të ri, kurse nji student për këtê shkak qiti me revolver kundër atij gjindarmi. Atëhere gjindarmët filluen me gjuejtë në turmë, kështu që u plagosën shum njerëz. Ky ishte shkaku që përpara kafes »Kunora sërbe« (Srpska kruna) filloi përleshja mâ e madhe, ku nga të dy anët mbetën shum të plagosun. Poashtu demonstrantët u përleshën me gjindarmë edhe në rrugën e princ Mihalit, ku mbërrijti kalorija. Ajo nuk përdori armët. Në këto përleshje mbetën katër qytetarë të vdekun dhe shum të plagosun. Dhimitër Tucoviqi kaloi në Zemun n'emigrim, kurse udhëheqësat tjerë të demonstratës u tërhoqën n'ilegalitet.

Demonstratat e Marsit shkaktuen ndamjen e përhershëme ndërmjet popullit dhe Obrenoviqit. Ato pohoheshin prej të

gjithë njerëzve të ndershëm dhe përparimtarë, pa dallim se në cilën parti bâjshin pjesë.

Atëhere mbreti e anuloi kushtetutën, shpërndau Asamblén popullore, shpalli ligjin e ri të zgjedhjeve dhe dekretoi votime të reja në Maj të vjetit 1903. Në këto votime radikalët nuk muerën pjesë. Obrenoviqi besonte se do të krijonte Asamblé të tillë popullore,e cila do të miratonte[1]) gjithëshka që bânte ai, e n'atê mënyrë do të fitojë sundim të plotfuqishëm e të pakufijshëm.

Kur u banë votimet dhe kur Obrenoviqi kujtonte se mâ në fund triumfoi, më 11 Qershuer (29 Maj simbas kalendarit të vjetër) të vjetit 1903, n'oborr u fut nji grup oficerësh dhe e vranë mbretin Aleksandër Obrenoviqin dhe mbretneshën Draga. Ajo ngjarje quhet Grusht shteti i Majit.

Në vjetët e fundit të sundimit t'Aleksandër Obrenoviqit pakënaqësija përfshiu jo vetëm popullin sërb, por ajo u përhap edhe te Sllovenët tjerë të Jugut, të cilët nuk kishin se shka me pritë prej nji sundimtari të tillë në Sërbi. Qysh në vjetin 1901 disa oficera përgatitën komplotin me vra mbretin dhe mbretneshën. Me komplotistët u bashkuen disa oficera prej Beligradi dhe disa qytetarë. Komplotistët mâ të dalluem ishin Dragutin Dimitrijeviqi, Apis, dhe Anton Antiqi.

Oficerat komplotistë u mblodhën në shtëpín e oficerave, prej kah n'orën dy mbas mesnate shkuen n'Oborr në rrugën e mbret Milanit (tash e Marshall Titos). Atje nji komplotist u hapi derën dhe ata u futën në pallat dhe vranë mbretin e mbretneshën. Përpara pallatit komplotistat kishin pru edhe njisi ushtarake. Kufomat e mbretit dhe mbretneshës nëpër dritare i hodhën në kopësht. Ate natë përveç mbretit dhe mbretneshës vranë edhe ordinancin e mbretit — oficerin, të dy vllaznit e mbretit — oficerët Lunjeviq, kryetarin e qeverís dhe ministrin e ushtrís.

Kur komplotistat mbaruen veprën e vet, proklamuen për mbret Petër Karagjorgjeviqin, të cilin e pranuen si ushtrija ashtu dhe populli.

---

[1]) miratonte = pëlqente, aprovonte.

Në këtê mënyrë u zhduk dinastija Obrenoviq dhe mbaroi sundimi i regjimeve antipopullore që pengonte zhvillimin politik dhe ekonomik të popullit sërb.

## HOVI EKONOMIK DHE PËRFORCIMI POLITIK I SËRBIS NË KUSHTET E DEMOKRACIS BORGJEZE DHE I PARLAMENTARIZMIT

### Fillimi i demokracís qytetare dhe i parlamentarizmit; lulëzimi i industrís dhe përforcimi i kapitalit të madh të vendit; depërtimi i kapitalit të huej

Grusht shteti që banë oficerët në Maj të vjetit 1903, në të vërtetë, nuk kishte karakterin e revolucjonit populluer, por sidoqoftë ka nji randësi të madhe për zhvillimin e mâtejshëm të shtetit sërb. Me këtê grusht shteti Sërbija zhduku pengesën kryesore për zhvillimin e vet demokratik. Atëhere filloi hovi në veprimtarín politike, e poashtu u krijuen edhe kushtet për zhvillimin e industrís dhe bankave.

Borgjezija e madhe, e veçanisht bankjerët dhe industrijalët, u lidhën me oficerat dhe nëpërmjet të Partís radikale muerën gjithë gjendjen politike në duert e veta. Së bashku prunë në fron, prej emigrimit prej Zheneve, Petrin e I Karagjorgjeviqin, i cili si mbret iu përmbahej princave parlamentarë në qeverimin e tij.

Asambleja popullore këtheu kushtetutën borgjezo-demokrate të vjetit 1888 dhe e plotësoi, kështu që në Sërbi u fut regjimi i parlamentarizmit, i cili i përshtatej si klasës sunduese ashtu edhe popullit. Qeverija gjithëmonë përbâhej prej njerëzish t'Asamblés popullore, dhe në tê mâ shum vende zinte ajo parti që kish shumicën n'Asamblén popullore. Ndamja e sundimit ndërmjet mbretit dhe shumicës n'Asamblén popullore tashmâ u zbatue, dhe në Sërbi fituen mâ në fund konstitucionalizmi dhe parlamentarizmi.

Borgjezija sërbe u përpoq në çdo mënyrë me përvehtësue dhe shfrytëzue ato fryte që mbërrijti me i nxjerrë në luftën e gjatë dhe të përbashkët me popullin kundër apsolutizmit t'Obrenoviqit. Mbassi synimet politike të borgjezís sërbe

shpreheshin mâ qartë në Partín radikale, këjo u bâ flamurtare e sundimit politik në Sërbi mbas vjetit 1903. Përpara ishte Partija e borgjezís së vogël, e cila kishte mbështetje në turmat e gjana katundare dhe ishte flamurtare e synimeve demokratike përparimtare. Partija radikale tash u shndërrue në partín e kapitalistave industrijalë dhe bankjerë, të cilët u larguen prej luftës demokratike dhe kaluen në pozita reakcjonare.

Ndikimi i Partís radikale në politikën e Sërbís ishte mâ i madhi por, përveç atij, nëpërmjet mbretit, ndikojshin shum edhe oficerat komplotistë. Prandej Partija radikale duhej me iu përshtatë oficarave komplotista dhe anasjelltas. Pasoja e këtyne konçesjoneve politike të shkëmbyeshme ishte ajo se qeverija e re, tue përmirësue kushtetutën e vjetit 1888, nuk futi të drejtën e votës për të gjithë, të paktën për të gjithë mashkujt, por mbante vazhdimisht cenzurën, dmth. të drejtën e votës simbas naltësís së taksave. N'atê mënyrë disa qinda mija njerëzish nuk kishin të drejta me ndikue në politikën e vendit të vet.

Të tre faktorët politikë — mbreti, Partija radikale dhe oficerat komplotistë — drejtuen politikën e tyne kryesisht kah ngritja e nacjonalizmit. Shpenshherë ata shfrytëzuen nacjonalizmin te turmat popullore për të marrë pëlqimin për ndonji vendim të qeverís që merrej me qëllim që disa individë të shfrytëzojshin pasunít e mbarë vendit.

Ndryshimet e mëdha nuk u kryen vetëm në politikën e mbrendshëme, por edhe në politikën e jashtëme të Sërbís. Mbas vjetit 1903 Sërbija iu largue krejtësisht politikës s'Obrenoviqëve për t'u mbështetë n' Austro-Hungarín. Tash ajo u orientue kah Rusija dhe aleatët e saj — Franca dhe Anglija. Prandej politika e jashtëme filloi me marrë drejtim mâ të qartë kundër Austro-Hungarís dhe kundër tentativave të saj për robnimin e mâtejshëm të popujve ballkanikë. Në këtê politikë të qeverís pajtohej populli sërb, i cili ishte vendosshmënisht kundër aspiratave imperialiste të Gjermanëve dhe programit t'atyne Drang nach Osten. Prandej në votimet populli i jepte gjithënji votat e veta për Partín radikale dhe

besonte se kryetari i saj, Nikolla Pashiqi, e çonte vendin në rrugë të drejtë.

Me vendosjen e parlamentarizmit dhe demokracís në vend, si dhe me realizimin e sundimit personal të mbretit dhe krijimin e kushteve mâ të mira për zhvillimin e ekonomís, Sërbija përsëri fitoi autoritet ndërmjet atyne Sllovenëve të Jugut, të cilët ndodheshin nën sundimin e Austro-Hungarís dhe Turqís. U ringjall përsëri ideja për bashkimin e popujve jugosllavë dhe nevoja për bashkimin e tyne.

Sllovenët Jugorë jashtë Sërbís qysh në vjetin 1904 këqyrshin n'organizatën e Sërbís parlamentare mishnimin e aspiratave të veta. Veçanisht lirija e shtypit në Sërbi ishte në naltësín e duhun. Të gjitha partít dhe organizatat e ndryshme botojshin nji numër të madh të fletoreve të veta. Përveç atyne, delshin edhe shum fletore tjera, revista, libra dhe broshura. Kurr në Sërbi nuk kish qenë kaq e lirë lirija e fjalës në mbledhjet dhe konferencat, e poashtu edhe në shtyp. Librat prej të gjitha lamive shkencore shtypeshin lirisht dhe shpërndaheshin, sikurse dhe librat politike, në të gjitha viset ku jetojshin Sllovenët Jugorë.

Fuqija e madhe tërheqëse për përtrimjen e ideve të Sllovenëve Jugorë, përveç sundimit parlamentar, ishte edhe organizata e ushtrís sërbe. N'atê kohë ajo mori veçori nacjonale dhe u jepte shpresë Sllovenëve Jugorë se së shpejti do të ndodhin ngjarje që ata të shlirohen nga zgjedha Austro-Hungare dhe Turke.

Mbassi iu përvesh rregullimit të financave shtetnore dhe shpenzimit të buxhetit me kujdes, Sërbija fitoi mundësi për të marrë kredí përjashta. Ato kredi mâ shum i shpenzoi n'armatimin e ushtrís për luftën shlirimtare.

Mbas vjetit 1904, Partija radikale ishte ende e ndame në dy grupe. Shumicën e quejshin radikalë të vjetër, kurse grupin mâ të vogël radikalë të pamvarun. Në votimet e para të lira të dy grupet fituen vende të njajta deputetësh n'Asamblén popullore. Me gjithë se ishin t'afërmë për kah ideologjija, ato nuk mujshin me punue së bashku në qeveri, veçse kur shteti ishte në rrezik. Radikalët e vjetër ishin përfaqësuesa të bor-

gjezís së madhe industriale bankare, kurse radikalët e pamvarun përfaqësojshin interesat e borgjezís së vogël dhe intelektualëve.

Për shkak të këtyne kundërshtimeve ndërmjet partive kryesore sunduese, qeverít ndërroheshin shpesh. Në fillim në ndërrimet e qeverive ndikuen edhe oficerët komplotistë, por mbas Luftës ruso-japoneze dhe krijimit t'aleancës ndërmjet Anglís dhe Rusís, gjendja ndryshoi. Simbas kërkesës s'Anglís disa oficerë komplotistë u qitën në pension, në vjetin 1906. Shtetet e Antantës Kërkuen që oficerët të mos ndikojnë si përpara, për politikën e shtetit.

Në kushtet e rikrijueme për politikën e mbrendshëme dhe të jashtëme të përshtatuna aleatëve, u duk mundësija për ngritjen e industrís dhe për forcimin e kapitalit të madh shtetnuer.

Pronarët e xeheroreve, guroreve dhe fabrikat, si edhe sipërmarrjet për premjen e pyjeve dhe bartjen e materjalit për ndërtime, muerën prej shtetit privilegje të shumta për kryemjen e punëve të veta. Përveç këtyne, u përhapën shum edhe ato shoqni tregtare, të cilat në vjetët e fundit të shekullit XIX u krijuen për caktimin e çmimeve (kartelet). Këto shoqni mbas vjetit 1903 filluen me luejtë nji rrol me randësi për forcimín e tregtís dhe industrís. Veçanisht u dalluen tregtarët e mëdhej beligradas, të cilët muerën autorizim për importimin e pambukut. Përveç këtyne, krijuen shoqata edhe tregtarët e qelqit, hekurit dhe materjalit ndërtues, e mâ vonë krijuen kartele edhe pronarët e mullijve, fabrikave të tjegullave shtypëshkrojave, mandej kasapët, furrtarët etj.

Sërbija dispononte pasuni të mëdha natyrale, veçanisht xehe. Kur në shtet u vendos regjimi qytetaro-demokrat, kapitalistat e huej u interesuen edhe mâ shum për shfrytëzimin e pasunive natyrale. Nën Obrenoviqët kryesisht mbretnonte ndikimi i kapitalistave austrohungarezë, kurse prej vjetit 1904, në Sërbi depërtoi kapitali francez, englez dhe gjerman. Kapitalistat e huej u lidhën me disa individa me influencë dhe nëpërmjet tyne merrshin koncesjone për eksportimin e xeheroreve dhe pyjeve, si dhe për përpunimin e disa landëve të para

me randësi. Poashtu, u futën në punë të ndryshme me tregtarët e mëdhej të tregtís import-eksport. Shum tregtarë të huej u vendosën në Sërbin dhe futën kapitalin e vet në punë të fitimshëme. Kështu u pasunuen shpejt edhe me lidhjet e veta jashtë shtetit tue i mundësue shtetit me marrë huana të hueja për armatimin e ushtrís. Disa kapitalista të huej nuk u kënaqën vetëm me shfrytëzimin e pasunive natyrore të Sërbís. Ata nëpërmjet të lidhjeve të veta me anë të punës dhe individëve politikë, ndikuen si në politikën e shtetit ashtu edhe për zgjidhjen e shum çashtjeve shtetnore. Nën ndikimin e tyne ishin shum politikanë në pozitat mâ të nalta shtetnore, kështu që këta të huej deri në njifarë shkalle frenojshin zhvillimin e mâtejshëm të demokratizmit dhe ndihmojshin eksploatimin e popullit.

### Zhvillimi i industrís fabrikante dhe shtimi i proletarjatit qytetar. Fillimet e lëvizjes moderne punëtore

Kah fundi i shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX në Sërbi u shfrytëzuen 13 xeherore: Bori, Vërshka Çuka, Majdanpeku, Rudniku i Senjes, Aleksinci etj. Përveç këtyne në Sërbi kishte 175 mullij, të cilët paraqitshin nji industri mjaft të fortë, kurse pronarët kishin shum fitime prej ujemit të drithnave që bluejshin. Veçanisht shpejt u zhvillue industrija e birrës; prej vjetit në vjet dhetë fabrika birreje shtojshin prodhimin e vet, mbassi me shtimin e popullsís qytetare shtohej edhe konsumimi i birrës. Në 74 sipërmarrje të ndryshme industrijale nëpër qytetet e mëdhej dhe të vogjël përpunoheshin landët e ndryshme dhe prodhoheshin sende industrijale, si: sheqer, pëlhura, cohe, qelq, letër, litar e spagë, armë e veçanisht tjegulla dhe materjal i ndryshëm ndërtimi. U zhvillue industrija e lundrava dhe objekteve të ndryshëm për lundrime të ndryshme në Savë dhe Danub, si dhe ndërtimi i hekurudhave, që poashtu përfaqësonte zhvillimin e industrís.

Numri i fabrikave u shtue, kurse sipërmarrjet e vjetra industrijale shtuen veprimtarín e vet prodhuese, mbassi u paraqit kërkesa gjithënji mâ e madhe për prodhime industri-

jale. Industrija e fabrikave u ndërtue mâ shum në qytetet, mbassi te ata ishte përqëndrue kapitali dhe banojshin pronarët e fabrikave.

Gjendja e punëtorëve mëditësa në Sërbi ishte shum e vështirë. Orari i punës ishte prej 14—18 orë në ditë. Pronarët e fabrikave këqyrshin në çdo mënyrë me u pré punëtorëve nji pjesë prej mëditjevet të tyne të vogla. Ndodhte shpeshherë që punëtorët të mos e merrshin krejt rrogën në të holla, por u jepshin »tantuza«, me të cilat mund të blijshin mall në tregtizat e fabrikës. N'atê mënyrë pronarët eksploatojshin punëtorët dyfish. E para që u paguejshin mëditje të vogla për nji kohë shum të gjatë pune, dhe e dyta, se i detyrojshin me ble mall në »kantinat« e veta me çmime mâ të nalta se në tregtoret tjera.

Në këtê gjendje kaq të vështirë, te punëtorët u përforcue ndërdija e klasës dhe filloi me u ndi nevoja për organizimin e proletarjatit në partín socjaliste. Deri sa sundonte regjimi apsolutist i Obrenoviqit, nuk kishte kurrfarë kushtesh për zhvillimin e lëvizjes moderne punëtore, por mbas Grushtshtetit të Majit gjendja u përmirësue. Tash klasa punëtore kishte mundësi me u organizue ekonomikisht, politikisht dhe në pikëpamje kulturore.

Mbassi borgjezija sërbe mâ në fund fitoi dhe mbërrijti në gjendje që mund të zhvillohej dhe të ndërtonte fabrikat e veta, edhe proletarjati i Sërbís u shtue shum simbas nevojës. Borgjezija nuk mujti me e pengue organizimin e tij. Mbas grushtit t'oficerave dhe ndryshimit të qeverís, Dhimitër Tucoviqi u këthye dhe u bâ, përveç Radovan Dragoviqit, autoriteti i parë në lëvizjen punëtore të Sërbís.

Dragoviqi dhe Tucoviqi e çmuen drejt gjendjen politike të rikrijueme dhe panë se ishte momenti për organizimin e partís socjaliste, e cila do të jetë thelbi i lëvizjes punëtore. Kishte 40 vjetë që në Sërbi egzistojshin idét socjaliste, por nuk kishte organizatë në bazat e klasës. Për gjithë atê kohë punëtorët nuk mujtën me u edukue në shkencën marksiste-revolucjonare. Prandej me 20 Korrik të vjetit 1903 në Kongresin në Beligrad u mblodhën delegatët socjalistë dhe themelue Partín socjaliste.

Klasa punëtore zhvilloi frymën luftarake të mâparshëme, që tash e çfaqi në programit e vet.

Programi i »Partís socjaliste sërbe« i vjetit 1903 ishte për luftë klase pa kushte, për ndryshimin e gjendjes shoqnore dhe politike të punëtorëve në Sërbi. Prej këtij programi nuk ishin të kënaqun disa persona deri atëhere socjalistë, (si Jovan Skerliqi), të cilët përpiqeshin që në parti të fusin aspiratat e borgjezís s'ulët. Prandej ata u larguen prej lëvizjes së klasës.

Shpejt mbas kësaj u organizue edhe lëvizja sindikale në trajtë të Bashkimit kryesuer të punëtorëve. Ai përfshiu punëtorët n'organizata profesjonale. Në çashtjen e marrëdhanjeve ndërmjet sindikatit dhe partís, ndërmjet personave të dalluem në lëvizjen punëtore lindën kundërshtime. Millorad Popoviqi, Dragisha Llapçeviqi dhe disa të tjerë kërkojshin që lëvizja sindikale të jetë e pamvarun prej Partís socjaliste. Në kundërshtim me grup qëndronte Dhimitër Tucoviqi me shumicën e punëtorëve, të cilët kërkojshin që nëprmjet t'organizatave të partís dhe sindikatit të përshkohet rryma e unjisimit t'ideologjís së Partís socjaliste. (Organizatat nuk mund të jenë të ndame njena prej tjetrës, mbassi në të dyja punojnë të njajtët njerëz). Parimet e drejta të Tucoviqit ngadhnjyen, dhe në këtë mënyrë prej vjetit 1904 në Sërbi filloi lëvizja moderne punëtore, e ndërtueme në parimet shkencore të marksizmit.

Përfaqësuesi dhe interpretuesi i lëvizjes punëtore ishte **Dhimitër Tucoviqi.** Ai lindi në vjetin 1881 në katundin Gostilje, në Zlltatibor, në rrethin e Uzhicës. Qysh fëmi njohu jetën e vështirë të katundarit sërb dhe mbeti për gjithë jetën e vet i afërm me popullin. Në gjimnazin real l'Uzhicës, Tucoviqi ishte i pari që u njoh me idét socjaliste, dhe u qëndroi besnik prej asaj kohe e deri në vdekje. Kur kaloi në Beligrad, ku dha maturën dhe filloi studimet e nalta, ishte mjaft i shkathët dhe mbas nji kohe të shkurtë u vû në krye të lëvizjes socjaliste të rinís studenteske. Tue qenë i zgjuet prej natyre dhe i fortë fizikishit, mujti me punue për plotësimin e dijes së vet me shkencat e ndryshme. Prej vjetit 1905 si sekretar i partís socjaliste mësoi shum për naltësimin e ndërdijes

socjaliste në Sërbi. U bâ redaktor përgjegjës i fletores »Gazeta punëtore« dhe i revistës »Borba«, dhe nëpërmjet shtypit jepte direktivën për lëvizjen e partís dhe atê sindikale.

Gjendja e punëtorëve nuk u përmirësue shum as mbas vjetit 1903. Mëditjet e tyne silleshin prej 20 pare deri më 1 dinar. Punëtorët punojshin në këthina të ndyta dhe johigjenike, kështu që punëtorët vdisshin në moshë të re. Mbassi në dhetëvjetëshin e parë të shekullit të XX numri i sipërmarrjeve industrijale u shtue prej 153 në 465, edhe numri i punëtorëve n'ato sipërmarrje u shtue shum. Me gjithë atê, mënyra e jetesës gati nuk u ndryshue aspak.

Lëvizja punëtore në Sërbi, e udhëhequn drjet prej politikës proletare, gëzonte autoritet ndër të gjitha lëvizjet e jugosllovenëve, për shkak të revolucjonaritetit dhe qëndrimit të drejtë të klasës kundrejt borgjezis nacjonaliste. Me githë se e pakët në numër, ajo gëzonte admirim edhe në lëvizjen punëtore ndërkombëtare. Në kongreset e Internacjonalës së II përfaqësuesat e Partís socjal-demokrate sërbe mbrojtën në mënyrë luftarake çashtjen e drejtë të punëtorëve.

Kur imperjalizmi gjerman kërcënoi paqën botënore dhe kur u ndi rreziku në Ballkan, në vjetin 1910, u mblodh konferenca e parë socjaliste ballkanike në Beligrad. Në konferencë muerën pjesë delegatët e Sërbís, Bullgarís, Maqedonís dhe Kosovës, Malit të Zi, Kroacís, Bosnjës e Hercegovinës, Sllovenís dhe Rumanís. N'atê konferencë u dha rezolucjoni për popujt ballkanikë. N'atê kërkohej që Lidhja e republikave socjaliste në Ballkan kështillon si dalje të vetme zgjidhjen e kundërshtimeve ndërmjet popujvet ballkanikë. Disa delegatë prej Kroacijs dhe Sllovenije nuk u pajtuen me këtê rezolucjon për shkak t'Austrís.

Lëvizja punëtore në Sërbi luftoi nëpërmjet grevave për të përmirësue gjendjen e vet socjale. Me agjitacjonin nëpër mbledhjet e punëtorëve dhe nëpërmjet shtypit luftoi për liri politike dhe barazim për të gjithë qytetarët, tue mos harrue patriotizmin e vërtetë ndaj popullit dhe atdheut të vet.

**Lufta doganore — lufta për emancipimin ekonomik të Sërbís prej Austro-Hungarís**

Sërbija i stabilizoi marrëdhanjet e politikës së vet të jashtëme tue u bazue në shtetet e Antantës, të cilët i kundërshtojshin gjithënji e mâ me vendosshmëni politikës rivale grabitëse të Gjermanís dhe Austrís. Hovi ekonomik në Sërbi shkonte në fitim të borgjezís, e cila dëshironte me u shlirue prej konventës së fsheftë të vjetit 1881 dhe të këputte presjonin ekonomik t'Austro-Hungarís. Prandej Sërbija, në vjetin 1905 bani marrëveshtje doganore me Bullgarín.

Regjimi demokratik i borgjezís sërbe përpiqej që me ndihmën e doganave të mbrojtuna të krijojë lehtësi për eksportimin e mallit-doganë t'ultë për prodhimet e industrís fabrikante të vendit, dhe doganë të madhe për importimin e fabrikimeve të hueja. Poashtu, qeverija e Sërbís u përpoq me shlirue prej disa taksave industrín e re sërbe, e cila filloi të zhvillohet në drejtimin modern, dhe prej vjetit 1898 u fut sistemi i privilegjëve.

Zhvillimi i ri ekonomik i Sërbís ndikoi shum për ngritjen e autoritetit të Sërbís si shtet. Parlamentarizmi i saj dhe demokracija u banë idé udhëheqëse për popujt tjerë jugosllovenë. Prandej Austro-Hungarija mendonte se politika përparimtare e Sërbís kërcënonte disa krahina të saja. Ajo veproi ashpër porsa Bullgarija shpalli botënisht marrëveshtjen doganore që lidhi me Sërbín.

Austro-Hungarija, në vjetin 1906, ndaloi çdo importim dhe transportim të kafshëve të gjalla dhe të theruna, shpendë, vo dhe gjana tjera prej Sërbije nëpër teritorin e vet. Në këtë Sërbija e përgjegj tue ndalue importimin dhe eksportimin e sheqerit, shpirtos dhe prodhimeve tjera prej Austro-Hungarís. Në këtë mënyrë ndërmjet Austro-Hungarís dhe Sërbis filloi lufta doganore, e cila zgjati deri në vjetin 1910.

Deri në shpalljen e luftës doganore nandë të dhetat e eksportimit prej Sërbije kalojshin nëpër Austro-Hungari. Për këtë shkak Austro-Hungarija njehsonte me siguri se Sërbija do të kapitulojë nën presjonin e saj, mbassi nuk do të ketë mundësi, për t'eksportue prodhimet e veta dhe prodhimet

bujqësore-blegtorale. Ndërsa, nji vështrim i tillë i çashtjeve tashmâ kish marrë fund. Sërbija nuk ishte mâ ajo e kohës s'Obrenoviqit, në të gjendja ishte ndërrue kryekëput. Borgjezija e përfaqësueme në Partín radikale dhe në regjimin parlamentar, nuk kujdesohej vetëm për eksportimin e prodhimeve bujqësoro-blegtorale, por edhe për interesat e kapitalistave të vendit. Ajo u përpoq që tregun e vendit ta sigurojë për vehte dhe për prodhimet e veta industrijale. N'atê mënyrë jo vetëm që u forcue industrija e vendit, por borgjezija fitoi fuqi politike dhe influencë në turmat popullore, të cilat e miratojshin qëndrimin e tillë politik ndaj Austro-Hungarís.

Mbarë populli sërb e pá se Austro-Hungarija filloi me pré marrëveshtjen tregtare dhe nisi luftën doganore mâ shum me qëllim politik se sa ekonomik. Austro-Hungarija i frigohej lidhjes së popujve të vogjël të Ballkanit, të cilët mbështeteshin te Rusija. Këjo ishte në kundërshtim me qëllimet e saj që prej Bosnje të pushtonte Ballkanin.

Në sulmin e vet t'ashpër kundër Sërbís, Austro-Hungarija llogaritte se do ta detyronte kundërshtarin e vet të vogël me kapitulue; por ndodhi e kundërta. Sërbín e ndihmuen shtetet e Antantës, p. sh. Franca i dha hua, me të cilën Sërbët mund të blejshin topa në Francë. Shpresa e Austro-Hungarís se Sërbija për armatimet e veta do të blente pa tjetër topa prej fabrikave Shkoda, dështoi. Anëtarët e Antantës e ndihmuen në fushën e tyne diplomatike që Sërbija të fitojë të drejtë eksportimi nëpër Selanik, dhe me hekurudhë nëpërmjet Bullgarís në Detin e Zi, si dhe nëpërmjet Danubit nëpër Braile. Në këtê mënyrë gjedja u ndryshue në favor të Sërbís, kështu që shpresa e Austro-Hungarís, që me anën e presjonit ekonomik me e detyrue Sërbín që të kapitulojë, dështoi. Sërbija mujti me përballue krejt kohën doganore pa dame materjale.

Pra, ndodhi e kundërta e asaj që shpresonte Austro-Hungarija. Sërbija u forcue në pikëpamje ekonomike dhe politike, mbassi bani lidhje tregtare me Francën, Italín, Belgjikën, Anglín dhe Zvicrën. Mâ me shpejti u zhvillue përpunimi i mishit; prandej u ndërtuen thertoret dhe u prunë vagona për transportimin e mishit të krypun dhe mallit prej mishit të

thatë. Rezultati i këtij suksesi ishte me randësi të madhe për Sërbín si shtet dhe për popullin e vet, i cili gjeti fitime në vend dhe nuk kishte mâ nevojë me u shpërngulë dhe me kërkue bukë në shtetet e huej kapitalistë. Shuma e të hollave prej t'ardhunavet t'eksportimit gjatë katër vjetëve të luftës doganore u shtue prej 62 milion në 98 milion dinarë. Këjo jipte me kuptue se këjo luftë e padrejtë doganore damtoi Austro-Hungarín, e cila edhe e provokoi, dhe jo Sërbín e cila duel prej saj e përforcueme materjalisht dhe moralisht.

Rezultati i luftës doganore ishte ai se Sërbija vetëqeverisej dhe u bâ e pamvarun prej Austro-Hungarís në pikëpamje ekonomike, e aq mâ tepër n'atê politike. Prandej, qeveritarët e Monarkís Austro-Hungare, kur panë se lufta doganore nuk zhvillohej në favor të tyne, përdorën mënyra të ndryshme politike për ta kallxue Sërbín si provokuese lufte në Ballkan në vjetin 1908—1909.

Në kohën kur Austro-Hungarija ia ndajmbathi (aneksoi) plotësisht Bosnjën dhe Hercegovinën perandorís së vet, në Ballkan filloi nji krizë e madhe dhe kërcënohej rrezik për fillinim e luftës. Në Sërbi dhe në Mal të Zi filloi nji gjallni e madhe politike dhe që të dy këta shtete filluen me u përgatitë për luftë. Populli Sërb u tregue shum i fortë dhe dijti me u orientue në këtê situatë të vështirë. Ajo fuqi i shtyni politikanët europjanë me u kujdesue seriozisht për çashtjen sërbe, e cila u ashpërsue deri në fund.

Fuqít e mëdha nuk ishin ende të përgatituna për luftë. Prandej Gjrmanija gjeti nji rrugë për të mos fillue lufta — e bindi Turqín që Bosnjën e Hercegovinën me ai dorëzue zyrëtarisht Austro-Hungarís, tue i pague disa dheta miljona. Poashtu Gjermanija lajmëroi Rusín se Austro-Hungarija do të fillojë luftën kundër Sërbís, në qoftë se ajo nuk heq dorë prej kërkesës së saj për Bosnjën dhe Hercegovinën. Në këtê gjendje të vështirë shtetet e Antantës ndikuen mbi Sërbín me iu largue luftës, dhe kriza akcjonuese përfundoi në favor t'Austro-Hungarís.

Simbas veprimeve dhunuese t'Austro-Hungarís, me ndihmën e aleates së saj, Gjermanís, u pá se këto dy fuqi të mëdha

përgatitshin pushtimin e Ballkanit. Prandej Sërbët filluen me shpejtësi me u përgatitë për rezistencë, tue krijue organizata të ndryshme, politike dhe kulturore, të cilat përfshijshin njerëz prej Sërbije dhe krahinavet tjera jugosllave.

Qysh prej Grusht — shtetit të Majit oficerat komplotista ishin të lidhun ndërmjet tyne, prej rrethit të të cilëve, kah mezi i vjetit 1911 u krijue organizata e msheftë »Bashkim ose vdekje«. Rëndom këtê organizatë e quejshin »Dora e zezë«, dhe në tê merrshin pjesë si anëtarë, përveç oficerave, edhe shum njerëz prej popullit. Organizata kishte rregulloren e vet, të cilën duhej ta respektonte çdo anëtar i saj. Qëllimi kryesuer i saj ishte bashkimi i sërbëve; anëtarët që trathtojshin organizatën dënoheshin me vdekje. Organizatorët kryesorë të »Dorës së zazë« ishin Dragutin Dimitrijeviqi-Apis, Çedo Popoviqi, Velimir Vemiqi etj.

Këjo organizatë ndikonte veçanisht te njerëzit e rij dhe te organizatat e ndryshme në Sërbi dhe jashtë kufîjve të saj. Anëtarët e saj muerën pjesë në përgatitjen e luftës ballkanike dhe për rezistencë kundër qëllimeve grabitqare t'Austro-Hungarís në Ballkan.

**Krijimi i Lindhjes ballkanike; planet agresive të borgjezís; dëshirat shlirimtare të turmave të gjana popullore; Lufta e parë ballkanike dhe randësija e saj progresive, dhe Lufta e dytë sërbo-bullgare**

Gjendja e popullit nën sundimin e Turqëve në Maqedoni, Kosovë dhe Metohi, dhe në Sanxhakun e Novipazarit ishte gjithënji e pasigurtë dhe shum mâ e vështirë se te popujt tjerë n'Europë. Pritmënija se ajo pozitë do të ndryshohej mbas revolucjonit të Turqëve të rij (Xhonturqëve), u kallxue si e pasaktë. Kur erdhën në sundim Turqit e Rij kallxuen dëshirat e veta supernacjonaliste. Revolucjoni i borgjezís turke prej vjetit 1908, i cili rrëxoi regjimin tiranik të Abdul-Hamitit, nuk përmirësoi gjendjen e popullsís së krishtenë në perandori. Turqit e Rij, jo vetëm që nuk këthyen rregullin dhe ligjshmënín në vend, por mbyllën edhe shkollat, që kishin deri atëhere disa popuj që nuk ishin turq. Përdhunisht i këthejshin të

krishtenët turq dhe i vritshin njerëzit që nuk pranojshin. Të gjitha këto i kryejshin nën parollën »Perandorija Osmanlike Osmanlijve!«. Ata kallxuen se në shtetin e tyne nuk njohin asnji kombësi tjetër përveç asaj turke.

Mbassi në nji kohë ishin të kërcënuem Sërbija prej Austro-Hungarís dhe Bullgarija prej Turqís, u krijue dëshira për lidhjen e popujve të vogjël ballkanikë. Me ndërmjetsimin e përfaqësuesit rus në Beligrad, Nikola Hartvigut, u zbutën kundërshtimet ndërmjet qeverís sërbe dhe bullgare, që çfaqeshin shpeshherë në shtypin e përditëshëm. Prandej u krijue mundësija për të bâ lidhjen. Sërbija bani lidhje me Bullgarín për ndihëm të shkëmbyeshme në rast se sulmohet cilado prej anëve që banë lidhje. Kryesisht këjo lidhje u bâ në rast se sulmojnë Turqija dhe Austro-Hungarija. Marrëveshtja kishte edhe shtesën e mësheftë, që përbâhej prej bashkëpunimit ushtarak kundër Turqís.

Kur u nënshkrue lidhja ndërmjet Sërbís dhe Bullgarís gjâ e cila qe vështirë me u bâ, ajo, me ndihmën e shteteve t'Antantës, u përhap shum shpejt në Malin e Zi dhe Greqi. Ndërmjet Malit të Zi dhe Sërbís qysh mâ parë egzistojshin marrëdhanje të mira, mbassi të dy shtetet kishin të njajtat aspirata, e poashtu edhe marrëdhanjet e Sërbís me Greqin ishin miqësore.

Me realizimin e kësaj lidhjeje, në Turqi ndodhën ngjarje të shpejta. Kështu në Kosovë-Metohi në gjysmën e parë të vjetit 1912 u çuen në kryengritje Shqiptarët, të cilët kërkojshin me rrëxue sundimin e Turqve të Rij. Ngjarja tjetër e randësishme ishte se Turqija e humbi luftën kundër Italís; këjo ngjarje vështirësoi gjendjen ekonomike dhe politike të shtetit osmanli.

Të gjithë shtetet ballkanikë u përgatitën për luftë, dhe prej buxhetit të tyne shpenzuen sasi të konsiderueshme të hollash për armatimin e vet dhe për nevojat tjera luftarake. Këto përgatitje shpejtuen ngjarjet, kështu që në verë të vjetit 1912 mâ në fund u nënshkrue Lidhja ballkanike ndërmjet Sërbís, Malit të Zi, Bullgarís dhe Greqís. Ky ishte blloku i popujve të vogjël ballkanikë i drejtuem kundër Turqís, për

dëbimin e saj prej Europe. Ky bllok kishte parollën: »Ballkanipopujvet të Ballkanit«.

Në çdo shtet anëtar të Lidhjes ballkanike rrolin udhëheqës e luejti borgjezija e pasun. Këjo borgjezi dëshironte që me anë të luftave të dalë në limanet e Detit Adriatik, Egje dhe të Detit të Zi, të cilët atëhere i takojshin Turqís: Çdonjanës prej borgjezive nacjonale i nevojiteshin vende importimi dhe eksportimi në bregdet për shkak të tregtís importuese dhe eksportuese mâ të lirë. Poashtu deshtën me zgjanue teritorin shtetnuer që kështu të fitojshin treg mâ të madh për prodhimet e fabrikave të veta. Nënkuptohet se secila prej atyne borgjezive nacjonale në disa shtete të ndryshëm të Lidhjes ballkanike theksonte vetëm aspiratat nacjonale dhe nevojat ekonomike të popullit të vet. Por te secila prej tyne mshifeshin edhe aspiratat agresive për të përforcue mbi sundimin e tyne edhe mbi popujt e vet, madjé edhe mbi popujt e kombsive tjera, që do të shlirojshin prej Turqëve, të cilët do t'u nënshtroheshin interesave të klasës së tyne.

Turmat e gjana popullore me qinda vjetë dëshirojshin me u shlirue prej zgjedhës turke. Tash ato dëshira, në shtetet e tyne të lirë nacjonalë, u shndërruen n'aspirata për të shlirue prej sundimit turk edhe vllaznit e vet. Prandej turmat popullore gjithëkund t'entuziazmueme përgatiteshin që me armë në dorë të këputeshin vargojt e robnís së vllazënve të tyne dhe me i shlirue prej detyrimeve feudale ndaj agallarëve dhe beglerëve turq.

Popujt e Maqedonís, Kosovës dhe Metohís, si dhe ata të Sanxhakut të Novipazarit, n'atê kohë nuk kishin forcë të mjaftueshme të mbrendshëme për me u shlirue prej sundimit turk nëpërmjet të revolucjonit, me gjithë se ai kërkonte shum mâ pak viktima në njerëz dhe në mjete materjale se sa lufta. Prandej, për shkak të ngjarjeve historike, çashtja e shlirimit nga sundimi turk duhej me u zgjidhë me Luftën Ballkanike. Kushtet për revolucjon nuk egzistojshin për shkak të ndamjes së popullit mbassi nji pjesë i takonte anës fetare e tjetra asaj nacjonale, si dhe për shkak të dobësís ideologjike të demokracive borgjeze të popujve të robnuem në Turqín europ-

jane. Poashtu ishin me randësi edhe kundërshtimet ndërmjet shtresave të pakta të pasuna të tregtarëve dhe shumicës së popullit të vorfën. Për shkak të të gjitha këtyne arsyeve, pra, çashtjen e shlirimit të Sërbëve, Maqedonasve, Malazesve, Grekëve, Bullgarëve dhe Shqiptarëve mund ta zgjidhshin vetëm shtetet e lirë ballkanikë.

## LUFTA E PARË BALLKANIKE

Shkaku i drejtpërdrejtë për luftë ishte ashpërsimi i regjimit turk mbi popujt e krishtenë dhe mobilizimi ushtarak turk. Kundër këtyne masave të Turqís u përgjigjën Bullgarija, Greqija, Sërbija dhe Mali i Zi tue mobilizue ushtrít e veta. Po n'atê ditë u shpall mobilizimi në të katër kryeqytetet ballkanikë, dhe në secilën shpallje shfaqej arsyeja sepse bâhet mobilizimi i ushtrís.

Ky bashkim i shteteve ballkanike hâbiti Europën, e veçanisht qeverít e shteteve të mëdhej europjanë. Ata ishin të bindun se ish e mundun me u realizue nji bashkëpunim i ngushtë ndërmjet shteteve të ballkanit. Prandj mâ përpara i këshillojshin vazhdimisht popujt e ballkanit të bashkëpunojnë, e tash kur panë se këjo u realizue, mbetën të pakënaqun prej situatës së tillë.

Kur më 30 Shtatuer të vjetit 1912 u shpall mobilizimi i përgjithëshëm ushtarak, fuqít e mëdha filluen bisedimet se si me pengue përpjekjen me armë. Asht e kuptueshme se ato bisedime nuk ishin të sinqerta. Prandej edhe Porta nxorri nji zakon të vjetër dhe shpalli se, kinse, do të bâjë reforma. Por për të gjitha ato premtime kërkush nuk besonte kurrgjâ. Ishte shum vonë edhe për çdo intervenim të fuqive të mëdha, mbassi Mali i Zi me 9 Tetuer i shpalli luftë Turqís, dhe të nesërmen filluen përpjekjet. Kështu filloi Lufta shlirimtare Ballkanike.

Fuqít kryesore ushtarake turke të dërgueme kundër Sërbís u koncentruen në Kumanovë. Aty u zhvillue beteja e madhe dyditëshe. Turqit i habiti armatimi modern i ushtrís serbe, e veçanisht fuqija normale e ushtarëve dhe oficerave sërbë. Artilerija sërbe u tregoi oficerave turq se âsht e rrejshëme bindja që u shpall në gazetat turke se nji milion e

gjysëm bajonetash turke mbaheshin jo vetëm për t'u fitue lufta, por edhe që Turqija të ripushtojë Sërbín, Bullgarín dhe Malin e Zi.

Planet për operacjonet luftarake t'ushtrís sërbe i përpiloi shefi i gjeneralshtabit, vojvoda Ratomir Putniku, me ndihmësat e tij. Operacjonet u zhvilluen nën komandën e tij aq me sukses sa që ushtrija turke nuk mujti me durue për nji kohë të gjatë presjonin e forcave t'armatosuna sërbe dhe vrullin luftarak të luftarëve. Ushtrija sërbe shliroi Kosovën dhe u nis me shlirue Maqedonín. Ajo pushtoi Shkupin dhe Prilepin, u korr fitorja në Bakarni Gumna, kurse në betejën e përgjakshëme që zgjati tri ditë afër Manastirit, ku Turqit banë qëndresë të fortë, ushtrija turke u thye. Në këtê betejë të madhe, ku kambësorija duhej pa tjetër të kapërcente lumin e gufuem Shemnicën, u duk epërsija e armatimit modern dhe ndërdija nacjonale e ushtrís sërbe mbi ushtrín turke, e cila nuk dinte se për shka luftonte.

Nji aradhë e ushtrís sërbe mbas shlirimit të Kosovës kaloi në Shqipni dhe në Durrës duel në bregdetin e Adriatikut. N'atê pjesë të betejës Sërbët i mundën njisit luftarake turke dhe pushtuen Leshin dhe Shëngjinin.

Ushtrija malazeze nën komandën e gjeneral Janko Vukotiqit, me gjithë se e armatosun keq, korri fitore të mëdha dhe u lavdue me veprat e veta trimnore. Malazezët muerën Beranin, Bijelo Poljen, Pejën dhe Gjakovën. Nën kushte shum të vështira, nëpër cegëm e borë, aradhat malazeze rrethuen Shkodrën, të cilën e mbronte me kambëngulje Esad-pasha. Ushtrija malazeze nuk ishte e armatosun mirë me armë moderne, veçanisht me topa, për të mujtë me pushtue nji kështjellë kaq të fortë, me gjithë se kallxuen trimni të rrallë. Për shkak të kësaj situate të vështirë nën Shkodër, Malazezëve u shkoi në ndihmë nji aradhë a artilerís sërbe. Mbas nji lufte të gjatë kështjella u pushtue dhe Turqit u detyruen me kapitulue.

Bullgarët kishin detyrë shum të vështirë në Luftën ballkanike. Armatat e tyne gjindeshin mâ afër qendrës politike turke, prandej atyne iu desht me luftue kundër forcave të

forta tuke. Ushtrija bullgare korri fitore të mëdha në Kirkilisë, Lile-Burgasa dhe Lozengrad, dhe mujti me rrethue Jedrenën. Jedrena ishte kryeqyteti i parë turk n'Europë, prandej këjo përfaqësonte mburrjen nacjonale turke. Aty inxhinjerët ushtarakë Gjermanë kishin ndërtue fortifikatat mâ të mëdha moderne në Ballkan. Prandej ushtrija bullgare ishte shum e dobët për të marrë këtê vend të fortifikuem. Nën Jedrene bullgarëve u erdhën në ndihmë divizjonet sërbe me artileri moderne, kështu që luftuen bashkarisht për me i dëbue Turqit prej atij qyteti të vjetër.

Humbjet e ushtrís turke ndoqën njena tjetrën, dhe ushtrija e Osmanlijve, dikur e lavdishme, u shndërrue n'ushtarë të tërbuem, t'unshëm dhe të çmendun që ikshin. Turqëve iu mbaruen edhe sendet ushqimore, matérjali sanitar për të plagosunit dhe barnat për të sëmundët. Betejat te Kumanova, Prilepi, Manastiri, Lile-Burgasa dhe Lozengradi ishin ploje të vërteta për katundarët turq të shumvuejtun prej Anadolli. Ata nuk mujtën me u qëndrue për nji kohë të gjatë ushtarëve sllovenë ballkanas, të cilët shkojshin në luftë tue këndue.

Ushtrija greke dhe marina luftuen me sukses në Maqedoni dhe Greqi. Pushtuen Epirin dhe nji pjesë mjaft të madhe të Maqedonís, dhe Selenikun, kurse marina pushtoi ishullin e madh Kretën.

Mâ në fund, mbas nji lufte të gjatë, mâ parë u dorëzue Jedreneja, kurse mandej Shkodra. Mbas këtyne ngjarjeve Turqit kërkuen paqë, lufta mbaroi me humbjen e Turqís dhe fitoren e shteteve ballkanikë.

Ndërmjetsimi i fuqive të mëdha shkaktoi konferencën e paqës në Londër, kur në vjetin 1913 u nënshkrue paqa. Me marrëveshtje paqësore u caktuen kufîjt ndërmjet Turqís dhe Europës në vijën Enos Midija. Prej qyteteve n'Europë Turqís i mbeti vetëm Stambolli me nji koridor shum të ngushtë toke. Me këtê paqë u vendos poashtu, në kërkesë t'Austro-Hungarís dhe Italís, që në Ballkan të krijohet shteti i ri — Shqipnija.

Nënkuptohet se Austro-Hungarija dhe Italija nuk kërkuen që të krijohet Shqipnija për pamvarësi nacjonale të popullit shqiptar, por, si njana ashtu dhe tjetra e banë këtê për shkak

t'aspiratave të tyne imperjaliste për të αepërtue në Ballkan. Austro-Hungarija u habit prej sukseseve luftarake të popujve të Ballkanit, e veçanisht u idhnue për bashkimin e kufijve të Sërbís dhe Malit të Zi, mbassi iu pre rruga për të depërtue nëpërmjet Sanxhakut në Maqedoni dhe me dalë në Detin Egje

Në Luftën e parë ballkanike u ndeshën dy pikëpamje politike; në nji anë regjimi i huej turk feudalo-apsolutist, e n'anën tjetër ai borgjezo-demokratik, që tërhoqi n'anën e vet turmat katundare. I pari u shkatërrue, kurse tjetri ishte në hovin e forcave të reja. Prandej ishte krejt normale që të fitonte ajo ushtri që luftonte me kangë në gojë, e me humbë ajo që shkonte në luftë e detyrueme prej oficeravet të vet.

Teritori kryesuer dhe mâ i madh ku u zhvillue lufta ishte Maqedonija. Në tê ndiheshin mâ fort marrëdhanjet feudale turke, dasija fetare dhe nacjonale ndërmjet sundimtarëve dhe popullit të robnuem. Ushtrija turke mun n'atê teritor nuk kishte mbështetje në popull dhe prandej fuqija e saj mbështetëse ishte e dobësueme. Fakti që ushtrija turke nuk kishte mbështetje në popull në vendin ku u zhvilluen operacjonet luftarake, çonte nalt moralin e ushtarëve aleatë. Prandej Lufta e parë ballkanike âsht shlirimtare; ajo shliroi prej sundimit turk Maqedonasit, Sërbët, Shqiptarët e Kosovë-Metohís, Malazezët, Grekët dhe Bullgarët, dhe u mundësoi që në t'ardhëshmen të zhyillohen në mënyra tjera. Me rrëximin e feudalizmit u rikrijue »klasa e lirë e katundarëve pronarë tokash«, të cilët do të shkojnë përpara t'udhëhequn prej borgjezís së tyne. Të gjithë popujt e shliruem nuk fituen liri të plotë nacjonale, mbassi disa hynë nën sundimin e shteteve ballkanikë, në të cilët klasa sunduese — borgjezija pengonte zhvillimin e tyne nacjonal. Por, me gjithë atê në rendin kapitalist forcat punëtore u zhvilluen mâ me shpejtësi nën sundimin e agallarëve dhe beglerëve.

## LUFTA SËRBO-BULLGARE NË VJETIN 1913

Fitoret e Sërbís në Luftën ballkanike mâ shum damtuen politikën austro-hungareze dhe gjermane. N'ato fitore Austro-Hungarija pá rrezikun për tanësín e vet shtetnore, pse Sllo-

venët e Jugut që gjindeshin nën sundimin e saj të gjitha shpresat e veta për shlirim i mbështetshin në Sërbín. Prandej ish e nevojshëme me e dobësue sa mâ parë Sërbín dhe me coptue Lidhjen ballkanike. Shtetet imperjalistë t'Europës qendrore filluen me veprue menjiherë dhe përdorën të gjithë mjetet për të krijue grindje ndërmjet Bullgarís dhe Sërbís.

Këtij qëllimi mujtën me ia mbërrijtë kur u paraqit çashtja për caktimin e kufîjve të Maqedonís së Vardarit ndërmjet Sërbís dhe Bullgarís. Simbas marrëveshtjes së këtyne dy shteteve, Bullgarija duhej t'i dërgonte Sërbís në ndihëm 100 000 ushtarë për të luftue në luginën e Vardarit. Por, Sërbija e shliroi prej Turqís dhe pushtoi krejt Maqedonín e Vardarit, kurse si shpagim u dërgoi Bullgarëve nën Jedrene nji armatë. Poashtu, simbas marrëveshtjes ndërmjet Sërbís dhe Bullgarís me rastin e lidhjes s'aleancës, ishte parapá që »Maqedonija ndërmjet Sharit dhe Rodopit, Arqipelagut dhe Liqenit t'Ohrit«, si teritor në konflikt, në qoftë se nuk do të mundte me u organizue si autonome, do të ndahej ndërmjet Sërbís dhe Bullgarís, e në qoftë se për këtê nuk do të mundeshín me u marrë vesh atëhere kishte me e zgjidhë cari rus.

Mbassi Sërbija, simbas vendimit të marrëveshtjes së paqës në Londër, duhej me lëshue Shqipnín, dhe kështu humbi daljen në det, kërkoi që Maqedonija e Vardarit t'i takojë asaj, mbassi Bullgarija nuk plotësoi marrëveshtjen mbi aleancën, kurse Sërbija dha shum flîjime për Bullgarín.

Këtê mosmarrëveshtje perandorija austro-hungareze e shfrytëzoi për qëllimet e veta. Vazhdimisht nxitte sundimtarët bullgarë me e sulmue me armë Sërbín; i premtuen Bullgarís se do të garantojnë teritorin e saj shtetnuer. Prandej në Bullgari u krijue nji gjendje shpirtnore për të prishë lidhjen me Sërbín. Ndërsa, diplomacija ruse u përpoq që të ruhet aleanca dhe që mbarë Ballkani të mbetet i bashkuem n'anën e Antantës.

Këjo mosmarrëveshtje në lidhje me çashtjen e Maqedonís së Vardarit përfshiu si popullin ashtu edhe ushtrín. Borgjezija bullgare dhe sërbe filluen luftën ideologjike rreth çashtjes se

kush me qenë zotnuese e tregut të Maqedonís së pasun. Në këtê situatë mbreti i Bullgarís dhe qarqet sunduese, të bindun në ndihmën e Austro-Hungarís dhe Gjermanís, vendosi me e prishë aleancën dhe me e zgjidhë me armë çashtjen e eksploatimit të pasunivet natyrore të Maqedonís së Vardarit. Ata nuk deshtën që konfliktin, simbas marrëveshtjes, ta zgjidhi cari rus, por kaluen n'anën e Austrís dhe Gjermanís. Pasoja e këtij qëndrimi ishte lufta që shkatërroi Lidhjen ballkanike, kurse shtetin Bullgar e hodhi n'anën e kundërshtarëve t'Antantës.

Mbreti i Bullgarís, Ferdinandi, i cili ishte me origjinë Gjermane, urdhënoi që natën e datës 15 Qershuer të vjetit 1913, trupat e veta të sulmojnë ushtrín Sërbe m'atê anë vijës së demarkacjonit. Kështu pra, më 17 Qershuer, në Bregalnicë, pa shpallë luftë, filluen luftimet ndërmjet dy popujve sllovenë. Sërbëvet këjo u erdhi në befasi, por diqysh mujtën me u gjetë me shpejtësi dhe banë qëndresë të fortë, e mandej kaluen në kundërsulm.

Ushtrija sërbe kishte 348 000 ushtarë, kurse ajo bullgare numëronte 350 000 luftarë.

Beteja në Bregalnicë zgjati tetë ditë; ajo qe betejë shum e përgjakshëme, mbassi kryesisht u zhvillue me bajoneta dhe bomba. Këjo nuk zgjati shum, por ishte luftë shum e tmershëme. Sërbëve u shkuen në ndihmë 12 000 Malazezë, të cilët luftuen trimnisht, poashtu si edhe Sërbët e Bullgarët. Për shkak të kësaj luftë të prgjakshëme oborri i Vjenës dhe ai i Habzburgëve ishin të kënaqun, mbassi kujtojshin se ia mbërrijtën qëllimit të politikës së vet dinake. Në këtê luftë mbetën shum të vramë dhe të plagosun; për ato flîjime nuk ka kurrfarë arsyetimi. Sundimtarët e Sofjes dhe të Beligradit nuk deshtën me kërkue zgjidhje mâ të mirë, që Maqedonija të fitonte pamvarësi dhe vetqeverim dhe të zhvillohej në paqë, por secili prej tyne deshti me provue se çashtjen e mbron drejtë.

Ushtrija Bullgare pësoi humbje. Këtê gjendje Rumanija e shfrytëzoi, dhe më 2 Korrik trupat e saj prej 300 000 luftarësh sulmuen në drejtim të Sofjes, dhe pushtuen Dobruxhen. Humbjen e Bullgarëve edhe Turqit e shfrytëzuen në Bregal-

nicë, kështu që sulmuen Bullgarín dhe ripushtuen Jedrenën me rrethin e saj.

Bullgarija ra në gjendje shum të vështirë, prandej më 18 Korrik kërkoi armpushim. Me ndërhymjen e fuqive të mëdha paqa u nënshkrue me 27 Korrik në Bukuresht. Dy ditë mâ vonë u shpall demobilizimi.

Paqa e Bukureshtit për kufî të shtetit caktoi vijën e përparshëme të demarkacjonit ndrmjet Sërbís dhe Greqís, në nji anë, dhe Bullgarís nga ana tjetër. Bullgarija humbi Dobruxhën, të cilën e mori Rumanija, kurse Jedrenën e muerën Turqit.

Këjo luftë Sërbís i kushtoi shum flîjime, 40 000 të vramë dhe të plagosun — ndërmjet të cilëve shum prej tyne vdiqën edhe prej kolere, që u përhap edhe mbas mbarimit të luftës — hapën jazin ndërmjet popullit sërb dhe bullgar, dhe ndërmjet tyne filloi përhapja e shovenizmit dhe e urrejtjes.

Poashtu edhe Antanta humbi shum, kurse shtetet e Europës qendrore banë për vehte Bullgarín. Maqedonija u nda ndërmjet tre shtetesh: Bullgarís, Sërbís dhe Greqís. N'atê mënyrë populli Maqedon nuk mbërrijti në gjendjen për t'u zhvillue normalish dhe në liri të krijojë unjisim kombsije. Këjo pati pasoja të randësishme për jetën e tyne të mâvonshëme nën sundimin e borgjezís sunduese bullgare, sërbe dhe greke.

## LUFTA AUTONOME TË SËRBËVE TË VOJVODINËS

### Kuvendet popullore — kishëtare dhe luftat për ruejtjen e të drejtave autonome. Svetozar Miletiqi

Politika e mbrendshëme e Sërbëve në Vojvodinë u zhvillue rreth kuvendeve popullore — kishëtare, të cilët mbaheshin në bazë të privilegjeve të dhanun prej perandorëve austrijakë. Mbas shpërnguljes së madhe të Sërbëve prej Kosovës në Hungari, mbarë politikën e Sërbëve në Vojvodinë e bante Kleri. Në radhë të parë ai ruente privilegjet fetare, për shkak t'interesave të veta.

Kisha zotnonte toka të mëdha dhe drejtonte shkollat fetare dhe fondet e mëdhej që u krijuen me t'ardhunat e Sërbëve

prej Vojvodine për ndërtimin e enteve me karakter arsimo-kulturuer.

Kur ndodhshin ngjarje që mund të ndryshojshin gjendjen e Sërbëve në Hungarín Jugore, atëhere mblidheshin Kuvendet popullore — kishëtare për të zgjidhë çashtjet e randësishme. Kështu u mbajtë Kuvendi i famshëm i Temishfarit (1790), Asambleja e Majit (1848) në Karlovcin e Sremit dhe Kuvendi i Bllagoveshtenit (1861).

Lëvizja sërbe në Vojvodinë në vjetin 1848—1849, mbaroi pa kurrfarë suksesi. Ai nuk u pruni kurrfarë fitimesh Sërbëve, madjé as turmave popullore e as reakcjonit, i cili pritte prej Austrís shpërblime për veprën e kryeme. Kërkesa e Sërbëve prej Vojvodine n'Asamblén e Majit ishte: autonomi e plotë për Vojvodinën sërbe. Oborri i Vjenës i shpërbleu Vojvodinasit tue »u dhanë vetqeverimin Sërbís dhe Banatin Tamishit«, që nuk popullohej prej shum Sërbëve, por në tê kishte shum Rumunë dhe Gjermanë. Ato pjesë ku jetonte numri mâ i madh i popullsís sërbe, Austrija i la nën qeverim të Hungarís. Për shkak të ndamjes së tillë dhelpënake Vojvodina nuk muer karakter nacjonal, mbassi n'atê mënyrë Austrija, si në qeverim ashtu edhe n'administratë mujti të futë ndikimin gjerman dhe gjuhën gjermanishte.

Kur Austrija e shoi Revolucjonin hungarez, dhe kur në mbarë perandorín u vendos apsolutizmi, ku ministri i saj i mbrendëshëm Bah qeveriste simbas qejfit, njerëzit që kishin ndihmue Austrín kundër revolucjonit u penduen që kishin ndihmue reakcjonin austriak. Apsolutizmi dhetëvjeçar i Bahut në Vojvodinën sërbe futi gjuhën gjermanishte në zyrat dhe nëpërmjet të nëpunësave futte frymën gjermane në katundet dhe qytetet. Me ndihmën e gjuhës zyrëtare pakica gjermane mori sundimin mbi shumicën sërbe dhe asgjâsoi çdo gjurmë t' autonomís sërbe.

Lufta për ruejtjen e të drejtave autonome gjatë kohës s'apsolutizmit të Bahut u çuen në zero, mbassi n'atê kohë nuk ishte e mundun kurrfarë lufte politike. Ajo gjendje ndryshoi kur në vjetin 1859 Austrija humbi në luftën kundër Italís. Pasoja e kësaj humbje ishte ramja e Aleksandër Bahut dhe

heqja e regjimit apsolutist. Më 28 Tetuer të vjetit 1860, Austrija me aktin e quejtun Diplloma e Tetorit shpalli gjendjen kushtetuese në perandori, dhe atëhere filloi prap gjendje e përshtatshëme për luftën e Sërbëve të Vojvodinës.

Po n'atê vjet, më 1860 (27 Dhetuer) perandori Fran Jozefi syprimoi me dekret Vojvodinën sërbe dhe e dorëzoi nën qeverimin e drejtpërdrejtë të Hungarís. Ky akt i Austrís pezmatoi Sërbët në Hungarin Jugore, e veçanisht turmat qytetare dhe ato katundare. Vojvodina, jo vetëm që u syprimue, por u coptue tue ia ndajmbathë Sremin Kroacís dhe tue lanë Baçkën me Banatin nën qeverimin hungarez.

Mbas syprimimit të Vojvodinës, politikanët hapzburgë u përpoqën menjiherë që me rastin e rregullimit të shtetit të përfitojnë Sërbët e Vojvodinës si e si me bâ presjon mbi Hungarezët. N'atê gjendje të re filluen me u ndëgjue përsëri lajmet për rikrijimin e Vojvodinës sërbe. Por tash këto lajme nuk patën mâ sukses, mbassi shumica e populit nuk u besonte premtimeve austrijake.

Në nji gjendje të tillë advokati i ri prej Novi Sadi, Svetozar Miletiqi, shkroi artikullin e vet të famshëm në gazetën »Srpski dnevnik« (Ditari sërb), me titull »Na Tucin-dan 1860«. N'atê artikull Miletiqi kallxoi se si Sërbët në Vojvodinë nuk ndijnë kurrfarë keqardhje për qeverimin e Bahovit, mbassi ajo u vorrue, por Vojvodina do të ngjallët në nji formë të shndërrueme. N'artikull Miletiqi shfaqi shpresën se do të mbërrihet në marrëveshtje me Hungarezët në luftë për shlirimin populluer dhe për egzistencën politiko-ekonomike.

Mbasis politika zyrëtare e Sërbëve të Vojvodinës gjindej gjithënji në duert e patriark Rajaçiqit, ai nën presjonin e popullit kërkoi prej oborrit të Vjenës leje për të mbledhë Kuvendin populluer sërb. Oborri lejoi dhe patriarku, në vjetin 1861, thirri Kuvendin e Bllagoveshtenit. Shum Sërbë e spjegojshin këtê liri si dredhi të ministrit austriak Shmerlingut, i cili dëshironte që me anën e Sërbëve të detyrojë Hungarezët që të jenë mâ modestë në kërkesat e veta kundër Austrís.

Në Kuvendin e Bllgagoveshtenit nuk kishte unjisim mendimesh nëpërmjet përfaqësuesave të popullit. Për këtê shkak

u paraqitën tri rryma në lidhje me zgjidhjen e çashtjes për jetë mâ të mirë të Sërbëve në Vojvodinë. Rrymën e parë e përbâjshin njerëzit që mbajshin anën e Austrís, të cilët, të ndihmuem prej jerakís kishëtare, përbâjshin shumicën. Atê grup e udhëhiqtë Gjorgje Stojanoviqi, këshilltar i oborrit në Vjenë, i cili ruente pozitën e vet dhe mbronte interesat e pasanikëve të mëdhej. Grupi tjetër kërkonte bashkëpunim me Hungarezët — që, tue luftue së bashku Sërbët dhe Hungarezët, të sigurojnë fitoren mbi politikën hegjemoniste austriake. Këtê grup e udhëhiqte Svetozar Miletiqi. Grupi i tretë kërkonte që Sërbët e Vojvodinës të punojshin bashkë me Kroatët dhe me Kroacín të krijojnë krahinë të përbashkët, e cila t'ishte e lidhun me Vjenën. Këtê grup e udhëhiqte Jovan Subotiqi dhe Gjorgje Stratimiroviqi.

Në Kuvendin e Bllagoveshtenit Svetozar Miletiqi filloi aktivitetin e vet politik ndërmjet Sërbëve të Vojvodinës. Ideja e tij e re ishte për bashkëpunim me Hungarezët dhe me vendosë sundimin konstitucional dhe parlamentar. Ai njeri i madh duel drejt prej popullit dhe i njihte shum mirë nevojat e Sërbëve në Vojvodinë, e poashtu edhe pengesat për zhvillimin e tyne mâ të mirë.

**Svetozar Miletiqi** lindi në vjetin 1826 në Moshorinë; i ati ishte zejtar (çizme-punues) dhe e ama katundare e pashkollueme prej Banati. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, kurse gjimnazin në Novi Sad. Mbassi ishte shum i zgjuet, dhe i ati nuk kish mundësi me e shkollue, e mbante në shtëpín e vet Jovan Haxhiqi (Millosh Svetiqi), drejtor gjimnazi. Mâ vonë shkoi në Pozhun (Bratislavë), ku studjoi dhe fitoi dije të shëndoshë prej sllovenofilëve të njoftun Jan Kolarit dhe Ludevit Shturit. Në Pozhun Miletiqi studjoi shkencat juridike. Aty e gjeti revolucjoni i vjetit 1848 kur ishte udhëheqës i studentëve që bâjshin pjesë në lëvizjen sllovene. Për shkak të revolucjonit ai i ndërpreu studimet, ndërsa gjatë kohës s'apsolutizmit të Bahut, kur çdo punë publike dhe politike ishte ndalue, vazhdoi studimet e drejtësís në Vjenë. Si student ishte shum aktiv, kështu që për shkak të prirjes së tij dhe aktivitetit fitoi dije të gjanë. Ajo i ndihmoi në politikë, në ligjëratat

dhe n'artikujt që botoi në gazeta të ndryshme sërbe, e mâ shum në gazetën »Zastavi« të Novi Sadit, e cila filloi të dalë në vjetin 1866.

Kur Svetozar Miletiqi u paraqit në Kuvendin e Bllagoveshtenit me parimet e veta politike krejtësisht të reja, në Kuvend filluen me bisedue mâ lirisht kundër jerarkís kishëtare deri atëhere të plotfuqishme. Tashmâ nuk ishte me randësi, sikurse përpara, në qoftë se kleri deklaronte ndonji njeri përparimtar për antifetar dhe të pazot, »i cili mbjell helm në popull«. Ajo kohë kaloi dhe idét përparimtare borgjezo-demokratike u përhapën ndërmjet Sërbëve vojvodinas. Ndërmjet Miletiqit dhe klerit të naltë filluen konfliktet në Kuvendet popullore-kishëtare dhe në shtyp.

Me çashtjen e fuqís eprore në Kuvendet popullore-kishëtare dhe për marrjen e fuqís prej duerve të jerakís kishëtare, që kështu me punën e popullit në Vojvodine të drejtojë klasa qytetare, Miletiqi joshi shumicën e popullit për drejtimin e vet politik. Ajo këthesë filloi në vjetin 1864, në Kuvendin në Karlovcin e Sremit, ku Miletiqi u çue ashpërsisht kundër zakonit të vjetruem që kleri të zgjidhë çashtjet që i përkasın popullit. Këto idé përparimtare të klasës qytetare u përputhën me nevojat e popullit n'atê kohë. Për këtê shkak patrijarku reakcjonar dhe njerëzit rreth tij kërkuen bashkëpunim t'afërm me qeverín e Peshtës.

Me vendosjen e gjendjes konstitucjonale u krijuen kushte mâ të mira për zhvillimin e marrëdhanjeve kapitaliste në Vojvodinë. Pasoja e këtij zhvillimi ishte përforcimi i klasës qytetare, e cila nuk mundte me jetue mâ e lidhun me mënyrën e vjetër t'udhëheqjes prej jerarkís kishtëtare. Klasa qytetare kërkoi me e udhëheqë vetë popullin në luftë për të ruejtë dhe zgjanue autonomín kishtëtare-shkollore, e poashtu, edhe me kontrollue shpenzimin e të hollave të përbashkëta.

Këto kundërshtime ndërmjet udhëheqësís kishëtare, e cila fillonte në mbetuninat e privilegjëve feudale, dhe të klasës qytetare, që kërkonte zhvillimin e kapitalizmit, u banë edhe mâ të dallueshme mbas krijimit të monarkís dyfishe, 1867. Kur Vjena dhe Peshta ndanë në dy njisi shtetnore të bara-

barta nën emnin Austro-Hungarija, humbën të gjitha shpresat që Vojvodina të fitojë pamvarësín tue u ndihmue prej Vjenës. Jerakija kishëtare e humbi besimin te populli. Prandej në vjetin 1869, në konferencën në Beçkerén e Madhe u themelue Partija popullore Sërbe e lirimendimit. Borgjezija vojvodinase përpiloi »programin e beçkerés«, në bazë të të cilit duhej të zgjidheshin përfaqësuesat e vet për në Kuvendin hungarez.

»Programi i beçkerés« kërkoi barazi për të gjithë popujt në Hungari. Këtê parim duhej me e kërkue dhe me e mbrojtë së bashku: Sërbët, Rumunët, Sllovakët dhe Rusinët. Çashtja sërbe duhej të rregullohej ashtu sikurse ish vendosë në Kuvendin e Bllagoveshtenit: Rumunëve duhet me u ndihmue për Erdeljin, ku shumica janë Rumunë, që të fitojë autonomín e vet tokësore.

## Përhapja e kapitalizmit gjerman dhe hungarez; rezistenca kundër hungarizimit

Qysh në fillim të shekullit të XVIII, e veçanisht në shekullin e XIX, perandorija austriake, populloi Gjermanët në Hungarín Jugore për shkak t'arsyeve politike dhe ekonomike. Me atê popullim të Gjermanëve dinastija Habzburge i krijoi vehtes mbështetje të sigurtë në pjesët mâ të pasuna të shtetit të vet. Ajo frigohej se popujt në Hungarín Jugore mund të bashkohen politikisht kundër plotfuqís së saj. Për këtê shkak, për të dobësue Hungarezët, Austrija lejoi dhe ndihmoi Gjermanët me ble tokë, me hapë dyqanet e vet për tregti dhe zejtari, dhe të bahen pronarë të xeheroreve. Kapitalistat gjermanë iu jepshin tregtarëve me origjinë gjermane huana të lira, me ndihmën e të cilave ata çelën në qytetet sipërmarrje industriale për përpunim prodhimesh bujqësore dhe blegtorale. N'atê mënyrë popullsija gjermane në Vojvodinë filloi me u shtue me shpejtësi. Prej vjetit në vjet ata fitojshin gjithënjí randësi mâ të madhe n'ekonomi e kështu, tue krijue kapitale, mbizotnuen në treg në disa gytete. Sundimi shtetnuer u ndihmonte për të fitue të drejtën me pajisë ushtrín dhe sipërmarrjet shtetnore.

Në disa qytete gjuha gjermanishte filloi me marrë hov mâ të madh, ndërsa hungarishten e sërbishten e përdorshin mâ pak. Tregtarët gjermanë dhe kapitalistat u bâjshin konkurencë Hungarezëve dhe Sërbëve, të cilët, në shumicë merreshin me bujqësi dhe blegtori.

Këjo përhapje e kapitalistave gjermanë shkaktoi urrejtje të madhe te Hungarezët. Për këtê shkak ata u banë kundërshtarët mâ të mëdhej të Vjenës dhe luftuen vendosshmënisht kundër Habzburgëve, për të drejtat e veta.

Kur mujtën me realizue nji pjesë të dëshirave të veta, krijimin e Monarkis Dyfishe, zotnijt e mëdhej tokash dhe borgjezija hungareze përpiqeshin që me çdo mënyrë të shfrytëzojshin pozitën e vet të re si komb sundues. Prej asaj kohe politika e tyne sillej në drejtim për realizimin e mbisundimit të tyne politik dhe ekonomik.

Mbas krijimit të Monarkís Dyfishe iu dha mundësija kapitalit hungarez për të marrë prej shtetit koncesjone për ndërtimin e hekurudhave dhe stacjoneve, për ndërtimin e urave dhe për eksploatimin e pyjeve dhe xeheroreve. Tregtarët e pasun u bashkuen dhe krijuen bankat. Ato jepshin të holla hua për ndërtimin e sipërmarrjeve industriale dhe kështu shtojshin kapitalin e tyne në dam të Sërbëve, Rumunëve, Sllovakëve dhe Rusinëve. Këta popuj ishin të shtrënguem me u marrë edhe tash e tutje me bujqësi dhe blegtori, e nji numër shum i vogël me tregti dhe industri, me gjithë se përbâjshin shumicën në Vojvodinë.

Për shtimin e kapitalit hungarez ndihmoi shum hungarizimi, që filloi me marrë hov gjithënji mâ tepër në saje të politikës zyrëtare të qeverís hungareze. Hungarizimi gjithënji mâ i madh e me përdhuni dhe futja e gjuhës hungarishte në të gjitha shkollat dhe zyrat shtetnore, shkaktuen nevojën që popujt johungarezë-Sërbët, Rumunët, Sllovakët dhe Rusinët — të bashkohen në nji front të përbashkët kundër asgjâsimit të pakicava nacionale.

Kur filloi me u zhvillue politika e marrëveshtjes ndërmjet Austrís dhe Hungarís, popujve t'asgjâsuem u duheshin drejtime të reja politike në bazë të së cilave duhej të mbështetej

lufta dhe kërkesat e tyne. Ato parime i përpunoi Mihal Politi-Desançiqi, përveç Miletiqit, personi mâ me randësi politike në Vojvodinë në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. Në bazë të parimeve të tij Miletiqi përpunoi kërkesat themelore kundër hungarizimit të përforcuem. Ato kërkesa ishin: 1) që kombësít johungareze të njifen si popuj në Hungari, 2) që në secilin ent të përdoret si gjuhë zyrëtare gjuha, të cilën përdor shumica e popullit n'atê vend.

Kur mbas internimit dhe burgimit Miletiqi u tërhoq prej jetës politike, Partija sërbe e njerëzve të mendimit të lirë u nda në dy pjesë: Në Partín liberale, të cilën u udhëhoqi Polit-Desançiqi, dhe në Partín radikale, nën udhëheqjen e Jasho Tomiqit. Të dyja këto parti politike vazhduen luftën kundër hungarizimit, mbassi këjo ishte e drejtueme mâ shum kundër shkollave sërbe.

Me ligj ishte e caktueme se gjuha hungarishte âsht e detyrueshme në të gjitha shkollat fillore të pakicave, e për disa landë u fut edhe si gjuhë amnore. Në nji gjendje të tillë u desht me u zhvillue luftë e ashpër, për shka jerarkija kishëtare nuk ishte e aftë. Për këtê arsye kundër saj luftoi borgjezija vojvodinase, të cilën e udhëhiqte Jasha Tomiqi. Kleri i naltë frigohej prej luftës kundër popullit dhe borgjezís. Për këtê shkak ata, për të ruejtë tokat e tyne të gjana, u lidhën me reakcjonin hungarez dhe punojshin atê që u urdhënonte qeverija hungareze.

Ndikimi politik i partive qytetare në popull u rrit me shpejtësi, dhe kur qeverija në Peshtë pá se prej jerarkís kishëtare nuk ka kurrfarë fitimesh politike, e pezulloi autonomín kishëtare-popullore në vjetin 1912. Prej asaj kohe luftën politike të Sërbëve vojvodinas e udhëhoqi klasa qytetare, e veçanisht inteligjenca e saj.

## Zhvillimi i lëvizjes punëtore

Mbas krijimit të Monarkís Dyfishe kapitalizmi në Hungari filloi me u zhvillue me shpejtësi. E gjithë Hungarija ishte gjithënji krahinë prej kah importoheshin landë për industrín austriake dhe që eksploatonte kapitali bankar austriak. Pran-

dej në Hungari sipërmarrjet industriale nuk u zhvilluen me shpejtësi, por me gjithë atë, prej vjetit të shtatëdhetë e këndej filloi nji ndryshim i madh.

Në tregtoret, punëtorít zejtare dhe në sipërmarrjet industrijale u shtue numri i punëtorëve mëditësa. Në shumicë ata vijshin prej katundeve, ku turmat po proletarizoheshin gjithënji mâ tepër. Koha e punës për punëtorët ishte e gjatë, kurse pushteti qeveritar nuk bante kurrfarë kontrollimi mbi eksploatimin e tyne.

Për shkak të gjendjes së vështirë në disa qytete, punëtorët filluen me u shoqnue për t'u bâ mâ të fortë në luftën për jetë mâ të mirë. Kur në Hungari, në vjetin 1875 erdhi Leo Frankli, i cili ishte ministër në Komunën e Parizit, ai pruni idét luftarake të studimeve të Marksit. Simbas udhëzimeve të tij u formue »Partija e atyne që nuk kanë të drejtë vote«, mbassi me ligj ishte e ndalueme Partija punëtore socjaldemokrate. Por, mbassi numri i punëtorëve, prej të cilëve mvarej zhvillimi i industrís hungareze, u shtue me shpejtësi, e në vjetin 1890 u krijuen mundësít për t'u themelue Partija socjaldemokrate e Hungarís në Kongresin e Peshtës.

Në këtê parti u futën punëtorët pa dallim përkah origjina e tyne nacjonale, kështu që me atê u bashkuen edhe punëtorët vojvodinas. Punëtorët n'industri jetojshin mâ mirë se punëtorët bujqësorë-mëditësa, si dhe mâ mirë se punëtorët në punëtorít zejtare. Prandej në Vojvodinë së pari u organizuen punëtorët në bujqësi, e mandej ata në zejtari dhe n'industri. Në fillim organizatat e tyne shërbejshin vetëm për ndihmë të shkëmbyeshme, e mâ vonë kërkuen edhe kushte pune mâ të mira.

Së pari u organizuen punëtorët këpuctarë në Vërshac më 1873, kurse shoqata e madhe e punëtorëve për ndihmë të shkëmbyeshme u themelue në vjetin 1878 në Beçkerek.

Punëtorët në bujqësi filluen me krijue organizatat e veta kah vjeti i shtatëdhetë i shekullit të XIX, e ndërmjet të parëve

ishte organizata në Senatë. Qendra e lëvizjes në Banat ishte n'Elemirin Serb, ku punëtorët përqafuen shkencën socjaliste.

Deri në vjetin 1901, Sërbët në Vojvodinë nuk kishin lëvizjen e vet punëtore të veçantë (por ishin në bashkësi me Hungarezët) dhe në Peshtë shtypej në gjuhën sërbishte gazeta »Narodni glas« (Zani i popullit). Në Kongresin e Partís socjaliste të Hungarís, në vjetin 1904, u vendos me u themelue komiteti sërb, kurse nji vjet mâ vonë »sekcjoni serb« i Partís socjaliste të Hungarís. Nëpërmjet të gazetës së vet »Narodni glas« dhe gazetavet tjera, lëvizja punëtore e Sërbëve ndikonte në punëtorët në Vojvodinë.

Sa mâ shum forcohej e rritej industrija dhe numri i proleterëve, lëvizja punëtore merrte gjithënji karakter mâ të qartë të luftës së klasës.

## MALI I ZI DHE LUFTAT E TIJ SHLIRIMTARE

### Mali i Zi dhe Kryengritja hercegovase; lufta me Turqit (1876—1878); Kongresi i Berlinit dhe fitimi i pamvarësís shtetnore

Mbas vrasjes së princ Danillos në Kotor, më 13 Gusht të vjetit 1860, në Mal të Zi erdhi në fuqi Nikolla Petroviqi, i cili trashigoi kujdesin për t'i dhanë ndihmë Hercegovinës. Në fillim të qeverimit të tij fjalën kryesore e kishte vojvoda Mirko, i cili nëpërmjet të Senatit merrte pëlqimin për punën e tij.

Kryengritja në Hercegovinë nën udhëheqjen e Lluka Vukalloviqit, në vjetin 1861—1862, të cilin e kishin ndihmue Malazezët, u bâ çashtje e përbashkët, mbassi në vjetin 1862, kaloi edhe në Mal të Zi. Për këtê shkak Malin e Zi e sulmoi nji fuqi e fortë turke. Kundër kryengritësave hercegovas luftoi ushtrija turke nën komandën e Omer Pashës. Mbas mosmarrëveshtjeve ndërmjet Lluka Vukalloviqit dhe vojvodës malazez Mirko, Kryengritja hercegovase filloi me u shue, kurse Malazezët vazhduen luftën. Por mbas nji kohe të shkurtë iu mbaruen armët dhe municjoni, ndërsa ushtrija e madhe turke i afrohej Cetinës, kështu që me ndërmjetësimin e fuqive

të mëdha u lidh Paqa e Rijekës, simbas së cilës mbetën kufijt e vjetër ndërmjet Malit të Zi dhe Turqís.

Pasojat e këtyne luftave ishin të vështira për Malin e Zi dhe për ekonomín e saj të vorfën. Veçanisht ndihej mungesa e pasunive materjale dhe mungesa e të hollave për të ble armë, të cilat u nevojiteshin për luftë kundër Turqëve. Për shkak të nevojës për me punue së bashku për shlirimin e popujve jugosllavë prej sundimit turk, në vjetin 1865 filluen marrëdhanjet e mira ndërmjet Malit të Zi dhe Sërbís. Princ Mihali i dërgoi Malit të Zi nji sasi të madhe armësh dhe municjon si dhe njerëz për t'ushtrue ushtrín. Nji vjet mâ vonë u nënshkrue ndërmjet Mihalit dhe Nikollës marrëveshtja politike, që âsht e para që lidhi Sërbín dhe Malin e Zi në punën e përbashkët për shlirimin e vllazënve të robnuem.

Ndërmjet Malazezëve dhe Turqëve ndodhën shpeshherë përpjekje në krahinat që gjindeshin nën sundimin turk. Veçanisht âsht e randësishme dhe ka qenë e përgjakshëme ngjarja e ashtuquejtun ploja në Podgoricë, në vjetin 1874. Pero Ivanov Popoviqi, far' e fis i vojvodës zulmadh Marko Miljanovit, u hakmuer përgjakshëm dhe vrau Jusha Muçinin në Podgoricë, e cila u takonte Turqëve. Atëhere atê e coptuen Turqit e tërbuem. Përveç atij ata masakruen dhe zbrunë edhe nja 20 Malazezë tjerë që u gjetën atê ditë në Podgoricë. Lajmi për këtê masakrim shtazuer të Malazezve ngjali në Mal të Zi urrejtje dhe shum kërkuen me ia nisë luftës kundër Turqëve, a në tê me u hakmarrë për atê vepër të ndytë. Këtê ngjarje të përgjakshëme e hetoi nji komisjon i përbashkët dhe me atê rast u dënuen disa përmbaruesa t'asaj vepre gjaksore.

Ploja në Podgoricë jehoi fort n'Europë, e veçanisht te popujt jugosllavë, ndërmjet të cilëve mâ shum u dalluen Sërbët e Vojvodinës, të cilët në shtypin e tyne mbrojtën çashtjen e drejtë të Malazezve.

Kur për shkak të marrëdhanjeve të padurueshme agrare dhe për shkak të grabitjeve turke plasi kryengritja e re në Hercegovinë në fillim të Korrikut të vjetit 1875, Malazezët e

ndihmuen me të gjithë mjetet që kishin mundësi. Turqija dyshonte në Malin e Zi se ai ndikoi për çuemjen e kryengritjes, mbassi ata Hercegovas që jetojshin në Mal të Zi mbas kryengritjes së Llukë Vukalloviqit, u këthyen në Hercegovinë tre muej përpara plasjes së kryengritjes së re, e quejtun »pushka e nevesinjit«.

Kryengritja hercegovase plasi mun në kohën kur princi malazes po zhvillonte bisedime me Portën, kështu që ato bisedime u keqësuen për shkak të kryengritjes. Mbassi Austrija, prej Dalmacije dhe Kroacije, vepronte në çdo mënyrë me përgatitë pushtimin e Bosnjës dhe Hercegovinës në momentin e përshtatshëm, Mali i Zi nuk mund të lejonte që prej ngjarjeve të Hercegovinës të përfitojë tjetërkush. Në fillim ajo nuk dha ndihmë të drejtpërdrejtë, por ndoqi me kujdes zhvillimin e luftës. Princi dhe personalitetet e tij mâ t'afërme panë gjendjen shpirtnore të popullit, i cili digjej prej dëshirës me u ndihmue vëllazënvet të vet. Prej frigës se mos kryengritja futet ndën ndikim të huej, Malazezët dërguen në Nevesinje vojvodën Peko Pavloviqin për të ndikue zhvillimin e kryengritjes.

Politika zyrëtare e Malit të Zi ndaj Kryengritjes hercegovase u ndryshue në gusht të vjetit 1875, kur u mbajtë mbledhja e mësheftë e princ Nikollës me personalitetet malazezë, dhe me personat mâ të dalluem të Kryengritjes hercegovase. Ajo mbledhje u quejtë »Mbledhja e Llovqenit«, në të Mali i Zi u shpall botënisht për t'u ndihmue Hercegovasve kryengritësa. Prej asaj kohe çetat e armatosuna kaluen kufinin, kurse princi në Cetinë, për shkak të dipllomatëve të huej, u shti kinse nuk shifte se shka bâjshin njerëzit e tij.

Qysh prej momentit kur Mali i Zi filloi me i ndihmue haptazi kryengritësat hercegovas, ministri austriak i punëve të jashtëme, konti Andrash, kërkoi prej fuqive të mëdha që ta ndalojnë atê ndihmë, si edhe ndihmën sërbe kryengritësave boshnjakë. Qeverít e shteteve të mëdhej e pranuen atê propozim. Në Rusi kishte shum njerëz që kërkojshin me u ndihmue kryengritësave dhe Malit të Zi për akcjonin kundër Turqëve. Ky drejtim politik në Rusi u mbrojtë prej sllovenofilëve,

ndërmjet të cilëve fjalën këryesore e kishte Ignjatoviqi, përfaqësuesi i Rusís në Stamboll. Sllovenofilët frigoheshin që Austrija me intervenimin e vet të tepruem për ngjarjet në Bosnje dhe Hercegovinë të mos i rrëmbej këto dy krahina jugosllave prej Turqëve dhe me ia ndajmbathë perandorís së vet të madhe. Për këtê arsye ata u munduen që çashtja të rregullohej me anë të marrëveshtjes ndërmjet sulltanit dhe kryengritësave.

Anglija ishte kundër Malit të Zi, e cila e paditi se i ndihmon kryengritësat. Franca dhe Italija mbrojtën politikën ruse përsa i përket Malit të Zi, kurse Gjermanija ndihmonte politikën e Austrís. Për shkak të qëndrimit të tillë të ndryshëm të shteteve të mëdhej, Porta shfrytëzoi gjendjen dhe vendosi me i shpallë luftë Malit të Zi. Por, simbas këshillës ruse, princ Nikolla, në Maj të vjetit 1876 nënshkroi marrëveshtje ushtarake me Sërbín. Simbas kësaj marrëveshtje Sërbija e ndihmoi Malin e Zi me 40 000 dukatë për të ble armë dhe municjon.

Gjendja u ndryshue shum kur prîjsat e Kryengritjes hercegovase në mbledhjen në Grahovë zgjodhën princ Nikollën për princ të Hercegovinës. Ai e pranoi atê zgjedhje. N'atê mënyrë politikës austriake iu vû kufini, dhe mbassi kryengritja boshnjako-hercegovase nuk mundi me u shue, filloi lufta. Mali i Zi dhe Sërbija, të bindun se do t'i ndihmonte Rusija, e simbas dëshirës së shumicës, i shpallën luftë Turqís në Qershuer të vjetit 1876.

Ushtrija malazeze së bashku me kryengritësat hercegovas numëronte 20 000 luftarë, e kishte 4 topa. Me gjithë se e vogël, këjo ushtri me vetmohimin dhe trimnín e saj korri suksese të mëdha. Së pari filloi lufta në Fundinë, ku Malazezët luftuen me qëndresë të madhe dhe korrën fitoren mâ të bukur në këtê luftë. Përveç kësaj fitoreje, gjatë vjetit të parë të luftës Malazezët korrën kundër Turqëve edhe fitoret në Vuçje Doll, Medunë, te Spuzha dhe në vende tjerë. Turqit patën shum mâ tepër humbje se sa Malazezët si në të vramë, ashtu edhe në të plagosun dhe robë. Këto fitore Malazezëve u përforcuen

besimin për vijimin e luftës, dhe ajo u vazhdue n'aleancë me Rusín.

Austrija veproi në të gjitha mënyrat për të prishë aleancën ndërmjet Malit të Zi dhe Sërbís. Kur Sërbija e ndali luftën, mbas ndërmjetsimit t'Austrís për armëpushim, Austrija shpresoi se do të dobësojë ndikimin e Malit të Zi në Hercegovinë, poashtu sikurse dobësoi ndikimin e Sërbís në Bosnjë. Mirëpo, këjo nuk ndodhi, mbassi Mali i Zi vazhdoi luftën kundër Turqëve, deri në mbarim të saj dhe kur u nënshkrue paqa në Shën Stefan.

Në pjesën e dytë të luftës Malazezët kishin vështirësi shum të mëdha, mbassi në fillim Turqit pushtuen Nikshiqin. Situata ndryshoi kur pjesa mâ e madhe e ushtrís turke, nëpërmjet të Shkodrës dhe Barit, shkoi në front kundër ushtrís ruse. Malazezët mujtën me e rikëthye Nikshiqin dhe me pushtue Barin, Ulqinin dhe Bileqin. Për shkak të qëllimeve të tyne pushtuese ndaj Hercegovinës, Austrija me ultimatum kërkoi që Mali i Zi të ndalojë pushtimin e teritorëve Hercegovase, mbassi atê krahinë e ruente për vehte.

Lufta mbaroi me nënshkrimin e paqës ndërmjet Rusís dhe Turqís në Shën Stefan. Simbas marrëveshtjes së paqës, Mali i Zi duhej të smadhohej 10 000 km² mâ shum. Mirëpo, Anglija dhe Austrija, të pakënaquna prej fitores Ruse, mujtën që në Kongresin e Berlinit të ndryshojnë vendimet e paqës së Shën Stefanit në lidhje me Malin e Zi. Mali i Zi përfshiu qytetet Nikshiq, Podgoricë, Kollashin dhe në bregdét Barin e Ulqinin. Grushti mâ i randë për Malin e Zi ishte që Austro-Hungarija fitoi të drejtën e kontrollimit policuer në Bar, si kontrollë për tragtín malazeze n'atê vend.

Me gjithë se në Kongresin e Berlinit Mali i Zi u damtue shum, sidoqoftë për atê ajo marrëveshtje kishte nji randësi të madhe. N'atê Kongres ndërkombëtar, ku për gjithëshka vendosshin shtetet e mëdhej europjanë, Malit të Zi iu njoht pamvarësija shtetnore. Fitimi i asaj pamvarësije dhe shlirimi plotësisht prej sovereniteti turk, kishin nji randësi të madhe për zhvillimin e mâtejshëm ekonomik dhe politik të Malit të Zi.

**Regjimi personal i princ Nikollës dhe rezistenca e njerëzve përparimtarë, kushtetuta e vjetit 1905. Mali i Zi në luftat e vjetit 1912 dhe 1913**

Me ndajmbathjen e teritorëve të rij, e veçanisht qyteteve në Mal të Zi, u shtue numri i tregtarëve dhe zejtarëve. Këjo shtresë qytetare ndihmoi zhvillimin e mâtejshëm të Malit të Zi në pikëpamje ekonomike dhe politike, e poashtu shtoi mundësít për krijimin e shtetit borgjez dhe për përparimin mâ të madh kulturuer. Prandej mënyra e vjetër e plotfuqís individuale të princit nuk do të mundet me qëndrue për nji kohë të gjatë, mbassi sundimi despotik nuk pajtohet me përparimin e tregtís dhe shtimin e prodhimit.

Me ndajmbathjen e rrafshnaltave pjellore dhe të gjana, si dhe të qyteteve në to, në Mal të Zi u krijuen kushtet për zhvillimin e tregtís së mbrendshëme dhe të jashtëme. Sendet e prodhimit zejtar për nevojat e mbrendshëme u zhvilloheshin ngadalë, por plotësojshin mjaft mjeshtërít shtëpijake, të cilat luejshin gjithënji rrolin kryesuer për pajisjen e popullsís.

Dega ekonomike kryesore mbeti edhe mâtej blegtorija, e kryesisht rritja e kafshëve t'imta. Mbas luftave shlirimtare populli filloi me i kushtue kujdes mâ të madh bujqësís, pyjeve dhe pemishteve. U hapën shkollat bujqësore dhe u krijuen fidanishtet, të cilat mundësuen që të seliten mâ shum ullij, kumbulla dhe molla. Prej pemëve kishin shum fitime banorët e Bregdetit, në luginën e Limës, e sidomos në rrafshinën e Podgoricës, Danillogradit dhe Nikshiqit.

Tregtija e Malit të Zi nuk mundi të zhvillohej me shpejtësi as mbas Kongresit të Berlinit, me gjithë se për atê kanë egzistue kushtet në Bregdet. Tregtín e pengojshin dy sende. E para se Mali i Zi nuk kishte mjaft të holla, dhe e dyta, Austro-Hungarija pengonte tregtín malazeze në qytetet e bregdetit. Anijet e saja kryejshin gjithë tregtín importuese dhe eksportuese në bregdetin e Malit të Zi.

Prodhimi gjithënji mâ i madh i vojit t'ullinit dhe duhanit, peshkimi në Liqenin e Shkodrës, premja e pyjeve, etj. ishin shkak që disa kapitalista italjanë dhe austriakë u interesuen për eksploatimin e Malit të Zi. Por në këtê punë mujtën me

ia mbërrijtë qëllimit ngadalë, mbassi te Malazezët u shoqnuen traditat e forta, dhe ata në pragun e mbarimit të shekullit të XIX mendojshin se tregtija dhe zejet janë punë të padenja për njerín — trim. Me këso punësh mund të merren Jevgjit dhe të huejt. Atê botëkuptim të gabueshëm e rrëxuen banorët e qyteteve, të cilët aftësín e vet në tregti dhe zeje e shfrytëzuen mirë dhe shtuen numrin e njerëzve që punojshin n'ato dy degë ekonomije. Ata qytetarë u pasunuen, e tue i pague shtetit taksa fituen mundësín me ndikue në politikë. Ata u banë forca e re, e cila pa tjetër shpartalloi rrethet e organizatës fisnore dhe mënyrës se saj të jetesës. Klasa qytetare ishte e pakët, por ajo i dha drejtim të ri politikës së shtetit dhe nën ndikimin e saj u shkatërruen format e vjetra të qeverimit, dhe u krijuen forma të reja borgjeze.

Nevojat shtetnore kërkojshin shtim të madh të taksave, prandej ato u rritën me shpejtësi dhe ngjallën pakënaqësi në popull. Këjo pakënaqësi u rrit për shkak të sundimit personal të princ Nikollës, i cili zotnonte me plotfuqi në të gjitha pasunít natyrore të vendit. Princi ishte gjyqtar suprem, kurse me arkën e shtetit vepronte si me qenë pasunija e tij. Me sjelljen e vet të tillë, princ Nikolla ngujonte zhvillimin e kapitalizmit, i cili n'atê kohë në Malin e Zi të mbrapambetun ishte përparimtar.

Shum gyrbetli u këthyen në Mal të Zi, tue pru me vehte të hollat e kursyeme, jasht atdheut të tyne, ku panë nji përparim të madh në disa degë të tregtís. Ata dëshirojshin me dhanë dishka për vendin e vet, por princi ua bani të pamundun çdo punë. Ai u dha konçesjone kapitalistave italjanë dhe ngujoi përparimin e borgjezís së vendit.

Mbassi në Mal të Zi qeverisej pa kushtetutë, krejt pushtetin e mbante në duer princi. Ai u pasunue tue përvehtësue livadhet dhe pyjet mâ të mirë, kurse prej tregtís dhe konçesjoneve merrte përqindje. Përveç këtyne t'ardhunave merrte gjithëmonë ndihmë në të holla prej Rusís dhe Italís, e kohë mbas kohe edhe prej Austrís. Këso forme qeverimi, borgjezija malazeze nuk mund të lejonte, e aq mâ pak intelektualët e saj.

Ata u lidhën me katundarët e pakënaqun dhe filluen luftën për kushtetutë.

Nën ndikimin e opozitës, e cila përfshiu turmat e gjana të popullit, princ Nikolla i dha Malit të Zi kushtetutën në vjetin 1905, dhe kështu u vendos gjendja kushtetuese. Këjo don të thotë se kaloi pjesa e parë e rrugës për krijimin e shtetit borgjez, dhe që lufta të vazhdohej për vendosjen e sundimit parlamentar. N'asamblén që u thirrë në bazë të kushtetutës, filluen luftat e ashpra ndërmjet flamurtarëve t'ideve përparimtare dhe mbrojtësave të botëkuptimeve të vjetërueme. Filluen me u formue partít politike dhe të përpilohen programat e tyne.

Me gjithë se u fut kushtetuta, princi ishte gjithënji zotnues. Ai emnonte ministrat, bânte lidhje, dhe emnonte e pushonte nëpunësat. Për shkak të gjendjes së tillë opozita organizoi Klubin e Partís popullore, pjesëtarët e së cilës thirreshin klubistë. Ata ishin përfaqësuesa të politikës demokratike malazeze. Kundër këtyne u organizue Partija e drejtësís, e cila mbronte princin dhe politikën e tij reakcjonare.

Votimet e para n'Asamblén popullore në Mal të Zi u banë në vjetin 1906. Kur asambleja filloi punën, nisën prap mosmarrëveshtje të mëdha ndërmjet përfaqësuesave përparimtarë dhe partizanëve të princit.

Ky konflikt u ashpërsue edhe mâ tepër rreth çashtjes së politikës së jashtëme. Princ Nikolla u largue prej mbështetjes tradicjonale të Malit të Zi me Rusín dhe prej lidhjeve të mira me Sërbín. Ai u përpoq që politikën e tij të jashtëme ta drejtojë kah Austro-Hungarija dhe Italija. Politikanët përparimtarë dhe shumica mâ e madhe e popullit nuk lejojshin që Mali i Zi të kolojë në taborin anmik. Prandej zhvilluen nji luftë shum t'ashpër kundër princit dhe partizanëve të tij.

Veçanisht ishte e ashpër lufta që zhvilloi rinija studenteske përparimtare demokratike, e cila ishte shkollue mâ shum n'univerzitetin e Beligradit. Kur në vjetin 1907, princi malazez shkoi me vizitue Vjenën, urrejtja kundër politikës së tij u forcue edhe mâ tepër. Mbas këthimit të tij, princi filloi me terorizue hapët kundërshtarët e vet politikanë.

Rinija vendosi që kundër terorit të princit dhe qeverís së tij (në krye me kryetarin e qeverís Llazar Tomanoviqin) me u përgjegjë me akcjon të hapët. Rinija gjeti bomba (granata) dhe i pruni në Kotor. Prej andej Stefan Rajkoviqi me kerr i pruni në Cetinë, ku ia dorëzoi ministrit të punëve të mbrendshëme. Manjiherë u burgosën shum partizanë të Partís popullore dhe në vjetin 1908 qeverija organizoi gjyqin për t'akuzuemit. E gjithë këjo çashtje u quejtë **»skandali i granatjerëve«.** Sërbija nuk desht me i dorëzue te rojet malazezët e akuzuem, prandej shtypi zyrëtar malazez paditi Sërbín se ishte përzi edhe ajo në skandalin e granatjerëve. Akuza bazohej në deklaratat e Stefan Rajkoviqit dhe agjentit të njoftun austriak — provokatorit Gjorgje Nastiqit, i cili punonte për llogari t'Austrís, kundër Sërbís.

Gjyqi dha dënime të randa: gjashtë u dënuen me vdekje, tre vetë me burgim të përjetëshem, kurse 38 vetë me burgime prej shum vjetësh.

Nji vjet mâ vonë ndodhi nji ngjarje e re — i ashtuquejtuni **„procesi i kollashinit".** Ai ishte komplot i ri, me qëllim që të rrëxojë princin. Atê e organizuen anëtarët e opozitës të cilët ndiqeshin shum prej qeverís. Në këtê komplot muerën pjesë edhe disa oficera, ndër të cilët u dalluen veçanisht majori Nikolla Mitroviqi. Organizata u zbulue dhe shum komplotista u burgosën. Gjyqi ushtarak shtatë vetë i dënoi me vdekje.

Për shkak të gjendjes së vështirë të vendit Nikolla kujtonte se gjendja politike do të qetësohej në qoftë se Malin e Zi do ta shpallte mbretní, e vehten për mbret. Shpallja e Malit të Zi për mbretní u krye në gusht të vjetit 1910. në Cetinë.

Mbassi mbreti dhe qeverija e tij panë se Gjermanija dhe Austro-Hungarija përgatitën luftë kundër Antantës, dhe se mbas nji kohe shum të shkurtë shtetet e vogjël ballkanikë do të shkatërrohen në vjetin 1910 bani lidhje me Sërbín. Atëhere filloi përgatitja për **Luftën ballkanike.**

Simbas marrëveshtjes së lidhjes Sërbija dhe Mali i Zi ranë n'ujdi që së pari Mali i Zi t'i shpallë luftë Turqís, kështu edhe u veprue, mbassi me 9 Tetuer të vjetit 1912 filluen operacjonet.

Malazezët u nisën drejt Sanxhakut, Pejës dhe Tuzit, kurse ushtrija kryesore u nis drejt Shkodrës, mbassi për Malin e Zi ishte mâ e randësishme me pushtue atê qytet. Por Austro-Hungarija nuk lejoi që Shkodra t'i mbetej Malit të Zi.

Monarkija austro-hungareze përqëndroi ushtrín e vet në kufîjt e Hercegovinës, që kështu të bante presjon mbi Malin e Zi të vogël. Kur Shkodra u pushtue prej Malazezëve, të cilët i ndihmuen 20 000 ushtarë sërbë dhe artilerija, Austro-Hungarija kërkoi me ultimatum që Mali i Zi të largohet prej Shkodre, se për ndryshe do të niset në luftë kundër tij. Shtetet e mëdha, përveç Rusís, nuk i kundërshtuen aspak këtij ultimatumi, kështu që, e kështillueme prej Sërbís dhe Rusís, ushtrija malazeze u largue prej Shkodre. Këjo ishte humbje e madhe, mbassi në Kallnuer të vjetit 1913, në sulmet për pushtimin e Shkodrës u vranë 5000 ushtarë malazezë. Largimin prej qytetit populli nuk mundte me e kuptue. Populli mendonte se mbas pushtimit të Doçiqit, Shipçinikut, Tuzit, Plavës, Gusís dhe fitorevet tjera, pushtimi i Shkodrës ishte kulmi i meritave të luftës së vet. Por fuqít e mëdha nuk pyetën popullin malazez, kështu që Austro-Hungarija fitoi diplomatikisht.

Në luftën e dytë ballkanike Mali i Zi muer pjesë n'anën e Sërbís kundër Bullgarís. Dymbëdhetë mijë malazezë u shkuen në ndihmë vllazënvet të tyne, Sërbëve. Ata luftuen trimnisht krah për krah dhe duruen të gjitha vështirësít e asaj luftë të shkurtë por të përgjakshëme. Mbas luftave ballkanike filloi nji bashkëpunim shum mâ i ngushtë ndërmjet qeverís së Malit të Zi dhe asaj të Sërbís, mbassi të gjithë e ndiejshin se Austro-Hungarija dëshironte me i asgjâsue të dy këta shtete të lirë jugosllavë në Ballkan. Prandej ata u ndihmuen shkëmbyerazi dhe u përgatitën për luftë të madhe kundër fqiut të madh.

## BOSNJA DHE HERCEGOVINA NË VJETIN 1875—1914

### Gjendja e vështirë e rajes dhe kryengritjes kundër eksploatimit të përforcuem dhe beglëkut; Kryengritja boshnjako-hercegovase e vjetit 1875—1878

Perandorija turke dobësohej gjithënji mâ tepër kah fundi i shekullit të XVIII dhe në fillim të shekullit të XIX. Ai dobë-

sim u dallue mâ shum n'organizimin e ushtrís dhe qeverís qendrore të shtetit. Prandej sulltani bani reforma të ndryshme për të forcue sundimin e tij.

Kundër reformave të sulltanit kundërshtuen beglerët boshnjakë, të cilët dëshirojshin me sigurue autonomín e Bosnjes dhe Hercegovinës dhe që me ndihmën e saj të ruejnë sundimin si feudalë. Lëvizja e feudalëve boshnjako-hercegovas kah fundi i shekullit të XIX u thye me ndihmën e ushtrís, e kështu u krijue mundësija për reforma.

Me Hatisherifin prej Gilhane të vjetit 1839, të gjithë banorëvet iu dha barazija fetare dhe qytetare, e poashtu edhe garancija kundër keqpërdorimeve me rastin e mbledhjes së taksave; u fut detyrimi ushtarak për muslimanët kurse të krishtenët, në vend që të shkojshin ushtarë, paguejshin të holla. Me të vërtetë për atê kohë ato reforma ishin përparimtare, por ato duhej që t'i zbatojshin përfaqësuesat e klasës feudale, prandej filluen kundërshtime të mëdha ndërmjet katundarëve dhe feudalëve. Feudalët ishin anmiq të hapët të reformave, prandej nuk i zbatuen ashtu si duhej. Me futjen e atyne reformave do të forcohej borgjezija e re, kurse klasa e feudalëve do të dobësohej.

Agallarët dhe beglerët i zbatuen reformat simbas interesave të veta, kundër katundarëve bujq-robë, kështu që ata ranë në gjendje edhe mâ të vështirë. Datyrimet e mëdha pengojshin përparimin e prodhimeve bujqësore, mbassi bujqërobët boshnjako-hercegovas nuk kallxuen kurrfarë dëshire për punë, sepse prej punës së tyne kishin mâ shum fitime feudalët. Bashkë me këto arsyena ekonomike shkojshin dhe arsyena tjera. Bujqët-robë, edhe mbas reformës, mbetën pa të drejta politike. Feudalët dhe përfaqësuesat e qeverís turke kryejshin mbi ta dhunime. Shumicën e popullsís së Bosnjes dhe Hercegovinës e përbâjshin katundarët, e prej 300 000 familjeve katundare 200 000 familje ishin familje bujqësh-robë. Prej atyne 200 000 familjeve shumica ishin të krishtenë-orthodoksë, kurse nji pjesë e vogël katolikë. Reformat nuk e zgjidhën çashtjen e përçamjes fetare, mbassi qeveritarët turq mbrojshin familjet mu-

slimane, kurse familjet orthodokse dhe katolike ishin lanë mbas dore.

Për shkak të kundërshtimeve të mëdha në pikëpamje nacjonale, ekonomike dhe fetare, bujqët-robë boshnjako-hercegovas shifshin si të vetmen rrugë-dalje me bâ turbullime dhe me u çue në kryengritje kundër qeverimit turk, që ishte përfaqësues i feudalizmit. Prandej, prej vjetit 1830 deri në vjetin 1870 plasën nji serí kryengritjesh katundare dhe lëvizjesh lokale në të gjithë vendet e Bosnjës dhe Hercegovinës. N'ato kryengritje mâ shum merrshin pjesë Sërbët kundërshtarë, mbassi ata ishin të shtypun mâ shum, ishin mâ me shumicë dhe nën ndikimin mâ të madh t'ideve prej Sërbije dhe Malit të Zi.

Turbullimi i parë ishte ai i quejtuni turbullim i Pop-Jovicës, në vjetin 1834, rreth Derventes dhe Belinës. Ajo plasi për shkak të plaçkitjeve që u bâheshin katundarëve nga ana e zotnís së madh të tokave, Hysen kapiten Gradashçeviqit.

Në Hercegovinë u dukën lëvizje mâ të mëdha, të cilat u shndërruen në kryengritje nën udhëheqjen e Llukë Vukallovigit. Këtê kryengriaje e ndihmoi Mali i Zi. Ajo përfshiu viset prej Sutorini deri në Durmitor dhe mori karakter të luftës shlirimtare kundër qeverimit turk.

Veçanisht e randë ishte jeta e katundarëve të Posavinës boshnjake, prandej në vjetin 1858, edhe këtu filloi kryengritja. Kryengritja filloi në Kneshpolje dhe prej andej u përhap në Krajinë. Ajo kryengritje quhet Turbullimi i parë i Pecit, mbassi kryengritjen e udhëhoqi Petër-Peci Petroviqi.

Të gjithë këto turbullime, dhe shum të tjera, sundimtarët turq dhe feudalët e vendit i shuen në mënyrë shum t'ashpër. Ata dogjën katunde të tanë dhe asgjâsuen pasunín e katundarëve të vorfën boshnjakë-hercegovas. Por as kryengritësat nuk i kursyen kullat e beglerëve dhe karaullat perandorake i shkatërruen kudo që ndëshën në to. Katundarët bujqrobë nuk dëshirojshin me mbetë me raje turke, me i eksploatue agallarët dhe beglerët, me gjithë se në nji formë të re, por gjithqysh mâ shum se përpara. Kundërshtimet ishin aq të mëdha sa që nuk mund të zgjidheshin në mënyrë tjetër veçse me anë të kryengritjes së përgjithshëme popullore.

## Kryengritja boshnjako-hercegovase e vjetit 1875—1878

Në kalimin prej shekullit të XVIII në shekullin e XIX u duk nji numër i vogël tregtarë kafshësh Sërbë prej Bosnje dhe Hercegovine, me origjinë katundare. Në fillim ata ishin ndërmjetës për transportimin e kafshëve prej Sërbije në Bregdetin Adriatik. Mbas shlirimit të Sërbís, ata tregtarë sërbë prej Bosnje u përforcuen dhe çelën tregtore në Zarë, Trieshtë, Split dhe Dubrovnik. Ata mbajshin lidhjet e veta tregtare me Bosnjen dhe Hercegovinën.

Qeveritarët turq dhe klasa feudale u bâjshin pengesa të mëdha tregtarëve në Bosnje dhe Hercegovinë si dhe atyne prej teritorit austrijak. Për shkak t'atyne pengesave tregtarët u gjetën në të njajtën gjendje që ishin edhe katundarët bujqë-robë të shtypun. Prandej të gjithë së bashku kishin vetëm nji rrugë-dalje, që me anë të kryengritjes me u shlirue nga Turqit dhe prej sundimit të tyne feudal. Tregtarët futshin ndërmjet katundarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës idét për mënyrën mâ të mirë të jetesës, kurse me të hollat e tyne mujtën me sigurue nji sasi armësh.

Përveç punës së tillë të tregtarëve, në Bosnje veproi edhe ndikimi politik i Sërbís, ndërsa ai i Malit të Zi në Hercegovinë. Mbi Kroatët ndikoi edhe Austrija, nëpërmjet klerit katolik, dhe u premtonte jetë mâ të mirë se sa nën Turqit.

Kur në vjetin 1874 të korrat u pakësuen shum, dhe si pasojë e kësaj ka pasë zi buke në nahín e Novosinjes dhe të Gatakut, gjendja u këqësue shum. Qeveritarët turq ishin krejtësisht të paaftë me sigurue sasít e nevojshëme t'ushqimit, prandej ndodhën shum grabitje dhe vrasje.

Marëdhanjet ndërmjet katundarëve bujqë-robë dhe zotnijve të mëdhej të tokave mbërrijtën kulmin e padurimit. Për shkak të gjendjes së tillë të gabueshme, prîjsat e popullit u mblodhën më 1874 në katundin Biograd, afër Nevesinjes. Aty vendosën që në pranverë të fillonte kryengritja dhe kërkuen ndihmë prej Malit të Zi.

Kryengritja filloi në pranverë të vjetit 1875 me aksjon të përbashkët të Sërbëve dhe Kroatëve. Mbassi filloi në vendin afër Nevesinjës u quejtë P u s h k a n e v e s i n j a s e. Prej

nahís së Nevesinjës shum shpejt kryengritja u përhap edhe në Bileq, Stolic dhe Trebinje, kurse mâ vonë edhe në nahín e Gatës. Kur Mali i Zi vendosi me marrë pjesë haptazi në luftë, udhëheqësín në kryengritje e muerën njerëzit prej Malit të Zi. Petër Vukotiqi dhe Peko Pavloviqi udhëhoqën operacjonet prej Grahove. Atëherë Kroatët që kishin fillue me luftue në katundin Draçevë, afër Gabelës, u tërhoqën prej kryengritjes.

Kur u përhap lajmi se në Hercegovinë filloi kryengritja, u çuen edhe katundarët në Kneshpolje dhe rreth Kostajnicës së Bosnjës, e pak mâ vonë edhe në rrethin Derventa. Kur ndëgjuen kryengritjen në Bosjne, këthyen prîjsat e përparëshëm, të turbullimeve dhe tregtarët, të cilët jetojshin n'emigrim në Sllavoni. Ndërmjet tyne ishte Petër-Peci Petroviqi dhe Gollub Babiqi, komandantat e famshëm në Bosnjën perëndimore. Këta tregtarë dhe komandantë themeluen në Tetuer të vjetit 1875 Këshillin kryesuer të kryengritjes boshnjake për shlirim, në të cilin kishin mâ shum influencë Vaso Vidoviqi dhe Jovan Bilbija. Këshilli kryesuer kish seksjonet e veta në disa vende të mëdha dhe u lidh me Sërbín, Malin e Zi dhe Kroacín. Në Kostajnicë të Kroacís, me pajisjen me armë dhe me vendosjen e emigrantëve në Sllavoni, n'emën të Kishillit të përgjithëshëm kryengritës udhëheqën Vaso Pellagiqi dhe Manojllo Ervaqani.

Kryengritja u zgjanue, dhe në vjetin 1876 përfshiu krejt Krajinën boshnjake dhe Bosnjën Jugore. Bosnja e Mesme dhe ajo Lindore nuk muerën pjesë në kryengritje, mbassi atje në shumicë popullsija ishte muslimane, e në këtê mbështetej qeverija turke.

Kryengritja në Bosnje dhe Hercegovinë mori shum shpejt karakter nacjonal sërbizmi, mbassi muslimanët ishin për Turqit, kurse Kroatët, nën ndikimin e politikës zyrëtare austriake, u larguen me shumicë prej fushës së luftës. Prandej në luftë mbetën kryesisht Sërbët.

Ndërsa, mbas nji kohe shum të shkurtë te Sërbët u krijuen tri rryma. Rryma që kishte mâ tepër ishte rinija liberale, e cila nëpërmjet të Këshillit të përgjithëshëm u lidh me Sërbín dhe kërkoi bashkimin e Bosnjës me Sërbín. Këtê grup e

ndihmojshin prej Vojvodine Svetozar Miletiqi, me anën e propagandës së madhe dhe gazetat sërbe. Grupi tjetër ishte ai socjalist, nën udhëheqjen e Vaso Pellagiqit. Ky grup dha nji shpallje për popullin që u quejtë: »Ungjilli i popullit« me anën e së cilës kërkonte heqjen e pasunive feudale dhe të blemjes së tokave, dhe ndamjen e tokës dhe pyllit në popull dhe në komunet, tue mos pague kurrfarë damshpërblimi. Programi i këtij grupi bazohej në demokraci të plotë popullore dhe nuk bante dallime nacjonale dhe fetare ndërmjet njerëzve. Ky grup kërkonte që Bosnja dhe Hercegovina të bâhen krahina autonome, dhe shumica e kryengritësave u pajtue me të. Grupi i tretë ishte mâ i paktë në numër, atê e udhëhiqte Petër Karagjorgjeviqi, nën emnin Mërkonjiq. Ai grup punonte kundër Sërbís dhe e ndihmuen disa anëtarë të Këshillit të përgjithshëm, si Mojo Ervaçanini etj.

Përçamja e Sërbëve kryengritësa e damtoi shum punën shlirimtare, e veçanisht prej Korrikut të vjetit 1876, kur asambleja kryengritëse në Bosnje shpalli bashkimin e Bosnjës me Sërbín. Në bazë të këtij vendimi qeverija Sërbe dërgoi kolonelin Mile Dhespotoviqin për komandant të përgjithshëm të trupave kryengritëse. Si pasojë e kësaj u shue akcjoni i Petër Mërkonjiqit dhe i grupit të tij, e nga ana tjetër filluen kundërshtime mâ të mëdha ndërmjet grupit liberal dhe atij socjalist.

N'atê gjendje kah fundi i vjetit 1876 duel Austrija si e interesueme për ngjarjet në Bosnje dhe Hercegovinë. Me lejen e saj ushtrija turke prej 10 000 ushtarësh, nën komandën e Ismet-pashë Uzunoviqit, mujti që, tue kalue nëpër Dalmaci, të sulmojë në shpinë kryengritësat. Këjo ushtri turke shpartalloi 3000 kryengritësa në Përrojt e Zi dhe në Gusht të vjetit 1877 theu fuqín e tyne kryesore. Numri mâ i madh i kryengritësave u detyrue me kalue në Likë dhe në Dalmaci.

Pozita e kryengritësave u keqësue edhe për shkak të vështirësive që kishte Sërbija në luftën e parë kundër Turqëve në vjetin 1876. Austrija e shfrytëzoi këtê ngjarje për propagandën e vet dhe përhapi lajmet se si e vetmja rrugë-dalje âsht që Bosnja dhe Hercegovina të futen nën mbrojtjen e saj.

Fitorja e Rusís dhe paqa në Shën Stefan nuk mujtën me e ndryshue gjendjen e kryengritësave në Bosnje dhe Hercegovinë. Ata nuk kishin mâ forca për të luftue. Vendimin e Kongresit të Berlinit mbi okupimin austriak të Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilën boshnjakët dhe hercegovasit nuk e kishin dëshirue kurr, e pritën tue u emigrue shumica prej tyne.

### Kongresi i Berlinit, okupacjoni dhe qeverimi austriak në Bosnje dhe Hercegovinë

Prej fitores aleate mbi Napoleonin e I dhe me mbarimin e Kongresit të Vjenës të vjetit 1815, Austrija filloi me mendue për pushtimin e Bosnjës dhe Hercegovinës. Këto aspirata u forcuen mbas shlirimit të Sërbís nga sundimi turk, e veçanisht prej kohës kur filloi me punue mâ shum për bashkimin e Sllovenëve të Jugut gjatë qeverimit të princ Mihalit.

Propaganda e Austrís u aktivizue veçanisht kur u krijue Monarkija Dyfishe dhe kur feudali hungarez, konti Andrashi, muer drejtimin e punëve të jashtëme të perandorís. Ai kallxoi aftësi për të krijue përçamje ndërmjet Sllovenëve të Jugut dhe për shtymjen e ndikimit rus te politikanët e Ballkanit. Andrashi zhvilloi nj'aso politikë, me anën e së cilës krijoi situatë të përshtatshëme për depërtimin e Austro-Hungarís në Ballkan.

Për këtê shkak Austro-Hungarija shfrytëzoi rastin kur Rusija përgatitej për luftë kundër Turqís në kohën e Kryengritjes boshnjako-hercegovase. Rusija u përpoq me sigurue neutralitetin e Austro-Hungarís gjatë kohës së luftës kundër Turqís. Prandej në Rajhshtad dhe në Budapesht nënshkroi marrëveshtje me Austro-Hungarín për ndamjen e sferave t'interesit në Ballkan. Simbas asaj marrëveshtjeje, Rusija përkohësisht pranoi kërkesën e Austro-Hungarís për të okupue Bosnjën dhe Hercegovinën si dhe Sanxhakun e Novipazarit. Mbas fitores ruse mbi Turqín, Rusija ndryshoi qëndrimin e saj dhe kërkoi autonomi për Bosnjën dhe Hercegovinën, por, Austro-Hungarija shfrytëzoi pakënaqësín e Anglís prej paqës së Shën Stefanit, kështu që në Kongresin e Berlinit fitoi të drejtën me pushtue Bosnjën dhe Hercegovinën.

Çashtja Boshnjako-Hercegovase u shqyrtue në Kongresin e Berlinit, dhe atëhere konti Andrash kërkoi të drejtën me pushtue këto krahina. Ai theksoi se 200 000 emigrantë prej Bosnje dhe Hercegovine gjinden në teritorin e Monarkis Austro-Hungareze, se në Bosnje dhe Hercegovinë mbretnon urrejtja fetare dhe se nuk âsht zgjidhë çashtja agrare. Ai vërtetoi se të gjitha këto çashtje Turqija nuk âsht e zoja me i zgjidhë. Me ndihmën e Anglis dhe Gjermanís, Austro-Hungarija fitoi të drejtën për me i pushtue ato dy krahina, kurse Rusija u pajtue me këtê vendim.

Kur lajmi mbi pushtimin e Bosnjës dhe Hercegovinës mbërrijti në Sarajevë, ndeshi, në protestimet e muslimanëve dhe Sërbëve, ndërsa shumica e Kroatëve e priti me kënaqësi. Menjiherë filluen përgatitjet për rezistencën popullore. U krijue Këshilli populluer që përbâhej prej 24 anëtarëve. Populli u thirr për t'u çue në kryengritje kundër pushtuesit, e kësaj thirrjeje iu përgjegjën muslimanët dhe Sërbët. Për përgatitjen e kësaj kryengritje veçanisht u angazhuen Haxhi-Lloja, Jamakoviqi, Kaukxhiqi dhe Halaqeviqi.

Ushtrija austro-hungareze filloi me kalue kufîjt e Bosnjës dhe Hercegovinës kah fundi i Prillit të vjetit 1878. Për shkak të rezistencës që banë kryengritësat u nis ushtrija pushtuese prej 300 000 ushtarësh e komandueme prej gjeneral Filipoviqit. Menjiherë filluen përpjekjet dhe luftat, të cilat vazhduen deri në Tetuer. Ushtrija austriake humbi betejat te Kljuç, Dobojë dhe Gllasincë, por në betejën te Klladusha (me 20 Tetuer) korri fitoren. Kryengritësat nuk kishin municjon dhe mjete tjera që nevojiteshin për të luftue kundër ushtrís pushtuese. Ushtrija perandorake humbi 5000 ushtarë, deri sa mbërrijti me vendosë pushtimin.

Porsa ushtrija austrijake mori vendet kryesore, filloi ndjekjen kundër prîjsave kryesorë të kryengritjes. Jamakoviqin, Kaukaxhiqin, Jabuçiqin dhe shum të tjerë i vranë, kurse Haxhi Llojën e dënuen me burgim. Regjimin e vet në Bosnje dhe Hercegovinë Filipoviqi e filloi me varje dhe pushkatime, e poashtu vazhduen edhe pasardhësat e tij.

Mbas pushtimit, në Dhetuer, në Vjenë te perandori shkoi nji delegacjon me kërkue falje; këtê delegacjon e udhëhiqte Fra-Gerga Martiqi. Shum njerëz me pozitë çfaqën besnikín e tyne ndaj Habzburgëve për të ruejtë pasunít e veta dhe për të zanë pozita me randësi. Ata me anë të spijujve sunduen mbi 1158160 banorë të pushtuem në Bosnje dhe Hercegovinë.

Mbas nji kohe shum të shkurtë, në vjetin 1881, filloi kryengritja e re për shkak të regrutimit në Bosnje. Këtê kryengritje populli e quejti »Stojanov vakat«. Kryengritja filloi në Krivoshijë për shkak të çashtjes agrare të pazgjidhun, të korrupcjonit të nëpunësave austriakë, për shkak të taksave të nalta dhe frigës prej katolikizmit. Udhëheqës i kryengritjes ishte kryetrimi Stojan Kovaçeviqi. Në fillim kryengritësat patën sukses, por kur Austro-Hungarija dërgoi ushtri të madhe, kryengritja u shue. Kryengritësat u tërhoqën në Mal të Zi, mbassi nuk kishin mbështetje prej së jashtëmi. N'atê kohë Sërbija ndiqte politikë austrofile, kurse Mali i Zi dhe Turqija e ndihmuen fshehtazi kryengritjen e Krivoshijës.

Mbas kësaj ngjarje në Bosnje dhe Hercegovinë Kalaj vendosi apsolutizmin dhe filloi me punue për përçamjen e popullit. N'atê kohë u ndërtuen me qinda kazerma dhe u krijue gjindarmerija boshnjake; erdhën shum nëpunësa të huej dhe filloi kollonizimi i Bosnjës dhe Hercegovinës. Njikohësisht u mbyll kufini me Sërbín dhe Malin e Zi. Qeverija e Kalajt veproi për krijimin e »kombësís boshnjake« dhe për të përhapë shovenizmin boshnjak.

Qeverimi pushtues i Filipoviqit kallxoi plotësisht se muslimanët dhe Sërbët u lanë krejtësisht mbas dore dhe se desht me u përforcue me ndihmën e Kroatëve dhe emigrantëve. Këtê drejtim politik ndoqi edhe Kalaj. Ky ishte shkaku që Sërbët dhe muslimanët filluen luftën për autonomín fetaro-shkollore. Lufta ishte e vështirë dhe e gjatë, por zhvillimi i ngjarjeve shkonte në duer t' atyne që e udhëhiqshin.

Turmat popullore nuk ishin të kënaqun vetëm me luftën për autonomi, por kërkojshin edhe zgjidhjen e çashtjes agrare. Austro-Hungarija nuk desht me e zgjidhë atê çashtje, me gjithë se u kishte premtue fuqive të mëdha në Kongresin e

Berlinit. Ajo u përpoq me bâ për politikën e vet agallarët dhe beglerët, prandej u la gjithë tokën që zotnojshin qysh në kohën e qeverimit turk. Me gjithë atë lufta për autonomi ishte me shum randësi mbassi zgjoi rezistencën nacjonale kundër depërtimit të mâtejshëm t'Austro-Hungarís në Lindje. Ajo luftë për autonomi në shekullin e XX u shndërrue në luftë për shlirim nacjonal dhe politik.

Qeverija boshnjake u mundue me të gjitha mënyrat me pengue zhvillimin e intelektualëve Sërbë dhe muslimanë. Por, ajo nuk mujti me ia mbërrijtë qëllimit të vet mbassi ngjarjet u zhvilluen ndryshe. Sërbët dasht e pa dashtë zhvilluen tregtín e vet dhe krijuen kapitale monetare me ndihmën e të cilëve filluen me ndikue nëpër qytetet. Muslimanët ishin të lidhun mbas agallarëve dhe beglerëve dhe nëpërmjet tyne ruejshin ndikimin e vet në vend.

Me ardhjen e Austro-Hungarís në Bosnje dhe Hercegovinë u ndryshuen edhe kushtet e zhvillimit ekonomik të këtyne krahinave. Katundari fitoi mundësín me i shitë mâ lehtë dhe mâ mirë prodhimet e veta, prandej prej Bosnje filluen me u eksportue prodhimet gjithënji e mâ shum. Qeverija pushtuese mbaroi ndërtesa të shumta, ura dhe rrugë. Shumicën prej tyne i ndërtuen për nevojat ushtarake dhe me eksportue mâ lehtë prej Bosnje pasunít natyrore. Katundarët muerën pjesë n'ato ndërtime dhe fituen nji sasi të hollash. Të hollat kishin nji randësi të madhe, mbassi bujqësija, për shkak të çashtjes agrare të pazgjidhun, nuk u zhvillue aq shpejt sa duhej. Për këtê arsye lindën kundërshtime të mëdha të klasës; katundarët e pasun ngadalë filluen me kalue n'anën e Austrís.

Qysh prej pushtimit shum njerëz filluen me kalue prej katundeve në qytete, të cilët u populluen rrastë, kështu që u ishin të nevojshëme mâ shum ushqime prej katundarëve. Kështu qytetet u banë qendra ekonomike dhe kulturore për rrethin e vet, kurse katundi mbetej gjithënji mâ mbrapa. Qytetarët muerën udhëheqësín në luftën politike dhe u prinë katundarëve për jetë mâ të mirë.

Në Bosnje dhe Hercegovinë Austro-Hungarija ndoqi nji politikë kolonizimi. Ajo kërkoi me u ndërtue vetëm ato degë

t'ekonomís prej të cilave ajo kishte fitime si: druj, thëngjill, hekur, krypë, kafshë. Prandej zhvillimi ekonomik ishte i njianëshëm dhe mbytte forcat ekonomike të vendit, kështu që nuk mund të zhvillohej kapitali i vendit. Kundër politikës së tillë të qytetarëve pushtuesa duhej të luftońte borgjezija e vendit.

**Aneksimi i Bosnjes dhe Hercegovinës si bazë për depërtimin e mâtejshëm t'Austro-Hungarís dhe Gjermanís në Lindje. Bosnja e Re.**

Mbas ushtrís së Filipoviqit në Bosnje dhe Hercegovinë u lëshuen kolona të tana nëpunësash të naltë dhe t'ultë. Bashkë me ta erdhën si qytetarë të pamvarun, industrijalët, zejtarët dhe katundarët kolonista. Të gjithë ata ishin njerëz me origjinë gjermane ose sllovene në shërbim t'Austro-Hungarís, dhe përfaqësojshin pararojën e depërtimit gjerman në Lindje.

Me krijimin e qeverimit të shtetit dhe kuadrit të nëpunësave u fut edhe përdorimi i gjuhës gjermanishte n'ushtri, zyra, hekurudha dhe në postë. Për të gjithë ligjët, urdhënesat dhe emnimet ishte kompetent teksti në gjuhën gjermanishte. Ushtrija bani të gjitha përgatitjet për me sundue nji kohë të gjatë në këto krahina.

Për shkak të forcimit të tillë të sundimit gjerman, në fillim të shekullit të XX filloi hov i ri në luftën politike kundër pushtuesit. Në këtë luftë muerën pjesë intelektualët e paktë boshnjakë dhe hercegovas, por të vendosun për luftë. Rinija shkollohej n'universitet n'Austro-Hungari dhe nuk dëshirojshin me mbetë vetëm njerëz të bindun te perandori dhe qeverija, por kërkojshin me qenë të barabartë me qytetarët tjerë në perandori. Ajo lëvizje ka karakter të përgjithëshëm jugosllav, edhe filloi me u zhvillue nëpërmjet të gazetave »Narod«, »Otadžbina«, »Srpska Riječ«. Kur në vjetin 1907, u themelue Organizata popullore sërbe, në të u futën edhe turmat popullore, e kështu lëvizja politike të Sërbët në Bosnje dhe Hercegovinë mori të gjitha dallimet e luftës për të drejta popullore. Në krye të kësaj lëvizje qëndronte borgjezija përparimtare.

Nën ndikimin e mësimeve socjaliste, në Bosnje dhe Hercegovinë filloi me u dukë lëvizja punëtore. Me krijimin e sipërmarrjeve industriale dhe tregtoreve u shtue edhe numri i punëtorëve mëditësa, jeta e të cilëve ishte shum e randë, mbassi eksploatoheshin pamëshirshëm. Për shkak të gjendjes së tillë filluen grevat, të cilat u shërbejshin punëtorëve si mjet për të luftue kundër grabitësave të tyne.

N'atê kohë vepruen së bashku Sërbët dhe muslimanët dhe kërkuen me u vendosë gjendja kushtetuese. Organizata popullore Sërbe kërkon: barazi fetare, të drejtën e shkëputjes së popujve, mbrojtjen e interesave popullore, liri njeriut, votime të fshehta, autonomín e Bosnjës dhe Hercegovinës, qeverín boshnjake të përbame prej njerëzve t'Asamblés popullore. Këto idé demokratike përparimtare nuk i pëlqejshin Austrís, prandej politika e saj drejtohej kryesisht kundër Sërbëve. Austro-Hungarija u përpoq me bâ për vehte muslimanët, kurse Kroatët gjindeshin nën ndikimin e fortë t'Episkopatës së Sarajevës, e cila bashkëpunonte me Austrín.

Kur përfundoi revolucjoni i Turqëve të rij, në Turqi u vendos rendi kushtetues dhe u krijue asambleja popullore. Austrija u frigue pse mos tash muslimanët dhe Sërbët prej Bosnje dhe Hercegovine mund të drejtojshin përfaqësuesat e vet në Stamboll, n'asablé, prandej, shfrytëzoi këtê rast dhe ia ndajmbathi (aneksoi) Bosnjën dhe Hercegovinën shtetit të vet. Atê ajo e bani në vjetin 1908, pa pëlqimin e fuqive të mëdha.

Pasoja e kësaj vepre kryeneçësije ishte kriza e gjatë dhe e rrezikshëme aneksuese. Kundër aneksionit protestuen Sërbija, Mali i Zi, Rusija dhe Turqija. U përqëndruen Forcat ushtarake në kufinin kundruell Sërbís dhe Malit të Zi, dhe filluen me u dukë shêjat se do të pëlsitte lufta europjane.

Austrija filloi me bindë shtetet europjanë dhe popullin në Bosnje dhe Hercegovinë se ajo si okupatore nuk mundet me futë rendin kushtetues, e prandej âsht i nevojshëm aneksimi. Të gjitha organizatat popullore në Bosnje dhe Hercegovinë refuzuen me njoftë këtê aneksim. Poashtu vepruen

edhe Sërbët e muslimanët, të cilët dërguen nji deputacjon për të protestue te fuqít që nënshkruen marrëveshtjen e Berlinit.

Mbas kryemjes s'aneksimit Austro-Hungarija qeveriste në Bosnje dhe në Hercegovinë si në krahinën e vet, pa marrë aspak parasysh pakënaqësín e popullit. Gjendja ndërkombëtare dalëngadalë u qetësue, dhe Austro-Hungarija me anë t'aneksimit bani nji hap mâ përpara për krijimin e bazës për me depërtue në Lindje.

Depërtimi i kapitalit gjerman në Bosnje dhe Hercegovinë filloi me u krye mâ shpejt dhe mâ me forcë. Pronarët e 170 sipërmarrjeve industriale, ku punojshin prej 20 deri më 150 punëtorë, ishin kryesisht kapitalista gjermanë. Përveç depërtimit të kapitalit, shum Gjermanë vijshin në Bosnje dhe Hercegovinë si katundarë, zejtarë, punëtorë dhe nëpunësa. Ata krijuen katundet e tyne, rëndom afër xeheroreve dhe shkojshin nëpër qytetet e Bosnjës. Gjermanët në Bosnje i ndihmoi shteti e veçanisht i ndihmojshin me të holla gjermanët prej Austrije, për t'i përforcue sa mâ mirë dhe me krye detyrën e dhanun: me përvehtësue njiherë e përgjithëmonë të gjithë vendet e Ballkanit.

Fëmijt e Gjermanëve në Bosnje, kishin shkollat e tyne, kurse fëmijt e katundarëve boshnjakë mbetëshin analfabetë. Pyjet e Bosnjes filluen me u pre dhe drujt dërgoheshin n'Austri. Pyjet shtetnore përfshijshin nji sipërfaqe prej 2 000 000 hk, dhe i shfrytëzojshin 14 sipërmarrje, të cilat ishin kryesisht gjermane. Industrín e drunit e financojshin bankat gjermane.

Politikën austriake e mbrojshin nëpunësat, pa dallim feje dhe kombësije, kisha katolike, pronarët e mëdhej të tokave muslimane, e, mbas futjes së kushtetutës, edhe nji pjesë e borgjezís sërbe. Turmat e gjana katundare ishin të pakënaquna, mbassi nuk ishte zgjidhë çashtja agrare. Mun për këtê, në vjetin 1910, filloi lëvizja katundare, e cila u quejtë »grevë«. Ajo filloi në katundin kroat Shimiq, e prej këndej u përhap edhe mâ tej. Katundarët dogjën çardhaqet e beglerëve, por ushtrija ngadhnjeu te Doboji.

Nji pjesë e borgjezís sërbe kërkonte bashkëpunim me qeveritarët austriakë. Rinija boshnjake nuk pajtohej me këtê

qëndrim dhe i dha fund asaj politike me atentatin në kryetarin e Bosnjës dhe Hercegovinës, Vareshaninin. Atentatin e kreu Bogdan Zherajiqi, dhe me atê kallxoi qëndrimin e intelektualëve të rij. Zherajiqi nuk mujti me e vra Vareshaninin, por vdekja e tij zbuloi përpara botës organizatën »Bosna e Ré«.

Organizata »Bosna e Ré« ishte kundërshtare e bashkëpunimit politik me Austro-Hungarín. Politika e saj nuk pajtohej me politikën e borgjezís përparimtare. Për nji kohë të shkurtë »Bosnja e Ré«, kishte lidhje me grupin e njerëzve rreth gazetës »Narod« dhe »Otadžbina«, për shkak të qëndrimit të tyne të vendosun në lidhje me çashtjen agrare. »Bosnje a Ré« lindi prej humbjes nacjonale në kohën e krizës s'aneksimit. Ajo ndjeu se atëhere çarshija nuk luftoi mirë, por njerëzit këqyrën interesat e veta personale.

Ndikimin mâ të madh në »Bosnjën e Ré« prej njerëzve të vjetër e kish Petër Koçiqi, me satirën e vet »Vjedulla përpara gjyqit«. Prandej nuk âsht për t'u habitë që anëtarët e »Bosnjës së Ré« dojshin mâ shum katundarët dhe njerëzit e vogjël përgjithësisht. Me gjith'atê dashuni, njerëzit prej »Bosnjës së Ré« nuk kuptojshin shum gjana që ishin domosdo të nevojshëme për punën në katund. Mbassi nuk pati sukses në katund, »Bosnja e Ré« kaloi në punë të drejtpërdrejtë kundër qeverís ushtarake. Njerëzit kryesorë n'atê organizatë ishin Borivoje Jevtiqi, Vladimir Gaqinoviqi, Pjaniqi, Ljubibratiqi etj. Ajo dha edhe Nedelko Çabrinoviqin dhe Gavril Principin.

»Bosnja e Ré« nuk ishte organizatë politike e bashkueme, por njerëzit e rij — partizanët e luftës revolucjonare — u lidhën me të gjithë atâ që ishin kundër çdo ndikimi politik t'Austrís në Bosnje dhe Hercegovinë. Ajo urrejtje kundër atyne njerëzve që i lajkatoheshin, i lidhi anëtarët e »Bosnjes së Ré«. Mun për atê se »Bosnja e Ré« nuk kishte programin e vet të përbashkët, njerëzit e saj ishin nën ndikime të ndryshme prej Beligradi, Zagrebi, Prage, Vjene dhe vendevet tjerë. Ndikimin mâ të fortë e bante Beligradi nëpërmjet t'organizatës »Bashkim ose vdekje«.

Kur n'organizatën »Bosnja e Ré« mbretnoi ideja e bashkimit të popujve jugosllavë për krijimin e shtetit të përbashktë

»Bosnja e Ré« u bâ mâ e rrezikshmja për politikën e Austro-Hungaris dhe partizanët e saj në Bosnje e Hercegovinë.

Ai rrezik u duk qartë në vjetin 1914, atëherë kur Gavrillo Principi vrau mëkambësin austriak Frano Ferdinandin.

## LËVIZJA SHLIRIMTARE E POPULLIT MAQEDON

### Gjendja ekonomike e Maqedonasve në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. Krijimi i egzarhis. Propaganda sërbe dhe bullgare kah fundi i shekullit të XIX

Gjendja e popullit maqedon në fillim të gjysmës së dytë të shekullit të XIX ishte e padurueshme. Grabitjet nga ana e qeveritarëve turq dhe nëpunësave të saj kaloi çdo masë. Përveç këtyne Maqedonasit i grabitshin edhe tregtarët grekë dhe vllahë, të cilët gëzojshin privilegje të dukshëme në shtetin turk.

Turqija përdorte mjete të ndryshme për të ruejtë përçamjen ndërmjet nështetasve të vet të kombësive të ndryshëm. Në gjysmën e parë të shekullit të XIX përçamja mbërrijti shkallë të naltë, për shkak se Maqedonasit përbâjshin shumicën e turmës sllovene dhe shumicën apsolute të vendit, në krahasim me Turqit, Grekët, Jermenët, Vllehët Sërbë dhe Bullgarë. Kundër tyne qeverija turke përdori masat mâ t'ashpra që të mos përforcohen ekonomikisht.

Me gjithë se perandorija turke dallohej shum prej shtetevet tjerë të perëndimit me rendin e vet feudal, fén dhe gjendjen jokushtetuese, prap se prap idét borgjeze depërtuen edhe në të. Ajo, nën ndikimin e vendevet tjerë kapitalistë, ishte e detyrueme me krye disa reforma. Nji reformë e tillë e randësishme u quejtë Hatisherifi prej Gilhanit, që u bâ në vjetin 1836 dhe që u përhap në vjetin 1856.

Qëllimi i këtyne reformave ishte me e përforcue qeverín qendrore dhe me barazue të gjitha fét në shtet; mandej me çelë shkolla dhe me ua mundësue të krishtenëve me hy n'ushtrín turke; të gjithë nështetasit me pasë të njajtat të drejta përpara ligjit, e poashtu edhe të drejtën me u marrë me tregti dhe zeje. Me këtê Hatisherif u ndalue rreptë ryshfeti,

keqpërdorimet e ndryshme të nëpunësave të shtetit, si edhe çdo lloj korrupcjoni.

Këto vendime përparimtare edhe atëherë mbetën vetëm në letër, sikurse edhe më përpare. Ato nuk i zbatuen, prandej nuk u banë kurrfarë ndryshimesh. U lejue vetëm me ble prodhime industriale prej vendevet tjerë përparimtarë së pari për ushtrín dhe klasën sunduese e mandej edhe për banorët tjerë.

Që shteti turk dhe klasa sunduese të plotësojshin nevojat e tyne, u duheshin më shum të holla se sa përpara. Ato të holla ata i sigurojshin tue grabitë katundarët më shum se përpara. Shteti shtoi taksat, kurse spahijt kërkojshin tagra më të mëdha. Shum katundarë në Maqedoni u detyruen me shitë tokën për të la detyrimet e veta. Katundarëve çifçij nuk u ndihmonte kurrgjâ puna e tyne prej agimit të diellit deri në mbramje, mbassi as ajo nuk mjaftonte me kënaqë tagrat e shumta dhe gjithënji më të mëdha që u ngarkojshin me pague. Ata katundarë që punojshin tokën për gjysëm ushqeheshin shum keq, me bukë elbi e thekne, me fasule dhe qepë. Shtëpijat e tyne i ndërtojshin prej qerpiçash, e shpeshherë kasollet u shërbejshin për banim shum familjeve barijsh.

Simbas ligjit, pronarët e tokës jepshin farë për mbjellje, kurse çifçijt punojshin tokën me krahët dhe veglat e veta. Kur kryhej korja, çifçijt ia këthejshin përsëri farën pronarit, e poashtu edhe të dhetën, kurse mbetjen e ndajshin për gjysëm me spahijt. N'atê mënyrë çifçijve të vorfën iu mbetëj vetëm 30% prej krejt fryteve të korjes. Përveç këtyne detyrimeve, detyra e çifçijve — që mershin tokën për gjysëm ishte që për çdo vjet me i çue agës së vet ose begut katër kere me dru dhe me i dhanë nji sasi të caktueme djathi, yndyre, vósh, pemësh, perimesh, leshi dhe prodhime tjera. Çifçiu — që punonte tokën për gjysëm e kishte për detyrë me punue angari 20 ditë në vjet në pronën e spahís së vet.

Edhe më keq jetojshin katundarët arendatorë (ata që punojshin qesim), kurse më e vështirë ishte jeta e argatëve, të cilët si të pabanim shkojshin prej nji vendi në tjetrin për të fitue kafshatën e bukës.

Pjesa tjetër mâ e vogël e popullsís në Maqedoni, e cila merrej me zeje, në gjysmën e dytë të shekullit të XIX ra në nji gjendje shum të vështirë. Malli industrial që vinte prej Europe asgjâsonte prodhimet e zejtarís, mbassi ato nuk mund ta konkurojshin. Shum zejtarë u detyruen me u shpërngulë prej Maqedonije, bashkë me njerëzit e vorfën prej katundi, për të fitue në shtetet fqîj. N'atê kohë nji numër mjaft i madh maqedonasish shkuen në mërgim në shtetet e lirë ballkanikë, në shtetet e perëndimit dhe në Rusi.

Në disa qytete të Maqedonís zejet shtëpijake mbetën aq shum mbrapa sa që për atê shkak vuente krejt rrethi. Çarshija e vjetër u shkatërrue, kurse e reja nuk mund të krijohej. Industrija europjane asgjâsoi zejet e vjetra, kurse për të rejat nuk kishte të holla. Prilepi, Ohri, Velesi dhe qytetet tjerë humbën randësín e tyne ekonomike të përparshëme. Qëndruen vetëm tregtarët e pasun (çorbaxhijt), të cilët të lidhun me nëpunësat turq, grabitshin popullin në çdo hap.

N'atê kohë, Maqedonasit zhvilluen luftë t'ashpër kundër fanariotëve grekë për zhvillimin kishëtaro-arsimuer të Maqedonasve. Ata luftuen për autonomin kishëtare (egzarhín), për shkollat e veta, dhe që në shkollat të punojnë si mësuesa bijt e vendit, Maqedonasit.

Në këtê luftë të përbashkët të borgjezís së re maqedonase dhe bullgare fituen sypremacin Bullgarët.

Kur në vjetin 1871 prej sulltanit u fitue egzarhija, ajo u fut nën ndikimin bullgar. Me ndihmën e egzarhís Bullgarët u përpoqën me bullgarizue Maqedonasit. Egzarhija nënshtroi kishën dhe shkollën, dhe nëpërmjet tyne ndikoi në popull që Maqedonija të bashkohet me Bullgarín. Ndikimi Bullgar në Maqedoni u përhap veçanisht mbas Paqës së Berlinit të vjetit 1878. Simbas asaj paqe, Maqedonija mbeti edhe mâ nën sundim të sulltanit, për dallim prej Paqës së Shën Stefanit, simbas së cilës krejt Maqedonija hyni në suazë të Bullgarís së Madhe.

Mbassi Maqedonasit u munduen e dhanë shum për t'u shlirue prej sundimit turk, shpresuen se mbas fitores mbi

Turqín në vjetin 1877—1878 u shliruen njiherë e përgjithëmonë. Por mbas Paqës së Berlinit filluen ditë edhe mâ të vështira.

Këtê situatë e shfrytëzoi propaganda bullgare, e cila përpiqej që të mos njifeshin vendimet e Paqës së Berlinit, që kishin të bâjnë me Maqedonín. Në qeverimin e ri mbi Maqedonin Turqit nuk iu përmbajtën vendimeve të paqës, që parashifnin me u zbatue reformat në krejt teritorin e Maqedonís. Këjo ndihmoi shum për t'u përforcue ndikimi bullgar mbi Maqedonín.

Përveç propagandës së borgjezís bullgare dhe klerit, kah fundi i shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX qiti krye edhe propaganda e përforcueme greke. Borgjezija sërbe u përpoq me provue se Maqedonija ishte në suazë të shtetit sërb të kohës së mesme nën Nemanjiqin dhe se mbas shlirimit prej sundimit turk ato pjesë duhesh të kalojshin përsëri në suazë të shtetit të rikrijuem sërb.

Të tri këto propaganda u ndeshën në çashtjen se kush do ta fitojë popullin maqedon për botëkuptimet e veta politike. Simbas botëkuptimeve të tyne Maqedonasit duhej t'ishin: Bullgarë, Grekë dhe Sërbë, mbassi të tre ata popuj sundojshin mbi ta në shekullin e mesëm. Por, prej shekullit të mesëm e deri në fund të shekullit të XIX, kaluen shum qindvjetësha dhe populli përjetoi robni të gjatë nën sundimtarët turq. N'atê periudhë të gjatë të robnís turke Maqedonasit luftuen për shlirimin e vet, por nuk mujtën me u shlirue. Forcat e tyne n'atê kohë nuk ishin të mjafta për me ia dalë në krye kësaj pune.

Nën ndikimin e ideve borgjeze demokrate në shekullin e XIX, te nji pjesë e madhe e intelektualëve dhe e borgjezëve të Maqedonís u krijue ndërdija nacionale, ashtu sikurse edhe te popujt tjerë. Prandej ata kërkuen jo vetëm shlirimin prej sundimit turk, por edhe shlirimin ekonomiko-politik të mbarë popullit. Për këtê shkak nuk mujti me qëndrue për nji kohë të gjatë kurrfarë ndikimi te Maqedonasit, pa marrë parasysh se çfarë arsyesh e udhëhiqshin në propagandë.

## VMRO

**Dhe kryengritja e Ilindenit, Goce Delçevi. Kundërshtimi i interesave të fuqive të mëdha në Maqedoni. Politika pushtuese e shteteve ballkanikë ndaj Maqedonis — Lufta ballkanike dhe shtypja e re nacjonale**

Inteligjenca e re maqedonase u krijue në shkollat dhe n'universitetet e Selanikut, Sofjes dhe Plovdivës. Ata djelmosha menduen mbi shlirimin e popujvet të tyne. Ata formuen qerthuj politikë dhe në ta diskutojshin për çashtje politike dhe për atê nacjonale. N'ata të rij në vjetët e fundit të shekullit të XIX ndikoi veçanisht fakti, se në Sërbín e shlirueme dhe në Bullgari nuk kishte zotnij të mëdhej tokash dhe se populli nuk duronte aso barre të randë si në Maqedoni. Prandej, këjo inteligjencë veproi me shpejtësi për organizimin e shoqnive për shlirimin e Maqedonís.

Me atê qëllim u themelue në vjetin 1893 organizata e mbrendshëme revolucjonare maqedonase — V M R O. Mbështetje të madhe për formimin e kësaj organizate dhanë Goce Delçev, Damjan Gruev edhe disa Maqedonas tjerë. Qëllimi i tyne ishte me shlirue Maqedonín dhe të fitojë autonomi të plotë nën mbrojtjen e shteteve të mëdhej europjanë. Së pari u formuen organizatat nëpër qytetet, e mandej puna u përhap edhe nëpër katundet. Anëtarët e parë ishin intelektualët, tregtarët, zejtarët, punëtorët dhe kleri, e pak mâ vonë edhe katundarët. Anëtarët e organizatës ndihmojshin me të holla për të plotësue shpenzimet rreth shtypit dhe nevojavet tjera.

Në fillim organizata punoi vetëm ndërmjet popullsís sllave, kurse mâ vonë përhapi veprimtarín e vet edhe ndër popujt tjerë në Maqedoni. Tue përfshi mbarë popullsín, V M R O mbështetjen kryesore e kërkoi ndërmjet katundarëve, mbassi ata duhej t'epshin numrin mâ të madh të luftarëve për luftat e parapamę kundër sundimit turk. Katundarët ishin mbështetja mâ e sigurtë e organizatës për luftën revolucjonare, mbassi ata grabiteshin mâ shum prej rrëmbyesave turq.

V M R O kishte seksjonet e veta në formë të komiteteve të katundeve, qyteteve dhe qarqeve, e mbi të gjithë qëndronte

Komiteti qendruer. U fut pagimi i detyrueshëm për t'ardhuna t'organizatës, për të gjithë njerëzit në Maqedoni, pa dallim në se janë miq ose anmiq t'organizatës. Poashtu u fut gjyqi revolucjonar, për të gjithë ata që trathtojshin organizatën ose damtojshin anëtarët e saj. Gazeta e parë me titull „Pravo" shtypej në Selanik, me parollën: »Maqedonija Maqedonasve!«

Nji pjesë e Maqedonasve në vjetin 1894 formoi në Bullgari Komitetin epruer maqedon, i cili në V M R O krijoi rrymën që ishte për qeverín bullgare. Këtê grup e ndihmojshin oborri i mbretit dhe qeverija me të holla, armë, veshje dhe mbathje. Prandej ai propagandonte se Maqedonija mund të shlirohet vetëm me ndihmën e Bullgarís. Grekët dhe Sërbët lejoheshin me u futë n'organizatë. Ndërsa, mbrenda n'organizatë filluen mosmarrëveshtje ndërmjet partizanëve të Komitetit epruer, që mbështetëshin në Bullgarín, dhe e atyne anëtarëve të V M R O, të cilët kërkojshin që shlirimi i Maqedonís të kryhet me forcat e veta.

Këto grindje penguen punën e drejtë t'organizatës dhe dalëngadalë ato grindje u shndërruen në luftë të vërtetë ndërmjet tyne. Mosmarrëveshtjet të V M R O i shfrytëzoi qeverija turke e cila vazhdoi me sundue simbas mënyrës së vjetër. Borgjezija greke dhe ajo Sërbe përforcuen ndikimin e tyne ndërmjet të pakënaqunve në Maqedoni.

Disa organizata të V M R O përhapën veprimtarín e tyne prej vjetit 1895 e deri më 1903, disa aradha provokuen 132 përpjekje me armë me ushtarët e njisive turke. Qeveritarët turq kapshin katundarët maqedonas dhe qytetarët dhe i mbyllshin në qytete të ndryshëm. Të burgosunit e shumtë i rrahën e zbrunë, e shum syresh edhe i vranë.

Maqëdonasit banë shum atentate, të cilëve Turqit u përgjigjeshin tue therë me qinda Maqedonas dhe tue burgosë me mija të tjerë. Për shkak të këtyne përpjekjeve të vazhdueshme marrëdhanjet u ashpërsuen edhe mâ tepër, kurse organizata e V M R O dha shum flîjime. Për t'i dhanë fund asaj gjendje të padurueshme, V M R O, në Kallnuer të vjetit 1903, mbajti kongresin në Selanik, ku u vendos që të fillojë kryengritja.

Kryengritja plasi më 2 Gusht të vjetit 1903 dhe u quejtë Kryengritja e Ilindenit. Disa revolucjonarë maqedonas të dalluem nuk pajtoheshin me u çue në kryengritje, mbassi parashifshin se ajo do të shuhej dhe se ka me pasë shum flîjime. Ndërmjet tyne ishin Goce Delçevi, Haxhi-Dimovi etj., por kur kryengritja plasi, u bashkuen të gjithë dhe luftuen deri në fund.

Udhëheqësi kryesuer i kryengritësave ishte Boris Serafovi, kurse me punën e vet për shlirimin e Maqedonís, mâ tepër u dallue Goce Delçev. Ai lindi në vjetin 1872 në qytetin Kukush, prej nji familje tregtare. Ishte revolucjonar i madh dhe demokrat, dhe mbi të gjitha donte popullin e vet. Si themelues i VMRO kaloi në mbarë Maqedonín, dhe, me sjelljen e tij të përshtatshëme dhe spjegimin e thjeshtë t'ideologjís së vet, bante për vehte Maqedonasit për lëvizjen shlirimtare. Delçevi ishte orator i shkëlqyeshëm, kurse me urrejtjen e tij kundër tiranís së sulltanit dhe me qëndrimin e tij të drejtë ndaj turmave të gjanë të popullit turk joshte simpati edhe te shtresat e vorfëna t'anmikut. Në spjegimet e tij politike kishte shum parime socijaliste dhe dëshironte që të gjithë njerëzit e Ballkanit dhe mbarë njerëzija të shlirohet prej shtypjes.

Suksesi mâ i madh gjatë kryengritjes së Ilindenit ishte krijimi i Republikës së Krushevcit. Në qytetin Krushevë revolucjonarët muerën sundimin në duert e veta dhe organizuen gjyqin revolucjonar, i cili dënonte spiunët turq. U krijue edhe organizata për pajisjen e popullsís me ushqim, e cila filloi menjiherë nga puna dhe popullsija e vorfën merrte miell dhe bukë pa të holla. Republika e Krushevcit zgjati dymbëdhetë ditë; ajo kishte disa veçori socjaliste, e ndërmjet njerëzve në të u dallue mâ shum socjalisti Nikolla Karevi.

Mâ në fund ushtrija turke e shoi Kryengritjen e Ilindenit, mbassi ishte mâ e fortë dhe pse atê e komandojshin oficera t'aftë. Humbjet e popullit maqedon në këtê kryengritje ishin të mëdha.

Për shkak të gjithë këtyne flîjimeve, dhe për shkak se paraqiti provën e armatosun për t'u shlirue nga Turqija, Kry-

engritja e Ilindenit mbeti e gëdhendun thellë në ndërdijen e popullit maqedon, i cili pritte me andje lirín.

Mbas kryengritjes filloi coptimi i V M R O. Anëtarët e saj luftuen ndërmjet tyne me armë dhe u hakmuerën njeni kundër tjetrit. Këjo u lehtësoi Turqëve për të sundue edhe mâ simbas mënyrës së tyne të vjetër. Shtetet europjanë kryen, vërtet, njifarë presjoni mbi Turqit për të bâ reforma në Maqedoni, por ajo nuk e ndryshoi gjendjen e rajes maqedonase. Këtê pasukses të shteteve të mëdhej europjanë, dhe pozitën gjeografike t'afërm i shfrytëzuen shtetet ballkanikë për të përhapë influencën e vet në Maqedoni. Atê influencë ato e kryejshin nëpërmjet disa çetave komitësh dhe t'akcjoneve. Kështu që në teritorin e Maqedonís ranë në konflikt interesat e bullgaromëdhejve, sërbomëdhejve dhe grekomëdhejve. Secili prej këtyne shteteve të Ballkanit tregonte dëshirën për të shlirue Maqedonín, por njikohësisht edhe dëshirën ngadhnjyese për të zgjanue teritorin e tyne shtetnuer, dhe n'atê mënyrë me mbërrijtë në landë të para për industrín e vet.

Prej revolucjanit të Turqëve të rij, Maqedonasit shpresojshin se gjendja do të ndryshojë. Me gjithë se grupi i oficerave të rij turq dhe borgjezija kryen revolucjonin në vjetin 1908 dhe rrëxuen sulltan Abdul Hamitin, gjendja e Maqedonasve nuk u përmirësue. Turqit e rij gjetën mënyra që gjendja e popujve joturq me u vështirësue edhe mâ. Ata thojshin: »Perandorija Osmanllike-Osmanllijve«. Ata nuk njifshin kurrfarë pakicash nacjonale, dhe si shovenista turqomëdhej filluen me mbyllë shkolla dhe me shkatërrue sukseset e kulturës maqedonase.

Në Maqedoni vazhdoi detyrimi për me u këthye në fén islame, veprim që ngjallte pakënaqësi të madhe në popull.

Mbas revolucjonit të Turqëve të rij kapitalistët e huej filluen me u interesue edhe mâ shum për pasunít natyrore të Maqedonís. N'atê kohë prodhimi i fortë kapitalist, të cilën e ndihmojshin Maqedonasit në mërgim dhe tregtarët, u lidhën kapitalistat e huej. Me shtimin e prodhimit u rrit edhe klasa punëtore, e cila eksploatohej tmerësisht.

Prej vjetit 1893, filluen me u dukë shêjat e para të lëvizjes punëtore në Maqedoni n'udhëheqjen e Vasil Gllavinovit, punëtuer prej Velesi. Fillimi i daljes së gazetës socjaliste »Socjalistička zora« (në vjetin 1910 në Shkup) ishte e nji randësije të madhe për lëvizjen punëtore në Maqedoni. Shum grupe socjaliste u bashkuen në Federatë socjaliste maqedonase, e cila nuk mujti me u bâ parti.

Me gjithë se ndërdija revolucjonare te populli maqedonas ishte mjaft e zhvillueme, forcat nacjonale të popullit ishin të coptueme. Lëvizja punëtore ishte në zanafillë të jetës së vet dhe nuk mundte me zêvendësue forcat munguese të borgjezís maqedonase.

Ato të meta e vunë çashtjen e shlirimit të Maqedonis prej Turqve në duert e Lidhjes së shteteve të vogla ballkanike me anën e luftës në vjetin 1912 e 1913.

Lidhja e shteteve ballkanikë e fitoi luftën kundër Perandorís turke dhe shliroi Maqedonín prej asgjâsimit feudal t' agallarëve dhe beglerëve. Rendi turk i çifçijve u rrëxue, por Maqedonija në Paqën e Bukureshtit u nda ndërmjet Bullgarís, Sërbís dhe Greqís. N'atê shtet Maqedonasit u banë pakicë kombtare dhe si e tillë ata asgjâsoheshin në fushën kulturore dhe politike.

## KROACIJA MBAS VJETIT 1848

### Kushtet ekonomike dhe politike mbas vjetit 1848. Koha e apsolutizmit

Mbas revolucjonit të vjetit 1848 në Kroaci mbarë ekonomija u desht pa tjetër të këthehej në gjendjen e pararevolucjonit. Ajo që u mbeti katundarëve ishte vetëm lirija personale, kurse feudalët zotnojshin gjithënji tokat e tyne dhe shfrytëzojshin fuqín punëtore katundare tue i dhanë tokat përgjysëm ose me mëditje. Edhe zejtarët mbetën n'organizatat e veta esnafe, tue punue me kallfat dhe shegërtat në punëtorit e vogla. Katundarët, zejtarët dhe punëtorët e pakët katundarë nuk e ndryshuen gjendjen e tyne ekonomike dhe politike, për shka luftuen në revolucjonin e vjetit 1848.

Mbassi n'Austri në vjetin 1849 fitoi kundër-revolucjoni tue i mujtë forcat përparimtare, në mbarë shtetin u këthye sundimi i zotnijve feudalë dhe nëpunësave të naltë. Kur perandori në Vjenë ishte i sigurtë se e kishte thye lëvizjen revolucjonare, në Mars të vjetit 1849 shpalli kushtetutën, e cila në Shtatuer hyni në fuqi në Kroaci. Në vjetin 1851, u anulue edhe ajo kushtetutë e dhurueme dhe u vendos apsolutizmi i hapët.

Prej vjetit 1851, në Kroaci, si edhe në gjithë vendet tjerë të perandoris austriake, rrolin kryesuer e kishin gjindarmët, të cilët i mbajshin në frigë të përhershëme të gjithë qytetarët. Flamurtarja e mbarë jetës politike ishte policija, e cila dënonte pa marrë parasysh në se njerëzit ishin të pafajshëm ose fajtorë. Në krejt perandorin sundimtar politik kryesuer u bâ Ministri austriak Aleksandër Bahu, prandej ai regjim u quejtë apsulutizmi i Bahut.

Të gjithë nëpunësat dhe njerëzit që në çfarëdo forme mvarëshin prej shtetit, duhej të pranojshin pa tjetër të gjithë përdhunimet e apsolutizmit. Në Kroaci shum njerëz u ndërruen prej pozitave të veta, kurse vendet e tyne i zunë. Gjermanët. Shum tregtarë kroatë, për shkak të qëndrimit të tyne kundër apsolutizmit, iu muerën lejet për tregti dhe në vendin e tyne vijshin të huejt. Gjuha kroatishte u la gjithëkund mbas dore, kurse gjermanishtja depërtonte gjithënji e mâ shum ndër qytete.

Në kohën e apsolutizmit të Bahut Austrija u përpoq, me e lidhë Kroacín fort mbas vehtes nëpërmjet të nëpunësave të vet të shumtë. N'atê kohë u matën arat, livadhet e pyjet, dhe të gjitha sipërfaqet u shënuen në librat (kadastër). U krijuen zyra të posaçme ku mbaheshin librat e tokave, dhe ato zyra u quejtën gruntovnica[1]). Që shteti të merrte sa mâ shum t'ardhuna në të holla, përveç shtimit të madh të taksave nxorri edhe pullat e monopolit për të gjitha lutjet dhe ankesat, dhe vendosi monopolin e duhanit, krypës dhe alkoolit. Të gjitha këto reforma shtuen t'ardhunat shtetnore, por vorfënuen turmat e gjana popullore.

[1]) Zyrat e kadastrës

Kroatët nuk ishin të kënaqun prej këtyne reformave austriake, por mbassi çdo fjalë ishte e ndalueme me u folë publikisht, ata nuk mujshin me bâ gati kurrgjâ për ngritjen e ndërdijes nacjonale të turmave të gjana popullore. Për shkak të gjendjes të tillë politike nji pjesë e intelektualëve u largue prej veprimtarís politike dhe kaloi n'atê shkencore.

Apsolutizmi i Bahut pengoi çdo përparim ekonomik dhe kulturuer të Kroacís, forcat prodhuese të së cilës ishin shum të dobëta, mbassi qëndruen për nji kohë shum të gjatë marrëdhanjet feudale. Për këtê shkak, shumica e popullit Kroat — katundarë, borgjezë, punëtorë dhe zejtarë, ishin kundër sundimtarëve të Vjenës.

**Formimi i partive politike, marrëveshtja e vjetit 1868; pengimi i zhvillimit ekonomik të Kroacis nga ana e Hungarezëve. Partija e drejtësis; randësija e Ante Starqeviqit. Kryengritja e Rakovicës — lufta e përbashkët e kroatëve dhe sërbëve për liri**

Kur perandorija Austriake në luftë kundër Italís dhe Francës u mund në vjetin 1859 në Magjentë dhe Solferinë, apsolutizmi i Bahut filloi me u dobësue me shpejtësi. Fuqija perandorake në Vjenë për shkak të kësaj pati si rrjedhim humbje ushtarake dhe krizë financjare dhe ekonomike. Shum njerëz vërtetojshin se ajo humbje e dyfishtë ishte pasojë e apsolutizmit, dhe qeverija në Vjenë u detyrue të bâjë disa lëshime politike. Në të gjitha krahinat e perandorís së gjanë filluen përpjekjet ndërmjet popullit dhe qeveritarëve.

Perandori u detyrue që në Tetuer të vjetit 1860 të shpallë dekretin e quejtun Diploma e Tetorit, me anën e së cilës këthyen kushtetutën në Kroaci dhe Hungari. Me këtê dekret mori fund apsolutizmi dhetëvjeçar dhe u këthye gjendja kushtetuese.

Këtê gjendje të re kushtetuese e shfrytëzoi bani i Kroacís Josip Shokçeviqi, i cili thirri në Zagreb konferencën për në Kallnuer të vjetit 1861. Detyra e kësaj konference ishte me bâ përgatitjet për votime të reja dhe për punën e Kuvendit kroat.

Të gjithë popujt e shtypun në Monarkín Habzburge nuk u kënaqën vetëm me këthimin e gjendjes kushtetuese, por kërkuen që asamblét e veta popullore të vendosin vetë për ndjekjen e politikës së vet dhe për rregullimin e jetës së mbrendshëme kulturore dhe ekonomike. Këjo don të thotë se popujt kërkojshin qeveri kushtetuese dhe parlamentare.

Mbassi në Kroaci shumica e popullit kërkonte që Kroacija të bashkohej me Dalmacín, qeveritarët në Vjenë ishin të pakënaqun prej atyne kërkesave dhe prandej i këqyrshin Kroatét sikurse edhe Çekët, Hungarezët dhe popujt tjerë. Për t'i dhanë fund atyne kërkesave të popujve me nji potez, në Fruer të vjetit 1861, perandori dha nji urdhën të ri, të quejtun P a t e n t i i F r u e r i t, me anën e të cilit vendosi përsëri centralizmin dhe siguroi sundimin e Gjermanëve në mbarë shtetin. Këtij urdhëni të perandorit i kundërshtuen Hungarezët, e mbas tyne edhe popujt tjerë të shtypun të cilët nuk dëshirojshin që ai të zbatohej.

Deri sa ndodhshin këto ngjarje, konferenca e banit u mblodh në Zagreb dhe zgjidhi nji problem të madh kulturuer. Me propozim të peshkopit Shtrosmajer u formue »Shoqnija kulturore Jugosllave ose Akademija«, e cila kishte për detyrë »më vû bazë për fitimin e nji ditunije mâ të shëndoshë për Kroatët, Sërbët, Sllovenët dhe Bullgarët«.

Kur u banë votimet — ku kishin të drejtë nji numër i vogël njerëzish, mbassi shumica nuk kishin të drejta politike — u mblodh Kuvendi më 1861. Shumicën n'atê kuvend e përbani inteligjenca kroate prej radhëve të borgjezís dhe fisnikëve. Ky Kuvend filloi me ndërtue Kroacín moderne qytetare ku mbisunduen idét borgjeze. Fisnikët duheshin me iu përshtatë gjendjes së tillë, mbassi i kërcënohej gjithënji rreziku prej kryengritjeve të turmave katundare.

Çashtja kryesore politike në Kuvend ishte n'atê në se Kroacija do t'i ndajmbathet Vjenës apo — Peshtës? Mbassi Partija popullore kishte shumicën e përfaqësuesëve në Kuvend, i ra kryesisht asaj në pjesë për ta zgjidhë atê çashtje. Partija tjetër politike ishte ajo e Hungareshëve, e cila në Kuvend përgatitte pakicën, dhe që ishte kryekëput e vendosun për Hungari.

Personat mâ me influencë në Partín popullore nuk pajtoheshin në botëkuptimet e tyne rreth çashtjes me kê duhet me u lidhë Kroacija? Personi kryesuer mâ me influencë në Partín popullore ishte n'atê kohë peshkopi Josip Juraj Shtrosmajer, i cili ishte kundërshtar i vendosun i centralizmit vjenez dhe kërkonte rendin federativ të shtetit. Prandej nuk desht me shkue së bashku me shumicën n'Asamblén popullore të Vjenës, sikurse kërkonte perandori. Shtrosmajeri n'atê moment ishte për bashkëpunim me Peshtën, mbassi besonte se lufta e përbashkët e Kroatëve dhe e Hungarezëve kundër centralizmit vjenez do t'i shërbejë mâ shum Kroacís.

Pikëpamjen tjetër e përfaqësonte Ivan Mazhuraniqi, i cili kishte pozitë me randësi kancelari në zyrën e oborrit për Kroaci në Vjenë. Ai kërkonte që politika e Kroacís të mbështetej n'oborrin vjenez te Hapzburgët, mbasi prej andej do të mundëshin me pasë mâ shum fitime për Kroacín. Tue pasë parasysh se lufta kryesore politike zhvillohej ndërmjet Vjenës dhe Peshtës, Mazhuraniqi besonte se do të fitonte Vjena dhe se prej asaj fitorje mvarej zhvillimi ekonomik dhe kulturuer i Kroacís.

Për shkak të këtyne pikëpamjeve të kundërta në ngjarjet politike, prej Partís së vjetër popullore u nda grupi me Ivan Mazhuraniqin, Ivan Kukuljeviqin dhe disa tjerë. Ata krijuen Partín popullore të pamvarun, dhe përfaqësuesat e tyne shkuen në Vjenë n'Asamblén popullore (Këshilli Perandorak).

Grupi tjetër, me Shtrosmajerin dhe Raçkimin, formuen Partín popullore liberale, e cila muer qëndrim opozite kundrejt politikës së Mazhuraniqit.

N'atê kohë u krijue edhe partija e tretë politike, ideologu kryesuer i së cilës ishte Ante Starqeviqi. Këtê e thirrën Partija Kroate për të drejtën, dhe ajo nuk kërkonte kurrfarë bashkëpunimi as me Vjenën e as me Peshtën.

Politika e Mazhuraniqit e mbështetun në Vjenën pati humbje të madhe. Ajo humbi besimin e njerëzve në Kuvendin kroat, dhe në vjetin 1867, kur u proklamue Monarkija e të Dyve, pësoi humbje dhe jo sukses sikundër pritte.

## Marrëveshtja e vjetit 1868

Kur në vjetin 1868 Austrija në betejën e Sadovës e humbi luftën kundër Prusís dhe kur i kërcënohej rrezik i madh prej politikës grabitqare të Bizmarkut, u detyrue me u marrë vesht me Hungarezët. Dinastija Habzburge kërkoi mënyra me qëndrue në fron dhe prandej për të ishte mâ mirë me kërkue mbështetje në popullin hungarëz, mâ të pasunin në mbarë perandorín. Marrëveshtja u lidh, dhe në vjetin 1867, u proklamue Monarkija Dyfishe. Simbas aktit të carit, perandorija ndahej në dy qendra drejtuese; njana qendër ishte Vjena, kurse tjetra Peshta. E gjithë Kroacija dhe Sllovenija u banë pjesë e Hungarís dhe ranë zyrëtarisht nën sundimin e Hungarezëve.

Përpara formimit të Monarkís Dyfishe u zhvilluen bisedime ndërmjet përfaqësuesit të Kroacís dhe Hungarís për marrëdhanjet e ardhshëme të këtyne dy vendeve. Bisedimet për marrëveshtje ndërmjet Kroatëve dhe Hungarezëve filluen me 1865 me numër të njajtë përfaqësuesash të Kuvendit kroat dhe Asamblés popullore hungareze. Në krye të përfaqësuesave të Kroacís qëndronte peshkopi Shtrosmajer, i cili kërkoi prej Hungarezëve me i njohtë Kroacís pamvarësi të plotë, për t'u zhvillue ekonomikisht dhe në pikëpamje kulturore. Hungarezët i refuzuen këto kushte të Kroacís dhe i prenë bisedimet.

Grupi tjetër i politikanëve Kroatë, të mbledhun rreth Mazhuraniqit, dëshironte me i pré hovin marrëveshtjes ndërmjet Vjenës dhe Peshtës, prandej kërkoi pjesëmarrjen e Kroacís në suazë të Vjenës. Mirëpo, perandori e refuzoi atê propozim të Mzhuraniqit dhe nënshkroi marrëveshtjen ndërmjet Austrís dhe Hungarís.

Që në Kroaci të zhvillohej politika që dëshirojshin Vjena dhe Peshta, perandori vuni për ban në Kroaci Levin Rauhun. Ky filloi sundimin e vet me teror gjindarmësh. Shpalli ligjin e votimeve dhe në votimet bani nji presjon të madh mbi votuesat. Me sjelljen e tij mujti që Partija hungareshe të fitojë dhe të ketë shumicën në parlament. Të dy grupet e Partís popullore kishin gjithsejt 14 përfaqësuesa.

Kur u mblodh Kuvendi në vjetin 1868, opozita shpalli se largohet prej Kuvendit, por me gjithë atê nji pjesë e përfaqësuesave prej Partís populore mbeti me Hungareshët në Peshtë ku lidhën Marrëveshtjen ndërmjet Hungaris dhe Kroacís.

Simbas asaj Marrëveshtjeje Kroacija fitoi autonomín në qeverimin e mbrendëshëm, në fé, në shkolla dhe në gjyq. Punët e përbashkëta të Kroacís dhe Hungarís ishin: financat, bujqësija, tregtija dhe mbrojtja e vendit. Qyteti Rijeka u fut nën sundimin e Hungarís dhe u shkëput krejtsisht prej Kroacis.

Mbas nënshkrimit të Marrëveshtjes filluen vështirësít në Kroaci, mbassi Hungarija pengonte zhvillimin e saj ekonomik. Industrija e vendit nuk mundte me u zhvillue, mbassi për çdo sipërmarrje industrijale ishte e nevojshëme leje për punë prej qeverís Hungareze. Mbarë komunikacjoni u fut në duert e kapitalistave hungarezë. Populli në Kroaci filloi me u vorfnue me shpejtësi; ai nuk mundte me gjetë fitime n'atdheun e vet, prandej u detyrue me kërkue në shtetet tjerë. Për këtê populli filloi me u shpërngulë gjithënji mâ tepër, e mâ shum n'Amerikë.

## Partija e drejtësis (juriste) dhe Ante Starqeviqi

Në kohën e mosmarrëveshtjeve politike ndërmjet prîjsave të Partís popullore, në vjetin 1861, u paraqit grupi i tretë i politikanëve kroatë. Në fillim ai ishte shum i vogël, porse shum luftar. Në kuvend u ndanë Ante Starqeviqi, Eugen Kvaterniku dhe Petër Vërdoljaku, dhe themeluen Partín kroate të drejtësís, anëtarët e së cilës quheshin juristë. Ideologu kryesuer i tyne ish Ante Starqeviqi, bir katundari prej Vojna Krajinës, i cili lindi në vjetin 1823.

Thelbi i parimeve politike të Partís juriste ruente me kambëngulje drejtësín e vjetër kroate. Këjo parti muer për bazë t'ideologjís së vet nacionalizmin modern prej Europës Perëndimore dhe futi në politikën kroate idét e demokracís borgjeze. Udhëheqësija e Partís llogaritte që Kroacija, tue i mësue ato, do të bâhet e pamvarun dhe do të shlirohet prej

Vjenës dhe Peshtës. Juristët besojshin se Kroacija me forcat e veta do të fitojë pamvarësín dhe do të krijojë organizatën shtetnore.

Starqeviqi e urente Austrín dhe Hungarín mbassi ata i konsideronte anmiq, të cilët prishin drejtësin e vjetër kroate dhe pengojne zhvillimin e lirë të Kroacís. Prandej ishte kundërshtar i madh i çdo marrëveshtjeje me Vjenën ose Peshtën. Por pranoi që Kroacija si shtet të lidhet me Perandorín austriake.

Starqeviqi ishte kundërshtar i madh i Sllovenëve dhe Sërbëve; ai nuk i njihte si kombësi, por i thirrte Kroatë. Poashtu ai ishte edhe kundërshtar i madh i idés jugosllovene, që përfaqësojshin Reçki dhe Shtrosmajeri, mbassi qëllimi i tij kryesuer ishte që Kroatët të fitojnë pamvarësín e vet.

Merita mâ e madhe e Ante Starqeviqit për Kroatët ishte ajo se mujti që në shtresat e gjana të popullit të krijojë ndërdijen nacjonale dhe idén për atdheun kroat. Pasojë e kësaj pune ishte ajo se fisnikët humbën ndikimin politik në Kroaci, me gjithë se deri atëhere kishin shumicën n'udhëheqësín e politikës kroate. Prej asaj kohe klasa qytetare muer plotësisht udhëheqësín politike në Kroaci; gradualisht u dukën aspiratat nacjonaliste të kroatëmëdhejve të borgjezís së madhe.

## Turbullimi i Rakovicës

Kur marrëveshtja Kroato-Hungareze u fut në veprim, në vjetin 1871 u shpallën votimet për kuvendin. N'ato votime shumicën e fituen kundërshtarët e Marrëveshtjes, prandej kuvendi as që u thirrë. Atê vjet ndodhi nji ngjarje me randësi politike, e cila, simbas vendit ku ndodhi, u quejtë Turbullimi i Rakovicës.

Turbullimin e filloi juristi Eugen Kvaterniku me qëllim për të krijue Kroaci të lirë prej Vojna Krajinës, Kroacís dhe Sllovenís. Ai shtet duhej të ndahej prej Austro-Hungarís dhe të ruhej prej anmikut me forcat e veta. Kryengritja filloi në teritorin e Vojna Krajinës më 8 Tetuer të vjetit 1871, dhe për katër ditë u mbyt në gjak.

Kvaterniku filloi përgatitjet për kryengritje përpara marrëveshtjes Kroato-Hungareze. Në kohën e krijimit të Monarkís Dyfishe u përhapën lajmet se do të syprimohet Vojna Krajina. Këjo paraqitte rrezik për Krajinasit. Me syprimimin e Vojna Krajinës jeta e oficerave krajinas do të bâhej shum mâ e keqe, kurse katundarët në Krajinë do të merrshin me punue tokën përgjysëm prej të tjerëve ose me qira.

Kvaterniku e shfrytëzoi këtê gjendje shpirtnore dhe filloi përgatitjen e kryengritjes në Vojna Krajinë. Bashkë me mikun e vet Vjekosllav Bahun, ai u largue prej Zagrebi dhe shkoi në Braçanc, ku më 7 Tetuer u themelue »qeverija e përkohshëme popullore e Kroacís«. N'atê qeveri bâjshin pjesë Kvaterniku, Vërdoljaku, Bahu, Rakijashi — të gjithë anëtarë të Partís së drejtësís, kurse komandanti i ushtrís u bâ Rade Quiqi, nënoficer i rojës së kufinit. Nji ditë mâ vonë nxuerrën proklamatën, në të cilën shfaqën par.met e qeverís së Kvaternikut, kurse me 9 Tetuer shkuen në Pllashkë për të marrë bekimin në kishë. Pllashka ishte qendër e Sërbëve n'ato anë. Disa njerëz e njoftën Kvaternikun dhe lajmëruen turbulluesat e Krajinës së ai ishte jurist. Këjo pruni ndryshimin dhe shkatërrimin e shpejtë.

Kur Kvaterniku po këthehej me suitën e vet në Rakovicë, e vranë bashkë me juristët tjerë krajinasit kryengritësa në Malin Lupçë. Prej udhëheqësave të Kryengritjes së Rakovicës shpëtoi vetëm Rade Quiqi, i cili iku në Bosnjë, e mandej në Sërbi.

Kryengritja e Rakovicës ishte e përgatitun keq, kurse Kvaterniku nuk ishte i aftë me udhëheqë luftë me karakter ushtarak. Turmat e gjana popullore nuk ishin të njoftuna me përgatitjet për kryengritje, e kështu që ajo u zhvillue në nji teren shum të ngushtë. Këtu ka randësi që të përmendet se n'atê kryengritje vepruen së bashku Kroatët dhe Sërbët kundër Monarkís austro-hungareze.

### Rilindja e Dalmacis dhe e Istrës

Gjatë kohës së luftës ndërmjet Austrís dhe Francës, në vjetin 1805 Dalmacija ra nën sundimin e Napolonit të I, kurse

me paqën e vjetit 1809 edhe gjithë Istra. Si pjesë t' Iliris së Napolonit, këta vise u njohtën me rendin e ri borgjez, i cili mundësonte kushte mâ të mira për përparimin ekonomik se sa rendi feudal nën Austrín. Kur në vjetin 1813 Napoloni i I u mund, Dalmacija dhe Istra ranë përsëri nën qeverimin e Vjenës dhe Habzburgëve. Dalmacín e pushtoi ushtrija austriake nën komandën e Franjo Tomashiqit.

N'atê gjendje të re Kuvendi kroat në Zagreb kërkoi shum herë që Dalmacija të bashkohet me Kroacín dhe Sllavonín. Prej Vjenës, këto kërkesa i refuzojshin gjithënji. Ky bashkim nuk u bâ as në vjetin revolucjonar 1848, e as gjatë gjithë kohës së sundimit austriak, deri në fund të Luftës së parë botënore.

Pengesa kryesore për bashkimin e Dalmacís me Kroacín ishte propaganda e fortë italjane. Austrija kishte interes me e favorizue atê ndikim italjan si e si që te Kroatët dhe Sërbët në Dalmaci të mos zgjohej ndërdija nacjonale.

Gjatë kohës s'Apsolutizmit të Bahut nuk egzistonte kurrfarë pune politike në Dalmaci dhe Istrë, si edhe as në krahinat tjera të Perandorís austriake. Prej vjetit 1859 në Dalmaci qeveriste si guverner gjeneral Mamula. Austrija caktoi Mamulën për t'ua bâ të pamundun Sërbëve lidhjen me Kroacín dhe Dalmacín, e poashtu edhe ndikimin e Hungarís, e cila ishte ajo mâ e rrezikshëmja për Austrín.

Austrija me ligjin e votimeve ndihmoi Italín në Dalmaci, kështu që 15 000 Italjanë zgjodhën 28 përfaqësuesa, kurse 400 000 Kroatë dhe Sërbë gjithësejt 15 përfaqësuesa. Për këtê arsye Kuvendi në Zadrë vendosi që përfaqësuesat e tij t'i dërgojnë në Vjenë. Në këtê mënyrë Dalmacija u lidh fort me Austrín, dhe u bâ i pamundun bashkimi i saj me Kroacín.

Mbas vjetit 1861, te turmat e gjana popullore u shfaq lëvizja luftarake, nëpër të cilën u forcue ndërdija nacjonale dhe gradualisht u mbërrijtë te ideja e popullit kroat në Dalmaci. Këjo nuk shkoi shpejt, mbassi pjesa mâ e madhe e popullsís qytetare dhe gati krejt shtypi, përdorte kryekëput italishtën. Njikohësisht u zgjue ndërdija nacjonale edhe te Sërbët në Dalmaci. Prandej anmiqt filluen me punue për të

futë në grindje popujt vellazën — Kroatët dhe Sërbët, gjâ që edhe u shkoi përdore përkohësisht. Për këtê arsye, n'atê kohë në Dalmaci, vendet mâ të mirë për tregti dhe për shërbim shtetnuer i pushtuen italjanët.

Kroatët t'organizuem në Partín popullore në vjetin 1873, ndryshuen qëndrimin e tyne ndaj Sërbëve dhe u njoftën barazi të plotë popujve vllazën si në pikëpamje politike ashtu edhe n'atê fetare. Ky bashkëpunim nuk zgjati për nji kohë të gjatë, mbassi erdhën në mosmarrëveshtje përsa i përket pushtimit të Bosnjës dhe Hercegovinës. Ajo gjendje përpara mbarimit të shekullit të XIX çoi këta popuj në kundërshtime edhe mâ të mëdha mbassi u zhvilluen aspiratat e kroatomëdhejve dhe sërbomëdhejve, të cilët shkojshin në fitim t'Italjanëve dhe Austriakëve.

Me dukjen e njerëzve të rij në politikën e Dalmacís, ndryshuen edhe marrëdhanjet në vjetin 1897, kur Kroatët dhe Sërbët nënshkruen marrëveshtje dhe në votime fituen për fundimisht mâ shum vota se Italjanët. Kroatët fituen 25 përfaqësuesa, Sërbët 10, kurse autonomistët gjithësej 6. Prej asaj kohe fitoi ndërdija nacjonale në Dalmaci, kurse propaganda italjane humbi fuqín e vet të deriatëhershëme. Prandej përfaqësuesat e Dalmacís n'Asamblén popullore të Vjenës mbrojshin po atê vijë politike si edhe të gjithë përfaqësuesat tjerë të Sllovenëve të Jugut në shekullin e XX në Zagreb dhe Peshtë. N'Austro-Hungari u krijue shumica e përfaqësuesave jugosllovenë, të cilët punojshin për bashkimin e Sllovenëve të Jugut në nji shtet të vetëm, jashtë ndikimit të Vjenës dhe Peshtës.

Dalmacija e Istra nën pushtimin e Austrís nuk u zhvilluen në pikëpamje ekonomike ashtu si pritej prej shum vetëve. Austrija ndërtonte limane të marinës tregtare e luftarake dhe i dërgonte njerëzit e vendit në punë të vështira. Gjithashtu merrte bukur shum Dalmatinas e Istrias në shërbim të marinës, por nuk jepte kushte tjera, që të mujshin me hy në punë e me u ushqye njerëzit e vobektë t'atyne viseve. Prandej në gjysmën e dytë të shekullit XIX, prej të gjitha viseve të Sllavëve të Jugut, mërgime mâ të mëdha njerzish në shtete të

hueja, e mâ së shumti në SH. B. A., janë bâ prej Dalmacije e Istre.

Tregtija u sillte përfitime vetëm njerëzve të pasun, mjesa turmat e vobegëta të popullit për shkak t'ushqimit të shtrejtë, jetojshin vështirë. Kjo gjâ krijoi pakënaqësín politike të turmave të punëtorëve të vorfën në Dalmací e Istër kundër regjimit t'Austrís.

### Qeverimi i Kuenit në Kroaci. Zhvillimi i industris së fabrikave, lëvizja punëtore. Vllazit Radiqë

Austrija përgatiti për nji kohë të gjatë pushtimin e Bosnjës dhe Hercegovinës. Prandej u përpoq që për atê politikë të bâjë për vehte sa mâ shum popull në Kroaci. Mbassi Hungarezët, mbas Turbullimit të Rakovicës, bâjshin nji presjon të madh në Kroaci dhe keqpërdorëshin financat e përbashkëta, hekurudhat, postën dhe pyjet, ndërmjet Kroatëve filloi me u zhvillue pakënaqësi politike. Prandej njerëzit që mbajshin anën e Austrís mujtën që në vjetin 1873 me vû për ban të Kroacís Ivan Mazhuraniqin. Me gjithë se Hungarija kundërshtoi, Mazhuraniqi qeveriste simbas dëshirës së Vjenës.

Periudha e qeverimit të Mazhuraniqit âsht e randësishme për shkak të ngritjes s'enteve kulturale, si dhe për organizimin e gjyqeve dhe themelimin shkollave dhe universiteteve në Zagreb në vjetin 1874. Në politikën e mbrendshëme Mazhuraniqi shkaktoi padurim të madh ndërmjet Sërbëve dhe Kroatëve. Sërbët nuk i konsideronte përpara ligjit të njajtë me Kroatët, tue i quejtë »grekë të lindjes«. Ndaloi shkollat fetare, të cilat egzistojshin deri atëhere. Edhe kundrejt emigrantave prej Bosnje dhe Hercegovine, të cilët gjatë Kryengritjes boshnjako-hercegovase u mërguen në Sllavoni, bani Mazhuraniq sillej anmiqësisht. Urrejtja e Sërbëve u shtue edhe mâ kur ai ndaloi flamurin sërb.

Këto marëdhanje të vështira ndërmjet Kroatëve dhe Sërbëve, të cilat Mazhuraniqi i ashpërsoi edhe mâ tepër, i shfrytëzuen Hungarezët, dhe mbassi pushtuen dhe Hercegovinën e rrëxuen Mazhuraniqin prej pozitës si ban. Mbas pushtimit Mazhuraniqi nuk i ishte mâ i nevojshëm as Austrís, mbassi kër-

konte që krejt Vojna Krajina, Bosnja dhe Hercegovina t'i ndajmbathen Kroacís dhe të krijohet krahina e tretë me të drejta të barabarta në monarki nën qeverimin e Habzburgëve. Me këtë nuk pajtoheshin as Austrija e as Hungarija, prandej në vjetin 1880, Mazhuraniqi u tërhoq prej pozitës si ban.

Hungarezët shfrytëzuen dasín ndërmjet partive politike kroate dhe prej grindjeve ndërmjet Kroatëve dhe Sërbëve, dhe për ban prunë kontin Kuen Hedervarin. Ky aristokrat i ri hungarez vendosi në Kroaci diktaturën. Ndërmjet Kroatëve dhe Sërbëve gjeti bashkëpunëtorë, të cilët, tue i shërbye besnikisht, mundësuen që ai të qeverisë plot njizet vjetë.

Kueni e anuloi ligjin mbi lirín e shtypit, mbledhjeve dhe shoqatave, që ishin në fuqi prej vjetit 1874. Gjyqet gjykojshin simbas urdhënit të policís. Burgjet u mbushën me njerëz t'akuzuem si të »pabindun«. Kueni bani »reformën e vet të votimeve«, së cilës i vuni cunz të madh, kështu që në nji mijë banorë kishin të drejtë votimi vetëm njizet. Regjimin e tij e vendosi me ndihmën e policís dhe gjindarmërís, në mbarë vendin sundonte »heshtje vorri«.

Partija popullore u shndërrue në maqinë automate votuese, mbassi përfaqësuesat e saj pranojshin gjithëshka që kërkonte bani.

Mbas pushtimit të Bosnjës dhe Hercegovinës u shtue gjithënji e mâ shum dasija ndërmjet Kroatëve dhe Sërbëve. Sërbët në Kroaci, Slloveni dhe në Dalmaci mendojshin se e padrejta nacionale u ishte bâ nga ana e Austrís. Ata e ndiejshin pushtimin si grusht të randë që i ishte dhanë idés së bashkimit të Sërbëve dhe idés për bashkimin e Sllovenëve të Jugut. Prandej paditshin Kroatët tue thanë se ata dëshirojshin edhe bashkimin e Bosnjës dhe Hercegovinës me Kroacín. Politika kroatomadhe e Starqeviqit dhe fjalimet e tij kundër Sërbëve, për shkak se ata ndihmojshin politikën e Kuenit, krijuen jaz edhe mâ të madh ndërmjet këtyne dy popujve vllazën.

Kueni e shfrytëzoi këtê dasi të Kroatëve dhe Sërbëve dhe bani për vehte shumicën në Kuvend, në mënyrë që Kroatët hungareshë dhe anëtarë të Partís popullore, e me këta edhe Sërbët, votojshin gjithënji për propozimet e qeverís. Për me

i bâ Sërbët për politikën e vet, Kueni anuloi të gjithë urdhënat e Mazhuraniqit kundër Sërbëve dhe i barazoi me Kroatët. Kështu Sërbët mund të zejshin të gjitha pozitat n'aparatin shtetnuer. Ai përdori parimin »ndaj dhe sundo« dhe mujti me ngjallë te shumica e Kroatëve pakënaqësi, që mâ në fund u shfaq në demonstrata të mëdha të Kroatëve kundër Sërbëve në Kroaci. Prej vjetit 1895 demonstratat u shndërruen në luftë vëllavrasëse dhe për asgjâsimin e pronave materjale të Sërbëve në Zagreb dhe në qytetet tjerë.

Qeverimi i Kuenit ishte antipopulluer dhe apsolut. Prandej, populli e urejti dhe e quejti »kuenovshtina«. Ai u përpoq me e ruejtë përgjithëmonë sundimin e Vjenës dhe të Peshtës në Kroaci dhe të bâjë të pamundun afrimin e Kroatëve dhe Sërbëve në punë të përbashkët.

### Zhvillimi i industrís së fabrikavet dhe lëvizja punëtore

Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX borgjezija e re kroate u përpoq që të forcohet ekonomikisht. Deri në vjetin 1872 egzistonte nji numër njerëzish të pasun, të cilët kërkojshin me hap lirisht dyqane tregtije dhe punëtori zejtare. Prej vjetit 1884 u themeluen sipërmarrje industriale, por për shkak të mungesës së kapitalit nuk u zhvilluen shpejt. Sipërmarrjet industriale rëndom i hapshin bankat, të cilat në Kroaci filluen me u zhvillue prej vjetit 1868, e nga të cilat deri në fund të shekullit të XIX kishte tridhetë.

Për shkak të zhvillimit të shpejtë të kapitalizmit dhe t'industrís u përforcue edhe komunikacjoni, që kështu tregtija importuese dhe ajo eksportuese të kryhej sa mâ shpejt. Për industrín e fabrikave ishte nevoja që disa landë t'importoheshin prej së jashtëmi. Mbassi krejt sundimin në shtet e kishin Austrija dhe Hungarija, ato zhvilluen industrín e tyne dhe nuk lejojshin që të forcohej industrija e fabrikave në Kroaci. Prandej, kufizojshin importimin e landëve të para të nevojshëme. Për këtê arsye në Kroaci u ndërtuen kryesisht ato fabrika industrije që pajiseshin me landë të para që gjindeshin në vend. Këto ishin sharrat me avull, mandej industrija e

mobiljeve, cigurat dhe gjysëm fabrikatët prej hekuri. U hapën xereroret e thëngjillit, u prenë pyjet, përpunoheshin sende ushqimore prej mishi, letra, leshi dhe lëkure.

Kroacija ishte vend bujqësuer dhe blegtoral, prandej u ndërtue mâ shum industrija për përpunimin e atyne prodhimeve.

Krahas me zhvillimin e mjeteve bankare u zhvillue pra edhe industrija e fabrikave, e cila me prodhimet e veta të lira u bante konkurencë zejeve, kështu që ato mbërrijtën në gjendje të vështirë.

Me paraqitjen e ekonomís monetare në Kroaci dhe me zhvillimin e industrís së fabrikave u krijue klasa punëtore. Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX gradualisht u shkatërruen kooperativat katundare dhe shum anëtarë të tyne nuk mundëshin mâ me jetue në katund, mbassi u vobegsuen. Ata shkuen nëpër qytete dhe u banë punëtorë mëditësa. N'industrín e fabrikave dhe në ndërtimin e komunikacjonit në Kroaci deri në vjetin 1890 mâ shum punojshin punëtorë të kualifikuem, e punëtorët e kualifikuem mâ shum ishin të huej.

Mëditjet punëtore ishin shum t'ulta, mâ të vogla ishin në bujqësi e mâ të mëdha n'industri. Ndryshimi ndërmjet çmimeve t'ushqimit, veshes dhe mbathjes, nga njana anë, dhe mëditjes së punëtorëve nga ana tjetër, ishte mâ e madhe. Prandej shum punëtorë shkuen në shtetet e huej — Austri, Gjermani, Belgjikë, Amerikë dhe Australi — për të fitue. Ata që mbetën në Kroaci u organizuen në lëvizjen punëtore, që nëpërmjet grevave të krijojnë për vehte kushte mâ të mira jetese.

Të parët u organizuen punëtorët e tipografís në »shoqnín e tipografëve«, në vjetin 1870. Ata qysh mâ përpara kishin arkën e tyne për të sëmundët. Tipografët ishin të parët në Kroaci që banë grevë, e cila u siguroi me qitë gazetën e tyne »Rad«, në vjetin 1883. Drejtimi politik i punëtorëve të tipografís nuk ishte revolucjonar, por ndikoi në punëtorët tjerë që t'organizohen edhe ata.

Lëvizja punëtore u zhvillue ngadalë, mbassi në Kroaci aty kah vjeti i tetëdhetë, ndikimin mâ të madh e kishte ideologjija e juristëve dhe lëvizja nacjonaliste. Kushtet u ndryshuen kur

në vjetin 1892, socjalistat e pakët filluen me nxjerrë gazetën e përjavshëme »Sloboda«, në të cilën shkruhej mbi lëvizjet e punëtorëve në botë.

Përforcimi i lëvizjes punëtore u duk në vjetin 1894, në kohën e fuqís mâ të madhe të regjimit të Kuenit. Punëtorët në Zagreb festuen Nji Majin dhe formuen Partín socjaliste. Nji vjet mâ vonë ata u ndanë në grupin partizanë të lëvizjes të klasës punëtore, dhe në grupin e atyne që ishin për nacjonalizmin e ngushtë të juristave të quejtun »Punëtori kroat«.

Lëvizja e klasës punëtore u organizue në vjetin 1896, në Kongresin në Zagreb, dhe prej asaj kohe punëtorët filluen me luftue kundër regjimit dhe kundër parimeve nacjonaliste të »Punëtorit kroat«. Për klasën punëtore u lehtësue çashtja mbas ramjes së regjimit të Kuenit, në vjetin 1903. Ndërkaq, lëvizja punëtore u la në duer të njerëzve që nuk ishin revolucjonarë, prandej ishte dhe shum e dobët.

Me numrin e partizanëve u rrit Partija socjaliste dhe sindikati, u zhvillue shtypi dhe bâheshin greva. Lëvizja nuk mori karakter revolucjonar mbassi Buksheku, Koraci dhe Demetroviqi ishin kundërshtarë të revolucjonit. Ata, si udhëheqës të Partís socjaliste, pengojshin aplikimin e mësimeve të Marksit.

## Vllaznit Radiqë

Në fillim të shekullit të XX në politikën kroate duelën vllaznit Radiqë — Ante dhe Stefani. Që të dy mbetën t'afërm me turmat katundare deri në fund të jetës së tyne. Zhvilluen luftë nëpërmjet të shtypit në nji gjuhë të kuptueshme për turmat e gjana popullore.

Kah fundi i shekullit të XIX ekonomija e katundarëve kroatë kishte mbetë shum mbrapa, e poashtu edhe analfabetizmi gjindej në nji shkallë të gjanë. Katundarët nuk kishin mjaft të holla për të ble vegla moderne, prandej fisnikët mujshin me prodhue mâ shum dhe me i shitë mâ lirë prodhimet e tyne bujqësore. Bankat u jepshin të holla hua katundarëve tue marrë prej tyne kamatë të naltë, kurse nëpunësat kërkojshin prej katundarëve ryshfet, që kështu të kryejshin punët e tyne, të cilat në të vërtetë duhet t'i kryejshin pa kurrfarë pagese.

Partít politike kroate-të hungareshëve, Partija e juristëve dhe Partija popullore (Obzorashët) po dobësoheshin me grindjet ndërmjet tyne, dhe secila përpiqej me kallxue se qëndrimi i saj âsht i drejtë. Për turmat katundare asnjana nuk kujdesohej, prandej populli mbeti pa të drejta politike.

Në nji këso situate në vjetin 1900 Ante Radiqi filloi me nxjerrë gazetën »Dom«, në të cilën, gati gjithëshka, shkruente ai vetë. Në nji menyrë të përshtatshëme për katundarët shkruente për ekonomín e vendit, për organizimin e shtetit, mandej artikuj prej letërsís dhe fillozofís, dhe shum gjana tjera.

Vëllai tjetër, Stefan Radiqi, prej vjetit 1903 botoi revistën e përmuejshëme »Hrvatska misao«, për intelektualët, të cilët desht me i afrue me turmat katundare. Me shkrimet e veta nëpër gazetat, të dy villaznit Radiqë përgatitën krijimin e Partís politike të katundarëve.

Kur përgatitën gjithëshka, kah fundi i vjetit 1904 themeluen Partín katundare kroate, ose si quhej zakonisht — Partín katundare. Këjo parti u themelue që në luftën për pamvarësín popullore të futeshin forca të reja — te katundari kroat, i cili deri atëhere ishte lanë krejtësisht mbas dore. Pika mâ e randësishme në programin e Partís katundare ishte që tokat e mëdha të coptohen dhe me ua nda katandarëve, tue u pague damshpërblimin zotnijve. Në kroaci, në fillim të shekullit të XX 300 zotnij tokash kishin nji sipërfaqe prej 350 000 hektarë tokë. Disa pronarë kishin prej 12 000 hektarë deri me 60 000 hektarë tokë.

Qeveritarët nuk ishin të kënaqun me idét e reja të vllazënve Radiq, prandej nëpërmjet të shtypit u organizuen sulme në punën dhe në programin e Partís katundare dhe kundër partizanëve të saj.

Partija katundare, poashtu si edhe ajo e juristëve, kërkonte shtet të lirë kroat në bazë të drejtësís historike shtetnore. Me idét e saja ajo përpiqej që atê ta fitonte me anë të ligjit. Partija nuk ishte për fitimin e lirís dhe pamvarësís nëpërmjet të revolucjonit, por mbronte idét përparimtare se pushteti shtetnuer duhet të jetë në duert e popullit. Për pushtetin duhej të vendoste shumica e popullit — katundarët. Në

program kërkohej me pasë të drejtë vote të gjithë, votime të mshefta, dhe që punëtorëve t'u merren parasysh kërkesat e tyne. Programi i Partís katundare dhe qëllimet e saj politike ishin mikroborgjeze, mbassi ajo mbështetej kryesisht në katundarët e mesëm dhe të pasun, kurse për të vobegtët nuk kallxonte kujdes të posaçëm. Vllaznit Radiq, nëpërmjet të programit të partís së tyne, kërkuen edhe autonomi të plotë për komunet dhe rrethet, gjyqe të pamvarun, dhe reformën e shkollave, që për atê kohë përfaqësonte idé përparimtare.

Gjith ato idena të çekuna në programin e Partís katundare janë marrë prej ideologjís së demokracís borgjeze perëndimore, të cilat n'atê kohë ishin përparimtare në Kroací.

Për shkak të këtyne kërkesave të përgjithshëme në Partín katundare me vllaznit Radiq mbeti vetëm nji numër i vogël intelektualësh, mbassi shumica në parti nuk pajtohej me programin e katundarëve. Këjo nuk i demoralizoi vllaznit Radiq e veçanisht Stefanin; ai vazhdoi me punue me katundarët dhe mujti me futë për shum vjet me radhë në katundarët idét demokratike dhe të luftojë kundër zotnijve feudalë dhe borgjezís së pasun me të holla.

**Idet e bashkimit sërbo-kroat. Supili. Koalicjoni sërbo-kroat**

Mâ në fund në Kroaci e panë se grindjet ndërmjet Kroatëve dhe Sërbëve dobësojnë rezistencën e tyne kundër Vjenës dhe Peshtës. Prandej filluen punën për afrimin e Kroatëve dhe Sërbëve dhe për realizimin e bashkimit të Sllovenëve të Jugut. Këto idé për bashkimin sërbo-kroat filluen me i predikue Frano Supili dhe Stefan Radiqi, Svetozar Pribiqeviqi e shum tjerë.

Frano Supili, i lindun në Kanavle, merrej me gazetari dhe propagandonte bashkimin e Sllovenëve të Jugut. Ishte demokrat borgjez luftar, i cili me idét e veta ndikoi shum për afrimin e Sërbëve dhe Kroatëve. Flitte se nuk âsht e randësishme në se Sërbët dhe Kroatët janë nji popull me dy emna ose dy popuj, në se janë dy fise të po nji populli ose dy degë të po nji fisi. Asht e randësishme që ata të lidhen me njani tjetrin, të kenë interesa të përbashkëta dhe anmiq të përba-

shkët. Anmiku mâ i madh i tyne âsht Austrija, prandej duhet me luftue bashkarisht kundër saj.

Supili ishte i aftë për të bindë, prandej i shkoi përdore që opozitën kroate ta lidhë me Hungarín, për të luftue së bashku kundër Austrís. Në saje të punës së tij, në Tetuer të vjetit 1905 u bâ mbledhja e përfaqësuesave të partive politike në Kroaci, e cila u mbajtë në Rijekë. N'atê mbledhje u formulue Rezolucjoni i Rijekës, i cili kërkoi me u zhdukë të gjitha marrëdhanjet e këqija politike dhe të vendoset lirija kushtetuese, poashtu sikurse edhe në vendet tjerë të kulturuem. Kroatët duhet me i ndihmue popullit hungarez në luftën e tij për pamvarësi, kurse Hungarezët duhet të kërkojnë që Dalmacija t'i ndajmbathet Kroacís. Kroacija duhet të fitojë liri të plotë për zhvillimin e vet politik, financjar, ekonomik dhe kulturuer.

Këtê rezolucjon nuk e firmuen frankovasit dhe klerikalët.

Katërmbëdhetë ditë mâ vonë u mblodhën në Zadrë përfaqësuesat e kombësís sërbe prej Kroacije dhe Dalmacije. Ata pranuen parimet e Rezolucjonit të Rijekës dhe shfaqën dëshirën për bashkëpunim me Hungarezët, të cilët luftojshin për liri dhe pamvarësi. Sërbët formuluen Rezolucjonin e Zadrës, në të cilin theksuen kërkesën për barazi të Sërbëve në Kroaci. Të dy këto rezolucjone ranë në Vjenë si rrufe, mbassi oborri dhe qeverija e panë se u kërcënohej rreziku prej punës së përbashkët të Kroatëve dhe Sërbëve. Prandej qeveritarët e Vjenës filluen me paditë menjiherë partizanët e rezolucjoneve si trathtarë, që punojnë për qeverín sërbe dhe për Beligradin.

Pasoja e Rezolucjonit të Rijekës dhe Zadrës ishte krijimi i grupit të madh politik — Koalicjoni sërbo-kroat.

Në koalicjon hynë: Partija juridike kroate, Partija popullore kroate, Partija e pamvarun popullore sërbe, Partija radikale sërbe, Partija socjal-demokrate dhe grupi pa parti në krye me Franko Potocnjakun. Partija katundare e Radiqit nuk u fut në Koalicjon. Koalicjoni duel përpara popullit me programin e vet me të cilin kërkohej vetqeverimi i komunës, rretheve dhe krahinave, mbrojtja e pasunís katundare dhe caktimi i drejtë i taksave për tokën, mandej, që me anë të

ligjit të caktohet minimumi i sipërfaqës së tokës së katundarëve që âsht e domosdoshme për jetë, të zhduken shkaqet e shpërnguljes, etj.

Në votimet e vjetit 1906 Koalicjoni fitoi dhe detyroi Vjenën dhe Peshtën që në Kroaci gradualisht të futet forma e qeverimit porlamentar. Me fitimin e Koalicjonit mâ në fund fitoi demokracija përparimtare borgjeze, dhe u krijuen kushtet për zhvillimin e kapitalizmit në Kroaci.

Vjenës nuk i pëlqejshin këto ndryshime, mbassi ato ishin pengesë për aspiratat e saja pushtuese në Ballkan. Prandej, kur në vjetin 1908 Austrija vendosi me e pushtue plotësisht Bosnjën dhe Hercegovinën, qeverija Vjeneze përdori kundër Koalicjonit mënyrat mâ të ndyta. Për ban u vû Pavao Rauh, i cili nuk desht me bashkëpunue me Kuvendin. Ndaloi gazetat »Pokret«, »Srbobran«, »Slobodna Rijeç«. Qeverija Vjeneze veproi kështu vetëm për të kallxue përpara Europës se si Koalicjoni, i lidhun me qeverín në Beligrad, përgatiti luftën. Me këtê Vjena desht me kallxue se si aneksimi âsht i nevojshëm për ruejtjen e paqës.

Për të realizue qëllimet e veta, Vjena përdori Gjorgje Nastiqin, Sërbijan prej Hercegovine, i cili ishte agjent-provokator, që shkroi libërthin »Finale«, në të cilin akuzoi Sërbët e Kroacís tue thanë se ata punojnë me Sërbín. Në bazë të këtij provokimi në vjetin 1908, bani Rauh urdhënoi që të burgosen 53 Sërbët mâ të dalluem dhe të mbyllen në burgun e Zagrebit. Këta Sërbë u paditën, u qitën përpara gjyqit dhe i dënuen. Ky ishte »proçesi për trathti të naltë«, e të pandehunit u dënuen me 184 vjetë burgim të gjithë së bashku. Kur mbaroi kriza e aneksimit »trathtarët« u liruen, me qenë se Austrija e mori atê që kërkonte. Prej vjetit 1908—1910, Kuvendi kroat nuk u mblodh asnjiherë, por Rauhu u tërhoq. Koalicjoni fitoi në votimet, por Vjena nuk lejonte qeverimin parlamentar, prandej në vend të banit u emnue »komesari mbretnuer« Cuvaj. Ai qeveriste me kryeneçi, dhe kundër interesave të popullit. Për këtê ai ngjalli pakënaqësi të madhe, veçanisht në rinín. Studentët dhe punëtorët organizuen demonstrata kundër tij.

Për shkak të qeverimit jokushtetues të Cuvajit, studenti i ri Lluka Jukiqi bani atentat kundër tij, por nuk mujti me e vra. Mbassi Lluka kishte lidhje me të rijt e së majtës prej lëvizjes revolucjonare, u burgosën dhe u dënuen edhe Vlladimfr Bornelisi, Gjuko Cvijiqi, Vlladimir Qopiqi dhe August Cezareci.

Partít borgjeze nuk kollxojshin haptaz simpatít e tyne për atentatin, por Koalicjoni ishte n'anën e rinís. Frankovasit dhe klerikalët, sulmuen ashpërsisht të rijt revolucjonarë dhe fyejshin me fjalët mâ të ndyta idealet e tyne — Bashkimin e Sllavëve të Jugut.

Mbassi Austro-Hungarija përgatitej për luftë, ajo nuk lejoi që në Kroaci të futet regjimi parlamentar. Po të vepronte ashtu duhej me ia dorëzue sundimin Koalicjonit, e dihej se ai grup politik dëshironte shkatërrimin e Monarkís Habzburge dhe kërkonte bashkimin e Kroacís me Sërbín dhe me vendet tjerë jogosllovenë në nji shtet të përbashkët.

## SLLOVENËT DERI NË VJETIN 1914

### Zhvillimi ekonomik dhe forcimi i borgjezis sllovene. Lëvizja e sllovenëve të rij (Fran Levstiku). Depërtimi gjerman n'Adriatik

Mbas revolucjonit të vjetit 1848/49 e gjithë jeta politike në Slloveni u ngujue nën shtypjen e apsolutizmit të Bahut. Austrija në Slloveni, ashtu si edhe në trevat tjera të parandorís së vet, hoqi lirín e shtypit, lirín e fjalës e shoqatat, dhe shtypte me forcë çdo punë politike. Shoqatat dhe gazetat që filluen me dalë në kohën e revolucjonit prenë punën. Krahas me vendosjen e apsolutizmit u fut edhe gjermanizimi. Të dy këto mënyra të shtrimjes së sundimit u dukën veçanisht në Slloveni, mbassi ajo gjindej në rrugën e kapitalistave gjermanë që i çonte për në Triestë, në limanin e tyne kryesuer n'Adriatik. Gjermanizimin Austrija e vendosi nëpërmjet të nëpunësave të shumtë, t'ushtrís dhe gjindarmërís.

Në kohën e apsolutizmit të Bahut qeverija e Vjenës u përpoq me bâ borgjezín për vehte, mbassi i nevojitesh kapitali i

saj, për të forcue ushtrín dhe qeverimin mbi popujt e shtypun. Prandej qeverija e Vjenës i bani borgjezís lëshime të ndryshme dhe në vjetin 1851 hoqi kufíjt doganorë ndërmjet vendeve të ndryshëm, të cilët deri atëherë gëzojshin autonomín. N'atê mënyrë krejt shteti u bâ treg i përbashkët, në të cilin prioritet kish Austrija. Pasoja e heqjes së doganës ishte ndërtimi i shpejtë i hekurudhave dhe qarkullimi mâ i madh i mallit.

Në kohën e apsolutizmit në Sllloveni u hapën xeherore të reja dhe u ndërtuen fabrika, mâ shum me ndihmën e kapitalit austriak, kurse Sllovenët kishin pjesë shum të vogla. Në Sllloveni zhvillimi i ekonomís kapitaliste filloi përpara revolucjonit të vjetit 1848, qysh atëherë kur filloi me u ndërtue hekurudha Vjenë-Trieshtë, në vjetin 1841. Ai zhillim u shpejtue edhe mâ tepër kur hekurudha u ndërtue plotësisht, në vjetin 1857.

Industrija u forcue, dhe rreth vjetit 1860 e mundi manifakturën e vjetër dhe mjeshtërít të cilat deri atëhere shitshin mallin e tyne në treg. Në trevat Sllovene prej asaj kohe filloi zhvillimi i ri ekonomik dhe përforcimi i borgjezís sllovene.

Kështu u krijue nji numër i madh sipërmarrjesh industriale për përpunimin e sendeve ushqimore, tekstilit, metalurgjís dhe për prodhime kimike. Sipërmarrjet industriale filluen me u ndërtue mâ tepër nëpër qytete, mbassi aty ishin kushtet mâ të mira për prodhime industriale. Ndër qytete u përqëndrue nji numër i madh punëtorësh, sepse qytetet ishin edhe tregu mâ i mirë për shitjen e mallit industrial. Mullijt me avull dhe fabrikat e kafes surogato përpunojshin mâ shum landë se sa kish mundësi me dhanë Sllovenija, prandej landët e para imortoheshin nga jashtë. Prodhimet eksportoheshin edhe në vise tjera t'Austro-Hungarís. Poashtu edhe Fabrikat e mëdha të birrës në Lublanë, Maribor dhe Trieshtë, prodhojshin mâ tepër birrë se sa kishte nevojë Sllovenija, prandej nji pjesë eksportohej përjashta.

Për industrín tekstile, si dhe për atê kimike, Sllovenija nuk kishte landë të para të mjaftueshme, prandej disa landë importoheshin, që kështu fabrikat e tjerrjes dhe endjes në Lublanë dhe Tërzhicë të mund të kryejshin punën e vet.

Industrija mâ e randësishme ishte ajo xeherore; në kushtet e prodhimit të ri kapitalist u shtue sasija e xeheve dhe e thëngjillit në xeheroret e vjetra. Këjo u ndie veçanisht kur kapitalistat formuen shoqni dhe bashkuen kapitalet e tyne, kështu që kishin mundësi me futë sa mâ shum të holla n'eksploatimin e pasunive xeherore të nëntokës.

Rrolin kryesuer në zhvillimin ekonomik të Sllovenís e luejtën bankat, të cilat ishin kryesisht me origjinë të huej, austrijake dhe hungareze. Ato çelën në Slloveni degat e veta dhe nëpërmjet të tyne mbytshin kapitalin slloven. Këto banka që ishin, mâ shum gjermane, e detyruen borgjezín sllovene që tue fillue prej vjetit 1870 të krijojë kapitalin e vet bankar, tue futë të hollat e veta n'arkë kursimi. Kështu, dalëngadalë te Sllovenët u krijue bankarizmi, që don të thoshte krijimi i borgjezís sllovene.

Me heqjen e apsolutizmit të Bahut në vjetin 1860 dhe me vendosjen e gjendjes kushtetuese me Diplomën e Tetorit, në Slloveni filloi me u këndellë jeta politike. Grupet politike filluen me shpallë me anë të shtypit programat e tyne, të cilat i përgjigjeshin dëshirave të borgjezís sllovene. Kah vjeti i gjashtëdhetë i shekullit të XIX u dalluen kryesisht ata dy grupe politikë, të cilët ishin krijue qysh në vjetin 1848.

Njani prej tyne ishte vjetrue përkah pikëpamjet e veta politike, kurse tjetri ishte përparimtar (liberalja), por që të dy kërkojshin kushte mâ të mira për forcimin e kapitalizmit slloven. Këto dy grupime politike të borgjezís sllovene frigoheshin shum prej depërtimit të kapitalit gjerman në vendin e tyne. Prandej grupi konzervativ iu përshtatë plotësisht politikës s'oborrit dhe zotnijve të tokave të gjana, të bindun se me ndihmën e tij do të mund të ruejnë kapitalin slloven. Këtij grupi i prini Blajvas, i cili ndihmoi politikën monarkofashiste të Vjenës dhe reakcjonin në vend dhe tregoi kujdes mâ të madh për »Austrín e mbrendshëme« se sa për bashkimin e Sllovenís. Programi i këtij grupi politik u krijue në vjetin 1865, në Maribor, prandej u quejtë Programi i Mariborit.

Simbas atij programi, Kranjska, Shtajerska, Korushka dhe Bregdeti Slloven duhej të bashkoheshin administrativisht si

Austrija e mbrendshëme. Secila prej këtyne krahinave duhet me pasë kuvendin e vet të trevës, e të gjitha së bashku kuvendin e përbashkët. Ky program u përpilue në baza të vjetra feudale dhe kërkonte marrëveshtje ndërmjet feudalëve dhe borgjezís. Këtê grup politik e quejtën Sllovenë të vjetër.

Kundër sllovenëve të vjetër të Blajvasit veprojshin të rijt — grupi i borgjezís së vogël përparimtare. Ata iu përmbajtën vijës themelore — unjisim i Sllovenís, por u lëkundën shum në realizimin e idealeve të veta. Për shkak të kësaj lëkundje ndërmjet Sllovenëve të rij u krijue krahu i majtë demokrat, i cili mbronte interesat e turmave të gjana popullore. Personi kryesuer në tê ishte shkrimtari politikan Fran Lestviku, i cili kritikoi ashpër punën e Sllovenëve të vjetër dhe atê të Blajvasve. Veprimtarija e këtij grupi politik u shpreh mâ fort mbas krijimit të Monarkís Dyfishe, atëhere kur e tanë Sllovenija u shkri n'Austrín dhe politika e saj mori karakter antipopulluer.

Në gjendjen e rikrijueme turmat popullore filluen me u interesue mâ shum për politikën në Slloveni. Kuvendet e trevave që mbetën në fuqi ndihmojshin vijën e vjetër feudale dhe mundësuen sundimin e të huejve. Grupi i Levstikovit punoi për unjisimin e Sllovenís dhe luftoi kundër ndikimit të huej dhe mbetuninave të marrëdhanjeve feudale. Aktiviteti i tij u çfaq mâ fort në »taboret e mëdhej« (mbledhjet), që u mbajtën në gjithë Sllovenín. Koha e veprimtarís mâ të fortë — taboreve — ishte prej vjetit 1868 e deri më 1871.

Të gjithë grupet politike mbajshin tabore dhe në to luftojshin për të bâ për vehte turmat popullore të Sllovenís për drejtimin e politikës së tyne.

Borgjezija sllovene nuk ishte e aftë për t'udhëheqë nji politikë demokratike në fitim të turmave të gjana popullore. U shfaq kundërshtimi ndërmjet dëshirave të turmave popullore dhe dëshirave të borgjezís liberale. Borgjezija nuk guxonte me shkue deri në fund me popullin, mbassi frigohej se mos vinte në mosmarrëveshtje me politikën shtetnore t'Austrís e kështu ajo mund t'i damtonte shum. Prandej borgjezija u largue prej luftës dhe u përpoq me ia përshtatë politikën e vet asaj të qeverís. As Levstiku nuk shkoi deri në fund n'atê luftë por u

tërhoq prej politike, e kështu demokracija sllovene humbi luftarin e vet mâ të mirë kundër reakcjonit. Për shkak të këtyne kundërshtimeve në taborin e demokracís u forcue reakcjoni dhe klerikët dalëngadalë filluen me marrë udhëheqësín në politikën sllovene.

Qysh prej shekullit të XVII dhe të XVIII egzistojshin vendbanime të shumta Gjermanësh në qytetet sllovene dhe në vendet e xeheroreve. Në gjysmën e parë të shekullit të XIX, Gjermanët mbajshin në duert e tyne pjesën kryesore të tregtís, zejet dhe industrín e fabrikave. Sllovenët ishin bujq dhe zejtarë të vogjël.

Edhe sipërfaqet e mëdha të tokave gjindeshin mâ shum në duert e Gjermanëve se sa në duert e Sllovenëve. Ata 600 zotnij të sipërfaqeve të mëdha të tokave, ishin pronarë të sipërfaqeve mâ të mëdha se sa 100 000 pronarë katundarë të vogjël. Për shkak të marrëdhanjeve të tilla në popull u ngjall pakënaqësija dhe urrejtja kundër feudalëve, e veçanisht kundër Gjermanëve.

Me zhvillimin e kapitalizmit nëpërmjet të bankave, sipërmarrjeve industriale dhe komunikacjonit hekurudhuer, të cilët shërbejshin për krijimin e banesave gjermane në të gjitha vijat kryesore deri në Detin Adriatik, fuqija rezistuese e Sllovenëve dobësohej. N'atê mënyrë politika gjermano-austriake, me krijimin e banesave gjermane vepronte me plan për me i krijue vehtës mbështetje në Sllloveni. Mbassi të gjitha rrugët gjindeshin krejtësisht në duert e tyne, ata u përpoqën me gjermanizue edhe pjesën e bregut t'Adriatikut Sllloven.

Depërtimi Gjerman n'Adriatik pengonte borgjezín sllovene, dhe këjo u bâ nji prej arsyeve që ajo me ndihmën e popullit të fillojë luftën kundër përhapjes së Gjermanís në Sllloveni.

**Zanafilla e partive politike, lëvizja punëtore dhe kooperativizmi, shpërnguljet, dëshirat për shlirimin socjal dhe nacjonal**

Depërtimi i kapitalizmit të madh në Sllloveni, dhe njikohësisht ruejtja e pasunive feudale, ishin shkak që filloi kriza agrare e gjatë njizetë vjeçare, tue fillue prej vjetit 1871—1890. Këjo krizë vorfënoi katundarët Sllovenë. Ata nuk kishin të

holla për të ble vegla, të cilat për ata ishin shum të shtrejta, e me ndihmën e të cilave tue lavrue thellë ose tue plehnue tokat do të merrshin mâ shum fryte prej tokës së vet. Pronarët e mëdhej duruen mâ lehtë kalimin në mënyrën moderne të prodhimit agrar. Ata merrshin prej bankave aq të holla sa u nevojiteshin, dhe i këthejshin mandej mbas korrjes.

Për shkak të këtyne kundërshtimeve vorfënimi i katundarëve sllovenë u zhvillue me shpejtësi. Nji numër i madh njerëzish nuk mund të jetonte në katund dhe u detyruen me shkue nëpër qytetet dhe xeheroret. Atje gjejshin punë dhe i sigurojshin vehtës mundësi për të jetue. Ndërkaq, numri i katundarëve të vorfënuem shtohej gjithënji mâ tepër dhe mâ me shpejtësi se sa kishte mundësi me zanë punë në Sllloveni, e për këtê arsye u shpërngulën dhe shkuen në vende tjerë. Nji numër i madh Sllovenësh shkuen n'Austri, Gjermani, Belgjikë dhe n'Amerikën Veriore e Jugore, dhe atje gjetën punë për të fitue.

Katundarët në Sllloveni për të gjitha fatkeqësít e veta ua hidhshin fajin marrëdhanjeve të reja t'ekonomís kapitaliste, dhe mbassi përfaqësuesat e asaj ekonomije ishin liberalët, katundarët u larguen prej grupit liberal dhe kaluen n'atê klerikal.

Kur në vjetin 1896 u krye reforma e votimeve dhe nji sasi katundarësh fituen të drejtën e votës, tash, ata, për politikanët, ishin shum mâ të randësishëm se përpara. Prandej u përforcue puna e tyne, dhe katundarët filluen me u marrë mâ aktivisht me politikë. Prej grupeve të vjetër politikë u krijuen dy parti borgjeze: Partija katolike nacjonale dhe Partija nacjonale popullore.

Partija nacjonale katolike, për fuqín e vet, duhet të falënderoji turmat katundare në Sllloveni, të cilat ishin nën ndikimin e klerit katolik. Këtê sukses ajo e mbërrijti edhe pse turmat katundare mbroheshin prej shfrytëzimit të borgjezís sllovene dhe asaj të huej. Në radhët e kishës katolike u futën katundarët, borgjezija e imtë, kleri dhe nji pjesë e intelektualëve. Programi i asaj Partije kërkonte që mbarë puna të drejtohet në frymën e katolicizmit, kurse udhëheqësija e saj kërkonte me u dhanë vendimet në favor të katundarëve. Në

bazë t'atyne ligjëve duheshin që katundarët të shlirohen prej huanave të vjetra dhe që të kufizohen huanat e reja, e veçanisht me u kufizue toka, që kështu të ruheshin kooperativat.

Për të joshë borgjezín e imtë, klerikët kërkuen që mjeshtrit, kallfët dhe shegertat t'organizohen n'organizatat klasash, të cilat do të mbrojshin komorat e zejtarëve dhe kooperativave. Klerikët u kujdesuen me joshë edhe klasën punëtore, prandej, mun për këtê qëllim futën në programin e tyne kërkesën që punëtorët të marrin mëditje mâ të mëdha dhe të shkurtohej koha e punës.

Nji prej themeluesave t'ideologjís klerikale dhe krijues i parimeve themelore të Partís katolike nacjonaliste ishte Mahniqi, profesor i seminarit në Goricë, e mâ vonë peshkop. Mahniqi dëshironte që prej Sllovenëve të nxjerrë luftarë aktivë të katoliçizmit, dhe që ndjenjat fetare te ata të jenë mbi ndjenjat nacjonale.

Partija klerikale ishte për Austrín, por në programin e vet kërkoi barazin e popujvet sllovenë me të gjithë popujt tjerë n'Austri. Me këtê mendohej në barazimin e gjuhës në shkollat dhe n'administratë.

Prej vjetit 1905, Partija nacjonale katolike thirrej Partija e njerëzve Sllovenë, dhe mbajti programin e vet të vjetër. Ajo mujti me u shtri edhe mâtej ndërmjet popullit dhe me u bâ partija mâ e madhe në Slloveni, me gjithë se për gjithë kohën ishte për politikën pushtuese austriake në Ballkan, e kundër interesavet të Sllovenëve. Gjatë kohës së pushtimit dhe aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës, si edhe gjatë kohës së Luftave Ballkanike, klerikalët ishin me Austrín, e kundër Sërbís dhe Malit të Zi.

Partija tjetër borgjeze në Slloveni ishte Partija nacjonale popullore. Mbështetja e saj kryesore ishin qytetet me intelektualët dhe borgjezín. Në katund partizanët e saj ishin pasanikët e katundeve, tregtarët dhe mësuesat.

Programi i kësaj partije ishte: për autonomi nacjonale, të drejtë votimi për të gjithë, dhe liri shtypi e shoqatash. Partizanët e partís përparimtare kërkojshin unjisimin e të gjitha

trevave sllovene. Ata luftuen kundër klerikalëve, por nuk dijtën me fitue turmat e gjana të popullit. Këjo pati pasoja të vështira për politikën e vetë Partís e poashtu edhe për mbarë popullin slloven. Prej frigës se mos klerikalët forcuen edhe mâ shum në katund, Partija përparimtare nacjonale, në fillim të shekullit të XX zhvilloi luftë kundër të drejtës së votës për të gjithë, kurse klerikalët e pranuen. Në këtê mënyrë Partija përparimtare ra në kundërshtim me programin e vet dhe punoi kundër interesavet të përgjithshëme të popullit. Mun për këtê arsye e humbi autoritetin në popull.

Gjendja e klasës punëtore, në fund të shekullit të XIX ishte shum e vështirë. Mëditjet ishin shum t'ulta, kurse koha e punës e gjatë. Prej vjetit të nandëdhetë të shekullit të XIX lëvizja punëtore u gjallnue mâ tepër dhe mori karakter revolucjonar. Ndërmjet punëtorëve u përhap ideologjija e demokracís socjale dhe përfshiu shumicën e punëtorëve industrialë.

Në vjetin 1896, në Lublanë u formue Partija socjal-demokrate e Sllovenis. Udhëheqësija e saj ra nën ndikimin e socjalistave Austriakë, të cilët ishin kundërshtarë të luftës në mënyrë revolucjonare. Kryetari i Partís socjaliste në Slloveni, Anton Kristani, i kushtoi mâ shum kujdes organizatave sindikale se sa atyne të partís. Mun për këtê e gjithë lëvizja punëtore në Slloveni mori nji qëndrim të gabuem të padurueshëm kundër anmikut të klasës. Mbas votimeve të vjetit 1897, në të cilat socjalistët fituen edhe 9 000 vota të katundarëve, Partija socjaliste mori qëndrim të padrejtë kundrejt katundarëve, tue vendosë që të mos punojë ndërmjet tyne.

Gabimi i madh i udhëheqësís së Partís socjal-demokrate ishte se ajo nuk u shkund prej ndikimit të Partís socjaliste austriake, përsa i përket çashtjes nacjonale. Ai ndikim u ndie mâ fort në çashtjen e bashkimit të Sllovenëve të Jugut në nji shtet të vetëm. Udhëheqësija e Partís socjal-demokrate kërkoi ruejtjen e Austro-Hungarís. Ky qëndrim i udhëheqësís u duk edhe në fillim të Luftës së parë botënore, kur ajo, politikën austriake nuk e çmoi si pushtuese, dhe këtê të drejtueme jo vetëm kundër Sërbís, por edhe për të pushtue Ballkanin dhe me dalë në Detin Egje.

Me gjithë qëndrimin e padrejtë t'udhëheqësís së Partís socjaliste, proletarjati i Sllovenís bani greva, si nji mënyrë lufte për gjendje mâ të mirë, dhe simpatizoi lëvizjet punëtore internacjonale.

Borgjezija sllovene, e veçanisht klerikët, përdorën të gjithë mjetet kundër lëvizjes punëtore, por nuk mujtën me pengue zhvillimin e saj historik.

Klerikët u munduen që në çdo mënyrë të ndalojnë zhvillimin e lëvizjes punëtore dhe të Partís socjal-demokrate. Ata i frigoheshin ndikimit të socjalistave në turmat katundare, prandej zhvilluen nji akcjon të madh për krijimin e kooperativave katundare. Kooperativat nuk formoheshin me qëllim për të ju ndihmue turmave katundare, por vetëm që katundarët të ndaheshin prej proletarjatit.

Kooperativizmi i këtillë i humbi veçorít e kooperativizmit bujqësuer dhe mori drejtimin e eksploatimit kapitalist. Kur në Slloveni u dukën shoqnít akcjonare, të cilave shteti u bani shum lehtësina, kooperativizmi hyni nën ndikimin e tyne. Prandej kooperativizmi nën udhëheqjen e klerikëve nuk ishte përparimtar, por i mbrapambetun.

Të dy partít politike borgjeze — ajo Klerikale dhe ajo Përparimtare — nuk mujtën me zgjidhë detyrat e randësishme në lidhje me nevojat e popullit. Prandej, rinija përparimtare studenteske u shkëput prej Partís përparimtare. Studentët sllovenë t'organizuem në Vjenë në shoqnin »Sllovenija« kërkuen të zhvillohet politika e lirís së mendimit dhe luftë e ashpër kundër klerikëve. Në krye të këtij grupi qëndrojshin Gregor Zherjovi, A. Krameri, A. Ribnikari etj. Këta politikanë të rij filluen me themelue organizata ekonomike-kooperativa. Ata ishin edhe për unjisimin e Sllovenëve të Jugut, jashtë suazës s'Austro-Hungarís.

Mun n'atê kohë, 1905—1907, ndikimi i klerikëve në popull ishte në kulmin e vet. Prandej liberalët e vjetër dhe rinija u bashkuen në nji parti të vetme. Kështu as ky grup të rijsh nuk mujti me i nda klerikët prej popullit.

Ngjarjet e mëdha politike-aneksimi i Bosnës dhe i Hercegovinës dhe Lufta ballkanike — tronditën situatën politike në

Slloveni. Klerikët ishin n'anën e Austrís. Borgjezija tjetër mbronte ideologjín jugosllave, por nuk u deklarue për t'u nda prej Austrís. Po nji qëndrim si ky, në lidhje me këtë çashtje, kishte edhe udhëheqësija e Partís socjal-demokrate. Për shkak të qëndrimit të tillë të grupeve të ndamë jugosllavë, klerikët mundën me mbajtë gjithënji mbas vehtes shumicën e popullit.

Gjendja e tillë ishte shkak që u krijue grupi i vogël i rinís nacjonaliste, i cili shprehte haptazi aspiratat për unjisimin e Sllovenëve të Jugut. Ky grup i vogël i Sllovenëve të rij, simbas aspiratave të veta, ishte shum mâ afër grupit »Bosnja e Ré«. Ai dëshironte që Austro-Hungarija të coptohej, që Sllovenët të shliroheshin nga sundimi austriak dhe të bashkoheshin me vllaznit e tyne Sërbë, Kroatë dhe me Sllavët tjerë të Jugut në nji shtet të përbashkët.

Kësisoj qëndrojshin marrëdhanjet e partive dhe të grupimeve politike në Slloveni në kohën kur filloi Lufta e parë botënore, e cila ndryshoi gjendjen e popullit Slloven.

# POPUJT JUGOSLLAVË NË PERIUDHËN E LUFTËS SË PARË BOTËNORE DHE TË REVOLUCJÓNEVE SOCJALISTE

## IMPERJALIZMI — STADJUMI MONOPOLIST I KAPITALIZMIT

### Imperjalizmi gjerman dhe politika e tij agresive për të fitue tregje të rij dhe për të ba ndamjen e re në botë. Krijimi i dy blloqeve anmiq të vendeve imperjalistë

Në verë të vjetit 1870 u zhvillue lufta ndërmjet Francës dhe Gjermanís, në të cilën fitoi armata gjermane. Pasojat e kësaj lufte ishin të randësishme. Në Francë qysh në Shtatuer po t'atij vjeti shpërtheu revolucjoni, kurse në Mars të vjetit 1871 punëtorët muerën qeverín në Pariz. Kështu u formue qeverija e parë e proletarjatit, e njoftun me emnin Komuna e Parizit. Në javët e fundit të muejit Maj po t'atij vjeti, kapitalistat, me ndihmën e ushtrís e rrëxuen atê qeveri të parë proletare. Komuna e Parizit ishte ngjarje me randësi të madhe për mbarë lëvizjen punëtore në botë.

Pasojat e luftës dhe fitimi i Gjermanís mbi Francën në vjetin 1870 qenë unjisimi i shteteve të vogjël gjermanë në nji shtet të madh. Atëhere Gjermanija, përposë Anglís, Rusís dhe Francës, u bâ fuqi e madhe europjane. Njikohësisht u bâ edhe unjisimi i Italís, e cila prej shum shteteve të vogjël të ndamë u bâ edhe ajo shtet i madh europjan. Përposë këtyne fuqive

të mëdha n'Europë, u krijuen edhe dy shtete tjerë: ShBA, n'Amerikë dhe Japonija n'Azi.

Deri në vjetin e shtatëdhetë të shekullit të XIX kapitalizmi u zhvillue dalëngadalë dhe ajo periudhë u quejtë periudha e zhvillimit të qetë t'ekonomís kapitaliste, me gjithë se për shum shekuj gjatë atij zhvillimi plasën lufta ndërmjet shteteve të ndryshëm, dhe revolucjone të mbrendëshëm. Prej vjetit 1871 marrëdhanjet n'ekonomín kapitaliste u ndryshuen, e me këtê edhe marrëdhanjet ndërmjet shteteve të mëdhej.

N'atê kohë kapitalistat shfrytëzuen zbulimet e shumta të reja si dhe zbulimet shkencore që u kryen në botë. Mbassi shpikësat nuk kishin mundësi materjale për të zbatue në praktikë zbulimet e veta, ato i blenë kapitalistat dhe me të hollat e tyne mundësuen zbatimin e tyne në praktikë n'industri dhe teknikë. Zbulimet mâ të randësishme ishin furrat e Simens-Martenit, për shkrimjen e çelikut, turbinat me avull n'Angli dhe në Zvicër, dizel motori dhe elektro motori, telefoni, dinamiti e shum të tjera.

Kur ato zbulime u zbatuen n'industri, atëhere filloi prodhimi me shumicë i mallnave të ndryshëm, të cilët ishin mâ të lirë se përpara. Por, ajo mënyrë e re e prodhimit kërkonte që në fabrikat e reja të futej nji kapital i madh. Shum kapitalista t'atëhershëm nuk kishin mundësi me ble maqina të reja për prodhim të tillë, mbassi ato ishin shum të shtrejta. Ato mundëshin me i ble vetëm kapitalistat e mëdhej, dhe në saje të kësaj dalëngadalë, ata asgjâsuen konkurentët e vet mâ të vogjël dhe blejshin sipërmarrjet e tyne të vogla. Në këtê mënyrë kapitalistat e mëdhej mbisunduen në prodhimin e mallit dhe industrija u përqëndrue në duert e nji numri të vogël pronarësh, pasunija e të cilëve shtohej vazhdimisht.

Kapitalistat mâ të mëdhej filluen me u marrë vesht për të ngritë çmimet e disa mallnave e kështu me u pasunue edhe mâ. Atyne nuk u kërcënohej kurrfarë rreziku prej konkurencës, mbassi për pak vjetë ata i mbytën prodhimet e vogla të mallnave dhe nuk i lanë të përparojnë. Me bashkimin e sipërmarrjeve kapitaliste u krijuen bashkësi me të njajtin çmim të mallnave të prodhuem. Ato shoqata u quejtën kartele. Ishte e

sigurtë se malli i tyne do të shitej, mbassi nuk mund t'u konkurojshin prodhuesat e të njajtit mall që nuk kishin hy në kartel. Forma mâ e naltë e shoqatave kapitaliste në vendet e zhvilluem industrialë qiti krye në fillim të shekullit të XX. Ky ishte monopoli, ku muerën pjesë kapitalistat mâ të pasun. Ata blenë xeherore, pusa nafte dhe begati tjera të ndryshme natyrore, kështu që disponojshin shumicën e landëve të para. Ato landë i përpunojshin në fabrikat e tyne të mëdha dhe prodhojshin pjesë veglash të ndryshme preçize. Ata u banë zotnuesat e çelikut, gomës, aluminit, naftës, thëngjillit, celulozës dhe landëvet tjera të nevojshëme, dhe prej tyne prodhojshin topa të gatshëm, pushkë mitraloza, automobila, aeroplana, anije, traktorë etj.

N'atê mënyrë kapitalistat e mëdhej i siguruen vehtes t'ardhuna të mëdha si dhe mundësín me ndikue në ngjarjet politike në disa shtete dhe në mbarë botën. Shtetet ishin të detyruem me marrë huana prej monopolit, në bankat e tyne, mbassi të hollat u nevojiteshin për të plotësue nevojat e ndryshme shtetnore. Ata ishin të detyruem që prej kapitalistave monopolistë të blejnë armë, të cilat bâheshin gjithënji mâ të përsosuna dhe mâ të shtrejta. Shpeshherë prej monopolit mvarej në se shtetet e ndryshëm do të mujshin me realizue armatimin e vet apo jo.

Me zhvillimin e monopolit humbën veçorít e përparshëme të kapitalizmit dhe u krijuen të reja. Prandej qysh prej fillimit të shekullit të XX, kur kapitalizmi mbërrijti kulmin e vet, filloi me u quejtë monopolist. Ajo kohë quhet imperializëm, dhe jo si deri atëherë kapitalizëm.

Gjermanija u bâ shtet i madh europjan mbas fitores në luftat e vjetit 1866 kundër Austrís, dhe asaj të vjetit 1870—1871 kundër Francës. Unjisimi i Perandorís gjermane u krye me ndihmën e ushtrís prusjane dhe politikës s'aftë të kancelarit Bizmark. Francezët e munduh duhej me i pague Gjermanís n'emën të dameve të luftës pesë miljard franga ari dhe me i lëshue dy treva mjaft të pasuna, Elzasin dhe Lorenën. Për shkak të këtyne fitoreve muer zemër shteti gjerman e poashtu edhe borgjezija e tij.

Mbassi Gjermanija mâ vonë u bâ fuqi e madhe n'Europë, ajo nuk kishte mundësi që në periudhën e përparshëme të zhvillimit të qetë të kapitalizmit të përvehtësonte koloni. Kolonít i ndanë ata shtete, të cilët ishin bâ fuqi të mëdha qysh mâ përpara, si Anglija, Franca dhe Rusija. Prandej kah fundi i shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit të XX Gjermanija u bâ agresive, mbassi nuk kishte mundësi me marrë koloni në ndonji mënyrë tjetër, përveç se me luftë. Kapitalistat dhe qeveritarët e saj u përpoqën që nëpërmjet t'agresjonit të pushtojshin koloni, prej kah me marrë landë të para për industrín e tyne.

Industrija gjermane, e cila deri në vjetin 1870, kishte mbetë shum mbrapa prej asaj angleze, mujti që, deri në fund të shekullit të XIX ta kalojë atê. Ajo zuni vendin e dytë në botë, menjiherë mbas industrís së Shteteve të Bashkueme t'Amerikës.

Kapitali gjerman, poashtu si edhe ai englez, amerikan dhe francez, bashkoi bankat dhe industrín. Me atê bashkim u krijue kapitali financjar. Këjo formë e re kërkonte gjithnji e mâ shum landë të para për përpunim, mbassi nuk mjaftojshin mâ ato sasi që mund të marreshin në vendin e tyne. Mbassi Gjermanís i mungojshin shum lloj landësh të para, ajo ishte e shtrëngueme me kërkue rrugë-dalje prej asaj gjendje të vështirë. Tue bâ presjon ajo muer disa koloni n'Afrikë — Afrikën Perëndimore dhe Lindore gjermane. Ndërsa, kërkesat e monopolit kapitalist gjerman nuk u kënaqën në këtê, por, tue vazhdue me bâ presjon, kërkojshin edhe Marokun, n'Afrikë.

Kur fuqit e mëdha europjane panë se kërkesat gjermane shtoheshin gjithënji, ato nuk deshtën me kënaqë mâ dëshirat gjermane. Kapitalistat gjermanë, tue llogaritë se ishin mjaft të fortë dhe se mund të mbështeteshin n'ushtrín gjermane, parashtruen çashtjen e ndamjes së re të botës. Simbas pikëpamjeve të tyne, ndamja e vjetër e botës nuk ishte e drejtë. Kundër kësaj kërkese gjermane për ndamjen e re të botës qëndrojshin ato fuqi të mëdha, të cilat kishin rrëmbye qysh mâ përpara koloni të mëdha, dhe mbrojshin ndamjen e vjetër si çashtje të drejtë. Për shkak të këtyne pikëpamjeve të kun-

dërta në ndamjen e botës, d. m. th. kryesisht në ndamjen e tokave koloniale, pa tjetër do të përpiqeshin fuqít e vjetra dhe të reja imperialiste. Kapitalistat e fuqive të mëdha ndikuen në politikën e shteteve të tyne tue e drejtue kah realizimi i interesave të tyne. Në këtê drejtim nisi me punue në fillim i pari burr shteti gjerman Bizmarku, tue u përpjekë me realizue lidhjen e atyne fuqive europjane që nuk kishin koloni. Tue shfrytëzue kundërshtimet e mëdha ndërmjet Anglís e Rusís dhe Austro-Hungarís e Rusís, në Kongresin e Berlinit Bizmarku filloi politikën e tij për të bâ për vehte Austro-Hungarín dhe Italín. Ai e dinte se Anglija dhe Rusija nuk do të mund të merreshin vesht për nji kohë të gjatë, mbassi interesat e tyne ishin përpjekë n'Azín Qëndrore. Këtu mund të fillonte përpjekja e këtyne dy grabitsave tokash të hueja. Poashtu, shfrytëzoi edhe kundërshtimet ndërmjet Rusís dhe Austro-Hungarís në Ballkan, ku Rusija ndikonte shum në popujt jugosllovenë, kurse Austro-Hungarija dëshironte me përvehtësue krejt gadishullin.

Në nji situatë të tillë Bizmarkut i shkoi përdore që në vjetin 1879 të krijojë lidhjen ndërmjet Gjermanís dhe Austro-Hungarís, e në vjetin 1882 ta shtrijë edhe me Italín. Italija ishte e pakënaqun që Franca shpejtoi dhe zgjanoi kolonít e veta tue marrë Tunizin. Lidhja e Gjermanís, Austro-Hungarís dhe Italís u quejtë Lidhja e të Treve. Ai ishte blloku i parë i vendeve imperjalistë drejtue kundër fuqivet tjera imperjaliste. Ky bllok kishte për qëllim me pushtue toka të hueja dhe me i shndërrue në pasuni të veta kolonijale.

Grupi i shteteve të mëdhej rreth Gjermanís, në fillim ishte i drejtuem kundër Francës dhe Rusís e mâ vonë edhe kundër Anglís. Franca, të cilës Gjermanija i kanosej qysh mâ përpara, ishte e detyrueme me kërkue aleatë që ishin në të njajtën gjendje si edhe ajo. Ajo ishte Ruija. Asaj i kanosej Gjermanija dhe Austro-Hungarija, mbassi me ata kishte nji vijë të madhe kufitare. Kështu Franca filloi me iu afrue Rusís; këtê e pengojshin Gjermanija dhe Anglija, secila për interesat e veta të posaçma. Gjermanija kishte frigë prej lidhjes francezo-ruse,

mbassi n'atê rast do të gjindej ndërmjet dy anmiqsh, e këjo don të thoshte me luftue në dy fronte. Nga ana tjetër, Anglija nuk kishte sqarue marrëdhanjet me Francën n'Afrikë (përsa i përkitte ndikimit n'Egjyptë dhe Sudan), kurse me Rusín n'Azín Qendrore.

Me gjithë këto pengesa, burrat e shtetit të Francës dhe Rusís mujtën që në vjetin 1893 të nënshkruejnë aleancën ndërmjet vendeve të veta. Këjo aleancë ishte fillimi i krijimit të bllokut tjetër të shteteve të mëdhej, që kish për detyrë me ruejtë kolonít e fitueme qysh mâ parë. Dy blloqe të krijuem në këtê mënyrë, ndërmjet tyne anmiq, banë ndamjen në dy tabore ushtarake, të cilët mund të përpiqeshin në çdo moment e kështu me provokue nji luftë të madhe.

N'atê kohë Anglija nuk dëshironte me kalue n'asnji anë. Ajo u përpoq me shfrytëzue mosmarrëveshtjet që egzistojshin ndërmjet këtyne dy blloqeve. Kur në vjetin 1896 në zemër t'Afrikës, te vendi i vogël Fashode, në Sudan, me ndihmën e ustrís detyroi Francën me lëshue pe dhe mori përfundimisht Egjyptin, Sudanin dhe krejt Jugun e Afrikës, Anglija e ndryshoi qëndrimin e vet. Atëhere Franca ra nën mvarrësín e Anglís dhe nuk kishte mâ mundësi me luftue kundër saj. Prej vjetit 1898, Anglija filloi me e ndi vehten gjithënji mâ të kërcënueme prej Gjermanís, mbbasi n'atê vjet ajo filloi me ndërtue marinë të madhe moderne. Kur kapitalistat englezë, ndien konkurencën e mallit gjerman në gjithë tregjet e jashtëm dëshirojshin me nënshkrue aleancë me Francën për të mbrojtë interesat e përbashkëta.

Imperjalizmi gjermàn delte gjithënji e mâ ashpër me kërkesat e veta për ndamjen e re të botës. Anglija nuk guxonte me pritë mâ, por filloi me bisedue me Francën për nënshkrimin e aleancës. Rezultati i bisedimeve ishte nënshkrimi i aleancës anglo-franceze në vjetin 1904, që u quejtë Antanta. Me këtê marrëveshtje Franca i njohti Anglís sudimin n'Egjypt dhe Sudan, kurse Anglija pranoi që Franca të marrë Marokun. Kështu u muerën vesht në llogari të huej këta dy shtete të vjetër imperjalistë.

Këjo marrëveshtje e Anglís dhe e Francës provokoi sulme edhe mâ t'ashpëra t'imperializmit gjerman, i cili filloi të kanosej me luftë dhe të shpejtësojë armatimin e vet.

Aleanca ndërmjet Francës dhe Rusís përforcohej gjithënji mâ shum, mbassi kapitalistat francezë i jepshin huana Rusís për armatimin e saj dhe për krijimin e marinës së re. Ndërkohë edhe Anglija ndryshoi qëndrimin e vet ndaj Rusís atëhere kur këjo humbi luftën me Japonín dhe u bâ e parrezikshëme për koloni angleze n'Azi. N'atê gjendje të rikrijueme në vjetin 1907 u nënshkrue marrëveshtja ndërmjet Rusís dhe Anglís. Edhe këjo marrëveshtje anglo-ruse u lidh në kurriz të huej, mbassi Rusija u nda në dy sfera ndikimi — pjesa veriore mbeti nën ndikimin e Rusís e ajo jugore nën atê t'Anglís, kurse Avganistani ra nën sundimin e Anglís si protektorat.

Me këtê marrëveshtje anglo-ruse mâ në fund, në vjetin 1907, u krijue blloku tjetër i fuqive të mëdha, që përbâhej prej Anglís, Francës dhe Rusís. Ky bllok u quejtë Marrëveshtja e të Treve, ose Antanta. Me formimin e Antantës u shtue edhe rivaliteti ndërmjet Anglís dhe Gjermanís në det dhe n'armatim mâ të madh të të dy anëve. Garat n'armatim, për të cilin u shpenzuen shuma të mëdha të hollash, ngjallën mosmarrëveshtje gjithënji mâ t'ashpra në botë, e prandej besohej gjithënji mâ shum në konfliktin e shpejtë me armë.

Dukej sikur lufta do të pëlciste për shkak t'aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës në vjetin 1908, por ajo gjâ nuk ndodhi. Poashtu pritej që lufta të fillonte në vjetin 1911, në lidhje me çashtjen e Marokut, por edhe ai rrezik u kalue mirë. Gjatë kohës së Luftave ballkanike poashtu u kërcënue rreziku i konfliktit të përgjithëshëm, por lufta as atëhere nuk shpërtheu. Të gjitha ato ngjarje nuk i joshën në luftë fuqít e mëdha, mbassi ato nuk ishin përgatitë me armatime. Të gjithë ishin të ndërdijshëm se ajo luftë do t'ishte luftë e përgjithshëme botënore, e cila të futte në luftë, shum popuj të botës mbarë.

### Lufta e parë botënore

Lufta e madhe botënore filloi në vjetin 1914; monarkija Austro-Hungareze si shkak për luftë shfrytëzoi atentatin në

Sarajevë që u bâ kundër trashëgimtarit të fronit, Frano Ferdinandin. Dy anëtarë t'organizatës »Bosnja e Ré«, Velko Çabrinoviqi dhe Gavrilo Principi, me datën 28 Qershuer të vjetit 1914 banë atentat kundër Frano Ferdinandit në rrugën kryesore të Sarajevës. Bomba e Çabrinoviqit nuk mujti me vra anmikun mâ të madh t'unjisimit të Sllovenëve të Jugut, por plumbat prej revolverit të Principit ia muerën shpirtin këtij shefi të grupit ushtarak t'Austro-Hungarís.

E mbështetun në Gjermanín, monarikija Austro-Hungareze e mori ngjarjen e Sarajevës si shkak për të paditë Sërbín zyrëtare dhe qeverin e saj për vrasjen e trashëgimtarit të fronit. Perandori gjerman Vilhelmi i II, me qëverín e vet vendosi me i ndihmue plotësisht Austro-Hungarís. Të dy shtetet menduen se ai ishte moment i përshtatshëm për të realizue qëllimet pushtuese.

Austro-Hungarija i dha Sërbís ultimatum, kushtet e të cilit nuk mund t'i pranonte asnji shtet suveren. Me gjithë se Sërbija u mundue për me iu largue luftës, anmiqt e saj nuk ishin të kënaqun prej përgjigjes, kështu që me 28 Korrik i shpallën luftë. Prej asaj dite ngjarjet të çojshin me shpejtësi në luftën botënore, mbassi Rusija dhe Franca mbrojshin interesat e Sërbís, kurse Gjermanija dëshironte me ndezë luftën botënore.

Mbassi Gjermanija kujtonte se Anglija nuk do të futej në luftë për shkak të Sërbís, Rusís dhe Francës, ajo i shpalli luftë Rusís me 1 Gusht, kurse Francës dy ditë mâ vonë. Natën ndërmjet datës 3 dhe 4 Gusht ushtrija gjermane kaloi kufijt e Balgjikës neutrale, që kështu nëpërmjet të teritorit të saj të futet në Francë. Anglija mori si shkak lufte cenimin e neutralitetit të Belgjikës, dhe më 4 Gusht i shpalli luftë Gjermanís.

Kështu kundërshtimet imperjaliste çuen në Luftën e parë botënore, e cila përgatitej kaherë. Menjiherë në fillim të luftës n'Europë u krijuen dy fronte — ai Linduer dhe ai Perëndimuer. Gjermanija, si agresori mâ i madh, ra në pozitë me luftue ne dy fronte, në Perëndim kundër Francës, Anglis dhe Belgjikës, kurse në Lindje kundër Rusís. Në fillim Austrija

kishte front vetëm në Ballkan — kundër Sërbís dhe Malit të Zi dhe në Lindje — kundër Rusis.

Në Gusht të vjetit 1914 hyni në luftë edhe Japonija për të marrë kolonít gjermane n'Azi dhe për të forcue pozitat e veta në Kinë. Japonija muer pjesë n'anën e Antantës. Në Tetuer të vjetit 1914 Turqija u fut në luftë kundër Rusís, dhe në këtê mënyrë si aleate e Gjermanís i hapi Rusís frontin e dytë. Kështu prej Europê lufta kaloi n'Azi.

Lufta kaloi edhe n'Afrikë, mbassi Anglezët dhe Francezët u përpoqën me pushtue shpejt kolonít gjermane.

Lufta e parë botënore, për të gjithë shtetet, me përjashtim të Sërbís dhe Malit të Zi, kishte karakter imperjalist, mbassi nji grup shtetesh luftonte për të pushtue koloni të reja dhe të robnojnë popuj, kurse grupi tjetër luftonte për të ruejtë kolonít dhe sundimin e vet mbi popujt e robnuem. Por sidoqoftë, në luftë nuk do t'ishin futë të gjithë shtetet, në qoftë se nuk do t'i kishte sulmue Gjermanija. Sërbija dhe Mali i Zi nga ana tjetër, zhvilluen luftë mbrojtëse për të mos u robnue.

Luftat mâ të mëdha u zhvilluen në frontin perëndimuer mbassi Gjermanët kishin plan të gatshëm për atê front. Atê e përpiloi qysh në vjetin 1905 gjenerali Fon Shlifen, kurse në vjetin 1909 e plotësoi gjenerali Moltke. Ai âsht plani i famshëm i Shlifenit, i cili ishte përpilue n'atê mënyrë për të luftue në dy fronte; së pari duhej që me luftë të rrufeshme të mundej Franca, e mandej krejt ushtrija të drejtohej kundër Rusís. Tue veprue simbas atij plani, ushtrít gjermane shum shpejt pushtuen Belgjikën dhe nëpërmjet të kufinit të saj u futën në Francë. Ushtrija franceze nën komandën e Gjeneral Zhorfit, e humbi betejën në kufinin e Belgjikës dhe u detyrue me u tërheqë në drejtim të Parizit. Kryeqyteti i republikës franceze ishte i kërcënuem, por situata u ndryshue në betejën e madhe në Marne; me 5 Shtatuer. Këtu Gjermanët u ndalën dhe u detyruen me u tërheqë. Beteja në Marne shkatërroi planin gjerman të luftës së rrufeshme. Prej asaj kohe lufta u shndërrue në luftë pozitash.

Njikohësisht u zhvilluen lufta të mëdha në Frontin e lindjes, ku trupat ruse në Gusht depërtuen në Prusín lindore.

Ushtrija gjermane nën komandën e gjeneral Hindenburgut dhe Lindendorfit mujti me ndalue depërtimin rus, dhe në Liqejt Mazure të korrë fitoren mbi armatën e gjeneral Samsonit.

Trupat ruse patën suksese në luftat kundër ushtrís austro-hungareze, armata nën komandën e gjeneral Brusilovit pushtoi Galicín dhe Bukovinën.

Anglija, tue e ndie se Gjermanët u përgatitën për luftë, u përpoq qysh mâ përpara që me çdo mënyrë të ndajë Italín prej Gjermanís dhe me e bâ për anën e Antantës. Në fillim të luftës Italija u shpall e paanshëme, që desht me thanë se nuk ishte aleat i sigurtë i Gjermanís dhe Austro-Hungarís. Në të vërtetë Italija përçmonte si njanën ashtu edhe tjetrën anë dhe shiqonte se prej të cilës do të fitonte mâ shum. Kështu prej Antantës kërkoi me iu garantue krahinat në bregun linduer t'Adriatikut; kur Antanta ia pranoi kërkesat, nënshkroi Paktin e Londrës në vjetin 1915 dhe u fut në luftë kaundër Austro-Hungarís, kështu që asaj iu hap edhe nji front i ri.

Në fillim të luftës Rumanija u shpall neutrale, por që të dy anët kundërshtare u përpoqën me e bâ për vehte. Arsyet për me e bâ Rumanín për vehte ishin pusat e saj të pasuna të naftës. Antanta i premtoi mâ shum, kështu që qeverija rumune në vjetin 1916 u deklarue për atê dhe i shpalli luftë Gjemanís dhe Austro-Hungarís. Mbassi ushtrís gjermane i mungonte benzini, puset vojgurore të Rumanís ishin shkak që kundër Rumanís u vërsul fuqija e madhe gjermane dhe austro-hungareze dhe e shkelën mbas nji kohe shum të shkurtë.

Bullgarija kishte pakt të mëshehtë me Gjermanín dhe Austro-Hungarin, dhe prej tyne mori premtimin se do të zgjanojë kufijt e vet në llogari të Sërbís. Kur Gjermanija e dau që të lidhet drejtpërdrejt me Turqín, vendosi me asgjâsue Sërbín si anmik lufte. Prandej Bullgarija, në vjetin 1915 u fut në luftë kundër Sërbís.

Anglija u përpoq që Turqija të bâhej e paaftë për vazhdimin e mâtejshëm të luftës dhe të pamundësohej lidhja e saj me Gjermanín. Prandej në vjetin 1915 u krijue ekspedicjoni i Dardaneleve, që përbâhej prej flotës anglo-franceze, e cila

kishte për detyrë me pushtue ngushticën. Këjo ekspeditë nuk mujti me ia mbërrijtë qëllimit, mbassi Dardanelet ishin të fortifikueme dhe të mbrojtuna mirë.

Njikohësisht, prej verës së vjetit 1915, ushtrija ruse zhvilloi lufta të mëdha kundër ushtrís austro-hungareze dhe korri fitore të randësishme te Pshemisla.

Në vjetin 1916 u zhvilluen lufta të mëdha në frontin e Perëndimit, së parí luftat u zhvilluen për kështjellën e Verdunit, të cilën Gjermanët deshtën me e pushtue me çdo mënyrë. Prej muejit Fruer e deri në Dhetuer atje u zhvillue luftë e përgjakshëme dhe e madhe, ku u vranë rreth 700 000 luftarë. Mâ në fund Gjermanët pësuen humbje, kurse ushtrija franceze shënoi nji prej fitoreve të saj mâ të randësishme. Beteja tjetër mâ e përgjakshëme u zhvillue më lumin Soma. N'atê betejë në të dy anët gjindeshin 1 200 000 luftarë. Gjermanët nuk mujtën me e fitue as këtê betejë, mbassi forcat ishin të barabarta.

Po n'atê vjet armata ruse nën komandën e gjeneral Brusilit zhvilloi me sukses ofensivën kundër ushtrís austro-hungareze dhe mbërrijti deri te lugu i Karpatëve. Ofansiva u ndal me përpjekjet e përbashkëta t'ushtrís gjermane dhe asaj austro-hungareze.

Kur në vjetin 1917 në Rusi plasi Revolucjoni borgjez demokratik i Fruerit dhe u formue qeverija e përkohshëme, situata në front u ndryshue. Prej asaj kohe ushtrija ruse nuk bante mâ mësyemje sulmuese, por bani tërheqje mbrojtëse deri në mbarim të luftës.

Në Frontin perëndimuer të dy anët zhvilluen lufta për ta lodhë anmikun dhe bâjshin përgatitje për ngjarje vendimtare në vjetin 1918. Në pranverë t'atij vjeti armatat gjermane filluen ofensivën e madhe të Marsit, me qëllim për të sigurue fitoren përpara se armatat amerikane t'u vijshin në ndihëm aleatëve. Fuqit franceze dhe angleze e përballuen këtê ofensivë, si edhe ofensivën e ardhëshme, në Korrik po t'atij vjeti. N'atê kohë vazhdimisht mbërrijshin fuqít amerikane, sepse edhe SHBA i shpallën luftë Gjermanís, mbassi si piratë mbytën anijet amerikane pa pasë kujdes se të kujt ishin.

Kur trupat amerikane zbarkuen dhe u forcuen fuqít e Antantës, atëhere u formue komanda e përbashkët në krye me gjeneralin Foshe. Më tetë Gusht filloi ofensiva ngadhnjimtare. Njikohësisht aleatët në të gjithë frontet bâjshin ofensiva sulmuese, kështu që Gjermanët nuk mund të kalojshin trupat e tyne në front tjetër, sikurse kishin veprue përpara dhe n'atê mënyrë të shpëtojnë situatën e vet.

Aty ku aleatët e Gjermanís ishin mâ të dobët, u bâ edhe kapitullimi i parë. Me 15 Shtatuer filloi ofensiva në frontin e Selanikut dhe Bullgarija u detyrue të kapitullojë. Prej këtij kapitullimi Austro-Hungarija ra në pozitë shum të vështirë.

Anglezët me trupat e formuem n'Azín Perëndimore i mundën Turqit dhe pushtuen Palestinën, Sirín dhe Mesopotamin. Kah fundi i Tetorit kapitulloi edhe Turqija.

Në mbrapavijat e frontit t'Austro-Hungarís filluen çrregullimet, mbassi popujt e robnuem memzi pritshin me u shlirue prej sundimit të Vjenës. Çekët, Sërbët, Kroatët, Sllovenët, Hungarezët dhe Rumunët nuk u bindeshin mâ komandantëve ushtarakë dhe shkuen nëpër shtëpijat e veta. Monarkija Habzburge, e cila me qinda vjetë sundoi tue mbjellë urrejtjen ndërmjet popujve të ndryshëm dhe feve, tash u shkatërrue. Kur më 24 Tetuer filloi ofensiva aleate në frontin italjan, ushtrija austriake filloi me ikë nga fronti, dhe ushtarët nuk deshtën me luftue mâ. Deri me 3 Dhetuer u korr fitorja përfundimtare e aleatëve, dhe atê ditë u nënshkrue armëpushimi.

Po të njajtat ngjarje ndodhën edhe në mbrapavijat gjermane. Shum ushtarë u bashkuen me turmat punëtore dhe katundare të pakënaquna, të cilat ishin shkri prej ushqimit të keq dhe prej punës së vështirë gjatë vjetëve të luftës. Nën ndikimin e Revolucjonit të Tetorit, në Gjermani filloi lëvizja revolucjonare. Të gjithë e ndijshin se lufta për Gjermanín âsht e humbun dhe gjeneralët vetëm përpiqeshin të pengojnë që me rastin e kapitullimit të mos fillojë revolucjoni. Kur me 9 Nanduer në Berlin u proklamue republika dhe kur perandori Vilhelm i II iku, Lundendorfi filloi aksjonin. Ai qysh mâ përpara, bashkë me Hindenburgun, kërkoi dalje të përshtatshëme prej gjendjes së vështirë, në të cilën gjindej klasa sun-

duese gjermane. Që të dy kërkuen prej kryetarit të qeverís së ShBA, Vilsonit nj'asi armëpushimi, që do ta çonte Gjermanín në kapitullim pa kushte. Që të dy janë orvatë të shfrytëzojnë proklamatën prej 14 pikash, që shpalli atëhere Vilsoni.

Porse, me gjithë atê Gjermanët u detyruen me kapitulue plotësisht dhe me nënshkrue armëpushimin, kushtet e së cilës i diktoi gjenerali Fosh në vagonin e trenit në pyllin Kompjesko me 11 Nanduer të vjetit 1918. Simbas atij armëpushimi, Gjermanija duhej t'i dorëzonte aleatëve pjesën mâ të madhe t'armatimeve të veta dhe shum anije, nëndetëse dhe aeroplana. Por pjesa mâ e madhe e kushteve nuk u plotësue kurrë.

Lufta e parë botënore asgjâsoi miliona njerëz. Pasoja e asaj lufte ishte 10 000 000 të vdekun, 3 500 000 invalidë dhe 19 000 000 të plogosun.

Dami materjal i shkaktuem prej asgjâsimit të fryteve të mbërrijtuna deri atëhere në lamín kulturore nuk mund të zêvendësohet kurrë e as që ishte e mundun me u çmue me të holla.

Si pasojë e Luftës së parë botënore filloi krijimi i shteteve të rij të pamvarun dhe shlirimi nacjonal i disa popujve n'Europë.

Mâ në fund në vjetin 1919, u nënshrue paqa në V e r s a j ku në shum çashtje vendosshin përfaqësuesat e shteteve të mëdhej aleatë: SHBA, Anglis, Feancës, Italís dhe Japonís. Përfaqësuesat e shteteve të vogjël, me gjithë se gjatë luftës ishin aleatë, ishin të detyruem me pranue vendimin e gatshëm të shteteve të mëdhej.

Paqa e Versajit përforcoi kushtet e armëpushimit të vjetit 1918, krijimin e shteteve të rij nacjonalë n'Europë dhe ndryshimin e kufijve të disa shteteve. N'atê paqe u bâ dhe ndamja përfundimtare e kolonive gjermane si dhe e sferave të ndikimit të shteteve të mëdhej.

Popujt e botës, të cilët dhanë viktima të shumta gjatë kësaj lufte, pritshin nji paqë dhe liri për nji kohë të gjatë. Por me paqën e Versajit nuk u krijuen kushtet për jetë të qetë të popujve. Kundërshtimet ndërmjet të të mundunve dhe ngadh-

njyesave u shtuen edhe mâ, dhe dalëngadalë u krijuen mundësi mâ të mëdha për të shkaktue konflikt të ri.

## REVOLUCJONI I TETORIT

Jeta e katundarëve dhe punëtorëve në Rusín cariste ishte shum e vështirë dhe gadi e padurueshme gjatë Luftës së parë botnore. Ushtari rus kallxoi në luftë patriotizëm të madh, mirëpo afshi luftarak i tij vinte tue ra, sepse klasa sunduese dhe komanda eprore i linte ushtarët pa municjon dhe pa materjal tjetër luftarak. Qeverimi i keq i pushtetit obsolut carist u shfaq mâ së forti gjatë luftës. Prandej filloi pakënaqësija e madhe e shumicës së popullit-punëtorëve, katundarëve e borgjezís.

Kjo pakënaqësi u shfaq dimnit në vjetin 1916/17 kur Moska dhe Petrogradi mbetën pa gjana ushqimore e populli filloi të vuejë unit. Përfundimi i njij gjendjeje të këtillë ishte Revolucjoni i Frorit. Ai filloi me grevën e 9 Kallnorit të vjetit 1917, e cila u shndërrue në grevën e përgjithshëme të punëtorëve të Petrogradit. Parollat e greys ishin: »Poshtë lufta! Poshtë cari! Na jepni bukë!« Qysh me 26 fruer këjo grevë u shndërrue në revolucjon, sepse me punëtorët u bashkuen edhe ushtarët.

Fryti mâ i madh i Revolucjonit të Frorit ka qenë-krijimi i Sovjetëve të deputatëvet të punëtorëvet e t'ushtarëvet. Në ta mbështetej revolucjoni, i cili qitte flakë edhe nën sundimin e borgjezís së rikrijueme të qeverís së përkohshëme.

Revolucjoni i Frorit rrëxoi car Nikollën e II, por borgjezija e madhe mbërrijti me e rrëmbye pushtetin me ndihmën e socjalistave-revolucjonarëve (eserëve) dhe të socjalistave të djathtë (menjshevikëve).

Në fillim Sovjetët e deputatëve të punëtorëvet dhe t'ushtarëvet kanë lejue qëndrimin e menjshevikëvet dhe t'eserëvet. Mirëpo, mbassi qeverija e përkohshëme nuk e kishte pushue luftën, që e kërkojshin turmat e gjana popullore, e gjithashtu nuk zgjidhi furnizimin e qytetevet me ushqim e as që ndërroi pozitën e katundarëve, ajo qeveri humbi prestigjin te punëtorët, katundarët e te nji pjesë e madhe e inteligjencës.

Qeverija e Revolucjonit të Frorit dha amnesti të përgjithshëme për të dënuemit politikë, prandej u këthyen nga internimi e ndjekja antarët e shumtë të Partís socjal-demokrate ruse-bolshevikët. Shum komunistë duelën prej ilegalitetit e filluen menjiherë të zhvillojnë veprimtarín politike publike. Në nji situatë të tillë revolucjonare ndihej mungesa e Vlladimir Iliq-Leninit. Prandej, ai u këthye në Rusí në Prill të vjetit 1917 prej së jashtëmi. Menjiherë mbas ardhjes n'atdhé Lenini ka hartue tezat e përmenduna të prillit në të cilat jepte plan me vend, se si revolucjoni borgjezo-demokratik të këthehet në revolucjon socjalist, kurse republika popullore të kalojë në republikën e sovjetëve.

Në Sovjetët shumicën e kishin menjshevikët e eserët, prandej duhej me u spjegue punëtorëve, ushtarëve e katundarëve të vorfën se këta po e ndihmojshin borgjezin, e cila dëshironte me e vazhdue luftën e toka të mbetej në duer të pronarëve të tokave. Turmat e popullit bashkoheshin dalëkadalë me bolshevikët e demonstratat e Petrogradit me 1 korrik të vjetit 1917, në të cilat merrshin pjesë 400.000 njerëz, tashmâ ishin nën ndikimin e Partís bolshevike.

Për këto ngjarje qeverija e përkohshëme filloi me i ndjekë komunistat, për shka Lenini shkoi përsëri n'ilegalitet. Qysh prej kësaj kohe bâhen përgatitje për kryengritje t'armatosun e përmbysjen e qeveris së përkohshëme me anë të revolucjonit. Rrëximin e qeverís borgjeze duhej ta kryjshin në lindhje punëtorët e katundarët e vorfën. Për arsye se spahijt e borgjezija e kishin ndihmue përbetimin (komplotin) e gjeneral Kornillovit që të marrë me ushtri Petrogradin, situata u ndërrue në dobi të komunistavet. Kornillovi qe kapë e ndikimi i komunistave qysh atëherë filloi të forcohet shpejt n'organizatën e Sovjetëve të deputatëve të punëtorëvet dhe t'ushtarëvet. Në zgjedhjet lokale për Sovjetët ngadhnjyen komunistat në Petrograd, Moskë e në vende tjera. Kështu komunistët fituen besimin e shumicës së popullit, prandej vendosën ta marrin pushtetin me anën e kryengritjes s'armatosun.

Kur u këthye Lenini prej ilegalitetit në Petrograd, u mbajt mbledhja e KQ të Partís. Në këtê mbledhje u vendos që në

ditët e ardhshëme të bâhet kryengritja. Gjithashtu u caktuen njerëzit, që do t'udhëheqin kryengritjen në krahina e qytete të nryshme.

Lenini muer udhëheqësin e drejtpërdrejtë të kryengritjes e me 7 nanduer (25 tetuer simbas kalendarit të vjetër), filloi Revolucjoni i madh socjalist i Tetorit.

Garda e kuqe e njisít tjera revolucjonare muerrën stacjonet hekurudhore, postën, telefonin dhe telegrafin, bankën shtetnore, ministrit e ndërtesat tjera në Petrograd. Marina luftarake e Kronshtatit ishte fuqija e madhe e Revolucjonit të Tetorit. Kryqëzorja »Aurora« shpalli me topat e vet të mëdhej epokën e ré-epokën e revolucjonit socjalist dhe rrëximin e sundimit kapitalist.

Qeverija e përkohshëme, mëshefë në Pallatin dimnuer, u thye dhe anëtarët e saj, përveç Kerjenskit, që mbërrijti me ikë, u burgosën.

Po atë ditë, me 7 nanduer, u hap Kongresi i dytë federativ i Sovjetëvet. Kongresi pruni dy dekrete me randësi. Dekreti i parë mbi paqën kërkonte premjen e luftës dhe mbylljen e paqës pa pague damshpërblimet e kontributet e luftës. Dekreti i dytë parashifte që krejt toka e spahijve, carit dhe monastireve të kalonte falas në duert e mbarë popullit. Katundarët u shliruen prej pagimit të përparshëm të qiras spahijvet. Gjithashtu pasunit xeherore: thëngjilli, hekuri, argjenti e xehet tjera, si edhe pyjet e ujnat kaluen në pronë të popullit.

N'atê mbledhje të Kongresit të sovjetëve âsht formue qeverija e parë-Sovjeti i komesarëve popullorë, kryetari i të cilit qe Lenini.

Revolucjoni u përhap shpejt prej Petrogradit në të gjithë drejtimet e vendit dhe korrte gjithëkund ngadhnjim mbas ngadhnjimit në kohën prej Tetorit të vjetit 1917 deri në Fruer 1918.

Mbas fitores mbi anmikun e klasës duhej të forcohej në vend pushteti sovjetik. Prandej simbas propozimit të Leninit âsht pru dekreti për krijimin e Armatës së Kuqe. Kisha u nda

prej shtetit e feja u bâ çashtje private e njerëzvet. U shpall barazija juridike e të gjithë kombevet në themel të »Deklaratës së të drejtave të popujvet në Rusi«.

Në fruer të vjetit 1918 përfaqësuesit e Rusis sovjetike nënshkruen paqën me Gjermaní në Brest-Litovski. Këjo paqë ishte shum e randë për Rusin, mirëpo ishte e nevojshëme, sepse katundarët duhej të ndijshin se nuk po bâhej luftë mâ e se toka ishte e tyne.

Ndërkaq, kah gjysma e vjetit 1918 fuqít e jashtëme e të mbrendshëme të kundrarevolucjonit filluen të bâjnë luftë kundra Rusís sovjetike. Anglezët dhe Francezët zbarkuen n'Arhangelsk e Murmansk, Japonezët në Vlladivostok, Gjermanët muerën Ukrainën dhe Zakavkazin, kurse shum gjenerala bellogardista filluen luftën civile mbrenda atdheut.

Në Rusín sovjetike filloi nji periudhë shum e vështirë, sepse krejt vendi ishte bllokue. Nuk ka pasë as bukë as mish, urija mundonte si punëtorët ashtu edhe katundarët. Fabrikat nuk punojshin sepse nuk ka pasë mjaft landë të para dhe landë djegëse. Me gjithatê klasa punëtore nuk u ligështue. Qeverija sovjetike dhe Lenini shpallën parollën: »Atdheu socjalist âsht në rrezik!« Qysh atëherë punëtorët e katundarët vijshin sa mâ shum n'Armatën e Kuqe. Partija e komunistavet e çoi popullin në luftën atdhetare kundër ndërhymësve të huej e kundrarevolucjonarëve të mbrendshëm. U krijue nji ushtri miljonëshe dhe ushtarët e entusiazmuem t'Armatës së Kuqe ngadhnjyen në luftën civile. Anmiku i jashtëm dhe i mbrendshëm u thye.

Kur u shlirue krejt shteti prej anmiqvet, populli mujti me kalue në periudhën e rindërtimit të vendit, i cili ishte shkatrrue e mbrapambetë në luftna. Ngadhnjimi i Revolucjonit të Tetorit ka krijue kushte për ngritjen e industrís së madhe e për krijimin e ekonomís së ré bujqësore. Mbassi Revolucjoni i Tetorit shliroi nji të gjashtën e lamshit tokësuer prej ekonomís kapitaliste e eksploatimit të njerëzve nga ana e saj, ai përhapi rrezet e veta në të gjitha lëvizjet e punëtorëvet të mbarë botës.

## SËRBIJA, MALI I ZI DHE POPUJT JUGOSLLAVË NË LUFTËN E PARË BOTËNORE

### Imperjalizmi austro-gjerman si pengesë kryesore për shlirimin dhe unjisimin e popujve jugosllavë. Atentati i Sarajevës. Ultimatumi i austro-Hungaris dhe fillimi i luftës

Aspiratat e imperjalizmit austriak dhe gjerman u banë të përbashkëta qysh me rastin e pushtimit të Bosnjës dhe Hercegovinës, mbassi atëhere Gjermanija lejonte të gjitha përgatitjet për pushtim, e veçanisht ndihmoi Austrín në Kongresin e Berlinit. Prej asaj kohe qëllimi kryesuer i politikës austro-gjermane në Ballkan ishte me pengue çdo mundësi që popujt jugosllavë të shlirohen nga robnija turke. Në se ndonji krahinë jugosllave shlirohet nga robnija turke, ajo duhet me ra nën sundimin austro-hungarez. Që imperializmi austro-gjerman të mund të depërtonte në Lindje, së pari duhej të thyente iden e unjisimit të popujve jugosllavë. Prandej u përpoq me krijue përçamje ndërmjet dy popujve jugosllavë mâ të fortë ekonomikisht — Sërbëve dhe Kroatëve. — Kur ishte e nevojshëme që okupimi i Bosnjës dhe i Hercegovinës të kryhet me sa mâ pak viktima, Austrija përkrahi Kroatët. Mbassi kreu punë — mbas pushtimit, gjatë kohës së Kuenit përkrahi edhe Sërbët, e i la me nji anë Kroatët. Në Bosnje dhe Hercegovinë filloi me krijue »kombësín boshnjake« që kështu me nda Sërbët prej Sërbís, kurse Kroatët prej Kroacís, njikohësisht me ndihmën e borgjezís së vendit mbolli përçamjen ndërmjet muslimanëve, Sërbëve dhe Kroatëve. Austrija bani gjithështka për të krijue përçamje edhe ndërmjet Sërbëve e Malit të Zi. Kështu ajo ndihmoi dinastín e Obrenoviqit kundër dinastís malazeze të Petroviqit, kurse Nikolla Petroviqin kundër Petrit të I Karagjorje.

Imperjalizmit austro-hungarez i shkoi përdore për nji kohë mjaft të gjatë që, me anë të nji politike të tillë, të krijojë pengesa të mëdha për shlirimin dhe unjisimin e popujve jugosllavë. Përveç kësaj shfrytëzoi me pamëshirë pasunít natyrore të vendeve të saj. Me anën e premtimeve të ndryshme dhe tue dhanë disave disa pozita dhe koncesione, imperializmi austro-gjerman u përforcue aq fort n'ata vende sa vendosi që

me anë të luftës me zgjidhë njiherë e përgjithëmonë në fitim të vet të gjitha çashtjet që paraqiteshin në lidhje me Sllovenët e Jugut.

Ai mendim u paraqit te politikanët austro-hungarezë atëhere kur Sërbija në Luftën ballkanike zgjanoi teritorin e vet dhe kur u bashkuen kufijt e Malit të Zi dhe Sërbís. Këjo ngjarje pengoi qëllimin e imperjalizmit austro-hungarez që me anë të mashtrimeve dhe tue mbjellë përçamje ndërmjet popujve të Ballkanit të pushtojë Ballkanin. Prandej Austro-Hungarija vendosi që qëllimet e veta t'i realizojë me anë të luftës. Për këtê qellim filloi përgatitjet për luftë.

Në verë të vjetit 1914 ushtrija austriake bani manevra të mëdha në Bosnje, në lindje të Sarajevës në drejtim të kufinit drejt Sërbís. Ato manevra i vizitoi edhe trashëgimtari i fronit t'Austro-Hungarís, Frano Ferdinandi, personi kryesuer i qarqeve ushtarake dhe mbrojtës i klerikëve në Monarkín Habzburge. Për të provokue Sërbët në Bosnje dhe Hercegovinë, caktoi që me 28 Qershuer, në ditën e festës kombëtare të popullit sërb (dita e Vidit), të futet në Sarajevë madhnisht.

Këjo vepër provokuese e politikës austriake ishte shkas për vendimin e organizatës revolucjonare »Bosnja e Ré«, për të vra trashëgimtarin e fronit austro-hungarez, si personin kryesuer të politikës grabitqare t'imperjalizmit austriak. Kur Frano Ferdinandi po kalonte në karrocë i përcjellun prej suitës nëpër rrugën kryesore të Sarajevës, e vrau me revolver Gavrillo Principi, nxanës i rendit të tetë të gjimnazit.

Atê ngjarje në Sarajevë Austro-Hungarija e shfrytëzoi dhe akuzoi përpara gjithë botës Sërbín zyrëtare si fajtore për vrasjen e trashëgimtarit të fronit. Prandej qeverija e Vjenës, me 23 Korrik i dorëzoi Sërbís ultimatumin. N'ultimatum theksohej që Sërbija punon për ndamjen e disa pjesëve të shtetit austro-hungarez. Ishte theksue gjithashtu se edhe atentatorët ishin t'armatosun me armë prej Sërbije, të cilat i kishin marrë prej oficerave-anëtarë të mbrojtjes së popullit. Ultimatumi në dhetë pika paraqitte kërkesa tue kërkue që Sërbija t'i plotësonte. Ndërmjet tyne kishte të shënueme edhe

shum pika fyese, e që nuk mund t'i pranonte asnji shtet suveren.

Qeverija e Sërbís, për t'iu largue konfliktit të luftës, vendosi me plotësue të gjitha kërkesat e ultimatumit, përveç nji pike në të cilën kërkohej që në hetimet ndërmjet qytetarëve sërbë të merrshin pjesë edhe organet e qeverís perandorake. Ajo pikë ish fyese dhe binte në kundërshtim me kushtetutën e Sërbís, prandej u refuzue. Dy ditë mbassi mori përgjigjen n'ultimatumin, plotësisht nji muej mbas atentatit të Sarajevës, Austro-Hungarija i shpalli luftë Sërbís. Të gjitha ndërmjetësimet e fyqive të mëdha t'Antantës nuk dhanë kurrfarë fryti, mbassi Austro-Hungarija vendosi me realizue politikën e vet grabitqare, të cilën e ndihmonte gjithashtu edhe Gjermanija e armatosun mirë.

Fillimi i luftës Austro-Hungareze kundër Sërbís ishte rast që Rusija të mobilizonte ushtrín e vet dhe me ndihmue Sërbin e sulmueme. Mobilizimin e Rusís, Gjermanija e mori si shkak për t'i shpallë luftë Rusís. Mbas kësaj u futën me radhë në luftë edhe shtetet tjerë të mëdhej e të vogjël, disa si aleatë t'Antantës, kurse të tjerët si aleatë t'Austro-Hungarís.

**Fitimet e ushtrís sërbe dhe malazeze. Pakti i Londrës. Ofensiva gjermano-austriako-bullgare në vjeshtë të vjetit 1915 dhe pushtimi i Sërbis dhe i Malit të Zi. Kalimi i ushtris sërbe nëpër Shqipni dhe kapërximi i saj në Korfuz**

Austrija luftoi kundër Sërbís me dy armata nën komandën e gjeneral Poqorekut.

Kur më 5 Gusht të vjetit 1914, në luftë kundër Austro-Hungarís, u fut Mali i Zi, u formue fronti i Ballkanit prej Detit Adriatik deri te gjiu i Timokut në Danub.

Epërsija numerike i bani të mundun ushtrís austro-hungareze që në disa vende të kalojë nëpër Drinë dhe Savë dhe të futet në Sërbi, afër Shabacit. Atëhere filloi B e t e j a e m a d h e e C e r i t, prej 16—19 Gusht, në vijën Shabac—Tekerish—Krupanjë. Në këtë betejë të përgjakshëme ushtrija austro-hungareze pësoi humbje dhe u detyrue me u tërheqë me shpejtësi m'at'anë Drinës. Deri me 24 Gusht Sërbija u pastrue

plotësisht nga ushtrija austro-hungareze. Në betejën e Cerit ushtrija sërbe zuni këto trofena lufte: 50 topa, 86 kerre plot me municjon dhe 4 500 ushtarë robë.

Mbas kësaj ushtrija austro-hungareze u detyrue me përforcue frontin e vet kundër Rusís dhe me hedhë Armatën e vet të dytë në frontin rus. Këtê rast ushtrija sërbe e shfrytëzoi, dhe me gjithë se nuk kishte materjal të nevojshëm ushtarak, simbas dëshirës së Rusís kaloi n'ofensivë te Kupinova dhe Mitrovica, dhe pushtoi krejt Sremin.

Ushtrija malazeze mujti me mbrapsë të gjithë sulmet e anmikut dhe tue shfrytëzue dobësín e armatës së Poqorekut, kaloi n'ofensivë. Ajo depërtoi nëpër Hercegovinë e Bosnjën Jugore dhe mbërrijti deri afër Sarajevës.

Mbassi mbërrijti në nji gjendje kaq të vështirë, ushtrís austro-hungareze i erdhi ndihma dhe kaloi përsëri n'ofensivë për të kalue Drinën. Gjeneral Poqoreku kujtoi se tash do t'asgjâsonte njiherë e përgjithmonë ushtrín sërbe dhe atê malazeze. Ushtrija sërbe kishte shum pak municjon artilerije dhe prandej u detyrue me u tërheqë në drejtim të Rudnikut. N'atê tërheqje qëndroi fort në Gushevë, te Maçki Kamen dhe në Cërni Vërh, por mâ në fund u detyrue me e lëshue Beligradin.

Mbas pushtimit të Beligradit anmiku mendoi se ushtrija sërbe u mund. Mirëpo, ndodhi e kundërta. Sërbija mori nji sasi të madhe municjoni prej France, i plotësoi njisít e veta me regrutë të rij dhe sulmoi përsëri. Armata e parë sërbe nën komandën e vojvodë Mishiqit e shpoi frontin anmik në Suvobor dhe më 3 Dhetuer zhvilloi me fitim Betejën e madhe të Kollubarës. Ushtrija Austro-hungareze u detyrue me u tërheqë, dhe për tetë ditë Sërbija u shlirue përsëri bashkë me Beligradin.

Për shkak të këtyne pafitimeve Poqoreku u ndërrue prej detyrës dhe në vend të tij u caktue arqiduka Eugen. Nën komandën e tij u bâ grupimi dhe plotësimi i ushtrís austro-hungareze. Njikohësisht ushtrija sërbe përgatitej për vazhdimin e luftës mbrojtëse kundër anmikut të fortë.

Gjatë operacjoneve luftarake, në vjetin 1914, anëtarët e Antantës e panë se Italija nuk ishte aleate e sigurtë e Gjermanís dhe Austro-Hungarís. Ajo kërkonte prej të dy anëve dhe këqyrte se prej kujt to të merrte mâ shum. Në fillim të luftës Italija shpalli neutralitetin e vet, dhe si çmim për të kërkoi prej Austrís krahinën e Tirolit Juguer, Trentinën dhe Istrën. Këtê Anglija e shrfytëzoi dhe n'emën t'Antantës hyni në marrëveshtje me Italín për ta bâ për vehte. Italija kërkoi prej Antantës me iu sigurue Dalmacija, nji pjesë e madhe e Shqipnís dhe disa treva turke. Me gjithë se Rusija u kundërshtoi kërkesave italjane, Anglija, tue dashtë që anmikut t'i hapë edhe nji front, pranoi të gjitha kushtet italjane. Në Prill të vjetit 1915 u nënshkrue në Londër marrëveshtja ndërmjet Italís nga njana anë, dhe Anglís, Francës dhe Rusís nga ana tjetër. Ajo marrëveshtje u quejtë P a k t i  i  L o n d r ë s, dhe kishte të gjitha karakteristikat e nji marrëveshtje imperjaliste, mbassi don të thoshte pushtim i teritorëvet tanë në bregdetin linduer të Detit Adriatik. Mbas mbarimit të luftës ajo marrëveshtje shkaktoi mosmarrëveshtje të mëdha ndërmjet nesh dhe Italís.

Gjeneralshtabi i ushtrís gjermane dëshironte që me çdo mënyrë të vente lidhje të drejtëpërdrejtë me Turqín, që kështu prej Azije të merrte landët e para të nevojshëme për luftë. Prandej vendosi me shkelë Sërbín dhe të pushtojë teritorin e saj. Për të mujtë me e realizue atê plan, duhej që Forcat qendrore të bâjshin për vehte Bullgarín. Në Gusht të vjetit 1915 në Bullgari u ndryshue qeverija dhe në pushtet hypën gjermanofilët. Qeverija e re bullgare, në Shtatuer bani marrëveshtje me shtetet qendrore, të cilët e premtuen Sërbín Lindore dhe Maqedonín. Komandën eprore mbi të gjitha forcat që luftuen në Sërbi dhe Mal të Zi e mori gjenerali gjerman Makenzeni.

Në fillim të Tetorit të vjetit 1915 tue kalue Savën dhe Danubin, ushtrija gjermane filloi ofensivën e madhe kundër Sërbís. Prej 5 deri me 22 Tetuer trupat sërbe, në tërheqjen e tyne kundrejt Rashkës, i banë qëndresë të fortë ushtrís anmike. Kur me 5 Nanduer u bashkue ushtrija gjermane dhe ajo bullgare, ushtrija sërbe u detyrue me u tërheqë në bregun e djathtë

të Moravës Perëndimore. Tue u tërheqë dalëngadalë drejt Kosovës, ajo luftoi pa ndërpremje. Kur më 22 Nanduer anmiku mujti me pushtue Prishtinën ushtrís sërbe iu prenë të gjitha mundësít me luftue mâ gjatë. Prandej komanda supreme vendosi që ushtrín e Kosovës me e tërheqë nëpër Mal të Zi dhe Shqipni në bregdetin e Adriatikut. Ajo tërheqje filloi me 25 Nanduer, dhe u krye nëpër Pejë për Andrijevicë dhe Shkodër, dhe prej Gjakove në Lesh dhe Shkodër.

Mali i Zi i mbajti edhe për njifarë kohe trupat e tij në kufi dhe ndaloi kalimin e anmikut, i cili përpiqej që nëpërmjet të Sanxhakut t'i presë rrugën ushtrís sërbe. Malazezët nën komandën e Janko Vukotiqit mujtën që në Majkovc të shpartallojnë ushtrín anmike superiore të cilën e komandonte gjeneral Keveshi. Këjo fitore prej 25—27 Dhetuer të vjetit 1915 nuk kishte ndonji randësi të madhe, mbassi anmiku, me gjithë atê, depërtoi në Cetinë dhe mori Llovqenin. Me këtê ngjarje edhe ushtrija malazeze u detyrue me u tërheqë. Në Mal të Zi filloi gjendja e vështirë. Mbret Nikolla shkoi n'Itali. Në kallnuer të vjetit 1916 anmiku e shkeli Malin e Zi dhe Janko Vukotiqi u zû rob.

Mbassi thyen rezistencën e ushtrís sërbe, trupat gjermane u tërhoqën. Njisít ushtarake austro-hungareze qëndruen me qeverisë vendin e pushtuem, Sërbín dhe Malin e Zi, kurse trupat bullgare Maqedonin dhe pjesët Lindore të Sërbís. Jeta e popullit nën pushtim ishte shum e vështirë, mbassi pushtuesat vendosën regjimin e plaçkitjes dhe të krimeve.

Ushtrija sërbe në rrugën për Shqipni dhe Mal të Zi filloi me vdekë prej urís, dhe lodhjes. Bashkë me ushtrín u tërhoq edhe nji pjesë mjaft e madhe e popullit sërb, të cilët u damtuen edhe mâ tepër, mbassi nuk kishin kurrfarë armësh. Në rrethin e Shkodrës dhe Leshit nuk kishte ushqim të mjaftueshëm, mbassi anijet aleate i sulmojshin nëndetëset prej bazës së Bokës së Kotorit. Prandej ushtrija sërbe e sëmundë dhe e rraskapitun u drejtue kah bregdeti drejt Durrsit dhe Vlonës. Prej këndej, në Kallnuer të vjetit 1916 u hodh në Korfuz, ku filluen me u kujdesue aleatët. Ushtarët, të lodhun prej urís dhe rrugës, vdisshin gjithënji. Prej rrezikut t'epidemís n'ishu-

llin Vide, afër Korfuzit u organizue karantini për të gjithë ata që ishin të dyshimtë me shëndet. Aty vdiqën shum Sërbë. Prandej ishullin Vido e quejtën »Ishulli i vdekjes«.

Ata që shpëtuen muerën tash dhe ushqim prej Francezëve, e mbas nji kohe ushtrija sërbe u organizue përsëri, me nji forcë prej 147 000 njerëzish. Ajo ushtri u ushtrue në Korfuz dhe dalëngadalë u aftësue për luftë.

**Forcimi i Frontit të Selanikut, ofensiva e vjetit 1916. Shpërthimi i Frontit të Selanikut në vjeshtë të vjetit 1918; thyemja e fuqive t'Europës qëndrore**

Njisít aleate, të cilat me 1915 erdhën prej Anglije dhe France për të fillue ekspeditën e Dardanelës mbas mossuksesit, mbërrijtën në Selanik dhe krijuen trupat e pasigurta greke në kufinin sërbo-grek, mbassi kanosej rreziku prej depërtimit t'ushtrís austro-hungareze dhe bullgare kundrejt Selanikut. Komandanti i njisive aleate në Frontin e Selanikut ishte gjenerali francez Saraj.

Në Prill të vjetit 1916 filloi kalimi i ushtrís sërbe prej Korfuzit në Selanik dhe deri në fund të Majit të tri armatat gjindeshin në kampet rreth Selanikut. Ushtrija bullgare dhe ajo austro-hungareze mbajshin në kufi nji ushtri prej 160 000 njerëz, prej Vardarit deri te Liqeni i Ohrid.

Deri në Dhetuer po t'atij vjeti u përqëndruen të tri armatat sërbe dhe bashkë me fuqít aleate banë përgatitjet e përbashkëta për ofensivë. Ofensiva filloi me 12 Shtatuer dhe mbas luftave të gjata që zgjatën gjashtë ditë, pushtuen Kajmakçallanin dhe Manastirin. Kështu në vjeshtë të vjetit 1916 u krijue teritori i vogël i shliruem, i cili ngjalli te të gjithë luftarët basimin në fitoren.

Në pranverë të vjetit 1916, në Rusi u formue divizjoni i vullnetarëve prej robëve të luftës prej ushtrís austro-hungareze — Sërbë, Kroatë, Sllovenë, dhe pak Çekë e Polakë. Ky divizjon së pari luftoi në Dobruxhe kundër Bullgarve. Mâ vonë në Rusi u krijue korparmata e vullnetarëve, e cila në fillim të Nandorit të vjetit 1917, u hodh në Frontin e Selanikut për të forcue ushtrín sërbe. Poashtu erdhën vullnetarë edhe prej Ame-

rike — Sllovenët e Jugut, të cilët ishin vendosë aty qysh kur ishin mërgue.

Në fillim të vjetit 1918 për komandant të përgjithshëm në Frontin e Selanikut u caktue gjenerali francez Franshe d'Epere, kurse ushtrín Sërbe e komandonte vojvoda Mishiq. Në njisít, aleate kish shum trupa koloniale, veçanisht zezakë prej Senegali, të cilët luftuen trimnisht.

Ofensiva filloi me qitje artilerije më 14 Shtatuer të vjetit 1918, dhe për pesë ditë luftarët e Selanikut e detyruen anmikun me u tërheqë. Ushtrija Sërbe dhe aleate pushtuen Krivolakun, e mandej Gradskën, Shtipin, Koçanin dhe vende tjerë. Me 29 Shtatuer Bullgarija u detyrue me nënshkrue armëpushim dhe kundër saj u ndalën luftimet.

Trupat austro-gjermane u tërhoqën drejt Nishit të ndjekuna kamba kambës prej njisive aleate. Qëndresën e fundit e banë me 21—22 Tetuer në Klisurën e Shtalasit, te Razhnja. Kur humbën betejën, filluen me u hedhë m'at'anë Danubit. Deri me 3 Nanduer Sërbija u shlirue, kurse njisít sërbe dhe aleate filluen me kalue Danubin dhe Savën për të shlirue Banatin, Baçkën dhe Sremin. Nji ditë mâ vonë trupat e Adriatikut shliruen Cetinën, kurse më 4 Nanduer Kuvendi populluer i Bosnjës dhe Hercegovinës shpalli unjisimin me Sërbín.

Austro-Hungarija u coptue nën grushtet e ushtrís ngadhnjimtare sërbo-aleate kah juglindja dhe për shkak të thyemjes së frontit të saj kundër Italís. Popujt e tyne të shtypun shpallën shkëputjen prej Vjenës dhe krijuen kuvendet e tyne popullore, të cilët do të vendosshin pamvarësisht për ardhmënín e atyne popujve.

**Gjendja e popujvet tanë nën Austro-hungarín gjatë kohës së luftës. Ndjekja e Sërbëve dhe e gjithë elementave përparimtarë. Ndalimi i të gjitha organizatave punëtore. Krijimi i këshillave Jugosllave. Deklarimi i Korfuzit. Aspiratat progresive të turmave popullore për krijimin e shteteve të përbashkët. Aspiratat reakcjonare të borgjezis**

Të gjithë popujt që jetojshin nën qeverín austro-hungareze menzi e durojshin atê sundim. Presjoni i randë i këtij qeverimi

ra mâ shum mbi Sllovenët, e ndërmjet tyne mâ shum te Sërbët dhe Çekët, të cilët qeverija e Vjenës i asgjâsoi mâ shum. Gjendja e Sllovenëve të Jugut, ishte veçanisht e randë, mbassi nji pjesë e madhe njerëzish duhej të shkonte në luftë dhe si ushtarë austriakë me luftue kundër vllazënve të tyne, Sërbëve dhe Rusëve. Prandej njisit ushtarake, në të cilat shumica qenë Sllovenë të Jugut, ishin të pasigurtë për komandën austrijake.

Katundari ishte i detyruem me dhanë ushqim për ushtrín dhe kafshët, dhe ajo sasi për çdo vjet shtohej. Populli ishte i pakënaqun prej këtij »rekvizimi«, që bâhej në mënyrë barbare, kështu që shpeshherë bijshin në konflikt katundarët me njerëzit që kryejshin atê »rekvizim«.

Për t'u dhanë fund dorëzimeve të shpeshta të Çekëve e të Sllovënve të jugut në frontin serbë e në frontin rus, Austro-Hungarija i përqëndroi kryesisht në frontin italjan. Aty ishte mâ pak rrezik që ushtarët Sllovenë të dorëzohen. Prandej politika austriake, tue mbjellë mjeshtërisht urrejtjen, gati për gjithë kohën e luftës, frontin italjan e mbajti kryesisht me sllovenë.

Menjiherë mbas shpalljes së mobilizimit të përgjithshëm, qeverija austro-hungareze përdori masat mâ t'ashpra për t'u zbatue mobilizimi. U vendos gjyqi special, përpara të cilit nxirrej çdokush që flitte kundër politikës s'atëhershëme t'Austro-Hungaris. Fílluen burgimet masovike të njerëzve që merreshin me politikë ose kishin autoritet në vendin e vet ku jetojshin. Këto ndjekje të qeveritarëve austriakë veçanisht goditën randë Sërbët në Bosnje dhe Hercegovinë, Vojvodinë, Kroaci, Slloveni dhe Dalmaci. Qeveritarët burgosën me mija Sërbë dhe i mbyllën në kazermat ushtarake, atje ku ishte vend — përqëndrimi për ushtarët e mobilizuem. Ata Sërbë ishin peng dhe i shërbejshin Austro-Hungaris si garanci se në vendet e tyne të gjithë ata qe kishin të detyrueshëm shërbimin ushtarak do t'i përgjigjeshin thirrjes së perandorit dhe do të shkojshin ushtarë. Për çdo mosbindje në rreth pushkatoheshin ata që ishín marrë peng prej atij vendi. Shum Sërbë i pushkatuen dhe i vjerrën, kurse shum të tjerë i dënuen me burgim të gjatë. Veçanisht u damtuen Sërbët e Sremit, mbassi ata e pritën me entuziazëm

ushtrín Sërbe, me rastin e kalimit të saj nëpër Savë në vjetin 1914. Në Bosnje dhe Hercegovinë u banë pushkatime në turma e poashtu edhe vjerrje, mbassi ato dy krahina paraqitshin rrezikun mâ të madh për politikën e Austro-Hungarís.

Qeveritarët austro-hungarezë ndoqën dhe âsgjâsuen të gjithë Sërbët, si kombësi, kurse ndërmjet Sllovenëvet tjerë të Jugut kryesisht ndiqshin njerëzit përparimtarë. Shum Kroatë dhe Sllovenë, për të cilët qeveritarët e dijshin se punojshin për unjisimin e Sllovenëve të Jugut dhe për ndamjen e tyne prej suazës s'Austro-Hungarís, burgosën dhe u mbyllën në burgje të ndryshme të perandorís së madhe.

Me kësi veprimesh kundër qytetarëve të vet, qeveritarët austro-hungarezë ngjallën urrejtje edhe mâ të madhe kundër tyne në popujt e shtypun. N'ushtrín e vet nuk kishin besim në shum oficerë e aq mâ pak n'ushtarët.

Monarkija austro-hungareze ishte shtet reaksjonar dhe imperjalist. Sundimi i saj mbështetej në byrokracín e naltë dhe në kuadrin e oficerave. Ata njerëz nuk kishin kurrfarë lidhjesh me popullin, ata madje edhe e urrejshin. Sundimtarëve u nevojiteshin turmat popullore që të luftojshin për ta, e mun për këtê shkak ata penguen në çdo mënyrë që populli të njifej me idét përparimtare, qoftë me ato nacjonale, qoftë me ato socjale. Prandej sundimtarët austro-hungarezë ndaluen të gjitha organizatat punëtore, si ato politike ashtu edhe ato sindikale.

Në momentin e parë mbas shpalljes së luftës, ata burgosshin njerëz prej lëvizjes punëtore, të cilët paraqitshin nji farë rreziku për qeverín. Por kur gjendja luftarake hyni në kolosek, burgimet u ndalën, mbassi maqinës luftarake i nevojiteshin sa mâ shum prodhime. E tanë industrija u drejtue kryesisht në prodhimin e gjanave të nevojshëme për luftë, kështu që punëtorët ishin tepër të nevojshëm. Prandej, mbas mobilizimit dhe ndalimit të shtypit punëtuer, qeveritarët banë ndamjen në ndërmarrje. Mbas kësaj u ndalue ndjekja e punëtorëve si anmiq të klasës.

Menjiherë mbas atentatit të Sarajevës shum punëtorë të dalluem në pikëpamje politike dhe kulturore-Kroatë, Sërbë dhe Sllovenë u emigruen. Ata vepruen kështu që mos t'i burgosshin

qeveritarët austriakë. Disa gjindeshin qysh mâ përpara jashtë shtetit, dhe tash u takuen n'Itali, e mâ në fund në Londër. Ndërmjet emigrantëve politikë ishin Frano Supilo, Ante Trumbiqi, Hinko Hinkoviqi, Mishiqi, Meshtroviqi etj.

Gjatë gjithë luftës ata nuk organizuen punë të përbashkët politike, por mâ në fund organizuen t'ashtuquejtunin Këshilli jugosllav. N'atê këshillë hynë përfaqësuesat kroatë, sërbë dhe sllovenë në teritorin e Monarkís Austro-Hungareze. Ndërmjet anëtarëve të Këshillit jugosllav ishin Supilo dhe Trumbiqi.

Anëtarët e këtij Këshilli punuen që te aleatët të merrnin fjalën për krijimin e shteteve të rij nacjonalë në teritorin e ish Austro-Hungarís.

Në çashtjen e unjisimit të Sllovenëve të Jugut në nji shtet të përbashkët anëtarët e Këshillit jugosllav nuk kishin pikëpamje të përbashkëta. Për këtê arsye edhe puna e Këshillit u ngadalësue shum. Punën e tij e pengonte edhe mâ shum ajo se anëtarët e tij në shum çashtje kishin pikëpamje të kundërta prej atyne të qeverís sërbë në Korfuz.

Nji prej detyrave mâ të randësishme t'anëtarëve të Këshillit jugosllav ishte me lajmërue publikun në shtetet aleatë se Sllovenët e Jugut posedojshin teritorët e tyne nacjonale dhe se ata janë të shtypun prej Vjenës, se ato krahina, si p. sh. Dalmacija nuk mund t'i jepen Italís, e cila në të vërtetë vetëm e zevendësoi Austrín n'asgjasimin nacjonal të Kroatëve dhe Sërbëve.

Puna e Këshillit jugosllav, si përfaqësues i Kroatëve, Sllovenëve dhe Sërbëve në teritorin e Austro-Hungarís, dhe puna e qeverís sërbe në Korfuz, si përfaqësuese e Mbretnís së Sërbís banë që t'epet Deklarata e Korfuzit. — Deklata e Korfuzit u përpunue gjatë kohës prej 15 deri më 20 Korrik të vjetit 1917. Nisjativën për përpilimin e saj e dha kryetari i qeverís sërbe, Nikolla Pashiqi, kur në Maj të po atij vjeti thirri Trumbiqin dhe Stojan Protiqin me shkue në Korfuz. Aty u krijue komisjoni që përbâhej prej anëtarëve të qeverís sërbe, prej kryetarit t'opozitës n'Asamblén popullore të Sërbís — Lubo Davidoviqit, Millorad Drashkoviqit dhe Vojo Marinkovi-

qit, dhe përfaqësueave të Këshillit jugosllav — Trumbiqit, Hinko Hinkoviqit, Boshnjakut dhe Vasiljeviqit. Ky komisjon, me ndihmën e disa personavet tjerë, përpiloi Deklaratën e Korfuzit.

N'atê shpallje thuhet se qëllimi kryesuer í luftës âsht krijimi i parimeve të ndamjes së lirë të popujve, dhe se ajo do të realizohet me ndihmën e Francës, Anglís, Amerikës dhe Rusís. Prandej përfaqësuesat sërbë, kroatë dhe sllovenë u pajtuen që popujt e tyne të bashkohen në nji shtet të lirë dhe të pamvarun, dhe që ai shtet të bazohet në parime demokratike. Shteti i Sërbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve do të jetë mbretni e pamvarun me teritor t'unjisuem dhe me nënshtetësi t'unjisueme. Ajo do të jetë kushtetuese, monarki demokratike dhe parlamentare në krye me dinastín Karagjorgje. Të gjithë nënshtetasit në mbarë teritorin do të jenë të njajtë dhe të barabartë ndaj shtetit dhe përpara ligjit. Përveç këtyne parimeve themelore, deklarata kishte edhe shum pika tjera të randësishme për popullin dhe për rendin e ardhëshëm shtetnuer.

Deklaratën e Korfuzit më 20 Korrik të vjetit 1917, e nënshkruen kryetari i qeverís sërbe, Nikolla Pashiqi, dhe kryetari i Këshillit jugosllav, Ante Trumbiqi.

Turmat popullore të Sllovenëve të Jugut, qysh përpara Luftës së parë botënore dëshirojshin me u krijue shteti i përbashkët që do të kishte karakter jugosllav. Këto aspirata ishin pasojat e shfrytëzimit të gjatë nga pushtuesi i huej — Turqija dhe Austrija. Turmat popullore dëshirojshin që popujt jugosllavë vllazën të jenë në nji shtet të përbashkët të lirë dhe të pamvarun dhe që të gjithë të jenë plotësisht të barabartë. Vetëm n'atê mënyrë do të munden me qëndrue të bashkuem dhe të pamvarun.

Secili prej këtyne popujve dëshironte që në t'ardhëshmen të zhvillohej në shtetin e përbashkët, mâ mirë dhe mâ shpejt se sa zhvillohej në sundimin e të huejit. Këto aspirata themelore të turmave popullore për krijimin e shtetit të përbashkët nuk deshtën me i përvehtësue njerëzit që udhëhiqnin politikën e atëhershëme. Klasa e borgjezís së madhe këqyrte që prej

luftës së fitueme të nxjerrë sa mâ shum fitime për vehte dhe të krijojë kushte për mundësi sa mâ të madhe eksploatimi të pasunive natyrore të vendit. Mbassi politikanët e qeverís sërbe në Korfuz dhe të Këshillit jugosllav në Londër kujdesoheshin mâ shum për pozitat e borgjezís, çashtja rreth unjisimit të Sllovenëve të Jugut nuk u zhvillue ashtu si shpresohej.

Aspiratat përparimtare të turmave popullore, të cilat u gjakosën në front gjatë luftës, qëndrojshin në kundërshtim me aspiratat reakcjonare të borgjezís sërbe, kroate dhe sllovene. Këto kundërshtime u dukën qartë në ditët e shlirimit nga sundimi austro-hungarez, kur mâ në fund u krijue shteti i përbashkët. Aspiratat e turmave popullore, të cilat u vorfnuen shum gjatë kohës së luftës, ishin të drejtueme kah zgjidhja e çashtjes socjale.

**Revolucjonimi i turmave nën ndikimin e Revolucjonit të Tetorit. Forcimi i lëvizjes punëtore. Krijimi i shtetit SHS (SKS)**

Qysh në ditët e para të Revolucjonit të Tetorit në Rusi, në turmat punëtore të Vojvodinës, Kroacís, Sllovenís dhe Bosnjës e Hercegovinës filloi nji gjallni e madhe. Qysh prej Revolucjonit të Tetorit në vjetin 1917 u ndëgjue prej ushtarëve, të cilët këtheheshin nga fronti se në Rusi po zhvillohej dishka me randësi. Mbas Revolucjonit të Tetorit filluen me u këthye në shtëpijat e tyne robët prej Rusije, të cilët kishin pá me syt e tyne ngjarjet e revolucjonit, ku shum prej tyne edhe kishin marrë pjesë aktive në revolucjon.

Nën ndikimin e Revolucjonit të Tetorit filloi revolucjonarizimi i turmave popullore, dhe numri i dezerterëve prej ushtrís u shtue shum shpejt. Këta dezerterë quheshin »kuadra të blertë«, kurse e gjithë ajo lëvizje — »kuadri i blertë«. Shum ushtarë shkuen në shtëpijat e tyne, por mbassi ishin në rrezik se mos i kapë policija, u mëshehën në pyll. Mâ shum dezerterë kishte në Slloveni dhe në viset malore të Kroacís. Në Vojvodinë mëshifeshin në mënyra tjera, sepse nuk kishte male.

Gjatë gjithë kohës së luftës në marinën luftarake ka pasë shum raste që marinarët u kundërshtojshin komandantëve të

tyne. Këjo ndodhte për shkak se eprorët e tyne në shumicë përbâheshin prej Gjermanësh dhe Hungarezësh, kurse marinarët në shumicë ishin Sllovenë të Jugut, mâ shum prej Dalmacije. Marinarët kryen shum vepra revolucjonare, të cilat i çelën punë udhëheqësís austro-hungareze. Kështu filloi kreyngritja e marinarëve në Pulje, por edhe mâ e madhe në Kotor. Në disa anije kryengritëse marinarët varën flamuj — ose kroatë tringjyrësh ose flamuj të kuq — si shej mbrojtjeje për liri.

Nën ndikimin e ideve të Revolucjonit të Tetorit punëtorët në Kroaci, në Korrik të vjetit 1917, filluen me nxjerrë rishtas gazetën socjaliste »Sloboda« dhe në tê shfaqshin pikëpamjet e Leninit ndaj Luftës së parë botënore dhe për lidhjen e paqës. Përsa i përket unjisimit të Sllovenëve të Jugut në nji shtet të përbashkët, punëtorët në revolucjonin e Partís socjaliste kroate kërkuen »shtetin e pamvarun jugosllav«.

Kur u bâ e qartë se Autro-Hungarija si shtet pësoi humbje të plotë, se Gjermanija gjindej tue dhanë shpirt nën grushtat e armatave t'Antantës, dhe se të vluemit e mbrendëshëm ndërmjet popujve po merrte gjithënji karakter mâ revolucjonar, u mblodh Kuvendi kroat me 29 Tetuer të vjetit 1918 dhe vendosi që Kroacija të këputte të gjitha lidhjet me Austro-Hungarín dhe me dinastín Habzburge, të bâhej unjisimi i Kroatëve, Sërbëve dhe Sllovenëve dhe të krijohej K u v e n d i p o p u l l u e r, i cili të merrte qeverimin në teritorin jugosllav që deri atëhere i takonte Austro-Hungarís. Poashtu u vendos me u bâ votimet demokratike për Asamblén popullore dhe ajo të vendosë rregullimin e shtetit.

Në mbrendí të vendit, ku sundonte shkatërrimi i qeveris së vjetër, në katundet dhe në qytetet u krijuen kuvendet popullore dhe këshillat e pushtetit populluer. Lidhja ndërmjet këtyne kuvendeve dhe Kuvendit populluer në Zagreb nuk mbahej si duhet, mbassi i gjithë komunikacjoni ishte i prishun.

Kryetari i Kuvendit populluer në Zagreb u bâ Anton Korosheci, udhëheqës i klerikëve sllovenë. Ai u zgjodh n'atê pozitë, mbassi mujti me bindë përfaqësuesat sllovenë n'Asamblén e Vjenës që të këpusë lidhjen me Austrín. Korosheci bashkë

me disa përfaqësuesa tjerë të Kuvendit populluer mbërrijti në Gjenevë për të bisedue me përfaqësuesat e qeverís sërbe dhe me ata të Këshillit jugosllav. Rezultati i atyne bisedimeve nxorri »Deklaratën e Gjenevës«, me anën e së cilës Kuvendit populluer íu njoftë e drejta me përfaqësue qeverín në teritorin e ish-Austro-Hungarís. Poashtu u vendosë edhe me u zgjedhë ministri i përbashkët për mbretnín e Sërbís dhe për teritorin e Kuvendit populluer në Zagreb. Ajo ministrí e përbashkët duhej të kryente punët deri sa të përpilohej kushtetuta e re.

Pra, në Zagreb u mblodh Kuvendi populluer si qeveri e Kroatëve, Sërbëve dhe Sllovenëve. Por kur Kuvendi filloi me shpallë vendimet e veta, si përfaqesues i shtetit të ri, aleatët — Amerika, Anglija dhe Franca — nuk e njohtën atê shtet të Kroatëve, Sërbëve dhe Sllovenëve.

Në nji gjendje të tillë, me 24 Dhetuer të vjetit 1918, plenumi i Kuvendit populluer dha vendim që shteti i Sërbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve të bashkohet me Mbretnín e Sërbís dhe Malin e Zi. N'atê mbledhje u zgjondhën delegatët që do të shkojshin në Beligrad për t'i dorëzue vendimin e Kuvendit populluer, regjentit Aleksandër.

Delegacjoni i Kuvendit populluer dhe përfaqësuesat e Sërbís, në mbledhjen e përbashkët me 1 Dhetuer të vjetit 1918, shpallën unjisimin e Sërbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Regjenti deklaroi se »do të jetë mbret vetëm për qytetarët e lirë të Sërbís, Kroacís dhe Sllovenís«.

N'atê mbledhje u shpall shteti i ri — Mbretnija e Sërbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, e me këtê papujve tjerë iu mohue kombësija. Shteti i krijuem u bâ Monarki. Turmat e gjana popullore, të lodhuna gjatë kohës së luftës në të cilën dhanë flíjime të shumta, shum shpejt panë se dobín prej fitores filloi me nxjerrë vetëm nji grup i vogël kapitalistash të mëdhej dhe njerëzit në pozita të nalta. Sërbija, e cila gjatë luftës humbi nji miljon njerëz dhe që prej saj duel prej luftës si ngadhnjimtare, ra në pozitë që n'emën të saj të flasin njerëzit, të cilët nuk kishin kurrgjâ të përbashkët me ndjenjat e populllit. Luftarët

dhe invalidët u lanë mbas dore, kurse kapitalistat e mëdhej sërbë, kroatë dhe sllovenë, zgjidhshin çashtjet politike ashtu si dëshirojshin ata. Te popujt në shtetin e Sërbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve u ngjall shpejt moskënaqësija, mbassi nuk fituen lirín e dëshirueme. Veçanisht ishin të pakënaqun Maqedonasit dhe Malazezët, të cilëve iu shkurtue lirija kombëtare. Mbas nji kohe shum të shkurtë panë se po largoheshin gjithënji mâ shum prej asaj që u ishte premtue kur dhanë pëlqimin e vet për krijimin e shtetit të përbashkët.

## PËRMBAJTJA


Faqe

**ZHVILLIMI I EKONOMÍS KAPITALISTE TE POPUJT JUGOSLLAVË** — — — — — — — — — — — — — — — — — — 3

**Zhvillimi i marrëdhanjeve kapitaliste dhe ndërtimi i organizatës borgjeze shtetnore në Sërbi** — — — — — — — — — — — 3

Despotizmi i Milloshit dhe monopolizimi i tregtís — — — 3

Çashtja agrare, turbullimet popullore dhe kushtetuta e parë 4

Zyrat e para shtetnore; zanafilla e klasës qytetare dhe formimi i byrokracís — — — — — — — — — — — — — 8

Ngritja e borgjezís, zhvillimi i xeheve dhe i ekonomís monetare. — Ndamja e kalundit në klasa shoqnore — — 9

Qëndrimi i Sërbís në vjetin 1848 dhe në kohën e luftës së Krimés — — — — — — — — — — — — — — — — — — — 11

Regjimi apsolutist i Mihal Obrenoviqit, puna në propagandën nacjonale dhe fitimi i qyteteve — — — — — — — — — 14

Rilindja kulturore e Sërbís dhe puna e Vuk Karaxhiqit — 17

**Mali i Zi në luftë për pamvarësi** — — — — — — — — — — — — — 19

Luftat kundër Turqve dhe Francezëve; lidhjet me Rusín — 19

Puna e Petrit të I dhe e Petrit të II për mbarështrimin e mbrendëshëm të vendit dhe rrethanat ekonomiko-kulturore — — — — — — — — — — — — — — — — — — 22

Princi Danillo dhe vendosja e sundimit të shejtë — — — — 25

**Lëvizja nacjonale te popujt jugosllavë** — — — — — — — — — — 28

**Rilindja popullore te Kroatët** — — — — — — — — — — — — — — 28

Lufta kundër dëshirave centraliste të Vjenës dhe Peshtës 28

Lëvizja ilire — — — — — — — — — — — — — — — — — — — — 30

Formimi i partive politike — — — — — — — — — — — — — — 32

**Rilindja popullore te Sllovenët** — — — — — — — — — — — — — 35

Periudha e okupacjonit francez — — — — — — — — — — — 35

Përforcimi ekonomik dhe zhvillimi i lëvizjes popullore — 36

Dy rryma në shoqnín sllovene — — — — — — — — — — — — 39

**Popujt jugosllavë në vjetin 1848** — — — — — — — — — — — — — 41

Rrethanat ekonomike dhe shoqnore te Sërbët në Hungarín jugore dhe revolucjoni i vjetit 1848. Asambleja e Majit në Karllovcin e Sremit — — — — — — — — — — — — — 41

Asambleja e Marsit në Zagreb: Kryengritja katundare — syprimimi i bujqëve-robë — — — — — — — — — — — — 44

Programi i »Bashkimit të Sllovenís« — — — — — — — — 47

Faqe

Dëshirat shlirimtare të turmave të popullit dhe qëndrimi reakcjonar i príjsave sërbë e kroatë — — — — — — — — 48

**Rilindja popullore te Maqedonasit** — — — — — — — — — — — — 50

Sistemi i beglerëve dhe gjendja e popullit maqedonas, zhvillimi i qyteteve dhe dukja e borgjezis maqedonase — — 50

Fillimet e zgjimit nacional — rilindja popullore dhe vllaznit Milladinovë — — — — — — — — — — — — — — — — 52

**Zhvillimi i matejshëm i marrëdhanjeve kapitaliste në vendet jugosllave dhe luftat nacjonale të popujvet tanë nën kushtet e depërtimeve imperjaliste në Ballkan. Lëvizja punëtore te Jugosllavët** — — — — — — — — — — — — — — — 56

**Kalimi n'ekonomín kapitaliste në Sërbi. Luftat për të drejta kushtetuese dhe për demokraci qytetare** — — — — — — — 56

Kalimi n'ekonomín kapitaliste, forcimi i borgjezís; shkatërrimi i kooperativizmit dhe vorfnimi i katundarís — — 56

Svetozar Markoviqi dhe puna e tij për përhapjen e ideve socijaliste; zanafilla e lëvizjeve punëtore — — — — — — 60

Luftat shlirimtare të Sërbís kundër Turqís (1876—1878) dhe Kongresi i Berlinit. Sërbija si shtet i pamvarum — — 67

Regjimi apsolutist dhe politika austrofile e Millan Obrenoviqit; konflikti me borgjezín — — — — — — — — — — 70

Formimi i partive të para politike qytetare: Kryengritja e Timokut; Lufta sërbo-bullgare dhe kushtetuta e vjetit 1888 74

Grusht shteti i Majit të vjetit 1903 — — — — — — — — — 81

**Hovi ekonomik dhe përforcimi politik i Sërbis në kushtet e demokracis borgjeze dhe parlamentarizmit** — — — — — — — 87

Fillimi i demokracís qytetare dhe i parlamentarizmit; lulëzimi i industris dhe përforcimi i kapitalit të madh të vendit; depërtimi i kapitalit të huej — — — — — — — 87

Zhvillimi i industrís fabrikante dhe shtimi i proletarjatit qytetar. Fallimet, e lëvizjes, moderne punëtore — — — 91

Lufta doganore — lufta për emancipimin ekonomik të Sërbís prej Austro-Hungaris — — — — — — — — — — — — — 95

Krijimi i Lidhjes ballkanike planet agresive të borgjezís; dëshirat shlirimtare të turmave të gjana popullore; Lufta e parë ballkanike dhe randësija e saj progresive, dhe Lufta e dytë sërbo-bullgare — — — — — — — — — — — 98

**Lufta e parë ballkanike** — — — — — — — — — — — — — — 101

**Lufta sërbo-bullgare në vjetin 1913** — — — — — — — — — — 104

**Luftat autonome të Sërbëve të Vojvodinës** — — — — — — — 107

Kuvendet popullore-kishëtare dhe luftat për ruejtjen e të drejtave autonome. Svetozar Miletiqi — — — — — — 107

Përhapja e kapitalizmit gjerman dhe hungarez; rezistenca kundër hungarizimit. Zhvillimi i lëvizjes punëtore — — 112

Zhviliimi i lëvizjes punëtore — — — — — — — — — — — 114

**Mali i Zi dhe luftat e tij shlirimtare** — — — — — — — — — — 116

Mali i zi dhe kryengritjet hercegovase; lufta me Turqit (1876—1878); Kongresi i Berlinit dhe fitimi i pamvarësís shtetnore — — — — — — — — — — — — — — — 116

Regjimi personal i princ Nikollës dhe rezistenca e njerëzve përparimtarë, kushtetuta e vjetit 1905. Mali i Zi në luftat e vjetit 1912 dhe 1913 — — — — — — — — — — — — 121

**Bosna e Hecegovina prej vjetit 1875—1914** — — — — — — — — 123

Faqe

Gjendja e vështirë e rajes dhe kryengritjet kundër eksploatimit të përforcuem dhe begllëkut; Kryengritja boshnjako-hercegovase e vjetit 1875—1878 — — — — — — — — — — — 125

Kongresi i Berlinit, okupacjoni dhe qeverimi austriak në Bosnje dhe Hercegovinë — — — — — — — — — — — — — — 131

Aneksimi i Bosnjës dhe i Hercegovinës si bazë për depërtimin e mâtejshëm t'Austro-Hungarís dhe Gjermanís në Lindje. Bosnja e Re — — — — — — — — — — — — — — 135

**Lëvizja shlirimtare e popullit Maqedon** — — — — — — — — — — 139

Gjendja ekonomike e Maqedonasve në gjysmën e dytë të shekullit të XIX. Krijimi i egzarkís. Propaganda sërbe dhe bullgare kah fundi i shekullit XIX — — — — — — — 139

VMRO dhe Kryengritja e Ilindenit, Goce Delçevi. Kundërshtimi i interesave të fuqive të mëdha në Maqedoni. Politika pushtuese e shtetevet ballkanikë ndaj Maqedonnís — Luftat ballkanike dhe shtypja e re nacjonale — — 143

**Kroacija mbas vjetit 1848** — — — — — — — — — — — — — — 147

Kushtet ekonomike dhe politike mbas vjetit 1848. Koha e apsolutizmit — — — — — — — — — — — — — — — — 147

Formimi i partive politike, marrëveshtja e vjetit 1868; pengimi i zhvillimit ekonomik të Kroacís nga ana e Hungarezëve. Partija e drejtësís; randësija e Ante Starqeviqit. Kryengritja e Rakovicës. — Lufta e përbashkët e Kroatëve dhe Sërbëve për liri — — — — — — — — — — — — 149

Marrëveshtja e vjetit 1868 — — — — — — — — — — — — — 152

Partija e drejtësís (juriste) dhe Ante Starqeviqi — — — — 153

Turbullimi i Rakovicës — — — — — — — — — — — — — — 154

Rilindja e Dalmacís dhe e Istrës — — — — — — — — — — 155

Qeverimi i Kuenit në Kroaci. Zhvillimi i industrís së fabrikave, lëvizja punëtore. Vllaznit Radiqë — — — — — — — 158

Zhvillimi i industrís në fabrikat dhe lëvizja punëtore — — 160

Vllaznit Radiqë — — — — — — — — — — — — — — — — 162

Idét e bashkimit sërbo-kroat. Supili. Koalicjoni sërbo-kroat 164

**Sllovenët deri në vjetin 1914** — — — — — — — — — — — — 167

Zhvillimi ekonomik dhe forcimi i borgjezís sllovene.

Lëvizja e Sllovenëve të rij (Fran Levstiku). Depërtimi gjerman n'Adriatik — — — — — — — — — — — — — — — 167

Zanafilla e partive politike, lëvizja punëtore dhe kooperativizmi, shpërnguljet, dëshirat për shlirim socjal dhe nacjonal — — — — — — — — — — — — — — — — 171

**Popujt jugosllavë në periudhën e Luftës së parë botënore dhe të revolucjoneve socjaliste** — — — — — — — — — — 177

**Imperjalizmi — stadjumi monopolist i kapitalizmit** — — — — — 177

Imperjalizmi gjerman dhe politika e tij agresive për të fitue tregje të rij dhe për të bâ ndamjen e re të botës. Krijimi i dy blloqeve anmiq të vendeve imperjalist — — — — — 177

Lufta e parë botënore — — — — — — — — — — — — — — 183

Revolucjoni i Tetorit — — — — — — — — — — — — — — 190

**Sërbija, Mali i Zi dhe popujt jugosllavë në Luftën e parë botënore** 194

Imperjalizmi Austro-gjerman si pengesë kryesore për shlirimin dhe unjisimin e popujve jugosllavë. Atentati i Sarajevës. Ultimatumi i Austro-Hungarís dhe fillimi i luftës 194

Faqe

Fitimet e ushtrís sërbe dhe malazeze. Pakti i Londrës. Ofensiva gjermano-austriako-bullgare në vjeshtë të vjetit 1915 dhe pushtimi i Sërbís dhe i Malit Zi. Kalimi i ushtris sërbe nëpër Shqipni dhe kapërximi i saj në Korfuz — — 196

Formimi i frontit të Selanikut, ofensiva e vjetit 1916. Shpërthimi i frontit të Selanikut në vjeshtë të vjetit 1918; thyemja e fuqive t'Europës qendrore — — — — — — — 200

Gjendja e popujvet tanë nën Austro-Hungarin gjatë kohës së luftës. Ndjekja e Sërbëve dhe e të gjithë elementeve përparimtarë. Ndalimi i të gjitha organizatave punëtore. Krijimi i këshillave jugosllave. Deklarata i Korfuzit. Aspiratat progresive të turmave popullore për krijimin e shtetit të përbashkët. Aspiratat reakcjonare të borgjezís. — — — — — — — — — — — — — — — — — 201

Revolucjonimi i turmave nën ndikimin e Revolucjonit të Tetorit. Forcimi i lëvizjes punëtore. Krijimi i shtetit SHS (SKS) — — — — — — — — — — — — — — — 206

GOJKO M. SOLARIQ

**HISTORIJA**
për klasën e VIII të shkollës tetëvjeçare dhe
për klasën e IV gjimnaz

Korektor:
ADEM BLLACA

Redaktori teknik:
DRAGICA SHESTANOV

Madhësija: 13½ tabakë shtypi

Tirazhi: 3.000 copë

Shtypshkroja »Jugoshtampa« — Beligrad — 1953